

Partnerët e Monitorimit të Komunave



Organizata Jo Qeveritare



KOMUNË E HAPUR DHE PËRFSHIRËSE
REALITET APO PREMTIM ZGJEDHOR?



KOMUNË E HAPUR DHE PËRFSHIRËSE REALITET APO PREMTIM ZGJEDHOR?



Përkrahur nga:



Me mbështetjen e:



ISBN 978-9951-8901-0-6



VLERËSIM VJETOR I KOMUNAVE TË KOSOVËS
2013

VLERËSIM VJETOR I KOMUNAVE TË KOSOVËS
2013

KOMUNË E HAPUR DHE PËRFSHIRËSE
REALITET APO PREMTIM ZGJEDHOR?



VLERËSIM VJETOR I KOMUNAVE TË KOSOVËS
2013

Copyright ©2014. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI).

Ky punim është bërë në kuadër të Projektit “Angazhimi Qytetarë për Transparencë dhe Llogaridhënie në Nivel Lokal.” Ky punim u mundësua me përkrahjen e United Nations Democracy Fond (UNDEF) i cili ka mbështetur KDI-në gjatë kësaj iniciative për monitorim dhe evokim për qeverisje lokale dhe ngritjen e kapaciteteve lokale për të angazhim qytetar në qeverisje lokale.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje e Përgjithshme	7
Hyrje.....	8
1. Komuna DEÇAN.....	11
Transparenca në Komunë.....	13
Llogaridhënia në Komunë	14
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	<i>15</i>
<i>Financat në Komunë</i>	<i>15</i>
<i>Disa vendime të rëndësishme komunale</i>	<i>15</i>
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	16
Rekomandimet për Komunë.....	17
2. Komuna GJAKOVË	24
Transparenca në Komunë.....	25
Llogaridhënia në Komunë	26
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	<i>26</i>
<i>Financat në Komunë</i>	<i>27</i>
Premtimet e Kryetarës së Ri	29
Rekomandimet për Komunë.....	30
3. Komuna KAÇANIK	38
Transparenca në Komunë.....	39
Llogaridhënia në Komunë	40
Urbanizmi në Komunë.....	41
<i>Financat në Komunë</i>	<i>41</i>
<i>Shërbimet jashtë institucioneve komunale.....</i>	<i>41</i>
<i>Qendra për Regjistrimin e Automjeteve Larg Vëmendjes së Komunës</i>	<i>42</i>
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	43
Rekomandimet për Komunën e Kaçanikut	44
4. Komuna KLINË	52
Transparenca në Komunë.....	53
Llogaridhënia në Komunë	54
Urbanizmi në Komunë.....	55
<i>Financat në Komunë</i>	<i>56</i>
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	58
Rekomandimet për Komunë.....	59
5. Komuna FUSHË KOSOVË	66
Transparenca në Komunë.....	67

Llogaridhënia në Komunë	67
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	68
<i>Financat në Komunë</i>	68
<i>Ujii pijes dhe ndërtimet egra</i>	68
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	69
Rekomandimet për Komunë.....	70
6. Komuna KAMENICË.....	78
Transparenca në Komunë.....	80
Llogaridhënia në Komunë	81
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	81
<i>Financat në Komunë</i>	82
<i>Parku i askujt</i>	82
<i>Problemet me ndriçim</i>	83
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	83
Rekomandimet për Komunë.....	84
7. Komuna MITROVICË	92
Transparenca në Komunë.....	93
Llogaridhënia në Komunë	94
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	95
<i>Financat në Komunë</i>	96
<i>Çështjet tjera nga raporti qytetar- pushtet lokal</i>	96
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	97
Rekomandimet për Komunë.....	98
8. Komuna SKENDERAJ.....	106
Transparenca në Komunë.....	107
Llogaridhënia në Komunë	108
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	108
<i>Financat në Komunë</i>	109
<i>Dëgjimet Buxhetore dhe Buxheti</i>	110
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	111
Rekomandimet për Komunë.....	112
9. Komuna SHTIME.....	120
Transparenca në Komunë.....	122
Llogaridhënia në Komunë	122
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	124
<i>Financat në Komunë</i>	124

Premtimet e Kryetarit të Ri.....	125
Rekomandimet për Komunë.....	126
10. Komuna VITI	134
Transparenca në Komunë.....	135
Llogaridhënia në Komunë	136
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	<i>137</i>
<i>Financat në Komunë</i>	<i>138</i>
<i>Komuna e Vitisë paguan rreth 35 mijë euro dënime nga gjykata</i>	<i>139</i>
<i>Kuvendi Komunal për gjatë gjithë mandatit nuk funksionalizon komitetet jo obligative</i>	<i>139</i>
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	139
Rekomandimet për Komunë.....	140
11. Komuna MALISHEVË.....	150
Transparenca në Komunë.....	151
Llogaridhënia në Komunë	152
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	<i>153</i>
<i>Financat në Komunë</i>	<i>153</i>
<i>Miratimi i Planit të Veprimit Rinor Lokal.....</i>	<i>154</i>
<i>Vendimi për vazhdimin e ndarjes së Mjeteve financiare për disa raste sociale, si dhe familje me nevoja të ndryshme</i>	<i>154</i>
<i>Vendimi për caktimin e mbeturinave Inerte</i>	<i>154</i>
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	155
Rekomandimet për Komunë.....	156
12. Komuna e JUNIKUT	164
Transparenca në Komunë.....	165
Llogaridhënia në Komunë	166
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	<i>166</i>
<i>Financat në Komunë</i>	<i>166</i>
<i>Vendime të rëndësishme</i>	<i>167</i>
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	167
Rekomandimet për Komunë.....	168
13. Komuna MAMUSHË	174
Transparenca në Komunë.....	175
Llogaridhënia në Komunë	176
<i>Urbanizmi në Komunë</i>	<i>176</i>
<i>Financat në Komunë</i>	<i>177</i>
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	177
Rekomandimet për Komunë.....	179

14. Komuna GRAÇANICË	186
Transparenca në Komunë.....	187
Llogaridhënia në komunë.....	188
<i>Urbanizimi në komunë.....</i>	<i>189</i>
<i>Financimi në komunë.....</i>	<i>190</i>
<i>Problemet e tjera në administratën e Komunës.....</i>	<i>190</i>
Premtimet e Kryetarit të Ri.....	191
Rekomandimet për Komunë.....	192
15. Komuna PRIZREN	200
Shkeljet ligjore	200
Seancat plenare.....	200
Komiteti për Politikë dhe Financa	201
Urbanizmi në Komunë.....	201
16. Komuna SUHAREKË	206
Transparenca në Komunë.....	206
Shkeljet ligjore	206
Urbanizmi në Komunë.....	207
Vendimet e miratuara	207
17. Komuna RAHOVEC	212
Seancat Plenare.....	212
Komiteti për Politik dhe Financa.....	212
Transparenca në Komunë.....	213
18. Komuna DRAGASH	218
Transparenca në Komunë.....	218
Shkeljet Ligjore	219
Përfundimet	220

Përmbledhje e Përgjithshme

Viti 2013 shënoj përmbylljen e mandatit të katërt të qeverisë lokale në demokracinë e re të Kosovës. Gjatë kësaj kohe, qeveria lokale ka kaluar nëpër reforma të ndryshme dhe ka avancuar dukshëm qoftë në kompetenca qoftë në sistem zgjedhor, ndërsa mjetet buxhetore vetanake dhe grante qeveritare janë rritur gradualisht. Madje edhe aktet ligjore që sigurojnë transparencë, llogari dhe përfshirje në nivel lokal kanë evoluar në drejtim të mirë.

Për kundër këtyre arritjeve, monitorimi jonë i komunave tona gjithandej Kosovës tregon që shumë qeveri lokale, përfshirë këtu edhe administratën lokale, mbesin të mbyllura për publikun dhe anashkalojnë kërkesat dhe mendimet e qytetarëve. Niveli i transparencës në komuna mbetet i dobët ku dokumente bazike si rregulloret komunale, procesverbalet e Kuvendit, planet urbanistike, buxheti i komunës, raportet e shpenzimeve nuk publikohen në faqen zyrtare të komunës, ndërsa kërkesat për qasje në dokumente zyrtare shpesh shkojnë pa u përgjigjur apo kthehen me shumë vonesë, gjë që përbën edhe të thyerje ligjore. Në ato komuna ku nuk ka patur zyrtarë për informim apo aty ku këta zyrtar kanë qenë tejet pasiv, transparenca ndaj qytetarëve, si element thelbësor i një qeverisje të mirë, ka mbet vetëm në fjalorin e të zgjedhurve.

Ka patur kryetarë që kanë mbajtur takime të rregullta me qytetarë, por ka patur edhe kryetarë që kanë qenë pak prezent madje edhe kryetarë që nuk kanë jetuar fare në komunën që kanë udhëhequr, gjë që konsiderojmë që ndikon në efikasitetin e punës si dhe prekjen e problemeve ditore të qytetarëve të komunës që udhëhiqet.

Drejtoritë e Urbanizimit përpos që kanë patur Planet Zhvillimore Urbane shumica e atyre që kemi monitoruar janë përballur me ndërtime pa leje dhe tejkalim të lejeve të ndërtimit. Kryetarët janë treguar indiferentë ndaj mbikëqyrjes së zbatimit të PZHU-ve, madje në njërin komunë Kryetari ka insistuar tek Drejtori i tij i urbanizimit që të nënshkruaj lejen e ndërtimit për një ndërtesë edhe pse do të ishte në kundërshtim me PZHU-në. Drejtorit i Urbanizimit në këtë rast ka dhënë dorëheqje dhe nuk ka nënshkruar.

Përderisa transparenca në proces legjislativ, gjegjësisht në kuvende komunale, ka shënuar përmirësim nga vitet e kaluara, sidomos përmes transmetimeve në televizione lokale në disa komuna, sallat e vogla në shumicën e kuvendeve komunale kanë pamundësuar ulëse për qytetarë të interesuar. Po ashtu, njoftimet për takime të Kuvendit dhe komiteteve legjislative nuk janë bërë publike për komunitetin e gjerë dhe kjo ka parandaluar qytetarë të interesuar të marrin pjesë në debatet politike për çështjet e komunës së tyre.

Më alarmante ka qenë pasiviteti i përfaqësuesve në kuvende komunale për të mbledhur qytetarët dhe të konsultohen për çështje që i preokupojnë në nivel ditor ato komunitete dhe pastaj të ngritën në kuvende. Përderisa niveli i pjesëmarrjes së anëtarëve në seanca të kuvendit dhe komitet ka qenë i lartë, një masë e madhe e tyre kanë qenë pasiv sa i përket drejtimit të Kryetarit të komunës dhe drejtorëve, si ekzekutiv i komunës, me pyetje të qytetarëve. Në të gjithat komunat që kemi monitoruar kemi evidentuar disa anëtarë të kuvendit që gjatë tërë vitit nuk kanë ngritur zërin asnjëherë për ndonjë çështje të komunës.

Konsultimi me qytetarë të komunës në përgjithësi, nga ekzekutivi dhe legjislativi komunal, mbetet në nivel të ulët. Kjo gjendje është vërejtur të ketë krijuar qytetar të pakënaqur për shkak të mungesës së informimit për punën e qeverisjes lokale. Këshillat lokale edhe pse të rregulluar me udhëzim administrativ mbeten jo të funksionalizuar mirë, madje në shumë komuna kanë qenë të politizuar nga Kryetarët e Komunave. Këto këshilla, që mund të jenë shumë të rëndësishme për konsultim qytetar, nuk kanë qenë të fuqizuar dhe në shumicën e rasteve janë anashkaluar nga Kryetari si dhe anëtarët e Kuvendit komunal.

Hyrje

Të gjeturat e këtij punimi janë të bazuara në monitorimin e rregullt dhe të vazhdueshëm të komunave gjatë gjithë vitit 2013. Me këtë iniciativë monitorohen gjithsej 18 kuvende komunale duke përfshirë të gjitha rajonet e Kosovës. Organet që janë monitoruar më direkt kanë qenë Kuvendi komunal, zyra e kryetarit, si dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Drejtoria e Financave si drejtori me çështje të ndjeshme nën kompetencë.

Monitorimi i komunave është bërë nga organizata jo-qeveritare që operojnë në këto komuna, ndërsa KDI ka monitoruar drejtpërdrejtë vetëm komunat e rajonit të Prizrenit.

KDI ka dizajnuar metodologjinë e monitorimit duke përfshirë këtu edhe mjetet e monitorimit dhe ka trajnuar organizatat partnere në monitorim dhe raportim. Metodologjia e monitorimit ka pasur për qëllim matjen e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit të punës së organeve komunale. Qëllimi ka qenë që të bëhet monitorimi i gjitha komunave me një metodologji të njëjtë që qytetarët si dhe zyrtarët të mund të bëjnë edhe krahasime me qeverisje lokale të komunave tjera të Kosovës.

Raporti po ashtu ofron rekomandime tek institucione lokale si Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e Financave, Kryesuesi i Kuvendit dhe Anëtarët e Kuvendit. Edhe pse tashmë shumë nga kryetarët e mandatit të kaluar nuk janë më në zyre të Kryetarit, besojmë se këto rekomandime duhet të merren parasysh nga qeverisja e re sepse besojmë që kjo qeverisje të jetë më e avancuar se e kaluara.

Më tutje, KDI dhe organizatat partnere kanë monitoruar premtimet e kandidatëve për kryetarë të komunave për zgjedhje lokale 2013 dhe për secilën komunë ka vënë një tabelë me premtimet e kandidatit të zgjedhur duke përfshirë: prioritetet, projektet kapitale si dhe premtimet për transparencë dhe llogaridhënie ndaj qytetarëve. Kjo do të mundësojë qytetarëve të mbajnë përgjegjës të zgjedhurit e tyre ndaj këtyre premtimeve dhe do të mundësojë që ne të monitorojmë udhëheqjen e re nëse do të bëjë këto premtime realitet apo do të lënë të flejë në fushatë zgjedhore. Për komunat e rajonit të Prizrenit, KDI ka bërë raporte më të detajuara prandaj dhe në këtë raport përfshihen vetëm disa të gjetura kryesore të këtyre komunave.

OJQ-të partnere për këtë nismë janë: Bashkohu Edhe Ti – Gjakovë, Elita – Viti, Fortesa – Kamenicë, Iniciativa Për Zhvillim Lokal - Fushë Kosovë, Instituti Demokratik i Kosovës – 6 komuna Rajon i Prizrenit, Klubi i Gazetarëve - Kaçanik, KOHA – Klinë, Mundësia – Mitrovicë, POLIS- Shtime, Prehja – Skenderaj, Shoqata Intelektualëve të Pavarur - Deçan dhe Junik, Srpska Demokratska Omladina – Gračanica.

Raporti Monitorimit 2013



Komuna

Deçanit


SHOQATA E INTELKTUALËVE TË PAVARUR




ASSOCIATION OF INDEPENDENT INTELLECTUALS

Struktura e Komunës

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



1. Komuna DEÇAN

Problemet kryesore të komunës

Përkundër faktit që ka resurse të shumta zhvillimore, qofshin ato mbi-tokësore apo nën-tokësore, Deçani, mbetet njëra ndër komunat më të pa zhvilluara të Kosovës.

Qytetarët e Deçanit përballen me probleme të shumta, siç janë:

- Mungesë të kanalizimit të ujërave të zeza,
- Furnizim të pamjaftueshëm me ujë të pijes,
- Ndotje të mjedisit,
- Shkatërrimi i pyjeve dhe pa mundësia e shfrytëzimit të resurseve turistike,
- Papunësia,
- Mos-efikasiteti i shërbimit të inspekcionit,
- Huliganizmi në shkolla të mesme dhe rrugë,
- Pamundësia e lëvizjes së lirë nëpër trotuare, përgjatë rrugës kryesore, nga parkimi e automjeteve,
- Mungesa e rregullores komunale për bashkëpunim me fshatrat e Deçanit etj.

Të arriturat në vitin e kaluar

Komuna e Deçanit, për dallim nga mandati paraprak, ka shënuar rritje të investimeve dhe zhvillimit me ç'rast edhe janë realizuar projekte në shumë fusha, kryesisht në infrastrukturën rrugore. Gjatë këtij mandati, ka rritje të nivelit të transparencës komunale, si në mënyrën e komunikimit me legjislativin apo ekzekutivin e komunës, apo edhe në organizime të ndryshme, duke iu dhënë hapësirë, edhe shoqërisë civile. Raportet në mes të nivelit lokal dhe atij qendror ishin më të afërta, krahasuar me mandatin paraprak, ku edhe është vërejtur një bashkëpunim më i madh, e që ka ndikuar në marrjen e fondeve qeveritare, për realizim të projekteve kapitale.

Një e arritur me rëndësi për këtë komunë është edhe emërtimi i shesheve dhe rrugëve, kur dihet se Deçani është njëra ndër dy komunat e para në Kosovë, që ka realizuar këtë projekt, pastaj fillimi i realizimit të projektit për ndërtimin e kanalizimit të ujërave të zeza. Deçani ishte komuna e vetme në Kosovë që s'kishte kanalizim, as në qendër të Deçanit. Së shpejti pritet edhe përfundimi i projektit për furnizim me ujë të pijes për dhjetë fshatra, projekt ky për të cilin kryetari i komunës ka premtuar që do përfundoj para mbajtjes së zgjedhjeve lokale.

Vlerësimi i performancës

Kryetari i komunës krahasuar me paraardhësin e tij, ishte më i hapur në komunikim, si me qytetarë, media apo përfaqësues të institucioneve të tjera, qeveritare dhe joqeveritare. Raportet e Kryetarit me Qeverinë e Republikës së Kosovës ishin të mira krahasuar me kolegun e tij, ku kishte raporte të shkëputura, duke shkëmbyer edhe akuza të ndërsjella me Qeverinë e Kosovës. Mirëpo, kryetari i Deçanit, në raste, nuk kishte respektuar procedurat ligjore apo statusore, sidomos kur ka të bëjë me raportimin para anëtarëve komunal. Ai, po ashtu, gjatë katër viteve të tij si kryetar komune, ka vepruar në kundërshtim me Statutin e komunës, duke rritur numrin e drejtorive komunale, megjithëse në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nuk kufizohet numri i drejtorive komunale. Kryetari i komunës, Rasim Selmanaj,

disa herë është akuzuar nga opozita deçanase, kryesisht nga LDK-ja, për keqqeverisje, keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe shpërdorim të buxhetit komunal. Po ashtu, ai është akuzuar edhe për dyshime për favorizime të shërbyesve civil, favorizime në baza partiake apo shoqërore, duke ngritur koeficientet e pagesës, apo edhe, duke ndarë subvencione, me arsyetimin për punë shtesë, që në praktikë nuk qëndron një arsyetim i tillë. Ai është ftuar edhe në bisedë informative në prokurorinë e Pejës, për dyshimet e ngritura ndaj tij.

Drejtorët e Drejtorive Komunale si këshilltar të kryetarit të komunës, kanë treguar një performancë relativisht të mirë, ku disa nga ata, ishin më të angazhuar, ndërsa disa të tjerë kanë mund të bëjnë më tepër siç do të shtjellojmë më poshtë në raport. Edhe qasja e kryetarit ndaj grupit të tij këshillues, nuk ishte e njëjtë, duke dhënë favore për disa nga ata, qoftë me angazhime shtesë apo edhe në mënyra të tjera. Përkundër asaj që është premtuar nga kryetari Selmanaj se, varësisht nga performanca që do tregojnë drejtorët e tij, edhe do të bëj ndërrime, këtë gjë nuk e ka bërë, për arsye të ndryshme. Prania e drejtorëve të drejtorive komunale në seancat e Kuvendit dhe takimet e KPF-së ishte e paktë dhe ka ndodhur që në këto takime të mos jetë prezent, as kryetari i komunës dhe as drejtorët e tij. Pos drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe asaj të Urbanizmit dhe Planifikimit, nuk janë prezantuar raporte të punës, gjatë gjithë mandatit qeverisës.

Anëtarët e Kuvendit Komunal si përfaqësues të qytetarëve, duhet të jenë të përgjegjshëm ndaj zgjedhësve tyre, me ç'rast edhe janë të obliguar që shqetësimet e qytetarëve t'i parashtrajnë për diskutim dhe të marrin vendimet e duhura në bazë të hapësirave ligjore, pa dallim partie. Mirëpo, një pjesë e madhe e këtyre anëtarëve, më shumë ishin të interesuar për pagat e tyre, se të përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Gjatë mandatit të kaluar, kishte këshilltar që asnjëherë nuk kanë diskutuar në seancat plenare, sikurse që është shqetësuese dukuria e lëshimit të seancave, gjë që ka vënë në dilemë, edhe kuorumin e nevojshëm në disa raste.

Seancat Plenare

Kryesuesi i seancave, në të shumtën e rasteve, nuk ka reflektuar ndonjë preferencë të veçantë për asnjërin grupim politik. Kryesuesi i KK-së, gëzonte një respekt nga ana e anëtarëve komunal, ndaj edhe ka bërë që seancat të kalojnë pa ndonjë problem të theksuar, dhe kështu nuk ka ndodhur që të ndërmerren masa ligjore ndaj anëtarëve apo të ketë ndërprerje të diskutimeve, marrjes së fjalës, largimit nga seanca apo edhe masa tjera të parapara me aktet ligjore. Po ashtu, nuk kemi pasur raste kur kryesuesi është detyruar të ndërpres fjalën e anëtarëve për shkak të tejkalimit të kohës të paraparë, sepse nuk është tejkaluar koha e planifikuar, por edhe në disa raste, kryesuesi ka bërë tolerime të cilat ishin në mirëkuptim me të gjithë të pranishmit.

Transparenca në Komunë

Seancat Plenare

Transparenca komunale, si te legjislativi ashtu edhe tek ekzekutivi, ka shënuar ngritje, duke bërë që qytetarët, sidomos shoqëria civile, të kenë më shumë informacione rreth aktiviteteve komunale. Gjatë mandatit të shkuar, është arritur progres në paralajmërimin e seancave të Kuvendit, duke shfrytëzuar edhe ueb-faqen zyrtare të komunës, por edhe monitorin e vendosur në hyrje të komunës. OSBE-ja ka përkrahur komunën e Deçanit, edhe me vendosjen e tabelës informative në qytet, që do mundëson vendosjen e publikimeve, ftesave, njoftimeve dhe shpalljeve të tjera, me interes për qytetarët. Po ashtu, është rritur bashkëpunimi me media, si për njoftim të seancave, apo edhe të agjendës së planifikuar, ndërsa materiali i takimit, varësisht nga interesimi i palëve. Me sugjerime edhe të OSBE-së dhe shoqërisë civile ka përmirësim të dukshëm edhe në freskimin e ueb-faqes zyrtare, pasi që kohë më parë kjo ishte e herëpashershme.

Nga OJQ-të vendore, monitorimin e punës së komiteteve dhe seancave plenare, e bën vetëm SHIP-KDI, ndërsa, nga ato ndërkombëtare, OSBE-ja monitoron e vetme në mënyrë të vazhdueshme. Varësisht nga volumi i punës, materiali i seancave, përpos anëtarëve, iu shpërndahet edhe të pranishmëve tjerë, sidomos mediave dhe monitoruesve të takimit. Në përgjithësi është qasje pozitive ndaj shoqërisë civile.

Edhe pse është kërkuar nga OSBE-ja dhe organizatat e shoqërisë civile krijimi i komiteteve konsultative, duke u bazuar në udhëzimin administrativ të MAPL-së, Deçani nuk ka asnjë komitet konsultativ të formuar.

Qysh në seancën e parë të punës, të vitit 2010, legjislativi komunal kishte marrë vendim për transmetim të seancave nga një medium kosovar, vendim ky i marrur me qëllim të rritjes së transparencës komunale dhe llogaridhënies para qytetarëve të kësaj komune. Pas këtij vendimi, ekzekutivi komunal, duke mos shpallur konkurs kishte kontraktuar televizionin regional me seli në Gjakovë "TV Syri Vizion" që të përcjell aktivitetet e legjislativit dhe ekzekutivit komunal. Ky kontraktim u cilësua nga opozita si shkelje ligjore pasi u akuzua se është fshehur kontrata e lidhur me këtë medium. Anëtarët opozitar, duke mos qenë të kënaqur me përzgjedhjen e bërë, si dhe mos mbulimin korrekt të diskutimeve të Kuvendit nga ky medium, kishin kërkuar që takimet e asamblesë mos të transmetohen nga ky medium. Ky interpretim u cilësua me anime kah partia në pushtet.



Komuna e Deçanit, është e hendikepuar për nga mbulimi medial. përkundër përpjekjeve të disa medimeve që të mbulojnë ngjarjet, ngase shumë pak media të shkruara kanë korrespondent të angazhuar për Deçan. Përderisa mediat kanë hasur në bashkëpunim me legjislativin komunal dhe kanë pas trajtim të duhur, nga ekzekutivi komunal ka pasur edhe raste kur janë kërcënuar apo janë penguar në kryerjen e punëve të tyre.

Mungesa e interesimit të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme për qasje në dokumente zyrtare ka bërë që një numër i vogël i kërkesave të adresohen në zyrën për qasje në dokumente zyrtare. Sipas zyrtarit për qasje në dokumente zyrtare janë adresuar vetëm 11 kërkesa për pajisje me dokumente të kërkuara të cilat kanë qenë kryesisht nga personat juridik, si subjekte politike.

Freskimi i Ueb-faqes së Komunës

Faqja zyrtare e komunës së Deçanit kryesisht freskohet me aktivitetet e zhvilluara nga kreu komunal. Mirëpo, kjo faqe shumë pak është e freskuar me dokumente të rëndësishme si projektet kapitale, buxheti komunal, tenderët publike, konkurse për punë, apo njoftime të natyrave të ngjashme.

Llogaridhënia në Komunë

Anëtarët komunal si përfaqësues të qytetarëve në nivel komunal, në disa raste nuk kanë arsyetuar besimin e marrë. Ata, duke qenë të obliguar që shqetësimet e qytetarëve t'i parashtrijnë për diskutim dhe të marrin vendimet e duhura në bazë të hapësirave ligjore, këtë nuk e kanë bërë. Një pjesë e madhe e këtyre anëtarëve më shumë janë të interesuar për pagat e tyre se sa të përfaqësojnë interesat e qytetarëve.

Prezenca e ekzekutivit komunal gjatë mbajtjes së seancave plenare është e vogël dhe shpesh nuk marrin pjesë në këto seanca. Kishte raste kur anëtarët komunal kërkonin raporte të ndryshme për punën e ekzekutivit komunal, ndërkaq, këto kërkesa injoroheshin duke mos sjell raportet e kërkuara. Ndërhyrjet e drejtorëve komunal, pa lejen paraprake të kryesuesit të kuvendit, ishin të shumta, sikurse edhe daljet e shpeshta jashtë sallës së kuvendit. Është shqetësuese mos-ardhja në kohë, si dhe, lëshimi i seancave nga ana e anëtarëve para përmbylljes së tyre, gjë që sillte në dilemë edhe kuorumin e duhur të seancës.

Raportimi i Kryetarit bazuar në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe Statutin Komunal, kryetari i komunës është i obliguar që së paku dy herë në vit të raportoj para qytetarëve për angazhimet e tij dhe të stafi. Raporti duhet të jetë i prezantuar edhe me shkrim. Gjatë këtij viti 2013, kryetari i komunës, ka raportuar vetëm njëherë para qytetarëve, por jo edhe me shkrim. Ndërkaq takimi i dytë me qytetarë nuk është mbajtur për arsye të fillimi të procesit zgjedhor.

Vlen të ceket se në takimin publik të mbajtur në gjashtëmujorin e parë të vitit, ishin një numër i konsiderueshëm i njerëzve (mbi 60 persona), çka lë të kuptohet se interesimi i qytetarëve për të marrë pjesë në tubimet publike vazhdimisht po shtohet.

Në katër vjet të mandatit të shkuar, kryetari i komunës, Rasim Selmanaj, vetëm njëherë ka raportuar gojarisht, dhe jo me shkrim. Kjo është në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale që parasheh që kryetari i komunës të raportojë çdo gjashtë muaj gojarisht dhe me shkrim.



Legjislativi dhe ekzekutivi komunal, varësisht nga nevoja, janë të obliguar të mbajnë edhe dëgjime publike me grupe të interesit. Në Deçan, dëgjimet publike me qytetar apo edhe me përfaqësues të shoqërisë civile janë mbajtur atëherë kur është trajtuar ndonjë rregullore komunale, strategji zhvillimore apo ndonjë plan rregullues urbanistik. Vitin e kaluar, Komiteti për Politik dhe Financa (KPF) ka mbajtur dëgjime publike edhe për planifikimin buxhetor, ndërsa në vitin 2013 nuk ka pasur dëgjime të tilla.

Grupi Jo-formal i Grave Asambleiste ka organizuar takime me qytetarë të organizuar por në përgjithësi anëtarët komunal kanë qenë pasiv në mbajtjen e takimeve me qytetarët.

Urbanizmi në Komunë

Drejtoria për urbanizëm, përkatësisht drejtori i saj, ka ofruar raporte të punës, varësisht nga kërkesat e anëtarëve komunal, edhe pse nga opozita nuk janë vlerësuar si raporte profesionale. Akuzat e opozitës janë të drejtuara kah kompania që merret me përgatitjen e projekteve, duke thënë se ajo kompani ka marrë para të majme, ndërkohë nuk ka prezantuar projektet e hartuara sikurse që akuza të ngjashme janë adresuar edhe për punët plotësuese të kompanive, si punë shtesë, që vazhdimisht marrin nga komuna. Në adresë të kësaj drejtorie janë dhënë vërejtje të shumta për mos realizimin e projekteve sipas parametrave të planifikuar, si dhe mos-përmblylljen e plotë të projekteve. Po ashtu, opozita ka drejtuar kritika ndaj kësaj drejtorie për shkak të anashkalimit të dokumenteve bazë, siç janë Plani Zhvillimor Urban dhe Plani Zhvillimor Komunal.

Punë e suksesshme e kësaj drejtorie konsiderohet realizimi i projektit për emërtimin dhe shenjëzimin e shesheve dhe rrugëve, nëpër të gjitha lokalitetet e kësaj komune ku Deçani është njëra ndër dy komunat e Kosovës që ka fituar këtë projekt. Po ashtu, vendimi mbi uljen e taksave ndërtimore konsiderohet si një vendim i mirë, ngase do të përkrahen bizneset e vogla dhe të mesme të komunës, kërkesë kjo që ka dalur edhe nga Banka Botërore.

Deçani disponon me Planin Zhvillimor Komunal (PZHK), Planin Zhvillimor Urban (PZHU) dhe atë Rregullues për zonën e parë të qytetit (99 ha). Mirëpo, PZHK dhe PZHU, duhet të revidohen pasi ka kaluar një kohë dhe gjendja në terren ka ndryshuar nga ajo e planifikuar në planet e hartuara dhe të aprovuara në Kuvendin Komunal.

Financat në Komunë

Drejtoria për Buxhet dhe Financa, përkatësisht drejtori i saj, është shprehur i hapur për bashkëpunim me përfaqësuesit e organizatës monitoruese në prezantimin e raporteve apo ofrimin e shërbimeve tjera. Kjo drejtori, bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe atë të Menaxhimit të Financave Publike duhet të ofrojë raportet e shpenzimeve për çdo 3 muaj, 6 muaj, dhe 12 muaj. Mirëpo, kjo ka ofruar raportet e shpenzimeve vetëm për gjashtë mujorin duke i prezantuar ato në mënyrë analitike dhe të përmbledhur. Akuzat e opozitës dhe shoqërisë civile janë drejtuara te kjo drejtori për shpenzime enorme në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, sidomos për dreka zyrtare, karburante dhe mirëmbajtje të makinave zyrtare. Ekzekutivi komunal akuzohet për borxhe të shumta ndaj operatorëve ekonomik që në disa raste komuna është detyruar të përgjigjet në gjykatë.

Disa vendime të rëndësishme komunale

Kuvendi Komunal, pas shqyrtimit së kërkesës së Kompanisë CEO, FAX Marble Holdings Plc. për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim për ndërtimin e fabrikës për përpunimin final të gurëve të dimensionuar, i është dhënë mundësia për procedim sipas ligjit dhe rregullores për ankande publike. Paraprakisht, anëtarët komunal kanë aprovuar rregulloren për procedurat e dhënies së objekteve dhe tokës së komunës për shfrytëzim afat-shkurtër përmes ankandeve, rregullore kjo e diskutuar edhe me qytetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Legjislativi i kësaj komune, ka kundërshtuar vendimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, vendim i cili i jep në pronësi Manastirit të Deçanit mbi 23 hektarë pronë publike. Sipas anëtarëve komunal, ky vendim që ka premisa politike dhe të dëmshme për Deçanin. Opozita ishte deklaruar se asnjëherë nuk do të pranohet ti bëhet ky dëm komunës dhe se do të shfrytëzojnë çdo rrugë ligjore dhe politike që ky vendim i Gjykatës Supreme të mos realizohet.

Kuvendi Komunal ka miratuar Rregulloren për Dhënien e Lejes Mjedisore e cila ishte trajtuar edhe në një diskutim publik. Pas diskutimit publik, anëtarët e Kuvendit Komunal kanë aprovuar Statutin e Qendrës për Punë Sociale, institucion komunal ky që vepron në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe që deri më tash ka punuar pa një dokument bazë juridik.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapitale	Transparencë, Llogaridhënie
1	Penda në Hulaj dhe “Grykë të Deçanit	Rruga Deçan-Plavë	Transparencë e plotë në shpenzim të buxhetit
2	Shëtitoren përgjatë lumit “Lumëbardhi”	Investime të shumta në bujqësi	Komunikim i vazhdueshëm me qytetar
3	Uji të pijes për gjitha fshatrat	Asfaltimin e gjitha rrugëve lokale	Respektim i plotë i Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare
4	Bursa për studentët		

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës:

- Kryetari i komunës të përfill Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në përpikëri që në mënyrë të rregullt të raportojë para anëtarëve komunal;
- Kryetari i komunës duhet të përfill listën e projekteve të aprovuara nga asambleistët, si dhe, të bazohet në planet e hartuara komunale, siç janë ato për palestrën sportive, stadiumin e qytetit, etj.;
- Kryetari dhe stafi i tij të jenë prezent në takimet e Kuvendit Komunal dhe tu përgjigjen anëtarëve komunal në çështjet e ngritura nga ta,
- Të fillohen konsultimet me qytetarë në momentin kur përpilohet buxheti, si dhe të merren parasysh sugjerimet që ipen nga qytetarët për alokimin e buxhetit;
- Të funksionalizohen Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi dhe të veprojnë në përputhje me Udhëzimin Administrativ të ministrisë përkatëse;
- Drejtoria e administratës komunale, të hartojë Rregulloren për Funksonimin e Këshillave të Fshatrave dhe ta zbatojë atë në terren, duke bërë ndërlidhjen e fshatrave me institucionet komunale, përmes të zgjedhurve të tyre.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Të bëhet revidimi i planeve të hartuara kohë më parë dhe mos të lejohen investime jashtë këtyre planeve;
- Të respektohet Plani Zhvillimor Urban, i aprovuar nga legjislativi i komunës dhe të mos lejohen ndërtime të cilat janë në kundërshtim me të;
- Të bëhet mbikëqyrja e duhur teknike e punimeve gjatë realizimit të projekteve, kur kemi parasysh se disa projekte kanë mbetur pa përfunduar në afatin e paraparë.

Drejtorisë së Financave

- Drejtoria për Buxhet dhe Financa të respektojë Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe të njoftojë Kuvendin Komunal në periudhë tremujore dhe specifikojnë shpenzimet e bëra;
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa të angazhohet për reduktimin e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, sikurse edhe për dreka zyrtare dhe mirëmbajtje makinash nga Zyra e Kryetarit;
- Të bëhen publike të gjitha raportet e shpenzimeve përmes ueb-faqes zyrtare dhe në takime me qytetarë.

Kryesuesit të Kuvendit

- Kryesuesi të obligojë anëtarët komunal për respektim të orarit të takimeve, si për fillimin e seancës apo mos lëshimin e tyre;
- Seancat e Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa të kenë distancën e duhur kohore, bazuar në ligj, që t'i mundësohet sekretarisë së Kuvendit që të përgatis materialet e duhura për shqyrtim në seancën e Kuvendit;
- Të bëhen publike të gjitha raportet, vendimet, rregulloret dhe dokumentacionet tjera përcjellëse të parapara edhe me ligj në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Anëtarëve të Kuvendit

- Anëtarët të jenë më aktivë në debate të kuvendit dhe të arsyetojnë besimin e marrë nga elektorati;
- Seancat e Kuvendit të fillojnë në kohën e paraparë dhe sipas rendit të ditës të planifikuar dhe jo të vonohen siç është bërë praktikë e gjertanishme;
- Anëtarët komunal mos të lëshojnë seancat para mbylljes së punimeve;
- Anëtarët komunal të kenë kontroll më rigorozë mbi shpenzimet buxhetore duke kërkuar edhe arsyeshmërinë e këtyre shpenzimeve.


Deçan Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika Agjendë	Pjesëmarrja (%)	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	6	24	%	%
Janar	/	/	/	/
Shkurt	/	/	/	/
Mars	1	5	93	93
Prill	0	0	0	0
Maj	1	5	89	80
Qershor	1	4	81	89
Korrik	1	3	89	89
Gusht	/	/	/	/
Shtator	1	4	81	78
Tetor	/	/	/	/
Nëntor	1	1	100	100
Dhjetor	1	2	100	100
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	7	19		
Janar	1	/	/	/
Shkurt	1	/	/	/
Mars	1	4	100	/
Prill	/	/	/	/
Maj	1	5	100	/
Qershor	1	4	86	/
Korrik	1	2	100	/
Gusht	/	/	/	/
Shtator	1	4	100	/
Tetor	/	/	/	/
Nëntor	/	/	/	/
Dhjetor				
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli i Sigurisë në Bashkësi	3		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Dëgjimet publike	1		60 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Rregullorja për procedurat e dhënies së objekteve të komunës dhe tokës për shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandeve.	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs:0
Rregullorja për dhënien e lejes mjedisore komunale.	Aprovuar	Pro: 25; Kundër: 0 Abs: 0
Shfuqizimi i vendimit për kushtëzimin e nxjerrjes së dokumenteve komunale, me pagesën për ujin e pijes.	Aprovuar	Pro: 11; Kundër: 11 Abs: 0
Statuti i Qendrës për Punë Sociale	Shqyrtuar	Pro: 24; Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për emërimin e rrugëve dhe shesheve në tërë territorin e Deçanit	Aprovuar	Pro: 20; Kundër: 0 Abs: 4
Shqyrtimi i plotësimeve dhe ndryshimeve në Rregulloren mbi Taksa dhe Tarifa Komunale	Aprovuar	Pro: 24; Kundër: 0 Abs: 0
Vendimit për shpallje të zonave me interes për Komunën	Aprovuar	Pro: 24; Kundër: 0 Abs: 0
Vendimit për shpallje të zonave me interes për Komunën, ngastra nr. 538	Aprovuar	Pro: 22; Kundër: 0 Abs: 0
Shqyrtimi i Raportit të Auditorit gjeneral për komunën e Deçanit	Shqyrtuar	Nuk votohet
Vendimi për binjakëzim të Komunës së Deçanit me komunën e Plavës	Aprovuar	Pro: 22; Kundër: 0 Abs: 0
Shqyrtimi dhe miratimi i propozim buxhetit për vitin 2014	Aprovuar	Pro: 16; Kundër: 8 Abs: 1
Vendimit për shndërrimin e pronës bujqësore në pronë ndërtimore, sipas kërkesës së Bekë Lokaj nga Sllupi.	Aprovuar	Pro: 22; Kundër: 0 Abs: 0

Raporti Monitorimit 2013




Komuna

Gjakovë




Struktura e Komunës

Kuvendi Komunal



Ekzekutivi



2. Komuna GJAKOVË

Problemet kryesore të komunës

Organizata jo-qeveritare “Bashkohu edhe Ti” ka arritur që në vazhdimësi të monitorojë nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes lokale të Gjakovës, përkatësisht Kuvendit Komunal, Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Drejtorisë së Financave.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të komunës, Kuvendi Komunal i Gjakovës është i detyruar të mbajë 10 (dhjetë) seanca plenare dhe 2 (dy) dëgjime publike, ndërsa gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2013, janë mbajtur 9 (nëntë) seanca plenare dhe 1 (një) dëgjim publik.

Në bazë të Rregullorës për Transparencë, raportimi i drejtorëve komunale para anëtarëve komunal është i paraparë të ndodh çdo tre muaj, mirëpo kjo nuk ka ndodhur ngase raportimi është bërë vetëm nëpërmjet Kryetarit. Gjithashtu në këtë periudhë është kërkuar edhe themelimi i komiteteve konsultative të cilat do të monitoronin punën e këtyre drejtorive por edhe kjo ka hasur në vesh të shurdhër.

Në kornizën afatmesme buxhetore për periudhën 2014 – 2016, opozita ka ngritur zërin për mungesën e transparencës në investime kapitale ku shumë projekte të parapara për investime në periudhën 2014 – 2016 nuk kanë specifika të qarta. Gjithashtu në planet për investime në infrastrukturë rrugore nuk janë të parapara zgjerimet e rrugëve në hyrje dhe dalje të qytetit, rreth-rrrotullimi tek dalja për Prizren, dhe shumë projekte të tjera që janë konsideruar nga opozita si të domosdoshme.

Problemet kryesore të cilat janë komentuar më së shumti nga qytetarët dhe anëtarët komunal kanë të bëjnë me hapësira të gjelbërta, trashëgiminë kulturore, cilësia e investimeve në parqe dhe mungesa e hapësirave sportive.

Në ueb-faqen zyrtare të komunës nuk janë publikuar raportet financiare gjashtë-mujore apo ato vjeçare, por as procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), apo vendimet dhe rregulloret e komunës.

Të arriturat në vitin e kaluar

Ndër arritjet kryesore të komunës së Gjakovës në vitin 2013 mund të konsiderohen projektet në vijim:

- Investimet në infrastrukturën rrugore në disa pjesë të qytetit dhe disa fshatra;
- Projekti për rregullimin e varrezave të qytetit, që është realizuar në bashkë-financim me Komisionin Evropian;
- Themelimi i Zyrave të Vendit në disa zona rurale, të cilat shërbejnë për tërheqje të dokumentacioneve administrative;
- Ndriçimi publik në zonat rurale;
- Rregullimi i objekteve të mjekësisë familjare në fshatrat e zonës së Dushkajës, Rugovës, dhe Rekës;
- Menaxhimi i 4 tregjeve;
- Renovimi i disa shkollave në fshatra dhe qytet.

Vlerësimi i performancës

Kryetari i Komunës së Gjakovës, Pal Lekaj, ka shprehur vullnet për punë dhe qeverisje transparente, mirëpo ka centralizuar qeverisjen duke i bartur të gjitha përgjegjësitë në vetvete dhe duke mos krijuar hapësirë për shpërndarje të përgjegjësisë dhe vendimmarrjes.

Anëtarët komunal shumë pak kanë përfaqësuar interesat e qytetarëve në trajtimin e problemeve të tyre dhe më shumë kanë përfaqësuar interesin partiak.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal ka përdorur një gjuhë unifikuese me opozitën mirëpo nuk ka shprehur vullnet të iniciojë ndonjë çështje të interesit qytetarë.

Transparenca në Komunë

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës, Kuvendi Komunal i Gjakovës është i obliguar të mbajë 10 (dhjetë) seanca plenare dhe 2 (dy) dëgjime publike, ndërsa gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2013, janë mbajtur 9 (nëntë) seanca plenare, 9 (nëntë) komitete për Politik dhe Financa dhe 1 (një) dëgjim publik, gjë që është arsyetuar me pengesë të procesit zgjedhor. Mos-arritja e numrit të paraparë të seancave përbën shkelje të ligjit dhe statutit komunal.

Në bazë të Rregullores për Transparencë, raportimi i drejtorive komunale para anëtarëve komunal, parashihet të bëhet çdo tre muaj, mirëpo kjo nuk ka ndodhur ngase raportimi është bërë vetëm përmes Kryetarit të Komunës.

Zëri i qytetarit në Kuvendin Komunal të Gjakovës nuk është dëgjuar aq shumë për shkak të mungesës së vullnetit të anëtarëve komunal dhe të ekzekutivit për të përgjigjur kërkesave të tyre. Projektet për infrastrukturë, mjedis, urbanizëm, shëndetësi, arsim, bujqësi, sport, kulturë, zhvillim ekonomik, shërbime publike nuk kanë marrë vëmendjen e duhur për investimet e nevojshme.

Mediat kanë qenë të pranishme në të gjitha seancat plenare, mirëpo mediat janë ankuar për mungesë të materialeve në diskutim dhe dokumentacion, si për shembull procesverbalet që u shpërndahen anëtarëve komunal. Ankesë të ngjashme kanë pas edhe organizatat e shoqërisë civile.

Qasja në dokumente zyrtare është një problem i madh dhe është kritikuar edhe nga Lëvizja FOL në raportin e saj për Komunën e Gjakovës. Kritika të ngjashme janë bërë edhe nga gazetarët dhe organizatat e tjera duke përfshirë edhe burokracinë e madhe e zyrtarëve komunal dhe pagesat e shtruarra për të marrur dokumentet e nevojshme.

Subjektet politike opozitare kanë kritikuar vazhdimisht vendimet të cilat janë marrë në muajin qershor, korrik, dhe shtator duke i konsideruar ato si vendime të marrura me qëllime të fushatës zgjedhore. Ky ka qenë rasti me vendimin për heqjen e taksës për të gjitha bizneset që gjenden në Çarshinë e Vjetër, dhe investimet në infrastrukturën rrugore. Opozita ka kritikuar edhe për televizionin “TV Syri Vizion”, i cili ka transmetuar seancat plenare në mënyrë selektive në favor të pushtetit.



Llogaridhënia në Komunë

Nëse i referohemi projeksioneve buxhetore të komunës për vitin 2014, vërehet një rritje e shpenzimeve dhe ulje e inkasimit të taksave apo të hyrave vetanake dhe komuna ka 1,158,549,09 Euro më pak se në vitin 2013. Sipas përlllogaritjeve të mëhershme që Gjakova të ketë patur 115,000 banorë, në komunë janë të punësuar 288 punëtorë ndërsa sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, Gjakova ka 94,556 banorë, dhe si rezultat i takojnë të ketë vetëm 181 persona të punësuar në administratë. Nga kjo del që Komuna e Gjakovës të ketë 107 punëtorë më tepër.

Anëtarët komunalë, të zgjedhurit direkt nga populli, gjatë periudhës janar– dhjetor të vitit 2013 në seancat plenare të Kuvendit Komunal të Gjakovës shumë pak kanë ngritur zërin për t'i trajtuar problemet dhe bregat e qytetarëve. Ata vazhdimisht kanë heshtur dhe i kanë përfaqësuar interesat e subjekteve të tyre politike.

Raporti financiar i vitit 2012 i prezantuar në seancën plenare të datës 25.03.2013 është kritikuar nga të gjitha grupet politike opozitare dhe shoqëria civile për shkak se paratë e taksapaguesve të qytetarëve janë shpenzuar për 27% më shumë se në vitin 2011. Të gjitha këto shpenzime kanë shkuar në mëditje brenda vendit, jashtë vendit, telefona, derivate, udhëtime dhe shërbime tjera.

Rreth kornizës afatmesme buxhetore të vitit 2014 – 2016, opozita ka ngritur zërin për mungesë të transparencës rreth investimeve kapitale ku shumë projekte të parapara për investime në vitin 2014 – 2016, nuk kanë qenë të detajuar mjaftueshëm në buxhet apo me afat kohor. Gjithashtu, në planet e investimeve në infrastrukturën rrugore nuk janë të parapara zgjerimet e rrugëve në hyrje dhe dalje të qytetit, rreth-rrrotullimi te dalja për Prizren, dhe shumë projekte të tjera që janë të domosdoshme për investim.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2013, është realizuar vetëm një dëgjim publik në muajin qershor, ku pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë mjaft e madhe. Aty janë shtruar shumë kërkesa dhe bregat të qytetarëve si: rregullimi i infrastrukturës rrugore në disa zona rurale, ofrimi i ujësjellësit, sjellja e rrjetit të kanalizimit në zonën e Rekës së Keqe, kompensimi për dëmtimet e shkaktuara nga reshjet në bujqësi, subvencione, nevoja për përkrahje ndaj blegtorëve.

Kryetari i komunës ka qenë prezent në të gjitha seancat plenare të organizuara për vitin 2013 dhe ka patur prononcime publike për media në nivel lokal duke iu është përgjigjur pyetjeve dhe polemikave të shtruar nga anëtarët komunal. Kryetari vazhdimisht është zotuar që do t'i realizoj premtimet e bëra ndaj qytetarëve, sidomos për projektin e Çarshisë së Vjetër, kanalizimin në Rekën e Keqe, infrastrukturën rrugore në qytet dhe fshatra, dhe investimet kapitale për zhvillimin ekonomik.

Qeveria komunale nuk ka patur sukses në menaxhimin e transportit për stafin e mjekësisë familjare në zonat rurale si në zonat e Rekës së Keqe dhe zonën e Rugovës, ndërsa stafi mjekësorë është detyruar të udhëtojnë me pagesë vetanake.

Urbanizmi në Komunë

Drejtorja e Urbanizmit në Komunën e Gjakovës vepron sipas Planit Rregullativ, në të cilin nuk janë të përfshira Zona e Çabratit (një ndër lagjet më të vjetra të qytetit) e cila ka mbi 10.000 banorë dhe ka probleme infrastrukturore. Zonat në dalje të qytetit (zona industriale) po ashtu nuk janë përfshirë në këtë plan urbanistik ku shumë ndërtime janë në pritje te legalizimit.

Problemet kryesore të cilat janë komentuar më së shumti nga qytetarët dhe anëtarët komunal, kanë të bëjnë me hapësira të gjelbërta, trashëgiminë kulturore, cilësinë e investimeve në parqe dhe mungesa e hapësirave sportive.

Lumenjtë e qytetit si lumi Krena, i cili përshkruan vijën kryesore të qytetit është degraduar nga mbeturinat dhe ujërat e zeza ndërsa lumi Erenik, i cili buron nga zonat kufitare dhe përshkruan një pjesë të madhe të fshatrave të zonës së Rekës së Keqe, qytetit dhe Rekës së Mirë, sot shfrytëzohet për derdhjen e ujërave të zeza.

Cilësia e investimeve në parqet e qytetit nuk është në nivelin e duhur, gjë që e ka pohuar edhe vet Kryetari i komunës në njërën nga seancat plenare ku është ngritur shqetësim nga subjektet opozitare.

Gjakova ka një trashëgimi të pasur kulturore si kullat, urat, çarshitë. Mirëpo nuk ka patur përkujdesje të duhur nga Drejtoria e Urbanizmit për t'i jetësuar apo funksionalizuar gjithë këto pasuri përpos Çarshisë së Vjetër e cila ka qenë në qendër të vëmendjes gjatë viti 2013 për shkak të renovimit dhe pa-kënaqësive të disa grupeve qytetare.



Investimet në infrastrukturën sportive në zonën urbanistike të qytetit ka qenë tejet të mangëta. Në planin urbanistik janë të parashikuara shumë fusha sportive si ajo e futbollit, tenisit, basketbollit, stazat e vrapimit mirëpo në asnjë nga buxhetet e mandatit të kaluar nuk është paraparë investime të tilla.

Gjatë periudhës janar – dhjetorë 2013, Drejtoria e urbanizmit Gjakovë, ka lëshuar:

68 - Leje ndërtimi për objekte të reja,

8 - Legalizime për objektet e ndërtuara më parë,

18 – Refuzime për aplikim të lejeve për ndërtim nga pala investuese,

97 – Ndërprerje të punimeve për shkaqe të mungesës së dokumentacionit (burokracisë)

Financat në Komunë

Buxheti total i paraparë për vitin 2014 nga MEF (Ministria e Ekonomisë dhe Financave) për Komunën e Gjakovës është 398,249.00 Euro më i vogël se buxheti për vitin 2013. Kjo ka ndodhur si rezultat i numrit të banorëve nga regjistrimi i fundit i popullsisë që ka rezultuar me numër më të vogël se që ishte parashikuar më herët.

Drejtoria e Urbanizmit	2012	2013
Të hyrat totale	744,361.87€	264,857.38€
Drejtoria e Zhvillimit Ekonom.	2012	2013
Të hyrat totale	320,746.63€	275,877.70€
Drejtoria për Buxhet dhe Fin.	2012	2013
Të hyrat totale	984,081.07€	976,168.25€

Komuna e Gjakovës në sezonin veror për ndriçimin publik për muaj paguan 13 – 15 mijë €, ndërsa në sezonin dimërorë për muaj paguan 20 – 22 mijë €, ndërsa për momentin borxhi i komunës ndaj KEDS është rreth 45 mijë €.

Kjo pasqyrë financiare tregon qartë që Komuna e Gjakovës për vitin 2014, ka më pak buxhet për 1,158,549,09€, krahasuar me vitin 2013, dhe se për vitin 2014 ka rritur shpenzimet për Paga dhe Mëditje për shumicën e drejtorive komunale.



Çështjet tjera sipas komunës

- Vendimi për heqjen e taksave ndaj bizneseve ka qenë një vendim i mirë por opozita ka kritikuar qeverinë komunale se ky vendim po merret në fund të vitit dhe se po bëhet për fushatë zgjedhore.
- Kërkesa për financimin e projekteve kapitale në vlerë prej 2 milion Euro që Kryetari i komunës i ka dërguar Qeverisë së Kosovës gjithashtu është kritikuar nga opozita ku sipas tyre kjo kërkesë nuk ka qenë profesionale në përgatitjen e planit dhe buxhetit.
- Tema për Çarshinë e Madhe është diskutuar shumë dhe ka mbretëruar skepticizëm si nga opozita ashtu edhe nga qytetarët për dëmtimin e trashëgimisë kulturore dhe humbjen e vlerës së saj pasi që ishin hequr kubëzat nga rruga dhe ishin zëvendësuar me një material tjetër arkitektonik.
- Themelimi i Rugovës si komunë është diskutuar dhe politizuar shumë para fushatës zgjedhore, dhe është krijuar një polemikë e madhe në mes të qeverisë komunale dhe opozitës, përkatësisht nga partia në pushtet në nivel qendror..
- Projekti TCG “Green Energy” është konsideruar si një ndër projektet më të mëdha për riciklimin e mbeturinave dhe prodhimin e energjisë së ripërtitëshme dhe për këtë kompani është ndarë tokë komunale, por sot ende nuk ka asgjë konkrete rreth investimit të saj në Komunën e Gjakovës.
- Themelimi i Bashkësive Lokale në qytet dhe fshatra ka qenë një proces që është diskutuar në radhët e opozitës ku është kërkuar edhe në seancë plenare që të raportohet për punën e bërë nga vetë kryesuesi i këtij komisioni por një gjë e tillë nuk ka ndodhur.
- Për dëmet e shkaktuara nga të reshurat atmosferike është kërkuar nga opozita të prezantohet një raport i përpikët i cili identifikon dëmet dhe koston financiare, por një përgjigje konkrete nga ana e qeverisë nuk është dhënë.
- Ngrohtorja e qytetit ka bërë një kërkesë direkt në Qeverinë e Kosovës për ndihmë financiare, ndërsa ky veprim është kritikuar nga Zt. Shpetim Rudi duke aluduar se këtu po shpërfillet hierarkia qeverisëse.

Premtimet e Kryetarës së Ri

	Prioritetet	Projektet Kapitale	Transparencë, Llogaridhënie
1	<p>Zhvillimi ekonomik dhe punësimi</p> <p>Dy Fonde për Zhvillim:</p> <ul style="list-style-type: none"> Fondi për Ndërmarrje të Vogla dhe Mesme Fondi për Bujqësi 	Zgjerim i rrugës në dalje të Prizrenit dhe Pejës	Udhëheqje përfshirëse e cila mbron të drejtat e të gjitha grupeve dhe individëve për pjesëmarrje të plotë në jetën sociale dhe ekonomike.
2	<p>Arsimi</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i programeve për ndërmarrjesi dhe inovacion në Universitetin e Gjakovës Bursave për studentë në inxhinier dhe inovacion 	Katër tranzite rrugore; gjitha me infrastrukturë përcjellëse	Barazi të plotë për gratë në çdo aspekt të aktivitetit publik, ekonomik dhe social.
3	<p>Kultura, Rinia dhe Sporti</p> <p><i>Sigurimi i pjesëmarrjes së klubeve sportive nëpër ligat elite të vendit dhe liga ndërkombëtare</i></p>	Ndërtimi i Gjakovës së Re dhe Qendra e Kongreseve; Financat nga Konferenca e Donatorëve.	Përfshirje të qytetarit të Komunës në të gjitha proceset e planifikimit dhe marrjes së vendimeve në lidhje me të ardhmen e Komunës
4	<p>Ambienti dhe turizmi</p> <p><i>Ndërtimi i dy parqeve dhe mbjellja e fidanëve në tërë Komunën</i></p> <p><i>Shenjëzimin e shtigjeve sportive dhe turistike</i></p>	Pika Grumbulluese të qumshtit. Brendi i Produkteve “Gjakova Quality” Parku Teknologjik për Aktivitete Biznesore	Llogaridhënie në shpenzime të buxhetit
5	Ndërlidhja e aktiviteteve me Shqipërinë në a fushat me kompetencë komunale	Shtretërit e Lumenjëve	

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Të gjithë drejtorët komunal të raportojnë për performancën e tyre dhe drejtorive që udhëheqin para anëtarëve në seancat plenare të Kuvendit Komunal në periudha 3 mujore;
- Trajtimi ndaj mediave dhe shoqërisë civile të jetë në frymë më bashkëpunuese dhe transparente, sidomos nga Zyra për Informim sa i përket qasjes në dokumente zyrtare, dhe nga Sekretaria e Kuvendit Komunal. Po ashtu, ueb-faqja e komunës të jetë e azhurnuar dhe freskuar me informacione të duhura;
- Në sektorin e shëndetësisë të ketë një përkujdesje më të madhe në ofrimin e kushteve të trajtimit shëndetësor, sigurimin e barnave esenciale, transportin e gjithë stafit mjekësor në zonat rurale, infrastrukturën teknologjike, dhe të ketë investime në objekte shëndetësore;
- Menaxhimi i mbeturinave në qytet të jetë më funksional, pasurimi me shporta dhe kontejner mbeturinash në zonat e parqeve, rrugët primare, sekondare, zonat rurale të kenë një përkujdesje më të veçantë të trajtimit të mbeturinave dhe të mos hidhen në lumenj;
- Themelimi i komiteteve konsultative garanton një qeverisje më transparente dhe respekton një normë më të lartë demokratike, andaj duhet të themelohen më shumë komitete konsultative duke përfshirë qytetarë aktiv, ekspertë dhe pjesë tjera të shoqërisë civile;
- Konsultimet me qytetarë duhet të jenë të përditshme, sidomos me sektorin e biznesit, stafin civil, organizatat jo-qeveritare, bujqit, sektet fetare etj. Buxheti të prezantohet hapur te qytetarët si në ueb- faqe, media, dëgjime publike, apo fushata informuese për qeverisje më transparente lokale;
- Këshillat në Bashkësi Lokale duhet të jenë shumë më aktiv në transmetimin e brengave dhe problemeve të qytetarëve ndërsa duhet tu ipen hapësira për takime, dhe të përkrahen me një fushatë për promovimin e këtyre mekanizmave;
- Kujdesi ndaj mjedisit dhe hapësirave të gjelbërta duhet të jenë me prioritet më të lartë si dhe kujdesi ndaj lumenjve, parqeve, ndriçimit publik, urat;

Drejtorisë së Urbanizmit

- Plani Rregullativ Urban të mbulojë të gjitha zonat urbane;
- Ndriçimi publik në qytet dhe fshatra të jetë i përfshirë në të gjitha zonat e banimit;
- Menaxhimi i objekteve të trashëgimisë kulturore të trajtohet më seriozisht dhe duhet të ketë më shumë investime në mirëmbajtje dhe restaurim të tyre;
- Të investohet më shumë në infrastrukturën sportive, në zonat dhe hapësirat publike të qytetit dhe fshatrave.

Drejtorisë së Financave

- Sa i përket buxhetit komunal, duhet të ketë më shumë kujdes në shpenzimet për mëditje brenda dhe jashtë vendit si dhe vigjilencë më të madhe në të hyrat vetanakedhe nga taksat komunale;

- Qeveria komunale, duhet të gjejë forma më transparente për t'i informuar qytetarët se ku, si, dhe në çfarë mënyre shpenzohen paratë e tyre.

Kryesuesit të Kuvendit

- Trajtimi i anëtarëve komunalë nga ana e Kryesuesit të jetë në nivel më të mirë;
- Marrëdhëniet në mes të Kryesuesit dhe opozitës të jenë në dobi të qytetarit e jo të politikës;
- Qasja ndaj shoqërisë civile të jetë më bashkëpunuese, dhe të ketë vullnet më të madh për të iniciuar çështje të cilat kanë të janë prioritet për komunitetin e komunës.

Anëtarët e Kuvendit Komunal

- Anëtarët e Kuvendit duhet të jenë më koshientë në shqyrtimin e dokumenteve dhe të kërkojnë ekspertizë edhe nga jashtë për të verifikuar çështjet që trajnohen;
- Të ngrisin zërin më shumë për temat të cilat kanë të bëjnë direkt me qytetarin e jo me politikën;
- Të jenë më bashkëpunues dhe më afër qytetarëve gjatë kohës sa nuk ka takime zyrtare në komunë dhe të kenë një qasje më fleksibile me shoqërinë civile.

Gjakovë Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika Agjendë	Pjesëmarrja (%)	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	8	29	80%	%
Janar	1	4	97%	92%
Shkurt	1	6	97%	100%
Mars	1	4	85%	92%
Prill	1	5	95%	85%
Maj	1	1	93%	100%
Qershor	1	4	97%	100%
Korrik	1	2	97%	100%
Gusht				
Shtator	1	3	97%	100%
Tetor				
Nëntor				
Dhjetor				
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	8	27	80%	%
Janar	1	4	93%	100%
Shkurt	1	4	97%	100%
Mars	1	4	100%	100%
Prill	1	5	100%	100%
Maj	1	2	97%	100%
Qershor	1	3	93%	80%
Korrik	1	2	97%	100%
Gusht				
Shtator	1	3	93%	80%
Tetor				
Nëntor				
Dhjetor				
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli për Sigurisë në Bashkësi	1		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	1		62 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi	
Rregullorja për Ndarjen e Subvencioneve,	Aprovuar	Pro: 40 Abs:0	Kundër: 0
Plani Rregullues Urban i vendbanimit “Rogovë”	Aprovuar	Pro: 40 Abs:0	Kundër: 0
Vendimi për shpalljen me interes publik në pronën komunale, për kompaninë TCG “Green Energy”	Aprovuar	Pro: 35 Abs:0	Kundër: 0
Plani rregullues Urban “parku i Qytetit” Rr. Tirana	Aprovuar	Pro:35 Abs:0	Kundër: 2
Kërkesa për ngritjen e shtatoreve për Fadil Hoxhën, Anton Çetën dhe Nesemi Dervishdana.	Aprovuar	Pro: 34 Abs: 0	Kundër: 1
Kërkesa për lirim të përhershëm nga taksa Komunale për të gjithë zejtarët e zejeve të vjetra tradicionale që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Komunën e Gjakovës.	Aprovuar	Pro: 36 Abs: 3	Kundër: 1
Buxheti i Komunës së Gjakovës, për vitet 2014 - 2016	Aprovuar	Pro: 35 Abs: 0	Kundër: 5
Plani Rregullues Urban i Kompleksit Urbanistik “Çarshia e Vogël ana perëndimore”	Aprovuar	Pro: 39 Abs: 0	Kundër: 0

Raporti Monitorimit 2013




Komuna


Kaçanik

Struktura e Komunës

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



3. Komuna KAÇANIK

Problemet kryesore të komunës

Qytetarët e komunës së Kaçanikut janë përballur me probleme të ndryshme këtë vit por në veçanti kanë dominuar sfidat në mirëmbajtje të mjedisit që nuk kanë hasur në gatishmëri për zgjidhje institucionale.

- Lumi Lepenc vazhdon të ndotet nga mbetjet industriale të fabrikës “Silcapor”, ndërkohë që lumi Nerodime ndotet në masë ekstreme nga derdhja e kanalizimeve fekale të disa fshatrave dhe qytetit të Ferizajt dhe Kaçanikut,
- Në gjendje alarmante ka qenë edhe ndotja e ajrit nga tymtarët e Fabrikës së Gëlqeres “New Lepenci”, me pluhurin e të cilit përballen drejtpërdrejt banorët e qytetit dhe një pjese e fshatit Bob.
- Mbledhja e mbeturinat kanë qenë e dobët dhe ka degraduar ambientin dhe shëndetin e qytetarëve. Ato menaxhohen pjesërisht dhe jo rregullisht nga ndërmarrja rajonale për menaxhimin e mbeturinave “Pastërtia” e cila e ka selinë në Ferizaj dhe njësinë në Kaçanik. Në disa lagje të qytetit dhe në disa fshatra ky shërbim nuk ofrohet fare duke u krijuar stoqe mbeturinash dhe kundërmim. Përkundër thirrjeve e presioneve nga shoqëria civile dhe qytetarët, Komuna nuk ka insistuar në zgjidhjen e problemeve të sipërpërmendura.
- Disa fshatra vazhdojnë të mbeten pa rrjete të ujësjellësit, por dhe aty ky ndodhen ato nuk mirëmbahen, duke rezultuar pjesërisht me ndotje kimike, e pothuaj vazhdimisht me ndotje bakteriologjike. Rrjeti i ujësjellësit të qytetit rrugëton nëpër gypa të asbestit i cili përmban substanca kancerogjene dhe vazhdon të jetë kërcënim i drejtpërdrejt për shëndetin e qytetarëve.

Funksionimi i Administratës Komunale të Kaçanikut

Administrata Komunale nuk ka funksionuar si duhet. Komunikimi ndërmjet zyrtarëve të lartë të ekzekutivit dhe koordinimi në zbatimin e planit dhe programit nuk ka qenë i kënaqshëm për shkak se ka pasur dorëheqje, përkatësisht shkarkime të dy drejtorëve, vendet e të cilëve nuk janë plotësuar nga atëherë.

Zyra e Prokurimit është njëri nga sektorët i cili dyshohet për përcaktim të tenderëve, zvarritje të qëllimshme të procedurave, favorizime e diskriminime të ofertuesve, vendosje mbi baza të perceptimeve, e jo në baza ligjore. Zyra e Prokurimit ka nënshkruar edhe kontrata me operatorë me çmim më të shtrenjtë. Në disa raste nuk ka paraparë as planin për kryerjen e punimeve, e rrjedhimisht nuk ka ndëshkuar operatorët për vonesat e punimeve. Zyra e Prokurimit nuk ka qenë transparente.

Cilësia e zbatimit të projekteve në terren ka qenë në nivelin më të ulët. Menaxhuesit e projekteve nuk janë treguar serioz në mbikëqyrjen e cilësisë së punëve, sidomos asfaltimin e rrugëve prej të cilave janë realizuar nëpër shi dhe baltë. Disa rrugë janë asfaltuar natën dhe të dielave, pa mbikëqyrje komunale, pa kualitet dhe të njëjtat projekte janë pranuar teknikisht. Në këtë mënyrë është keq-menaxhuar buxheti komunal dhe plasaritur rrugët.

Të arriturat në vitin 2013

Si e arritur pozitive duhet të veçohet gatishmëria e kryetarit të Komunës, Besim Ilazit, për procedimin në Kuvend Komunal dhe rishqyrtimin e disa vendimeve të mëhershme

kundërligjore, përkatësisht gatishmëria për rikthimin e ligjshmërisë në institucione. Po ashtu gjatë kësaj kohe janë shlyer të gjitha borxhet e trashëguara që nga viti 2004 e këtej dhe janë ulur në masë të jashtëzakonshme shpenzimet për mallra e shërbime.

Vlerësimi për performancë

Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, vlerësohet për mënyrën e komunikimit me subjekte politike të përfaqësuara në Kuvendin Komunal, shoqërinë civile dhe afërsinë me qytetarët, duke u dhënë hapësirë në shprehjen e mendimeve dhe këshillimet për procese të ndërlikuara dhe çështje të ndjeshme. Kreu i Komunës së Kaçanikut është treguar tolerant ndaj stafit të ekzekutivit komunal që ka rezultuar në rënien e imazhit, efikasitetit profesional, disiplinës në punë të shërbyesve civilë dhe eprorëve të tyre. Investimet kapitale nuk i ka realizuar racionalisht siç ka premtuar, por shumë projekte i ka orientuar dhe realizuar në lokalitetin në të cilin banon ai.

Drejtoritë komunale të Kaçanikut janë treguar anemike dhe indiferentë përballë problemeve evidente në fushat menaxhuese përkatëse dhe nuk kanë treguar përkushtim në krijimin e mundësive për përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve në fushat për të cilat janë kompetentë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Xhelal Gashi, i ka udhëhequr seancat e KK-së në përputhje me Rregulloren e KK-së duke lënë në dispozicion maksimal kohën e trajtimit të temave, dhënien e mundësive maksimale për diskutime dhe trajtim të barabartë e të gjithë anëtarëve komunal, pavarësisht përkatësisë politike.

Nga ana tjetër, Kryesuesi është treguar pak tolerant ndaj disa anëtarëve të shpërqendruar, të cilët krijojnë zhurma dhe pengesa të tjera gjatë seancës, por edhe braktisnin punimet e legjislativit, duke injoruar debate kyçe siç ishin buxheti dhe raporti i auditorit.

Anëtarët e Kuvendit Komunal

Në përgjithësi, anëtarët e Kuvendit Komunal nuk kanë treguar interesim për t'i trajtuar me meritë problemet dhe kërkesat e qytetarëve.

Ka munguar debati dhe shqyrtimi i hollësishëm i adresimeve në Kuvendin Komunal, sidomos për çështjet me interes të përgjithshëm, siç ishin orientimi dhe shpenzimi i buxhetit komunal, si dhe kërkimi i përgjegjësisë dhe llogaridhënies për dështimet e zbatimit të ligjit. Përderisa anëtarët kanë qenë më të zëshëm në çështjet me interes direkt dhe jo-direkt personal apo politik. Për keqardhje, anëtarët e Kuvendit të Komunës, gra, sidomos të subjektit politik në pushtet (PDK), kanë qenë tejet pasive në seanca.

Transparenca në Komunë

Seancat e Kuvendit Komunal të Kaçanikut kanë qenë të hapura për të gjithë qytetarët të cilët janë interesuar për t'i ndjekur punimet e legjislativit lokal.

Subjekteve të organizuara e individuale u është mundësuar qasje në materialet e seancave të KK-së dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF). Seanca janë transmetuar edhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Ndonëse Kuvendi disponon teknikën e zërimit, gjatë seancave nuk është aktivizuar, ndërsa mungesa e një foltoreje është hendikep për vendosjen e rendit të diskutimeve. Me përjashtim të ndonjë individi nga ndonjë subjekt, grupi interesit dhe për çështje të caktuara, seancat e KK-së nuk janë ndjekur nga qytetarët. Nuk ka pasur interesim të qytetarëve për të qenë pjesë e seancave, por paraprakisht edhe hapësira e sallës së mbledhjeve të KK-së nuk i plotëson kushtet për numër më të madh të qytetarëve.



Komitetet Konsultative nuk janë themeluar gjatë mandatit që e lamë pas. Madje, për këto sektorë këshillues nuk ka pasur ndonjë përpjekje për t'i vënë në dispozicion të ndihmës profesionale të dikastereve të ekzekutivit komunal.

Prezenca dhe Trajtimi i Mediave: Institucionet komunale kanë qenë prezentë pothuaj vetëm në gazetën “Koha Ditore”. Komuna ka qenë e hapur ndaj mediave, por ka munguar interesimi i këtyre të fundit për të pasur korrespondentë në komunën e Kaçanikut. Madje, problemet e qytetarëve dhe zhvillimet e përgjithshme në komunën e Kaçanikut nuk i ka mbuluar as televizioni publik i Kosovës (RTK), i cili financohet edhe nga paratë e taksapaguesve kaçanikas.

Qasja në dokumentet zyrtare ka qenë e pjesshme. Kërkesat për qasje në dokumente publike jo çdo herë marrin përgjigje, kurse në disa raste marrin përgjigje jo të plotë. Ndonjëherë institucioneve qeveritare i vonojnë përgjigjet e kërresave duke mohuar mundësinë e informimit për punën, përgjegjësinë, llogaridhënien e institucioneve dhe shkeljen e afateve kohore të rregulluara me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. Publiku ka mbetur pa qasje edhe atëherë kur është kërkuar të dihet për dyshimet e dëmtimit të buxhetit komunal.

Ueb-faqja është freskuar me ritëm të ngadalshëm dhe kryesisht e imponuar nga zhvillimet e kohës. Ajo përmban vetëm pasqyrën pozitive të Komunës së Kaçanikut, por jo edhe ngjarjet tjera sidomos në mbledhjet, debatet dhe takimet publike në të cilën kanë prezantuar edhe përfaqësues të subjekteve politike opozitare, shoqëria civile dhe qytetarët në përgjithësi.

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Komunës së Kaçanikut e ka prezantuar pjesërisht punën e ekzekutivit, nëpër takime të ndryshme me qytetarë dhe grupe të interesit. Ekzekutivi i është përgjigjur interesimit të qytetarëve për çështje të caktuara nëpër debate publike, të ftuara nga organizata ndërkombëtare në Kosovë. Nuk i ka ftuar mjetet e informimit për publikimin e punës së qeverisë lokale. Komuna është prezentë në media vetëm me interesimin e këtyre të fundit.

Kryetari i Komunës është prezent në seancat e KK-së së Kaçanikut në të cilat prezantohet me shkrim raporti i punës i qeverisë komunale.

Ai nuk e ka prezantuar raportin as në pika të shkurtra, por për raportin i cili u është dërguar anëtarëve nëpërmjet formave elektronike, këta të fundit kanë shprehur vlerësimet e tyre dhe kanë shtruar pyetje dhe kërkuar sqarime nga kryetari i Komunës, i cili u është përgjigjur në tërësi.

Raportet tremujore të buxhetit komunal, përkatësisht raporti vjetor i ekzekutivit është i rregulluar me ligj dhe si të tillë janë paraqitur në seancat e legjislativit, në afatet e caktuara për shqyrtimin e tyre.

Komuna e Kaçanikut, gjatë vitit 2013 ka mbajtur dy debate publike, të cilët falë organizimit nga Projekti zviceran për përkrahje të qeverisjes lokale (LOGOS) pjesëmarrja ka qenë

masovike me mesatarisht 150 qytetarë. Po ashtu, janë mbajtur edhe tryeza e takime publike për tema të ndryshme. Megjithatë, nga 26 projekte të propozuara në një debat, në listën e investimeve janë përfshirë vetëm nëntë këso lloj projektsh, përfshirë këtu edhe projektet e vendbanimit të kryetarit të Komunës: ndërtimi i një objekti të ri shkollor, kanalizimi fekal, kanalizimi atmosferik dhe asfaltimi i rrugëve të 4 lagjeve: pastaj asfaltimi i rrugës në fshatin e lindjes së nënkryetarit të Komunës; ndërtimi i një objekti të ri shkollor dhe asfaltimi i rrugëve të katër lagjeve në vendbanimin e drejtorit të Urbanizimit, etj.

Qytetarët kryesisht kanë kërkuar investime në lokalitetet dhe lagjet e tyre, shpenzimin e parasë publike vetëm për projekte të nevojshme, punësim, etj. Takimet e këshilltarëve komunalë me qytetarë kanë ekzistuar, por zakonisht me kërkesë të qytetarëve, ndërsa të rralla janë rastet kur këshilltari i fton në takim qytetarët për t'u njohur me kërkesat e tyre, për t'i adresuar në Kuvendin Komunal.

Urbanizmi në Komunë

Komuna e Kaçanikut vazhdon të ketë probleme në planin urbanistik, sidomos në zonën e parë të qytetit. Ndërtimet private pa ndonjë plan të menaxhuar më herët, imponojnë shmangie nga urbanizimi i kësaj zone në bazë të nevojave të kohës. Rruga e ngushtë e cila përshkon pjesën më të madhe të qytetit, pamundëson ndërtimin e trotuareve shumë të nevojshëm për lëvizjen e lirë të qytetarëve. Kjo gjendje imponon ndryshimin e trajtimit të kësaj zone, duke i aplikuar rrugët një-kahëshe. Drejtoria e Urbanizimit deklarativisht është promovuar si dikaster që po bën shumë punë, por nuk e ka mbikëqyrur mirë zbatimin e projekteve infrastrukturorë në terren. Ajo ka lejuar punë të rëndësishme jashtë orarit të punës dhe pa inspektim, duke u mundësuar operatorëve përfundim të punimeve jo-cilësore.



Kjo drejtori ka lejuar ndërtime pa leje, ndërsa në disa raste lejet i ka lëshuar pas përfundimit të punimeve. Ka munguar transparenca reale e projekteve, ndërsa prezantimet e tyre në instancat vendimmarrëse kanë qenë të pakompletuara, shpesh edhe me tendenca për t'i vënë para aktit të kryer vendimmarrësit. Drejtoria në disa raste ka vepruar me dy kute në kualitetin e projekteve dhe orientimin e tyre sipas agjendave personale të zyrtarëve të lartë, edhe atëherë kur është dëmtuar buxheti i komunës dhe kontestuar qëndrueshmëria e investimit.

Financat në Komunë

Viti 2013 vlerësohet si vit i kursimeve të ndjeshme buxhetore për mallra e shërbime. Kursimet nga shpenzimet e panevojshme janë të mirëseardhura, por jo vetëm për të prezantuar shifra të ulëta të shpenzimeve, në kohën kur një shpenzim i caktuar do t'i sillte të mira qytetarëve. Drejtoria e Financave mendohet se nuk ka pasur kontroll të duhur financiar nga të gjitha të hyrat vetanake. Përkundër konfirmimeve zyrtare se taksa komunale për regjistrimin e automjeteve nuk është duke u paguar në të gjitha rastet, kjo çështje është heshtur. Përmbajtja e raporteve financiare është e përgjithësuar, ndërsa të deshifruara i adresohen Kuvendit Komunal vetëm me kërkesë të anëtarëve të Kuvendit.

Shërbimet jashtë institucioneve komunale

Njësia e ndërmarrjes rajonale të ujësjellësit dhe kanalizimit "Bifurkacioni" në Kaçanik, është pavarësuar në kundërshtim me ligjin dhe është duke vepruar si ndërmarrje komunale me emrin "Lypeteni". Kontestimi i ligjshmërisë së saj nga donatorët e huaj ka ndikuar në

humbjen e investimeve në vlerë qindra-mijëra euro. Rikthimi i ligjshmërisë së kësaj ndërmarrjeje do t'i rriste investimet e huaja në ujësjellës dhe kanalizim.

Qendra për Regjistrimin e Automjeteve Larg Vëmendjes së Komunës

Në objektin në të cilin është vendosur Qendra për Regjistrimin e Automjeteve, punëtorë të sigurimit fizik kanë bartur shufra të gomës. Ky veprim është perceptuar si kontroll me simbole të dhunës në institucione të lira e demokratike. Ndonëse është institucioni më i përfolur për dyshime për keqpërdorime zyrtare e financiare, por edhe në shfrytëzim për përfitime të tjera të individëve të caktuar, QRA është jashtë kontrollit Komunës. Ndonëse e frekuentojnë mijëra qytetarë të saj, Komuna asnjëherë nuk është interesuar për të pasur qasje dhe për të kërkuar përgjegjësi dhe llogari.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapitale	Transparencë, Llogaridhënie
1	Zhvillim ekonomik Institucione të qëndrueshme	Ndërtimi i objektit të ri të QKMF-së	Thellimi i transparencës së organeve komunale
2	Ndarja e bursave për 40 studentë	Ndërtimi i objektit të ri të shkollës në Kaçanik të Vjetër	Lehtësimi i qasjes në dokumente zyrtare komunale
3	Subvencione në bujqësi në vlerë 130euro	Ndërtimi dhe rregullimi i terreneve sportive	Emërimi i një drejtoreshe komunale

Rekomandimet për Komunën e Kaçanikut

Kryetarit të Komunës

- Të iniciojë procedurat për rikthimin e ligjshmërisë së ndërmarrjes së ujësjellësit dhe kanalizimit, me qëllim që donatorët e jashtëm t'i pezullojnë "sanksionet" për këtë ndërmarrje dhe t'i zhblokojnë fondet e parapara për investime në këtë fushë;
- Të zgjidhet problemi i ndotjes së ajrit dhe ujërave të lumenjve nga prodhuesit industrialë dhe shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe të organizohet menaxhim më i mirëfilltë i mbeturinave me shtrirje dhe efikasitet të plotë në tërë territorin.

Drejtorisë së Urbanizmit

- T'i bëjë të gjitha konsultimet profesionale e ligjore të interesit publik dhe me organet relevante, për ta fuqizuar interesin publik për realizimin e projekteve;
- T'i shqyrtojë me kohë propozim-projektet të cilat janë të ndërlydhura me qeverinë qendrore dhe që kanë varësi financiare nga donatorët e jashtëm;
- Të trajtojë në mënyrë të barabartë menaxhimin e kualitetit të punimeve dhe orientimin racional të projekteve, gjithnjë duke u bazuar në nevojat reale të qytetarëve si dhe t'i vazhdojë projektet e lëna përgjysmë me vite të tëra.
- Drejtorisë së Financave
- Të jetë transparente në shpenzimet buxhetore dhe të kujdeset që të hyrat vetjake komunale të realizohen plotësisht, si dhe të inspektojë shmangiet eventuale të pagesave të parapara me të hyrat vetjake komunale;
- Gjatë raportimeve për shpenzimet buxhetore nëpër periudha të caktuara të vitit t'i prezantojë në mënyrë të detajuar të gjitha shpenzimet buxhetore për secilin artikull, shërbim dhe projekt, si dhe të mos lejojë pagesa të faturave të tipit të darkës së Kryeministrit me mësimdhënës.

Kryesuesit të Kuvendit

- T'i themelojë komitetet konsultative, për t'i dhënë mundësi shoqërisë civile dhe ekspertëve në planifikimet dhe strategjitë, hartimin e politikave dhe implementimin e projekteve në fusha të ndryshme.
- KK i Kaçanikut duhet ta themelojë Këshillin Komunal të Sigurisë në Bashkësi, në përputhje me Udhëzimet të Qeverisë së Kosovës dhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.
- Të mos lejojë shpërqendrimin e anëtarëve gjatë seancave dhe braktisjen e punës pa arsye të mirëfilltë;
- Të kërkojë investime në rregullimin e sallës së mbledhjeve të KK-së duke vendosur tavolinat dhe ulëset standarde, foltoren, krijimin e hapësirës së mjaftueshme dhe me inventar për pjesëmarrje të qytetarëve në seanca, si dhe ta funksionalizoj teknikën e zërimit.

Anëtarëve të Kuvendit

- Të sjellin kërkesa të qytetarëve dhe t'i prezantojnë shqetësimet e tyre në KK.
- Të jenë aktivë në trajtimin e çështjeve të cilat i adresohen legjislativit dhe të jenë të disiplinuar e të përgjegjshëm gjatë zhvillimit të seancave.
- T'iu dhënë tretman të merituar kërkesave dhe problemeve të qytetarëve nga të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë.
- Këshilltaret femra të mos lejojnë supremaci të gjinisë së kundërt, por ta përdorin në mënyrë të barabartë foltoren për çështjet që diskutohen në kuvend.

Kaçanik - Mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe Pjesëmarrja


Lloji i takimeve	Numri	Pika në rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e femrës
Seanca plenare	10	51	84.89 %	80.47 %
Janar	1	4	96.3 %	90.9 %
Shkurt	1	2	92.5 %	90.9 %
Mars	1	6	96.3%	90.9%
Prill	1	5	92.5 %	81.8 %
Maj	1	4	92.5 %	90.9 %
Qershor	1	1	88 %	81.8 %
Korrik	2	13	94.5 %	86.6 %
Gusht	0	-	-	-
Shtator	1	8	96.3 %	90.9 %
Tetor	0	-	-	-
Nëntor	0	-	-	-
Dhjetor	1	8	100 %	100 %
Komiteti për Politikë dhe Financa	7	41	90.42 %	100 %
Janar	1	5	100%	100%
Shkurt	0	-	-	-
Mars	1	7	100 %	100 %
Prill	1	7	100 %	100 %
Maj	1	3	61.4 %	100 %
Qershor	1	5	100 %	100 %
Korrik	1	5	85.8 %	100 %
Gusht	0	-	-	-
Shtator	1	9	85.8 %	100 %
Tetor	0	-	-	-
Nëntor	0	-	-	-
Dhjetor	0	-	-	-
	Gjithsej takime		Pjesëmarrja e shoqërisë civile	
Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi	6		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja mesatare	
Takimet me publikun	2		150 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Rregullorja për ndarjen e bursave për studentët	Aprovuar	Pro: 27, Kundër: 0, Abs: 0
Rregullorja për barazi gjinore	Aprovuar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 0
Ndryshimi i rregullores së orarit të barnatorëve	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 0
Rregullorja për caktimin e tarifave për nisjet e transportit rrugor nga Stacioni i Autobusëve	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 1, Abs: 0
Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores 01 Nr. 16-27192/12, për caktimin e kritereve për subvencionedhe transfere	Aprovuar	Pro: 26, Kundër: 0, Abs: 0
Rregullorja për vendosjen e tatimit në pronë në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2014	Aprovuar	Pro: 24, Kundër : 2, Abs: 0
Rregullorja për fuqizimin dhe promovimin e vullnetarizmit në komunën e Kaçanikut	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 1, Abs: 0
Plani rregullues urban për zonën e dytë dhe të tretë të qytetit të Kaçanikut	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 0
Plani i veprimit për rekomandimet në raportin e auditimit për vitin 2012	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 1, Abs: 0
Vendimi për buxhetin e Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2014 dhe vlerisimi për vitet 2015-2016	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 1, Abs: 0
Raporti i Auditorit të Përgjithshëm	Shqyrtuar	Nuk ka dalë në votim
Vendim për aprovimin e rregullores për bursa	Aprovuar	Pro 20, Kundër 0, Abs: 3
Vendim për bartjen e bilanceve të pashpenzuara i të hyrave vetjake nga viti 2012 në vitin 2013	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 1
Vendim për aprovimin e Planit te punës së KK-së për vitin 2013	Aprovuar	Pro: 26, Kundër: 0, Abs: 0
Vendim për lejimin e mjeteve financiare për Ditën e Pavarësisë së Kosovës	Aprovuar	Pro: 26, Kundër: 0, Abs: 0
Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Palestrës Sportive	Aprovuar	Pro: 15, Kundër: 0, Abs:10
Vendim për themelimin e Komisionit komunal të aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve"	Aprovuar	Pro: 23, Kundër: 0, Abs: 3
Vendim për lejimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Aprovuar	Pro: 26, Kundër: 0, Abs: 0
Vendim për lejimin e mjeteve financiare në shumë 55.125 euro për realizimin eprojekteve	Aprovuar	Pro: 23, Kundër: 0, Abs: 3
Vendim për hartimin e Planit rregullues urban të zonave II dhe III të qytetit të Kaçanikut	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 0
Vendimi për shfuqizimin e vendimit të ndalimit të organizimit të lojërave të fatit	Aprovuar	Pro: 10, Kundër: 2, Abs: 0
Vendimi për aprovimin e Rregullores për barazi gjinore	Refuzuar (rishikim)	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 0
Vendim për themelimin e Këshillit Komunal të	Refuzuar	Pro: 25, Kundër: 0,

Sigurisë në Bashkësi		Abs: 0
Vendim për aprovimin e Statutit të QPS-së	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 0
Vendim për rishikimin e buxhetit të Komunës për vitin 2013	Aprovuar	Pro: 24, Kundër: 0, Abs: 0
Vendim për aprovimin e Statutit të Ndërmarrjes Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve" sh.a.	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 0, Abs: 0
Vendimi për caktimin e tarifës për lëshimin e vërtetimit që Komuna nuk është e interesuar për blerjen e ngastrave në territorin e saj	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 8, Abs: 2
Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për rregullimin e Varrezave të Dëshmorëve	Aprovuar	Pro: 18, Kundër: 0, Abs: 5
Vendim për vazhdimin e lejes së ndërtimit të Hidrocentralit 3, në fshatin Sllatinë	Aprovuar	Pro: 12, Kundër: 1, Abs: 9
Vendim për prolongimin e vendimit për themelimin e Këshillit Komunal të Sigurisë në Bashkësi	Aprovuar	Pro: 23, Kundër: 1, Abs: 1
Për konfirmimin e vazhdimin të marrëveshjes së partneritetit me komunën e Mosseedorf të Zvicres	Aprovuar	Pro: 26, Kundër: 0, Abs: 0
Vendim për aprovimin e Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve	Aprovuar	Pro: 26, Kundër: 0, Abs: 0
Vendim për ndryshimin e shumave të ndara për projekte kapitale sipas ndarjeve me buxhetin e Komunës për vitin 2013	Aprovuar	Pro: 24, Kundër: 2, Abs: 0
Vendim për mbështetjen financiare të KF Lepenci	Aprovuar	Pro: 25, Kundër: 1, Abs: 0
Shpallja e zonës industriale në Kaçanik të Vjetër	Aprovuar	24, Kundër: 1, Abs: 1
Shfuqizimi i vendimit të KK-së (2006), për lejimin e lokacionit të ndërtimit të kazermës së TMK-së	Aprovuar	25, Kundër: 1, Abs: 0
Aprovimi i Rregullores së tatimit në pronë, për 2014	Aprovuar	25, Kundër: 1, Abs: 0
Vendim për buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2014 dhe vlerësimet për vitet 2015-2016	Aprovuar	25, Kundër: 1, Abs: 0
Aprovimi i Planit të veprimit për rekomandimet zbatuese në raportin auditimit për vitin 2012	Aprovuar	25, Kundër: 1, Abs: 0
Aprovimi i Rregull. për fuqizimin dhe promovimin e punës vullnetare e të rinjve në komunën e Kaçanikut	Aprovuar	25, Kundër: 1, Abs: 0


Raporti Monitorimit 2013




Komuna
Klinë

Struktura e Kuvendit Komunal

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



4. Komuna KLINË

Problemet kryesore të komunës së Klinës

Në komunën e Klinës, edhe pse ka pasur investime të dukshme në infrastrukturë gjatë kësaj periudhë, qytetarët e saj vazhdojnë të përballen me problemet esenciale drejt një jete të mirë dhe të sigurt. Vonesat në realizimin e projekteve, monitorimi i punimeve dhe stafi që bën pranimin teknik të punëve janë sfida për Komunën e Klinës, ndërsa problemet kryesore mbesin:

- Uji i pijes dhe rrjeti i ujësjellësit (investime ka nevojë të bëhen në 49 vendbanime dhe uji në disa raste është me përbërje kimike);
- Rrjeti i kanalizimit (50 vendbanime kërkojnë investime, shpesh kanalizimi i ndot pusët e ujit të pijes);
- Kushte jo të mira në shkolla;
- Mbledhja i mbeturinave ku 46 fshatra nuk janë nën menaxhim të ndërmarrjes së mbeturinave;
- Rrjeti elektrik shumë i vjetërsuar (rrezik për banorët, sidomos në fshatra);
- Mirëmbajtja e hapësirave publike, mungesa e parkingjeve, hapësirave të gjelbërta, stacioni i autobusëve, ndriçimi, mungesa e çerdheve, biblioteka e qytetit, etj.

Të arriturat në vitin e kaluar

Edhe përkundër limiteve buxhetore për investime kapitale, ekzekutivi komunal ka arritur të realizoj më shumë investime se që ka qenë e paraparë për vitin 2013, falë fondeve të ndryshme shtesë nga qeveria qendrore dhe donatorë të tjerë. Megjithatë, projektet e rëndësishme të përfunduara në këtë vit, karakterizohen nga dy gjëra: 1. vonesa të mëdha dhe mos ndëshkim të punë kryerësve dhe 2. shumë projekte janë realizuar në kohë fushatë elektorale, si projekti i Shtëpisë së Kulturës dhe bibliotekës së qytetit.

Fabrika e ujit, investimi më i madh i Komunës së Klinës, edhe pse e përfunduar në shkurt, 2013 ende nuk është lëshuar në funksion për shkak të mos-kryerjes së obligimeve nga Komuna. Infrastruktura rrugore ka gjetur përmirësim në vitin 2013, sidomos në muajin e fushatës elektorale. Infrastruktura shkollore, po ashtu, ka pësuar disa ndryshime pozitive, falë fondeve të ardhura nga qeveria qendrore dhe donatorë të tjerë.

Vlerësimi për performancë

Kryetari i Komunës së Klinës, Sokol Bashota, i cili jeton me familje në Prishtinë, në pjesën e parë të ditës nuk ndodhet në zyrë, ndërsa ditën e enjte, të cilën e ka të paraparë të komunikoj me qytetarët, nuk e respekton. Gjatë këtij viti Kryetari i Komunës ka tentuar të anashkaloj Kuvendin e Komunës me disa veprime, si edhe të ndikoj në vendimet e tij (si tek vendimi për zhvendosjen e shtatores së Nënë Terezës, ndryshimi i PZHU-së dhe emërtimet e rrugëve). Kryetari i Klinës njihet për thithje fondesh nga Qeveria e vendit për projekte të ndryshme kapitale, madje Kryeministri i vendit në kohë fushate elektorale për zgjedhjet lokale 2013 ka ndarë për Komunën e Klinës 500.000 euro për investime.

Drejtoritë – Ekzekutivi i Komunës është i ndarë në 10 drejtori dhe udhëhiqet nga koalicioni, PDK, LDK dhe LDD dhe me vonë, pas shkëputjes së koalicionit, grupi më i madh, ai i PDK-së, bëri koalicion Grupi i Veçantë Kuvendar-GVK (fraksion i shkëputur nga AAK) dhe LDD. Vërehet një mos-efikasitet dhe mos-koordinim në mes të Drejtorisë së Urbanizmit dhe asaj

të Inspektoratit. Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, funksionon vetëm si një lloj kontabilisti i funksionimit të Komunës së Klinës, ndërsa obligimet rreth zhvillimit ekonomik (bazuar në statutin e Komunës) nuk i ka përmbushur aspak, madje ka edhe mungesë stafi. Komuna e Klinës funksionon pa strategji për zhvillim ekonomik lokal që nga viti 2010. Asnjë drejtori komunale nuk udhëhiqet nga një femër.

Anëtarët e Kuvendit Komunal – Anëtarët janë tejet pasiv dhe diskutimet i bëjnë vetëm shefat e Grupeve Kuvendare (GK). Këshilltarët komunal marrin materialet pak minuta para seancave, ka shumë telefonata dhe lëvizje të këshilltarëve që ndikojnë në atmosferën e punës gjatë seancës. Këshilltarët komunal në disa raste kanë qenë vetëm makina votuese (të ndikuar nga Ekzekutivi), ata kanë votuar edhe në rastet kur vendimet janë konsideruar jo të ligjshme. Gjatë këtij viti ka pasur lëvizje të shumta të këshilltarëve komunal nga një parti në tjetrën, duke ndikuar edhe në punën e efikasitetin e Kuvendit. Asambleistet gra kanë kontribuar shumë pak në diskutimet e bëra në Kuvend, ndërsa asnjë femër nuk është deleguar nga partitë në Komitetin për Politikë e Financa.

Kryesuesit të Kuvendit – Pas dorëheqjes së Kryesuesit, Fadil Gashi (si pasojë e prishjes së koalicionit), Kuvendi ka zgjedhë Kryesues të ri, Haxhi Ibishin. Gjatë vitit 2013, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Klinës ka lejuar veprime përmes të cilave është shkelur rregullorja për punë e Kuvendit, ka pasur shtim të pikave të rendit të ditës edhe pasi është votuar për rendin e ditës në fillim të seancës, tejkallim të kohës së lejuar për të diskutuar. Në seancën e datës 30 gusht, 2013 që ka vazhduar edhe me 03 shtator, 2013, është shkelur rendi i ditës me rastin e futjes në rend dite të një vendimi për shpalljen e një toke si “Zonë e interesit të Përgjithshëm”, duke mos respektuar rregulloren për punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës (Neni 21).

Transparenca në Komunë

Seancat e Kuvendit të Komunës dhe komiteteve janë realizuar siç janë paraparë me orarin e takimeve. Njoftimet për seancat dhe takimet janë bërë publike në kohën e caktuar ligjore si dhe janë publikuar në ueb-faqen e Komunës, në tabelarin e Komunës, si edhe në faqen e komunës në Facebook. Por, siç shihet edhe në foto gjatë fushatës elektorale kjo faqe është shndërruar në faqe promovuese të subjektit politik, PDK. Nga fillimi i vitit 2013, Komuna nuk ka bërë asnjë njoftim përmes radios, përveç njoftimit për tatim në pronë. Ueb-faqja e Komunës rrallëherë pasqyron punën e Kuvendit, duke mos vënë njoftime për vendimet e marra apo zhvillimet e punës së Kuvendit. Kuvendi ka vende të rezervuara për mediat, organizatat e Shoqërisë Civile dhe për qytetarë.

Komuna e Klinës ka të themeluar 2 komitete konsultative. Anëtarët e këtyre komiteteve shprehen që përveç që nuk janë ftuar të kontribuojnë për ndonjë çështje, ata nuk kanë as kushte për punë. Edhe pse në mënyrë vullnetare kanë realizuar disa takime dhe kanë proceduar në Kuvend disa rekomandime për çështje të mjedisit, ato nuk janë marrë në konsideratë. Ata takohen shumë rrallë.

Gjatë vitit 2013, të gjitha seancat e Kuvendit dhe komiteteve kanë qenë të hapura për publikun dhe mediat kanë qenë të pranishme. Mediat shprehen që ndihen të lira gjatë realizimit të punës së tyre, mirëpo më problematike mbetet marrja e informacioneve për çështjet më të ndjeshme. Informatat zakonisht merren prej drejtorëve, ndërsa nga Zyra për Informim merren vetëm njoftime për takime apo ngjarje.

Qasja në dokumentet publike në Komunën e Klinës nuk është në nivelin e duhur. Janë bërë kërkesa zyrtare dhe përgjigja ka qenë e vonuar dhe me komente shtesë nga ana e zyrtarëve komunal. Në pjesën e dytë të vitit vërehet një komunikim më i mirë dhe zyrtarët iu japin përgjigje kërkesave të drejtuara në Komunë. Nga gjithsej 11 kërkesa të evidentuara nga OJQ

KOHA, në 6 raste është ofruar përgjigjja. Dokumentet e kërkuara janë kryesisht të punës publike të Komunës së Klinës dhe transparencës së shpenzimeve.

Ueb-faqja e Komunës së Klinës mbetet ende larg të qenit në informim dhe shërbim të qytetarëve, meqenëse ka mungesë të shumë informacionesh. Në ueb-faqe janë më shumë ngjarje të cilat ndodhin në Komunë, prerje shiriti, vizita, etj. Investimet kapitale, kontratat, raportet e shpenzimit të parasë publike për periudha të ndryshme mujore apo ato vjetore financiare nuk publikohen. Raporti financiar i fundit i publikuar është me datë 27.03.2011. Mungojnë edhe strategjitë komunale, planet zhvillimore, urbane dhe komunale. Po ashtu mungojnë edhe biografitë e të gjithë udhëheqësve dhe të zgjedhurve. Njëjtë mungojnë edhe procesverbalet e seancave të KK-së ngase aktualisht ekzistojnë vetëm ato të vitit 2011 dhe disa nga viti 2012.

Llogaridhënia në Komunë

Me fillimin e monitorimit të punës së Komunës, është realizuar takim me Kryetarin, Kryesuesin dhe bartësit tjerë të pushtetit dhe kemi hasur në mirëkuptimin dhe gatishmërinë e Komunës për të bashkëpunuar. Por, Kryetari i Komunës së Klinës vazhdon t'i ik takimeve të organizuara nga organizatat e Shoqërisë Civile (SHC). Drejtorët janë më përgjegjës ndaj ftesave të marra. Në bazë të një hulumtimi të bërë nga OJQ KOHA, qytetarët janë të pakënaqur me komunikimin që kanë me zyrtarët e zgjedhur. Nga 380 qytetarët e intervistuar në lidhje me vizitat që iu bëjnë zyrtarët e zgjedhur, 330 qytetar apo 86.8% janë përgjigjur negativisht, ndërsa pozitivisht janë përgjigjur 50 qytetar apo vetëm 13.1%. Në pyetjen se sa marrin pjesë në takimet që Komuna e Klinës organizon, 285 qytetarë apo 75%, janë përgjigjur negativisht ndërsa 95 prej tyre apo 25% kanë thënë që marrin pjesë në takimet me publikun. Qytetarët thonë se të zgjedhurit e tyre u kthehen vetëm në kohë të zgjedhjeve. Për shkak të mos komunikimit të duhur, Komuna e Klinës është përballur shpesh me reagimin e qytetarëve deri edhe në bllokimin e punimeve. Ekzekutivi nuk i bindet as vendimeve të nivelit qendror dhe vazhdon të kushtëzoj qytetarët me pagesat e faturave të mbeturinave për të marrë shërbime komunale. MAPL këtë e ka quajtur veprim të kundërligjshëm. Kryetari i Komunës së Klinës iu është përmbajtur obligimit ligjor duke raportuar në Kuvendin e Komunës. Kryetari dhe disa nga drejtorët janë shpesh të pranishëm në seanca të KK-së.

Takimet me qytetarë që Komuna e Klinës organizon kanë mungesë të madhe të qytetarëve dhe zakonisht stafi civil i Komunës është prezent, sado e rëndësishme që është tema. Zyrtarët nuk kanë ndërmarr ndonjë hap për të ndryshuar diçka që qytetarët të konsultohen mirëfilli para vendimeve të rëndësishme. Dy takime të rëndësishme, ai për punën e Ekzekutivit për 6 mujorin e parë, si dhe diskutimi për draft-buxhetin e vitit 2014 janë vënë në diskutim publik por qytetarët mungonin. Ekzekutivi i Klinës, në momentin që sjellë në diskutim publik draft-buxhetin, zakonisht është finalizuar tanimë dhe i ngjason atij që votohet në Kuvend dhe qytetarët pjesëmarrjen e cilësojnë të kotë. Ajo çfarë qytetarët dëgjojnë më së shumti të thuhet nga ana e Kryetarit të Komunës, është që "Kushdo, secila lagje apo zonë urbane, që mbledh fonde në vlerë të 30% të projektit, ejani dhe pjesën tjetër e siguroj unë".

Komuna e Klinës ende nuk ka të rregulluar përfaqësimin e vendbanimeve të Klinës. Edhe pse e diskutuar me publikun me 12 shkurt, 2013, draft-rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Klinës ende nuk është miratuar në Kuvendin e Komunës. Madje, as për vitin 2014 nuk është paraparë buxhet për të jetësuar këtë rregullore. Në këtë mënyrë, komunikimi i qytetarëve, përfaqësuesve të fshatrave apo zonave urbane me të zgjedhurit e tyre, mbetet në nivel të ulët dhe shpesh qytetarët nuk dinë se kush i përfaqëson.

Në anën tjetër, në ueb-faqen e Komunës nuk ka ndonjë rregullore komunale për transparencë të publikuar, e asnjë plan-veprimi për transparencë edhe pse neni 9, pika 1 e Udhëzimit Administrativ 5/2013 për Transparenca në Komuna obligon që “çdo Komunë duhet të hartoj planin e veprimit për transparencën në Komuna”

Urbanizmi në Komunë

Urbanizmi në Komunën e Klinës përballet me probleme të shumta dhe mosgatishmërinë e Ekzekutivit për t’i zgjidhur ato. Qyteti i Klinës funksionon pa Plan Detal Urban (PDU), edhe pse vite më parë është kontraktuar kompania (Urban Plus). Në kohën kur pritej që Klina të ketë PDU-në e saj, kompania e angazhuar ka hasur në ndryshime në terren dhe shkelje të Plani Zhvillimor Urban (PZHU). Derisa etazhiteti në Klinë lejonte në P+6, banesa afër Komunës e dhënë në koncesion nga Komuna ka dalë të jetë P+9, etj., dhe ata nuk mund të vazhdonin me përfundimin e PDU-së. Për këtë shkak, Ekzekutivi insistonte të miratoheshin ndryshimet e PZHU-së, duke rritur etazhitetin në P+9, etj. Komunat në bazë të ligjit për Planifikim Hapësinor janë të obliguara që të kenë Planin Zhvillimor Komunal, Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të hollësishme, por Komuna e Klinës ende funksionon pa këto dokumente bazë.

Një ndër problemet më të mëdha të Drejtorisë së Urbanizmit, janë ndërtimet pa leje në zonën ndërmjet Klinës dhe fshatrave Dollc e Dresnikë, që me Planin Zhvillimor Urban të Klinës është shpallur Zonë e Mbrojtur Bujqësore. Janë mbi 100 ndërtime pa leje e Komuna ka shifra vetëm për 80 ndërtime, duke u bazuar në shqiptimin e dënimeve prej 150 euro. Komuna (Inspektorati dhe Urbanizmi), është treguar joefikase dhe e pa vullnetshme të ndaloj ndërtimet dhe të ushtroj autoritetin e vetë duke kryer obligimet ligjore në respektim të vendimeve të Kuvendit të Komunës. Në anën tjetër, janë shumë projekte infrastrukturore edhe pse të përfunduara por që janë jashtë funksionit dhe qytetarët presin ndërhyrjen e organeve komunale.

Komuna e Klinës nuk ka respektuar procedurat ligjore me rastin e futjes në rend dite të vendimit për Ndryshimin e Planit Zhvillimor Urban (PZHU) e gjithashtu edhe miratimit të ndryshimeve të tij. Është shkelur Ligji për Vetëqeverisje Lokale (LVL), Neni 47, pika 2 ku thuhet se: “Anëtari i Kuvendit mund të kërkoj shtimin e një pike në rend të ditës për një çështje që është urgjente dhe me rëndësi publike”. Kjo çështje nuk ka qenë e natyrës urgjente pasi që Klina e ka pasur një Plan (PZHU 2005-2015) dhe ndryshimi ka qenë në proces. Neni 14, pika 14.3 thotë se Plani Zhvillimor Urban duhet të përmbaj (3) pjesë: Analizën socio-ekonomike dhe fizike; Vetë planin; Strategjinë e Zbatimit, përfshirë dhe afatin kohor si dhe mekanizmat e financimit. Edhe në këtë rast, në këtë seancë kanë munguar të gjitha dokumentet e kërkuara edhe më parë në KPF.

Po ashtu, është shkelur neni 6 i Ligjit për Planifikim Hapësinor në rastin e këshillit të ekspertëve sepse nuk ka pasur një pëlqim të tyre, është sjellë analiza e ekspertëve, e cila ishte e pa nënshkruar dhe e pa protokolluar nga anëtarët e Këshillit të Ekspertëve. Në këtë takim nuk është sjellë analiza gjeologjike, por është sjellë një dokument i një kompanie private, që këtë analizë e ka përdorur për qëllime ndërtimi/biznesore, e jo duke u bazuar në interesin publik dhe sigurinë e përgjithshme. Në këtë mënyrë është proceduar me një vendim pa konsultime të gjera profesionale duke llogaritur vetëm në fuqinë e votës në Kuvendin e Komunës. Por, MAPL dhe MMPH pas shumë vonesave dhe paqartësive kanë deklaruar si të ligjshëm këtë vendim të komunës së Klinës.

Komuna e Klinës funksionon me disa rregullore të cilat janë miratuar duke u thirrur në rregullore të ndryshme të kohës së UNMIK-ut apo ligje të cilat janë shfuqizuar gati një dekadë më parë. Shembull i tillë është Rregulloren për Konsultim dhe Pjesëmarrje të Publikut në Vendimmarrje e miratuar dhe nënshkruar në vitin 2005, ndërsa Komuna e

Klinës nuk ka marrë asnjë hap duke krijuar huti tek qytetarët dhe anëtarët e Shoqërisë Civile.

OJQ KOHA (si edhe Kryesuesi i KK-së), pas kësaj situate ka kërkuar interpretim ligjor rreth këtij vendimi të Ministria e Administratës dhe e Pushtetit Lokal (MAPL). MAPL dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, (Komisioni i përbashkët MMPH-MAPL për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të Komunave nga fusha e planifikimit urban dhe rural), kanë kthyer përgjigje në adresë të Komunës së Klinës më 7 korrik, 2013 përmes një paragrafi të shkurtër në të cilin thuhet: Komisioni konstaton se duhet të respektohet neni 20 i LPH “2003/14, në të cilin thuhet se ndryshimet dhe plotësimet e planeve hapësinore dhe urbanistike bëhen sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar për miratimin e tyre fillestar. Prandaj, plani duhet t’i nënshtrohet të gjitha procedurave të parapara me legjislacionin e fushës së planifikimit hapësinor dhe atij për vetëqeverisje lokale në fuqi dhe përfundimisht të miratohet nga Kuvendi i Komunës. Komisioni i MMPH-së përbëhej nga Hidajete Zhuri, kryesuese e komisionit, Shpend Agaj dhe Jeton Qela, anëtarë.

Pas një kohë me shumë paqartësi, më 01 gusht, 2013, KDI dhe OJQ KOHA ka organizuar takim të përbashkët ndërmjet MAPL-së, MMPH-së, Komunës dhe grupeve të ndryshme të fushës me temë “Mbikëqyrjen e Planeve Urbanistike Komunale”, që të deshifrohet ky paragraf që nuk kuptohej nga Komuna e Klinës e as të tjerët. Nga ky takim doli përfundimi që MAPL dhe MMPH nuk kanë kërkuar materiale shtesë dhe se vendimi duhet të kthehet nga Kuvendi i Komunës brenda afateve. Hidajete Zhuri, kryesuese e këtij komisioni në takim tha se raporti i dërguar MAPL-së dhe Komunës së Klinës është i qartë dhe bazuar në atë raport Komuna e Klinës ka bërë shkelje ligjore me rastin e ndryshimeve të PZHU-së pa përfillur procedurat dhe sqaroi se ata nuk kanë kërkuar dokumente shtesë. Ndërsa, më 14 gusht, 2013, vetëm me nënshkrimin e kryesueses së komisionit, Hidajete Zhuri është dhënë një vendim i dytë, i cili përmes një paragrafi tjetër të shkurtër precizon: Pas shqyrtimit të informatave shtesë, Komisioni konsideron se vendimi i aprovuar më datë 16. Prill, 2013 nga Kuvendi i Komunës së Klinës dhe i nënshkruar nga Kryesuesi, në parim nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Financat në Komunë

Trendi i shpenzimeve të parasë publike nga zyrtarët Komunal vazhdon të mbetet në përmasa të mëdha, sidomos në kategorinë për mallra dhe shërbime, telefon, derivate, dreka zyrtare, mirëmbajtje të veturave etj. Gjatë periudhës 9 mujore, janar-shtator 2013, bazuar në raportin e Drejtorisë së Financave, Komuna e Klinës ka shpenzuar 55.174 euro për derivate për vetura dhe 18.506 euro tjera për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve. Vetëm për karburante, regjistrim, sigurim dhe mirëmbajtje të automjeteve, Komuna ka shpenzuar 84.704 euro, ndërsa për telefona 23.956 euro, dreka zyrtare 19.037 euro e në një kategori tjetër furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) ka shpenzuar 7348.00 euro apo 816.44 euro në muaj.

Sa i përket shpenzimeve, Klina ka dëmtuar buxhetin me mijëra euro me rastin e largimit pa të drejtë e pastaj rikthimit në punë të dy shërbyesve civil (me vendime të gjykatave përkatëse), duke bartur edhe detyrimin për pagesën e pagave që nga koha kur ata janë larguar nga puna. Njërit shërbyes civil, Komuna duhet t’ia paguaj 28 paga ose afër 8000 euro, ndërsa tjetrit 40 paga ose 11.200 euro.

Raportet financiare nuk bëhen publike në ueb-faqen e komunës dhe qytetarët nuk dinë si shpenzohet paraja publike, e raportet e publikuara nga OJQ KOHA kanë hasur në reagimin e Komunës së Klinës, duke u etiketuar si tendencioze. Raporti i vjetor i punës së Ekzekutivit i vitit 2012, i paraparë të diskutohet në vitin 2013 nuk është bërë, edhe pse është obligim ligjor. Raportet 3 dhe 6-mujore të vitit 2013 janë diskutuar në Kuvendin e Komunës.

Shëndetësia, Arsimi dhe ndriçimi në Klinë

Shëndetësia – qytetarët përballen me probleme të shumta, duke filluar nga lista esenciale e barnave, që duhet të blihen duke përfshirë edhe gjilpërat e injeksioneve. Ndërsa, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Klinë përballlet me shumë probleme dhe sfida, që nga higjiena e mirëfilltë, mos-respektimi i orarit të punës-sidomos nga mjekët specialist, shumicën e rasteve ka edhe mungesë të EKG-së dhe Retgen-it, emergjenca është në kushte të rënda (edhe higjienike), mirëmbajtja e aparaturave, ujit, rrymës që është jo e mirë, pastaj inventari tejet i vjetërsuar, laboratorit mbetet pa shërbime të duhura në mungesë materiali, tualetet janë në gjendje të rëndë etj. Në anën tjetër, shtretërit e vjetër dhe pa pastrimin e duhur, çarçafët nuk ndërrohen, pacientët nuk kanë mbulesa kur bënë ftohtë, muret e përlyer dhe të pa ngjyrosur, në disa raste duhani pihet brenda, e ka raste kur edhe mjekët pijnë alkoool në orar të punës. Pastaj ka mungesë të autoambulancave që të plotësojnë kushtet e nevojshme, etj. Edhe pse nuk ka pasur ende probleme, materniteti në QKMF në Klinë, funksionon pa licencë të Ministrisë së Shëndetësisë. Në rast të ndonjë komplikimi për nënën apo fëmijën, mjekët thonë “n’dorë të zotit” ose duhet në atë gjendje të dërgohen në spitalin regjional në Pejë, e kur i shton mungesën e autoambulancave që të plotësojnë kushtet, atëherë nëna dhe fëmija mund të jenë në rrezik. Po ashtu, nuk ka mjekë kujdestar, nxehe ndërsa në ndërrim të natës punon vetëm një shofer.

Qendrat e Mjekësisë Familjare në fshatrat më të mëdha, Zllakuqan, Ujmirë dhe Sferkë nuk funksionojnë si duhet. Edhe vetë autoritetet e pranojnë se në këto qendra ofrohen shërbime të përgjysmuara. Këto qendra punojnë me vetëm gjysmë orari, edhe pse sipas ligjit, Qendrat e tilla duhet të funksionojnë 24 orë. Ndërsa, ka fshatra që secilin shërbim shëndetësor e kanë shumë larg dhe nuk ka ekip mobil që ofron shërbime shëndetësore prandaj, ata detyrohen për secilën çështje të shkojnë në QKMF, në Klinë. Me gjithë këto probleme, Komuna e Klinës në buxhetin e miratuar në Kuvend ka ndarë zero (0) euro buxhet, për sektorin e shëndetësisë për vitin 2014.

Arsimi në Komunën e Klinës - Viti i ri shkollor 2013/2014 në Komunën e Klinës ka nisur me shkelje të Ligjit për Arsimin Para-universitar, pasi që nuk është shpallur fare konkurs për pranimin e kuadrit të ri shkollor edhe pse janë rreth 70 mësimsdhënës që janë të pakualifikuar. Veprimet nga MASHT-i dhe Inspeksioni kanë munguar dhe kjo çështje ka kaluar vetëm me reagimin e partive opozitare. Në të njëjtën kohë, në fillim të vitit shkollor është shpallur edhe konkursi për drejtor shkollash të kësaj komune. Pjesa më e madhe e drejtorëve janë zgjedhur nga partia në pushtet, PDK-ja. Mos shpallja e konkursit dhe zgjedhja e drejtorëve një muaj e gjysmë para fushatës elektorale është vlerësuar si fushatë elektorale nga partia në pushtet. Gjatë kësaj kohe është larguar nga puna Bekim Gashi, i cili ka qenë zëvendës-drejtor në Shkollën e Sferkës dhe nuk i është vazhduar mandati më, duke e lënë madje pa asnjë orë mësimi, ani pse ka mbaruar Fakultetin e Historisë. Fillimi i vitit është përcjellë me probleme edhe për faktin që rreth 1.000 nxënës e kanë nisur vitin shkollor 2 muaj me vonesë, për shkak të renovimit të objekteve. Janë shumë shkolla të cilat janë në gjendje të rëndë dhe duan kujdesin e organeve, duke nisur nga kushtet elementare(higjiena në klasë, tualete, uji, etj.) deri tek kushtet më të mira për edukim (mungesë hapësirash, kabinetesh, bibliotekash, etj). Qyteti i Klinës ka vetëm një çerdhe publike për fëmijë e që nuk i plotëson kërkesat e qytetarëve.

Mungesa e ndriçimit publik në qytet dhe fshatra – Ndriçimi mbetet çështje e pazgjidhur dhe një pjesë e madhe e dritave ekzistuese nuk ndizen fare, ngase nuk mirëmbahen. Ndriçimi mungon edhe në rrugën kryesore të qytetit. Edhe rruga “Ymer Berisha”, nuk ka ndriçim të duhur ani pse është ndër më të frekuentuarat, sikur as në lagjet “Arbëria”, “Dukagjini” dhe “Drenica. Në pjesën ku frekuentojnë nxënësit dhe ndodhen autobusët për ta, është errësirë e plotë.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Vazhdimin e punëve të nisura	Ndërtimi i tri shkollave: Jashanicë, Perqevë dhe Kpuz (bashkë-financim me MASHT-in)	Qeverisje transparente
2	Rregullimin e tërë infrastrukturës shkollore në Komunën e Klinës	Ndërtimin e qerdhes për fëmijë	Komunikim me qytetarë
3	Bujqësi Ngritje të serave, makina mjelëse për bagëti – lopë, penda për ujitje në Krushevë të Madhe, rregullimi i kanalit të ujitjes	Rregullimi i sheshit “Ndue Përllëshi”, (në partneritet publiko/privat). Vazhdimi e ndërtimit të objektit për kategoritë e luftës	Administratë efikase
4	Funksionalizimin e të gjitha sporteve në Klinë	Staza për këmbësorë për të Ujëvarat e Mirushes - duke nisur nga rruga Klinë-Gjakovë e deri të Ujëvara e parë	
5		Ndihmë në projektin për rregullimin e mozaikut të zbuluar në fshatin Dresnikë	
6		Kanalizime dhe ujësjellës në të gjitha fshatrat	
7		Salla e sporteve	

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Të ketë koordinim më të mirë të Kryetarit dhe Kryesuesit në përpilimin e rendit të ditës, siç është e përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, statutin dhe rregulloren e punës dhe të eliminohet atmosfera negative në Kuvend në miratimin e shumë vendimeve, duke kaluar procedurat e duhura ligjore;
- Funkcionim efikas të Ditës së Takimeve të Kryetarit me qytetarë në ditën e enjte (siç është e përcaktuar). Terminet e caktuara të jetë të sakta dhe mos të ketë maltretime për banorët që udhëtojnë dhe nuk gjejnë Kryetarin në zyre për t'i pritur;
- Të bëhet publikimi i orareve të takimeve të Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, të Drejtorëve apo të akterëve të tjerë të përhershëm apo të krijuar për një çështje të caktuar;
- Të bëjë një analizë të thellë të gjendjes në shëndetësi, duke nxjerrë nevojat dhe problemet urgjente dhe gjatë rishikimit të buxhetit të ndahen mjete buxhetore për të plotësuar nevojat dhe kërkesat elementare të qytetarëve;
- Të planifikoj dhe siguroj hapësirën për ndërtimin e stacionit të autobusëve;
- Të përpilojë një plan veprimi në bashkëpunim me kompaninë regionale 'Ambienti' duke përfshirë koston që të përfshihet gjithë territori i Komunës së Klinës në sistemin e grumbullimit të mbeturinave;
- Të bëjë një plan të ruajtjes së hapësirave të gjelbërta dhe planifikimin për parkun e qytetit. Në këtë mënyrë, zona përreth Drinit të Bardhë duhet të ruhet mirë nga ndërtimet dhe krijimi i shëtitoreve dhe zonave të gjelbërta të mbetet prioritet;
- Të respektoj vendimin e MAPL-së me të cilin ka shpall të kundërligjshëm kushhtëzimin e Komunës karrshi qytetarëve me pagesat e mbeturinave;
- Organet komunale, bartësit e tyre të kenë konsultime paraprake, të përhershme dhe të mirëfillta me zyrën ligjore dhe rekomandimet e zyrës ligjore të merren në konsideratë. T'i lihet kohë e mjaftueshme zyrës ligjore për të shqyrtuar secilën kërkesë drejtuar kësaj zyre;
- Qytetarët të informohen me punën dhe angazhimin e organeve të Komunës së Klinës. Ftesa në adresë të përfaqësuesve të fshatrave apo zonave të dërgohen në kohë dhe në mënyrë të rregullt;
- Konsultim i gjerë qytetar para miratimit të buxhetit për periudhën vijuese, planifikimeve afatgjate, strategji të ndryshme, investimet kapitale apo çështje me interes për publikun. Takimet të realizohen në fshatra apo Bashkësi Lokale, varësisht çështjes dhe zonës që preket;
- Zyra për Informim të jetë më aktive duke publikuar lajmet nga funksionimi i organeve komunale, njoftimet dhe çdo gjë tjetër t'i komunikohet qytetarit me kohë;
- Themelimin dhe organizimin e Këshillave në Bashkësitë Lokale të Komunës dhe zona urbane të Klinës. Procesi i zgjedhjes në këto Këshilla të jetë i drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Drejtoria së Urbanizmit

- Të respektohen planet urbane të miratuara në Kuvend në përpikëri. Para ndryshimeve faktike në terren (shkeljeve të planeve) të nisnin procedurat e rregullta për ndryshimin e secilin plan, gjithnjë brenda kornizave ligjore dhe të jetë Kuvendi i Komunës, ai që miraton ndryshimet duke u pajisur me dokumentet e nevojshme dhe në kohëtë mjaftueshme për shqyrtimin e tij;
- Ekzekutivi të sjell në Kuvend Komunal, draftin e fundit (pas plotësimeve nga diskutimet me publikun) të Planit Zhvillimor Komunal të Klinës. Pas ndryshimeve dhe miratimit të Planit Zhvillimor Urban të zhvilloj dhe sjell për miratim edhe Planin Detal Urban të qytetit.
- Mbikëqyrje dhe kontroll më efikase të realizimit të projekteve nga kompanitë e kontraktuar për kryerjen e punëve të ndryshme. Në të njëjtën kohë të bëhet një vlerësim dhe të ndahet buxhet për funksionalizimin e plotë të shumë projekteve që janë lënë në gjysmë apo janë jofunksional;
- Të trajtoj si çështje urgjente ndërtimet e shumta ilegale në rezervatin bujqësor.

Drejtoria së Financave

- Komuna e Klinës duhet të jetë më e arsyeshme dhe më e kujdesshme në shpenzimin e parasë publike, sidomos në kategorinë mallra dhe shërbime, telefoni, derivate, mirëmbajtje e veturave;
- Ngritja e transparencës përmes ndarjes së informacioneve rreth shpenzimit të parasë publike. Raportet financiare të publikohen në ueb-faqen e Komunës së Klinës dhe formave të tjera si rrjetet sociale;
- Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal të iniciohet dhe seriozisht të adresohet nga ana e Drejtoria së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik dhe të përpilohen planet për zhvillim të Komunës, duke u ofruar edhe me donatorë të ndryshëm apo Organizata të Shoqërisë Civile në shkrimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme në Komunën e Klinës.

Kryesuesit të Kuvendit

- Kryesuesi i Kuvendit të respektoj në përpikëri Rregulloren për punë të kuvendit dhe Komiteteteve. Kryesuesi të konsultoj rregulloret në fuqi dhe të jetë i përgatitur për t'i dhënë zgjidhje cdo situatë të krijuar gjithnjë duke u konsultuar me zyrën ligjore paraprakisht, kur është e mundshme;
- Të ruaj neutralitetin gjatë udhëheqjes së seancës duke trajtuar barabartë të gjitha grupet kuvendare, pa anime politike;
- Të thellohet bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile, sidomos në organizimin e takimeve me qytetarë. OJQ-të dhe grupe tjera interesi, varësisht çështjes që është në trajtim, të përfshihen në procesin e diskutimit dhe bërjes së politikave.
- Të ndërmarr hapat e duhur dhe të menjëhershëm që t'i harmonizoj të gjitha rregulloret komunale me ligjet në fuqi.
- Anëtarët e Kuvendit të Kuvendit
- Të shqyrtojnë mirë dhe marrin kohë të mjaftueshme para diskutimeve në seancë për të gjitha dokumentet të cilat ofrohen në Kuvend nga ana e Ekzekutivit apo

KPF-së. Dokumentacioni të merret me kohë, sidomos ata të cilët nuk përdorin formën elektronike (e-mail);

- Të konsultohet mirë dhe kujdesshëm rregullativa ligjore për secilën çështje në diskutim dhe në këtë mënyrë të jenë aktiv dhe përçojnë interesin publik, interesin e qytetarit dhe zhvillimit të drejtë të Komunës së Klinës duke u bazuar në argumente dhe kontribuar në vendime të drejta dhe të ligjshme të cilat edhe e korrigjojnë punën e Ekzekutivit dhe vetë Kuvendit;
- Të jenë aktiv në seanca duke trajtuar çështjet në diskutim. Po ashtu duke respektuar procedurat ligjore të sjellin propozime konkrete për temën në diskutim apo të sjellin propozime të reja për diskutim në Kuvend. Mos të jenë çdo herë pro propozimeve të cilat sjellë Ekzekutivi, sidomos pa i trajtuar dhe vlerësuar mirë nëse kjo është më e mira për Klinën dhe qytetarin;
- Këshilltarët të jenë më të kujdesshëm gjatë zhvillimit të seancave duke lënë anash punët dhe obligimet tjera dhe të jenë 100% pjesë e zhvillimeve, që do të thotë më pak telefonata dhe lëvizje gjatë zhvillimit të seancave;
- Këshilltarët komunal të jenë vazhdimisht të lidhur dhe në konsultim me qytetarët, po ashtu tu përgjigjen ftesave të organizatave të Shoqërisë Civile dhe të gjejnë forma bashkëpunimi.


Raporti Monitorimit 2013




Komuna Fushë Kosovë



Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



5. Komuna FUSHË KOSOVË

Komuna e Fushë Kosovës ka probleme thuajse të njëjta sikurse komunat tjera në Republikën e Kosovës. Trendi i zhvillimit ekonomik që ka komuna e Fushë-Kosovës përcillet me shumë probleme. Gjatë ndërtimeve të komplekseve banesore i kushtohet pak rëndësi ruajtjes së mjedisit. Kontaminimi dhe derdhja e ujërave të zeza dhe hedhja e mbeturinave në lumenjtë që janë pjesë e komunës, ai i Prishtevkës dhe Sitnica, që pastaj krijon edhe kundërmim erërash dhe insekte të shumta, po ashtu gjatë të reshurave ka ndodhur që lumi Sitnica ka dalë nga shtrati duke ia vështirësuar jetën e qytetarëve dhe ka pasur edhe dëmtime.

Problemet kryesore të komunës janë:

- Problemi i ujit të pijes;
- Ndërtimet e shumta dhe të larta,
- Hapësirat e pakta të gjelbërta,
- Ndotja e ajrit që vjen nga KEK-u ,
- Derdhja e ujërave të zeza në lumenjtë etj.

Komuna e Fushë-Kosovë gjatë këtij mandati qeverisës ka disa të arritura nga të cilat përfiton direkt qytetari i saj. Arritja kryesore e komunës është që në partneritet me UNDP ka arritur marrëveshje për hapjen e 250 vendeve të punë, e që ka për qëllim nxitjen e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe përfshirjen sociale të individëve të cënueshëm që jetojnë në Komunën e Fushë-Kosovës. Kjo marrëveshje në fokus ka zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e mjedisit, edukimin e komuniteteve etj.

Një e arritur tjetër është edhe realizimi i ndriçimit solar në qytet dhe në disa fshatra që i lehtëson qytetarëve lëvizjen e lirë edhe gjatë kohës së mbrëmjes. Po ashtu, Komuna ka marr iniciativën për ndërtimin e shtëpive për personat e riatdhesuar.

Disa fshatra që kanë pasur problem me rrjetin e kanalizimit në vitin 2010 tani e kanë të rindërtuar rrjetin e kanalizimit si për fshatrat Miradi e Epërme dhe Grabofc.

Drejtoritë komunale kanë mundësi shumë të mëdha përmirësimi të cilësisë së shërbimeve dhe kryerjes së punëve në terren por një vështirësi e madhe për të bërë këtë, është mungesa e stafit të kualifikuar dhe adekuat për të përballur sfidat që janë përpara. Një drejtori e cila është e lidhur direkt me funksionimin e jetës kulturore dhe civile në komunë është ajo e



Kulturës por e cila, shikuar nga ndarja që i bëhet buxhetit të saj, duket që është e interesuar më së shumti për udhëtimet e ansambllit dhe jo shumë për sektorë tjerë, edhe pse komuna e Fushë-Kosovës është komunë lidere për ndarjen buxhetore që i bën Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Vlen të vlerësohet ndihmesa direkte për bujqit dhe fermerët e komunës së Fushë-Kosovës e cila gjatë vitit 2013 ka qenë në nivele relativisht të larta karshi buxhetit të përgjithshëm që kjo komunë ka.

Këshilltarët komunal kanë qenë kryesisht shumë pasivë gjatë vitit 2012 dhe ky veprim është dëmtrim i parimit të kontrollit dhe balancimit të pushtetit lokal. Profili profesional i shumicës së anëtarëve komunal të Kuvendit Komunal duket që nuk ua lejon atyre të flasin me kompetencë për problemet që komuna ka dhe për shkeljet eventuale që Ekzekutivi komunal bën. Kjo qetësi tyre hap rrugën për drejtorët komunal që me thjeshtësinë më të

madhe të kalojnë vendimet e tyre në Asamble edhe atëherë kur ato janë në kundërshtim me interesat e qytetarëve. Shumica e anëtarëve të mandatit 2009-2013, nuk kanë ri-kandiduar apo ri-zgjedhur për një mandat të ri në Asamble gjë që jep shpresë se ndoshta Asambleja do të ketë një rol më të rëndësishëm dhe do të jetë më vigjente përballë Ekzekutivit komunal, i cili në disa raste sillet me plotë vetëbesim dhe deri në arrogancë përballë të zgjedhurve të popullit. Asambleistët gjatë këtij viti, asnjëherë nuk kanë sjell propozime për ndonjë çështje.

Transparenca në Komunë

Transparenca në komunën e Fushë-Kosovës ka qenë e kënaqshme, por duhet të punohet më shumë në informimin e qytetarëve lidhur me mbajtjen e seancave të Kuvendit Komunal.

Seancat plenare janë mbajtur në formë të hapur për publikun, në objektin e Komunës, respektivisht në sallën e Kuvendit, njoftimi për mbajtjen e seancave është bërë me kohë ashtu siç e përcakton ligji për vetëqeverisjen lokale, 1 javë më herët. Materiali për seancë iu është dërguar me kohë të gjithë deputetëve dhe OJQ-ve të cilat e monitorojnë punën e Kuvendit. Të gjitha vendimet që janë marr kanë qenë transparente pasi që votimi është bërë në mënyrë të hapur dhe ky votim ka ndodhur pas shterjes të gjitha diskutimeve.

Gjatë seancave plenare nuk ka pasur prezencë të mediave edhe pse gjithmonë ka pasur hapësirë për përcjellje mediale të kuvendit, mirëpo për shkak të mungesës së një kanal televiziv dhe radios lokale kjo nuk ka ndodhur.

Qasja në dokumente zyrtare ka qenë në nivel mesatar në relacion me kërkesat e qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit. IZHL ka kërkuar qasje në disa dokumente zyrtare dhe ka marr përgjigje pozitive.

Disa nga dokumentet e kërkuara janë:

- Shpenzimet kapitale për periudhën maj-shtator,
- Listën e dhënieve për lejet urbanistike dhe lejet ndërtimore,
- Listën për mbikëqyrjen e projekteve që realizohen në territorin e komunës etj

Duke e parë se Ueb-faqja e komunës nuk po freskohet me informacione të nevojshme, IZHL ka ngritur këtë çështje në takime publike, dhe së fundmi vërehet një përmirësim i vogël, por ende lë shumë për të dëshiruar.

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari dhe drejtorët e drejtorive të ndryshme kanë sjellë raportin dhe kanë raportuar në kuvendin komunal, ku kanë qenë të pranishëm të gjithë anëtarët e kuvendit komunal dhe disa OJQ që e monitorojnë punën e Komunës në përgjithësi. Anëtarët pas përfundimit të seancave nuk kanë marr iniciativën për tu takuar me qytetarë për t'i informuar rreth zhvillimeve që ndodhin në Kuvendin Komunal, kjo tregon se llogaridhënia nga ana anëtarëve komunal nuk ka qenë e kënaqshme. Nuk ka pasur shumë takime në mes anëtarëve komunal dhe qytetarëve, në disa takime, IZHL ka ftuar asambleistët që së bashku të shkojnë në komunitet dhe të diskutojnë për problemet e tyre.

Kryetari ka sjellë raportin për punën e tij para anëtarëve komunal, ku ka mbajtur edhe një fjalim rreth punës që ai ka bërë dhe ka shtjelluar raportin në pika të shkurtra. Në fund, asambleistët kanë mundur t'i parashtrajnë pyetje Kryetarit lidhur me raportin, gjithashtu ky raport është pritur mirë nga asambleistët. Në komunën e Fushë-Kosovës në vitin 2013, janë mbajtur 3 dëgjime publike.



Prezenca e qytetarëve ka qenë e vogël, kryesisht kanë qenë disa OJQ. Disa prej sugjerimeve të qytetarëve janë marr parasysh dhe kjo vërehet nga paraqitja e buxhetit final. Edhe rekomandimi i IZHL që sektorit të arsimit t'i shtohen dhe një pjesë nga sektori i kulturës në mënyrë që të mund të përfundohen disa projekte të nisura më herët.

Urbanizmi në Komunë

Një plan i ri urbanistik që ka parasysh gjendjen aktuale të ndërtimeve dhe tendencat e tyre do të ishte i domosdoshëm për komunën e Fushë Kosovës me kusht që të njëjtit t'i përmbaheshin të gjithë. Pozita gjeografike që ka komuna e Fushë Kosovës dhe kushtet e mira për jetesë kanë bërë që prej nga paslufta e këtej, komuna e Fushë Kosovës të jetë atraktive për banim për qytetarët nga i gjithë vendi. Në këto rrethana, vendi është shndërruar në një kantier ndërtimi ku me dhjetëra ndërtime të larta janë gjithmonë në ndërtim e sipër, ndërsa dhjetëra në mos qindra janë përfunduar. Përball kësaj situatë shpeshherë qytetarët e komunës së Fushë Kosovës janë ankuar për prishje të qetësisë dhe ambientit. Po ashtu një pjesë e madhe e rrugëve lokale në qytezën e Fushë Kosovës janë shkatërruar nga kamionët me mbi peshë të shfrytëzuar për ndërtim nga kompanitë e ndryshme. Në këtë valë të ndërtimeve një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk kanë përfillur ligjet për ndërtim apo dhe Planin Urbanistik të Fushë Kosovës.

Gjatë këtyre muajve të monitorimit, më shumë se njëherë është përmendur çështja e legalizimit apo jo të këtyre ndërtimeve dhe duket që ekziston një disponim që kjo të bëhet duke ndjekur shembujt e komunave tjera por edhe Ligjin për Ndërtime. Ne konsiderojmë që, legalizimet e objekteve duhet të bëhen vetëm në ato raste kur ndërhyrja për largimin e tyre është e pamundur dhe se tarifat e vendosura për legalizim të pjesëve që tejkalojnë parashikimet e ligjit dhe planit urbanistik të jenë të larta sepse kështu arrihet edhe ndëshkimi i tyre dhe i bënë të tjerët që eventualisht në të ardhmen të mendojnë më mirë për rastet e tejkaloimit të parashikimeve.

Financat në Komunë

Financat janë një sektor kyç në funksionimin e komunës, sa i përket raportit të shpenzimeve buxhetore e ka bërë këtë në mënyrë transparente dhe ka pasur qasje çdo i/e interesuar por edhe nga shoqëria civile edhe pse ka pas vonesa në kthim të përgjegjeve.

Një ndër problemet kyçe për komunën e Fushë Kosovës është edhe definimi i kufijve administrativ me komunën e Prishtinës në mënyrë që mos të ketë huti se cila komunë është kompetente për pagesat dhe taksat komunale që i kryejnë qytetarët. Komuna ka aprovuar një Rregullore për Rarifat, Ngarkesat dhe Gjoha ku banorët e komunës së Fushë Kosovës duke iu përmbajtur kësaj rregulloreje, kryejnë shërbimet që kanë ndaj komunës. Komuna e Fushë Kosovës sa i përket raportit financiar mund të thuhet se është një ndër komunat me të hyrat më të mëdha vetanake për kokë banori, ku në vitin 2012 i ka tejkalu parashikimet e bëra. Këto shifra të larta të të hyrave i japin komunës së Fushë Kosovës komoditetin të investoj më shumë në projekte kapitale. Për këta muaj të monitorimit nuk kemi vërejtur ndonjë shkelje në shpenzimin e parasë publike përveçse vonesa në fillimin e investimeve kapitale.

Ujii pijes dhe ndërtimet egra

Komuna e Fushë Kosovës me një numër të madh të banorëve që jetojnë në këtë komunë, ka problem kyç çështjen e ujit të pijshëm, i cili nuk mungon vetëm në viset rurale por gjithashtu dhe në qytet. Për këtë problem, institucionet kompetente komunale janë angazhuar për zgjidhjen e tij, mirëpo duke e pasur parasysh se nuk është vetëm kompetencë e komunës por edhe e kompanisë rajonale përkatësisht, ujtësjellësit rajonal "Prishtina",ky

problem mbetet evident për shkak të mos-arritjes së ndonjë marrëveshjeje për zgjidhjen e këtij problemi.

Problemtjetër për komunën e Fushë Kosovës janë ndërtimet e komplekseve banesore të cilat ndërtohen duke mos e respektuar planin urbanistik, që përcakton se në komunën e Fushë-Kosovës mund të ndërtohen komplekse banesore p+7 ndërsa ka raste kur investitori ka ndërtuar p+9 dhe kjo paraqet problem të madh edhe për banorët që jetojnë afër lokacionit. Po ashtu, një rregull tjetër që shkelet nga investitorët është që në hapësirën ku bëhen investimet duhet të jetë 49% ndërtim dhe 51% gjelbërim.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Zhvillim ekonomik përmes stimulimit të prodhimeve vendore	Shkollave me laboratore, do të mbështes dhënien e bursave për studentëtve të dalluar.	Do të punojmë që qytetarët të jenë pjesëmarrës në politikëbërjes.
2	Punësim i të rinjve	Mbështetje agro bizneseve	Dera e kryetarit gjithmonë e hapur për qytetarë
3	Komunë ekologjike, më një ambient të pastër, mekanizmat filtrues.	Shkolla të reja	Shërbime të shpejta dhe efikase
4	Shërbimeve shëndetësore cilësore dhe forcimin e rolit të mjekut të familjes.	Asfaltim i rrugëve	Qasje në dokumentet publike
5	Kultura dhe sporti	Ndriçim solar	
6		Investim në kanalizim dhe ujësjellësë	

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Të ketë sa më shumë dëgjime publike me qytetarët dhe jo vetëm në objektin e komunës por edhe nëpër fshatra gjatë hartimit të buxhetit dhe të merren parasysh rekomandimet e qytetarëve;
- Kryetari duhet të punojë në funksionalizimin e shtëpive të shëndetit nëpër fshatra gjatë tërë javës e jo vetëm një ditë të javës;
- T'i kushtohet më shumë vëmendje hapësirave gjelbëruese në mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre, që janë shumë të pakta aktualisht;
- Ligji për vetëqeverisje lokale parasheh që komuna të ketë autonomi të plotë në marrjen e vendimeve në të mirë të qytetarëve të komunës, andaj edhe në rastet e ndërtimeve pa plan urbanistik të merr vendime për ndalimin e tyre e mos të pres udhëzimet e rekomandimet nga ministritë.
- Të funksionalizohen këshillat e bashkësive që të marrë rekomandime nga ata dhe në një farë forme këta të jenë një mekanizëm i procesit të transparencës.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Për arsye të mbingarkesës së qytetit, Drejtoria e Urbanizmit duhet të jetë më e vëmendshme dhe mos të lejoj shkeljen e Planit Urbanistik nga kompanitë ndërtimore;
- Të inspektojë në mënyrë më rigorozë punën e ndërtimeve që bëhen në komunën e Fushë Kosovës.
- Të monitorohet zbatueshmëria e planit urbanistik dhe të sigurojë që objektet banesore zbatohet përmbahen plani urbanistik me përpikëri, dhe veçanërisht të mos lejohet ndërtimi i objekteve banesore që i tejkalojnë limitet e ndërtimit të objekteve.

Drejtorisë së Financave

- Të nxitet zhvillimit ekonomik dhe kryesisht përmes ndihmesës direkte dhënë bujqësisë dhe blegtorisë si sektorë strategjik për investime kapitale.
- Ta respektoj normat për dëgjimet publike rreth buxhetit ku parashihen së paku tri dëgjime publike rreth buxhetit, kurse komuna për kornizën afat-mesme buxhetore ka mbajtur vetëm dy dëgjime publike.
- Duhet të ketë më shumë kujdes gjatë përpilimit të buxhetit, t'i ipet përparësi sektorëve strategjik të zhvillimit të komunës dhe më pak të ndahen për sektorë tjerë.
- Shpenzimet javore, mujore dhe vjetore të komunës të ndara në kategori dhe me detaje të paraqiten në ueb-faqen e komunës e që është një model tashmë i praktikuar edhe në Kosovë, pas suksesit të treguar në shtetet demokratike.

Asambleistëve të Kuvendit

- Anëtarët e Kuvendit duhet të vijnë të përgatitur në seanca, ngase ka pasur të atillë që janë deklaruar që nuk e kanë lexuar fare dokumentet për të cilat do të duhet që ai t'i votoj.
- Asambleistët duhet të jenë më aktiv gjatë shqyrtimit të rregulloreve dhe vendimeve të ndryshme që merren në Kuvend e jo vetëm ta ngrisin dorën siç bëjnë shumica e tyre. Asambleistët duhet të kenë kontakte me qytetarët përmes debateve të ndryshme.


F. Kosovë - Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	10	58	74%	%
Janar	1	4	100%	8/8
Shkurt	1	2	100%	8/8
Mars	1	5	96.29%	8/8
Prill	1	7	100 %	8/8
Maj	1	9	100 %	8/8
Qershor	2	7	92.59% 100%	6/8 8/8
Korrik	0	0	%	%
Gusht	1	11	92.59%	6/8
Shtator	1	9	96.29%	8/8
Tetor	0	0	%	%
Nëntor	0	0	%	%
Dhjetor	1	4	100%	8/8
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	9	46		
Janar	1	2	88.88%	2/2
Shkurt	1	1	100%	2/2
Mars	1	5	100%	2/2
Prill	1	7	100%	2/2
Maj	1	7	100%	2/2
Qershor	1	4	100%	2/2
Korrik	0	0		
Gusht	2	11	88.88%	1/2
Shtator	1	9	100%	2/2
Tetor	0	0		
Nëntor	0	0		
Dhjetor	0	0		
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli i Sigurisë në Bashkësi	0		(Po)	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	3		20 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Rregullorja për punën e Kuvendit të Komunës së Fushë Kosovës	Aprovuar	Pro: 27, Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja për ndarjen e subvencioneve	Aprovuar	Pro: 27 Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja për tarifa , ngarkesa dhe gjoha	Aprovuar	Pro: 27 Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit TAXI të udhëtarëve	Aprovuar	Pro: 27, Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës për subjektet afariste në territorin e komunës së Fushë Kosovës	Aprovuar	Pro: 27, Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në komunën e Fushë Kosovës	Aprovuar	Pro: 27, Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për lejmin e mjeteve financiare për pagat e tetë mësuesve parashkollor.	Aprovuar	Pro: 12, Kundër: 2 Abs: 8
Vendim për lejmin e mjeteve financiare për shoqaten humanitare, “Nëna Terezë”	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 0 Abs: 10
Vendim për lejmin e mjeteve financiare për shoqaten e invalideve të luftës të ushtrisë çlirimtare të Kosovës	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 0 Abs: 10
Vendim për lejmin e mjeteve financiare për organizaten e pensionistëve dhe invalideve te punës	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 0 Abs: 10
Vendim për lejmin e mjeteve financiare për organizaten e prindërve të fëmijeve me aftësi të kufizuara	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 0 Abs: 10
Vendim për lejmin e mjeteve financiare për klubin e futbollit Fushë-Kosova	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 0 Abs: 10
Vendim për lejmin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës së fushë-kosovës.	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 0 Abs: 10
Raporti i Auditorit të jashtëm 2012	Shqyrtuar	
Vendim për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2013	Aprovuar	Pro: 27, Kundër: 0 Abs: 0
Raporti i Kryetarit	Shqyrtuar	
Vendimi mbi lirimin nga taksa komunale për regjistrim në zyrën e Gjendjes Civile për qytetarët e komunitetit rom, ashkalinj dhe egjiptioan për periudhën njëvjeçare	Aprovuar	Pro: 27, Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për mos-shfrytëzimin e resurseve natyrore, me qëllim të përpunimit	Aprovuar	Pro: 27, Kundër: 0 Abs: 0


Raporti Monitorimit 2013




Komuna

Kamenicë

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



6. Komuna KAMENICË

Në punën e ekzekutivit kemi evidentuar shumë shkelje e mangësi, ndërsa Kuvendi ka qenë shumë i kufizuar dhe nuk ka arritur të instaloj mekanizma për ta kontrolluar ekzekutivin. Kamenica ka pasur një opozitë jo unike dhe mjaft pasive, e cila shumë pak ka ngritur çështje dhe nuk ka dhënë alternativa për zgjidhjen e problemeve. Rezultatet e këtij viti nuk kanë përmbushur premtimet dhe kërkesat e qytetarëve.

Krijimi i komunës së Hogoshtit, ndërtimi i shkollave të reja në Roganë dhe Berivojcë, përfundimi i palestrës sportive, ngritja e shkollës së transparencës dhe llogaridhënies, përmirësimi i kushteve në arsim, krijimi i vendeve të reja të punës, përkrahja e klubeve sportive kanë qenë vetëm disa prej premtimeve të pa-përmbushura të kryetarit Shaip Surdulli

Institucioneve publike u është bërë thirrje publike që të ndërmarrin masa për ndërtimet pa leje, të cilat e kanë degraduar dhe shëmtuar Komunën. Në Kamenicë janë 109 objekte pa leje ndërtimi, 79 prej tyre vetëm në qytet. Dhe në 14 vjet, Inspeksioni nuk ka rrënuar asnjë objekt pa leje.

Problem tjetër ka qenë kualiteti i dobët i investimeve. Edhe përkundër qëllimeve për të bërë investime në ndërtimin e rrugëve, kanalizimeve e ujësjellësve, në të shumtën e rasteve ato janë realizuar dobët apo në mënyrë gjysmake. Dy rastet më të vonshme kanë qenë asfaltimi i rrugëve lokale, në fshatin Ruboc dhe në fshatin Topanicë që për shkak të kualitetit të dobët janë shkatërruar brenda tre muajve.

OJQ “Fortesa”, gjatë vitit 2013 ka bërë 8 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, ndërsa përgjigje ka marrë vetëm në 4 prej tyre. Ky është një tregues që Komuna e Kamenicës nuk është transparente në nivelin e duhur.

Problemet kryesore të komunës

Ndër problemet kryesor në Komunën e Kamenicës në vitin 2013 kanë qenë:

- -Mungesa e ujit të pijes;
- -Papunësia;
- -Dyshimet për afera korruptive;
- -Mbingarkesa e të punësuarve në administratë;
- -Politizimi i administratës komunale dhe arsimit.

Furnizimi me ujë të pijshëm po del si problem i pazgjidhshëm në Kamenicë. Me mungesë uji sidomos gjatë verës përballet qyteti, por edhe lagjet përreth. Edhe pse janë investuar qindra mijëra euro për ujësjellës, ky problem akoma nuk është zgjidhur as pas 14 vitesh.

Varfëria dhe papunësia po e godasin çdo ditë e më shumë popullatën e Kamenicës. Numri i të papunëve është vazhdimisht në rritje. Edhe ato pak punësime që bëhen, zgjasin nga dy deri në tre muaj. Në bazë të të dhënave të Zyrës Komunale për Punësim, papunësia në Kamenicë ka shkuar në shifra shqetësuese deri në 40 %.

Ndonëse komunë e vogël, Kamenica ka të punësuar hiq më pak se 222 shërbyes civil. Punësimi partiak gjatë mandatit të kaluar ka bërë që administrata e Kamenicës të jetë e mbingarkuar me më shumë se 100 punonjës.

Në vitin 2010, kryetari Shaip Surdulli kishte larguar rreth 50 punëtorë nga administrata me arsyetimin se janë punësuar pa konkurs, pa respektimin e kriterëve dhe se Komuna nuk ka më nevojë për punëtorë. Por, me kalimin e viteve, Surdulli me partnerin qeverisës

akomoduan militantë partiak madje duke e kaluar shifrën prej 50 personash. Buxheti komunal është dëmtuar për dhjetëra mijëra euro për shkak të largimeve të paligjshme nga puna.

Arsimi çdo ditë e më shumë po nëpërkëmbet e degradohet. Ankesat më të mëdha gjatë këtij viti kanë qenë pikërisht nga mësimdhënësit. Në shumë raste atyre u është bërë e padrejtë për shkak të pikëpamjeve politike. Kishte ndodhur që të punësuar me nga 30 vjet përvojë të jenë lënë jashtë sistemit, nga pesë arsimtarë të japin një lëndë në një shkollë, të punësohen profesor me drejtim në gjeografi që të japin Edukatë Qytetare dhe refuzohen kuadrot profesionale, si dhe të stërngarkohen shkollat me norma e gjysmë norma të arsimtarëve në prag të zgjedhjeve.

Të arriturat në vitin e kaluar

Në gusht në vitin të kaluar, Drejtoria e Bujqësisë kishte ndarë 71 makina mjelëse për 71 fermerë të komunës së Kamenicës. Meqenëse bujqësia është burim i të ardhurave për shumë familje, kjo ndihmë ua ka lehtësuar punën fermerëve, si dhe ka qenë një shtysë që ta shtojnë kapacitetin dhe të merren edhe më shumë me bujqësi. Gjatë këtij viti, Komuna ka ndihmuar fermerët e bujqit me rrethoja të pemishteve, koshere të bletëve, motokultivatorë etj.

Një e arritur tjetër që mund të vlerësohet në kulturë dhe sport është angazhimi i drejtpërdrejt i drejtorit, Faton Krasniqi, për t'i ndihmuar këtyre sektorëve dhe për t'ia kthyer Kamenicës namin e dikurshëm. Klubet e Kamenicës kanë shënuar suksese të shumta gjatë vitit në nivel kombëtar dhe jashtë vendit. Klubi i Atletikës "Rogana", tash e disa vite me atletët e vet është fituese absolute në shumë disiplina. Suksese ka pasur edhe Klubi i Volejbollit "Flaka", si dhe klubi i futbollit "Kamenica" dhe klubi i shahut. Komuna, përkatësisht Drejtoria e Kulturës dhe Sporteve, gjatë vitit 2013 dy herë i ka subvencionuar klubet sportive.

Vlerësimi për performancë

Qeverisja e Shaip Surdullit në Kamenicë gjatë vitit 2013, ka pasur shumë probleme dhe shkelje ligjore. Z. Surdulli nuk ka pasur bashkëpunim me shoqërinë civile dhe mediat, ndërsa ka pasur shkelje sa i përket ligjit për qasje në dokumente zyrtare. Po ashtu, nuk u është dhënë llogari institucioneve dhe qytetarëve dhe nuk i ka përmbush në masë të madhe premtimet elektorale.

Drejtorët komunalë, sidomos nga partia AAK, parti në koalicion me LDK-në, kanë pasur vështirësi në drejtimin e posteve për shkak të presionit. Duart më të lira në ushtrimin e përgjegjësive dhe kompetencave i kanë pasur drejtorët e LDK-së, parti nga e cila vjen kryetari i Komunës. Në përgjithësi, performanca e drejtorëve ka qenë e dobët.

Një pjesë e madhe e këshilltarëve kanë shërbyer vetëm si makina votimi dhe nuk e kanë kryer rolin dhe përgjegjësinë si të zgjedhur të qytetarëve. Një numër i madh i tyre asnjëherë nuk kanë ngritur ndonjë çështje dhe nuk kanë diskutuar gjatë tërë mandatit katër vjeçar.

Kryesuesi i Kuvendit është munduar të jetë neutral gjatë drejtimit të seancave, por ka pasur raste kur është ndikuar nga kreu i komunës. Me përjashtim të një apo dy rasteve, kryesuesi ka respektuar rregulloren e punës së Kuvendit.

Transparenca në Komunë

Transparenca nuk ka qenë në nivelet e kënaqshme. Ndonëse kanë qenë të hapura edhe për publikun shumë pak qytetarët kanë marrë pjesë në seancat e Kuvendit Komunal gjatë vitit 2013. Mediat dhe OJQ-të, vazhdimisht janë ankuar se nuk pranojnë ftesa për mbajtjen e seancave të Kuvendit apo mbledhje apo Komitetit për Politikë dhe Financa. Gjatë tërë vitit 2013, përfaqësuesit e OJQ-ve lokale në Kamenicë nuk kanë pranuar asnjë e-mail apo dokument të shtypur nga zyra e Kuvendit Komunal. Asambleja Komunale nuk ka ftuar asnjëherë në konsultim organizatat e shoqërisë civile për ndonjë pikë të rendit të ditës apo çështje me rëndësi për komunën.

OJQ-të lokale në Kamenicë iniciuan themelimin e komiteteve konsultative. OJQ-të propozuan që në bazë të specifikave të komunës së Kamenicës të formohen tri komitete: Komiteti për Planifikim, Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Ambient, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe Komiteti për Shëndetësi, Çështje Sociale dhe Emergjencia. Në seancën e gushtit, Kuvendi me unanimitet miratoi këtë propozim të dalë nga organizatat e shoqërisë civile. Por këto komitete, tash e pesë muaj, kanë mbetur të pa-funksionalizuara. Komuna ka shpallë një konkurs për pranimin e 21 anëtarëve, por interesimi ka qenë shumë i vogël dhe konkursi ka dështuar.

Mediat kanë qenë të lira të përcjellin zhvillimet në legjislativ por në shumë zhvillime brenda komunës, mediat nuk kanë qenë aktive për mbulimin e tyre. Përpos radios Premiera e cila ka përcjell shumicën e seancave të Kuvendit dhe ngjarjeve në komunë, të tjera medime kanë qenë pasive. Kryesuesi i Kuvendit vazhdimisht ka bërë thirrje për pjesëmarrje sa më të madhe të medias dhe shoqërisë civile në Kuvend dhe organe të tjera, dhe është shprehur i hapur për bashkëpunim. Por e njëjta gjë nuk ka ndodh me ekzekutivin. Gazetarët e paktë që veprojnë në komunën e Kamenicës kanë shpreh vazhdimisht ankesa për qasjen në informata, mungesën e një zëdhënësit të Komunës dhe vështirësitë në komunikim me kryetarin e komunës dhe disa drejtorë komunalë.

Komuna ka qenë thuajse hermetikisht e mbyllur sa i përket qasjes në dokumente zyrtare. Zyrarët e saj janë përgjigjur pozitivisht vetëm në disa kërkesa themelore por jo edhe kur është kërkuar qasja në pasurinë e paluajtshme të zyrtarëve të lartë të komunës, kontrata me Viva-Fresh, shpenzimet për dreka e darka, shpenzimet e veturës zyrtare të kryetarit të komunës. Në këto raste, zyrarët komunalë kanë heshtur, nuk kanë kthyer përgjigje, kanë shkelur afatet dhe ligjin për qasje në dokumente zyrtare.



Kryesisht në vitin e fundit, ka pasur një përmirësim sa i përket freskimit të ueb-faqes së komunës, por ajo vazhdon të ketë mjaftë mangësi. Aty mungojnë procesverbalet e takimeve të ndryshme, njoftimet me kohë për ndonjë takim, ngjarjet ditore, vendimet, si dhe ka vështirësi në hapjen e saj. Në zyrën e informimit janë të angazhuar tre zyrtarë komunalë. Pra, me një angazhim shumë të vogël ueb-faqja do të ishte e pasur dhe do të mund të funksiononte në mënyrë të shkëlqyeshëm. Vërejtje ka pasur edhe opozita se aty pasqyrohen kryesisht qëndrimet e udhëheqjes komunale dhe shumë pak hapësirë i jepet partive opozitare, kryesisht gjatë diskutimeve në Kuvend.

Zyra Komunale e Informimit duhet të jetë plotësisht në funksion të transparencës dhe publikut. Por, mjerisht, kjo zyrë edhe për shkak të mungesës së profesionalizmit po transmeton te qytetarët vetëm punën e kryetarit dhe ngjarje që lidhen me ceremoni apo suksese.

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Kamenicës gjatë vitit 2013 nuk e ka mbajtur asnjë tubim publik me qytetarët, ndonëse në bazë të obligimeve ligjore që burojnë nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ai duhet të mbajë së paku dy tubime. Roli i Kuvendit Komunal për ta kontrolluar ekzekutivin dhe për të kërkuar llogari nga ky organ, ka qenë pothuaj inekzistent. Kryetari i komunës dhe përfaqësues të tjerë të ekzekutivit kanë përdorur çdo instrument për ta nënshtruar legjislativin dhe zërat kritikë që mund të vijnë nga shoqëria civile apo mediat.

Bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe qytetarët nuk është prioritet i kryetarit të komunës. Ai vazhdon të ketë qasje selektive ndaj OJQ-ve dhe qytetarëve.

Mungesa e konsultimeve dhe takimeve të anëtarëve të kuvendit me qytetarë është një tjetër problematikë e këtyre muajve. Në anketimet e zhvilluara, shumica e qytetarëve, deklarojnë se nuk janë konsultuar asnjëherë nga anëtarët e kuvendit për ndonjë çështje të caktuar. Në tri seancat e fundit të Kuvendit së Kamenicës, asnjë qytetar nuk i ka përcjellë punimet.

Në shumicën e kohës, zyra e kryetarit të komunës dhe ajo e nënkryetarit kanë qenë të mbyllura. Takimet me palë, dy ditë gjatë javës, të nisur në fillim të mandatit të kryetarit të komunës janë ndërprerë vitin 2013. Kryetari i Kamenicës ka vazhduar të japë mësim në dy universitete dhe së paku dy ditë pune gjatë javës ai nuk ka qëndruar në zyrë.

Në fillim të muajit mars është mbajtur një dëgjim publik për buxhetin, i organizuar nga drejtoria e Buxhetit në bashkëpunim me organizatën “Intercooperation”, por deri më tani nuk kemi parë se është marrë parasysh ndonjë sugjerim i qytetarëve.

Kryetari i Komunës ka raportuar për punën gjashtëmuajore dhe financat në Asamble, si dhe ka marrë pjesë në pothuaj çdo seancë. Ai është përgjigjur në pyetjet e anëtarëve komunal. Por, vazhdimisht, ka bërë përpjekje që të ndikoj në vendimet e legjislativit, duke bërë propozime dhe duke e marrë fjalën për diskutim sa herë që ka dashtë.

Kontaktet e krerëve të komunës dhe anëtarëve të kuvendit me qytetarët kanë qenë shumë të rralla, kjo edhe për faktin se Komuna nuk ka ofruar një hapësirë ku do të mundësohej një linjë komunikimi në mes të qytetarëve dhe të zgjedhurve të tyre. Edhe ato pak takime me qytetarë organizohen sa për të përmbushur obligimet ligjore, fare pak janë marrë parasysh vërejtjet dhe ankesat e qytetarëve. Ato regjistrohen në procesverbal, por nga praktikat e viteve të kaluara, ato nuk inkorporohen në planifikime buxhetore. Vetëm Bashkësia Lokale në Qendër i ka adresuar qeverisë komunale 17 kërkesa për projekte të ndryshme në qytet dhe asnjë prej tyre nuk është realizuar në vitin 2013. Kjo ka ndikuar në masë të madhe në humbjen e besimit të qytetarëve në institucione. Dhe për pasojë, qytetarët po ua kthejnë institucioneve me bojkot, mos-përmbushjen e kërkesave të tyre.

Urbanizmi në Komunë

Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Urban gjatë vitit 2013 ka pranuar 91 kërkesa, ka lëshuar 12 leje ndërtimore, 14 pëlqime urbanistike, 27 vërtetime të ndryshme dhe 23 leje për shfrytëzim të hapësirës publike.

Por ndërtimet e shumta pa leje në komunën e Kamenicës, po vazhdojnë të jenë shqetësim për qytetarët. Prej 76 ndërtimeve të evidentuara dhe shumë të tjera që nuk janë publike, asnjë prej tyre nuk është rënë, apo nuk është marrë iniciativë për legalizim. Konsiderojmë se kjo është një papërgjegjësi e institucioneve të cilat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim që prej 14 vitesh për ta zgjidh këtë problematikë. Përmes një reagimi publik është kërkuar që në bazë të rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të fillohet me legalizimin apo rrënimin e të gjitha objekteve pa leje, për t'i dhënë fund një herë e përgjithmonë kaosit urbanistik. Pikërisht për shkak të problematikës së lejeve të ndërtimit, kryetari i Komunës, Shaip Surdulli, ka pasur vazhdimisht konflikte verbale me Drejtorin e Urbanizmit, Ilir

Kastratin, të cilin e shkarkoi nga detyra në prill të vitit 2013. Kastrati nuk e kishte nënshkruar lejen ndërtimore për një objekt në qendër të qytetit me arsyetimin se e prish planin urbanistik. Dhe kjo qoj në shkarkimin e tij, ndërsa në arsyetimin e Kryetarit, thuhej se drejtori nuk ishte bashkëpunues.

Në muajin tetor, Drejtoria e Urbanizmit lejoi tokën publike për ndërtimin e objektit montazh për ushtrimin e veprimtarisë së avokaturës, pa miratimin e Kuvendit.

Ne, si organizatë, u kemi bërë thirrje organeve komunale që të kenë kujdes me hapësirat publike e të gjelbërua. Por, përkundrazi restoranteve vetëm sa u është shtuar hapësira publike për shfrytëzim, madje u është lejuar që ta betonizojnë atë. Në këtë mënyrë, qytetarëve, veçmas atyre që banojnë në ndërtesa kolektive, u është zënë fryma nga karriget e tavolinat e subjekteve afariste.

Financat në Komunë

Buxheti i Komunës së Kamenicës për vitin e kaluar ka qenë 7 milionë e 525 mijë euro, apo 5.2% më i lartë se viti paraprak. Në 2013 ka pasur rritje të mjeteve nga granti qeveritar dhe kategoria e të hyrave vetanake. Gjithashtu, komuna ka rritur buxhetin për subvencione dhe investime kapitale.

Por, nga viti në vit, Komuna e Kamenicës po e vazhdon edhe trendin e rritjes së shpenzimeve. Komuna gati ka dyfishuar shpenzimet, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në drekat zyrtare, karburante, udhëtime brenda dhe jashtë vendit, veshmbathje e telefoni.

Deri në publikimin e raporteve të drejtorive, komuna ka mbajtur fshehtë shpenzimet edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme të OJQ “Fortesa” për të pasur qasje në dokumente.

Tabela e Shpenzimeve :

	2012 (Janar-Shtator)	2013 (Janar-Shtator)
Meditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	2,569.60	7,567.00
Shpenzimet të telefonisë Vala	12,683.51	16,086.68
Mobilie (me pak se 1000 euro)	0	2,604.00
Furnizime për zyre	26,204.08	31,603.87
Karburant për vetura	52,343.35	67,245.59
Dreka zyrtare	12,390.90	26,864.40
Mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	498.60	3,280.48
Mirëmbajtja e teknologjisë informative	1,219.68	4,018.74

Parku i askujt

Parku i qytetit të Kamenicës, vazhdon të mbetet park i askujt. Prishja dhe shkatërrimi i ulëseve, mungesa e ndriçimit dhe papastërtia e bëjnë të pashfrytëzueshëm parkun e vetëm të qytetit të Kamenicës. Hapja e një kanali në vitin 2010, në mes të hapësirës së parkut,

përbënë rrezik për vizitorët e paktë që mund t'i ketë. Vitin e fundit, parku ka mbet tërësisht pa mirëmbajtje, për shkak se në kontratën që komuna ka nënshkruar me një kompani për mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese, parku nuk është futur fare.

Problemet me ndriçim

Komuna duhet ta rregulloj një herë e mirë çështjen e ndriçimit publik. Për shkak të defekteve, qyteti shpeshherë mbetet në errësi. Problemet me ndriçim janë më të theksuara në lagje dhe fshatra. Drejtoria e Shërbimeve Publike duhet të ndërmarr masa të nevojshme në mënyrë që në ato pjesë që ekziston infrastruktura të rregullohet ndriçimi dhe në të tjera që mungon, të filloj shtrirja. Qytetarët, kanë ankesa për mungesë ndriçimi sidomos në orët e vona dhe gjatë dimrit, për shkak edhe të sigurisë.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Reformimi i administratës komunale	Rregullimi i parkut, prapa Qendrës për Punë Sociale	Transparent dhe bashkëpunues me mediat dhe OJQ-të
2	Zhvillimi ekonomik dhe hapje të vendeve të reja të punës	Rekonstruimi i stadiumit. (Ndriçim, shirita të vrapimit, mbulimi i tribunave)	Bashkëqeverisje me qytetarët; Takime të shpeshta me qytetarë
3	Projekte infrastrukturore për qytetin	Ndërtimi i shkollës në Berivojcë	Respektim në përpikëri të ligjit dhe udhëzimeve administrative
4	Kujdes institucional për vlerat kulturore dhe mbështetje klubeve sportive	Ujësjiellës në Muçiverc	Llogari për çdo centë të shpenzuar; Kursim maksimal të shpenzimeve për dreka, karburante e telefoni
5		Rregullimi i shtratit të lumit në Hogosht. Ujësjiellës dhe kanalizim për këtë fshat	
6		Shkollë e re në Krilevë	
7		Asfaltimi i rrugëve në fshatin Kopërnice	

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Të ketë angazhim më të madh për ta zgjidh problemin me furnizimin me ujë të pijshëm. Urgjentisht duhet të funksionalizohen ujësjellësit e lënë në gjysmë dhe të ndërtohen të rinj, në ato lokalitete ku mungojnë;
- Të ndalohet politizimi i shkollave përmes punësimeve partiake;
- Të propozohet rritja e Fondit për Ndihma të Rasteve Sociale nga 5 mijë në 20 mijë euro, për shkak të gjendjes së rënduar të shumë familjeve të komunës së Kamenicës;
- Të shtojë ndikimin mbi ndërmarrjen publike për bartjen e mbeturinave në mënyrë që ajo të jetë më efikase në kryerjen e detyrave;
- Të përpjekjet të sjell vendimmarrjen sa më afër qytetarëve dhe ta respektoj në përpikëri çdo nen të ligjit për vetëqeverisje lokale;
- Të jetë bashkëpunues me Kuvendin dhe të respektoj rregulloren e Kuvendit, si dhe të raportoj para Kuvendit kur t'i kërkohet, por jo të ushtroj ndikim në punën e këtij organi.
- Të mbledh dy herë në muaj këshillat lokale që do të duhej të ishin urë lidhëse mes pushtetit dhe qytetarëve, si dhe të rregullojë kompensimin e anëtarëve të këtyre këshillave.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Ndërtimet të lejohen vetëm në zonat e destinuara për ndërtim të përcaktuara me Planin Zhvillimor Komunal;
- Komuna të krijoj një platformë të partneritetit publiko-privat për zhvillimin e banimit (investime të përbashkëta, dhënia e tokës me koncesion etj.)
- Në bazë të rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, të fillohet me legalizimin/rrënimin e objekteve pa leje, për t'i dhënë fund kaosit urbanistik.

Drejtorisë së Financave

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave të respektoj qarkoret buxhetore të përcaktuara me ligj për organizimin e dëgjimeve publike për përfshirjen e qytetarëve në hartimin dhe planifikimin buxhetor;
- Draft-buxheti të publikohet në ueb-faqen e komunës, si dhe të shtypen në letër dhe të jenë të qasshme për publikun.

Kryesuesit të Kuvendit

- Të ketë raporte korrekte me përfaqësuesit e secilit subjekt të përfaqësuar në Kuvendin Komunal;
- Të bashkëpunoj me shoqërinë civile, të marrë mendimin e tyre rreth mbarëvajtjes së punës së Kuvendit. T'i konsultoj ndonjëherë edhe për rendin e ditës si dhe të mundohet t'i inkorporoj në procesin e vendimmarrjes.

Anëtarët e Kuvendit

- Ta shfletojnë materialin para seancave dhe të vijnë të përgatitur në seanca;
- Të përqendrohen më shumë në diskutime konkrete dhe të japin kontribut e alternativa në zgjidhjen e problemeve;
- Të sjellin propozime individuale dhe të mos mbesin gjithmonë peng të shefave të grupeve parlamentare;
- Të respektojnë orarin e seancave dhe të përfaqësojnë interesin e të votuesve.
- Të takojnë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile së paku një herë në muaj për tu informuar për gjendjen në terren dhe për të krijuar lidhje të qëndrueshme me ta.

Klinë - Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja


Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	12	33	88.42%	91.66%
Janar	1			
Shkurt	1			
Mars	1	3	70.37%	100.00%
Prill	1	4	100.00%	100.00%
Maj	1	5	88.88%	88.88%
Qershor	3	5	88.88%	88.88%
Korrik	1	3	88.88%	88.88%
Gusht	1	7	85.18%	88.88%
Shtator	1	4	88.88%	88.88%
Tetor	//	//	//	//
Nëntor	//	//	//	//
Dhjetor	1	2	96.29%	88.88%
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	11	23	79.58%	00.00%
Janar	1			
Shkurt	1			
Mars	1	3	71.42%	00.00%
Prill	1	3	85.71%	00.00%
Maj	1	4	85.71%	00.00%
Qershor	1	3	85.71%	00.00%
Korrik	2	2	57.14%	00.00%
Gusht	1	4	85.71%	00.00%
Shtator	1	2	85.71%	00.00%
Tetor	//	//	//	//
Nëntor	//	//	//	//
Dhjetor	1	2	//	//
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli i Sigurisë në Bashkësi			1	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	2		30 persona	

Sqarim: Të dhënat e paraqitura, janë për periudhën mars – dhjetor, 2013.

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Plani Zhvillimor Urban	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 9 Abs: 0
Ridestinimi i mjeteve për investime kapitale	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 2
Vendimi për zgjerimin e KKSB-së	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Raporti financiar Janar-Shkurt 2013	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 2 Abs: 0
Raporti i dëmeve të luftës 1998/99	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Organogrami Komunal 2013	Aprovuar	Pro: 23 Kundër: 0 Abs: 0
Raporti i dëmeve nga vërshimet	Shqyrtuar	Pro: 0 Kundër: 0 Abs: 0
Inicimi i procedurës për emërtimin dhe ri emërtimin e lagjeve, rrugëve dhe shesheve të Klinës	Aprovuar	Pro: 22 Kundër: 0 Abs: 0
Ndryshimet e anëtarëve të KPF-së	Aprovuar	Pro: 22 Kundër: 0 Abs: 0
Zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit Komunal	Aprovuar	Pro: 17 Kundër: 0 Abs: 7
Shqyrtimi dhe aprovimi i kërkesave të KPF-së	Aprovuar	Pro: 20 Kundër: 0 Abs: 0
Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës afatmesme buxhetore	Aprovuar	Pro: 17 Kundër: 0 Abs: 3
Rishikimi i buxhetit 2013	Aprovuar	Pro: 22 Kundër: 0 Abs: 0
Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së	Shqyrtuar/a provuar	Pro: 22 Kundër: 0 Abs: 3
Riemërtimin e lagjeve, rrugëve dhe shesheve të Klinës	Shqyrtuar/a provuar	Pro: 18 Kundër: 0 Abs: 7
Ndërtimi i një objekti P+6 për kategoritë e luftës	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0
Preferencat e KPF-së	Aprovuar	Pro: 14 Kundër: 7 Abs: 3
Raporti për menaxhimin financiar komunal për periudhën janar-qershor 2013	Shqyrtuar/a provuar	Pro: 17 Kundër: 7 Abs: 0
Vendimi për zhvendosjen e Shtatores Nënë Tereza në hapësirë me të përshtatshme në të njëjtin shesh	Shqyrtuar/a provuar	Pro: 17 Kundër: 7 Abs: 0
Procesverbali i debatit me publikun dt: 27.06.2013	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
Futja në diskutim publik e buxhetit 2014	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
Kërkesa për interpelancë me drejtorin e Arsimit	Refuzuar	Pro: 7 Kundër: 13 Abs: 3
Preferencat e KPF-së	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për konfirmimin e shkallës së njëjtë të tatimit në pronën e paluajtshme për vitin fiskal 2014 (sikur në vitin 2013)	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0


Raporti Monitorimit 2013




Komuna

Mitrovicë

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



7. Komuna MITROVICË

Problemet kryesore të komunës

Komuna e Mitrovicës përkundër shumë projekteve që ka realizuar në disa sektorë përfshirë investimet në ujësjellësin e ri, infrastrukturën rrugore dhe investimet në shkolla (arsim), për shkak të problemeve të mëdha ekonomike dhe politike, ka mbetur pa i funksionalizuar shumë kapacitete prodhuese, që kanë ndikuar në papunësi enorme dhe stagnim të zhvillimit ekonomik.

- Qytetarët janë ballafaquar me shumë probleme thuajse në të gjitha fushat e jetës ndërsa ndër problemet kryesore, që edhe më tej mbesin sfidë për pushtetin e që janë trashëguar edhe në vitin 2013, janë:
- Mungesa e furnizimit të mjaftueshëm me ujë;
- Mungesa e hapësirës shkollore për shkollën e Mesme të Medicinës (ish-objekti është matanë Ibrit);
- Ndërtimet pa leje dhe ndërtimet jashtë planit urbanistik dhe problemi i zbatimit të Planit Rregullativ;
- Realizimin e buxhetit dhe shpenzimet enorme në disa nënkategori të kategorisë për mallra dhe shërbime;
- Probleme të shumta në sektorin e shëndetësisë pasi Spitali rajonal ende nuk është plotësisht funksional, mungon edhe stafi i kualifikuar mjekësor.
- Mungesë të barërave nga lista esenciale.
- Probleme në finalizimin e shumë projekteve rrugore, kanalizime dhe rrjete të ujësjellësit për ujë të pijshëm;
- Gjendja jo e mirë e mjedisit përfshirë dëmet që shkaktojnë mbetjet minerale nga e kaluara.

Të arriturat në vitin e kaluar

Komuna e Mitrovicës gjatë vitit 2013 ka pasur disa të arritura si shërbime më të mira ndaj qytetarëve me zyrën pritëse në hyrje të objektit, shtimi i efikasitetit dhe largimin e radhës për qytetarët në ofrimin e shërbimeve dhe pajisjen me dokumente, po ashtu lëshimi në punë i dy zyrave lokale të shërbimit të ofiqarisë në Shupkocv edhe Gushavc.

Komuna me grantet dhe participimin e qytetarëve ka shtruar me kubëza shumë rrugë brenda qytetit, ndërkohë falë këso lloj projekteve janë ndërtuar edhe rrugë në zonat rurale përfshirë këtu ato në Shalë të Bajgorës. Janë kryer edhe investime të vogla me bashkë-financim në kanalizime në disa lokalitete dhe në fshatra e lagje.

Vlerësimi për performancë

Kryetari i Mitrovicës, Avni Kastrati, në mandatin e tij, posaçërisht në aspektin e takimeve të rregullta me palët dhe qytetarët ka mbajtur takime në bazë mujore (6 të tilla në vitin 2013), ndërkohë që secilën të enjte ka pritur dhe ka biseduar me qytetarët për hallet dhe kërkesat e tyre. Ka marrë pjesë në shumicën e mbledhjeve të KPF-së dhe Kuvendit duke shpjeguar dhe arsyetuar propozim-rregulloret dhe vendimet, sidomos ato më të rëndësishmet ku është diskutuar nxjerrja e Rregulloreve të reja, aprovimi dhe realizimi i buxhetit, etj.

Drejtoritë komunale në masë të madhe kanë qenë efikase në kryerjen e obligimeve të veta ligjore, si drejtoria për Buxhetit dhe Financave ashtu edhe ajo Urbanizmit ndërkohë që janë përballë edhe me probleme të shumta si në shpenzimin e buxhetit ashtu edhe me ndërtimet pa leje. Në Drejtorinë e Arsimit ka pasur ankesa në konkursin për zgjedhjen e drejtorëve dhe emërimin në baza partiake.

Duke u bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit Komunal nga mediat dhe organizatat e shoqërisë civile është vlerësuar se ky Kuvend ishte më pak i suksesshëm dhe më i dobët se përbërja paraprake. Përveç një grupi të opozitës (atë të LDK-së), të tjerët asnjëherë nuk i kanë ngritur në diskutim shqetësimet e qytetarëve që kanë përfaqësuar, duke qenë më shumë dekor dhe të pranishëm vetëm për të votuar vendime që u janë ofruar nga ekzekutivi.

Kryesuesi i Kuvendit, Dr. Rrustem Musa ka kryer punën e tij me shumë korrektësi, konform rregullores së punës së Kuvendi në përputhje me detyrat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës. Ai shpesh ka kryer punën konform ligjit duke kundërshtuar edhe vendime që ishin kundër statutit që vinin nga subjekti prej nga vinte edhe ai.

Transparenca në Komunë

Transparenca në komunën e Mitrovicës ka qenë relativisht e mirë duke patur parasysh që një numri i madh i kërkesave për qasje në dokumente publike janë shqyrtuara dhe miratuara. Po ashtu, vlerësohet numri i takimeve publike të kryetarit, diskutimeve publike me qytetarët, sikurse edhe mirëmbajtja dhe freskimi i rregullt i faqes së komunës në internet, ku gjenden jo vetëm informacione por edhe mënyra e qasjes më të lehtë në vendime dhe rregullore të miratuara. Gjatë kohës së monitorimit të punës së Kuvendit Komunal është ndërtuar një bashkëpunim korrekt me drejtuesit komunalë përfshirë drejtoritë që janë monitoruar.

Sekretaria e Kuvendit ka një bashkëpunim të mirë me ekipin monitorues duke i furnizuar me material të nevojshëm si dhe duke e informuar me kohë opinionin për zhvillimet në komunë, veçmas për mbledhjet e Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF). Gjatë kësaj periudhe monitoruese dhe raportuese janë vërejtur edhe shkelje të ligjit dhe rregulloreve, siç janë mos-njoftimi rreth mungesës me arsye të këshilltarëve si dhe rasti i votimit të një propozimi që u kundërshtua nga këshilltarët dhe që më pas u rikthye pasi kishte përfunduar votimi dhe u votua sipas qëndrimit të pozitës. Ishte fjala për vendimin për formimin e ndërmarrjes publike të Stacionit të Autobusëve, gjë që është përcjell sipas këshilltarëve me shumë shkelje të procedurës së formimit, emërimit të bordit dhe nepotizmit. Kjo ngjarje është kritikuar edhe nga anëtarët e komisionit përfshirë Safet Kamberin (LDK) që ka dhënë dorëheqje për këto shkelje të vazhdueshme.

Komuna e Mitrovicës me vite ka të themeluara dhe funksionale pesë Komitetet Konsultative që përfshijnë shumicën e sferave të jetës së qytetarëve, ku shqyrtohen, analizohen dhe jepen propozime për zgjidhjen e shumë çështjeve.

Komitetet konsultative të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës janë: Komiteti konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komiteti konsultativ për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti konsultativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komiteti konsultativ për Shërbime Publike dhe Zhvillim Ekonomik dhe Komitetin Konsultativ për Turizëm dhe Bujqësi. Po ashtu funksionojnë edhe komitetet e përhershme të Kuvendit të Komunës: Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Komiteti për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Ambientit, Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komitetin për Zhvillim Ekonomik dhe Komiteti për Barazi Gjinore. Ata kanë mbajtur takimet e tyre të rregullta në bazë vjetore, ku ka marr pjesë shpesh edhe kryesuesi i Kuvendit Komunal, ndërkohë që një problem shqetësues mbetet përfundimi i afatit të anëtarësisë së disa prej anëtarëve të këtyre komiteteve konsultative

dhe mos-plotësimi i tyre me anëtarë të rinj, por kjo arsyetohet me kohën e përfundimit të mandatit dhe procesit zgjedhor.

Mitrovica ka një televizion rajonal dhe dy radio lokale që vazhdimisht e përcjellin punën e Kuvendit komunal por jo edhe të trupave tjera si KPF-në dhe komitetet konsultative. Puna e ekzekutivit dhe legjislativit të Mitrovicës është përcjell edhe përmes mediave qendrore që kanë korrespondentë në qytetin e Mitrovicës. Këto media elektronike dhe të shkruara e kanë përcjellur në vazhdimësi punën e trupave dhe komiteteve të Kuvendit Komunal, mirëpo në dy raste për shkak të problemeve, gazetarët nuk janë njoftuar e as ftuar në mbledhje, për shkak të keqkuptimit mes zyrtarëve përgjegjës për dërgimin e ftesave. Në disa drejtori ka pasur nganjëherë zvarritje lidhur me marrjen e informacioneve rreth raporteve 3 apo 6 mujore, mirëpo ato janë tejkualuar me kohë. Në disa raste ka pasur edhe probleme me sigurimin e informacioneve për mënyrën e shpenzimit të parasë publike dhe shpenzimeve në mallra e shërbime.

Ekzekutivi Komunal në Mitrovicë gjatë vitit 2013 ka ngarkuar zyrtarin për informim për të pranuar kërkesa për qasje në dokumente publike dhe gjatë kësaj periudhe kanë realizuar thuajse të gjitha kërkesat e parashtruara. Nga 39 kërkesa të drejtuara në zyrë, 38 janë zgjedhur pozitivisht duke ofruar qasje në dokumentet e kërkuar në mënyrë të plotë, ndërsa në vetëm në një raste është miratuar qasje e kufizuar në kërkesën e parashtruar. Mënyra e përgjigjes është 19 raste me mënyrën elektronike, 17 janë me kopje, ndërsa në 3 edhe me mënyrën elektronike edhe me kopje. Shikuar nga profili i kërkuarve në 16 raste janë gazetarët që kanë parashtruar kërkesa ndërsa në 13 raste janë kërkesa të shoqërisë civile, 8 prej tyre janë individë dhe 2 studentë. Sa i përket fushës për të cilat është kërkuar qasje, 15 kanë të bëjnë me buxhetin dhe shpenzimet, 5 janë vendime të komunës, 1 kontratë e komunës, ndërsa 9 janë projekte të caktuara dhe 9 të tjera janë statistika rreth harxhimeve në mallra e shërbime.

Ueb-faqja e Komunës së Mitrovicës falë stafit të saj, vazhdimisht thuajse në baza ditore freskohet me lajme dhe informacione të ndryshme, përfshirë këtu njoftime për shpallje, tenderë, vendime të miratuara, rregullore nga Kuvendi, publikime nga zhvillimet në zyrën e Prokurimit etj. Në faqen e komunës, po ashtu gjenden të inçizuar të gjitha mbledhjet e Asamblesë Komunale të Mitrovicës, njoftime të tjera të nevojshme për qytetarët e po ashtu ekziston edhe hapësira për lajmërimin e keqpërdorimeve dhe shkeljeve. Ueb-faqja ngërthen në vete edhe anketën për kënaqshmërinë e qytetarëve me punë në ekzekutiv dhe legjislativ.

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Avni Kastrati, gjatë vitit të fundit të mandatit të tij ka qenë kryesisht transparent. Përveç disa takimeve të mbajtura me publikun (tetë gjithësej) ai ka qenë pjesëmarrës edhe në rreth 16 takime publike rreth diskutimeve për buxhetin dhe shpërndarjen e tij, ndërkohë që në tri raste ai ka raportuar me shkrim rreth gjendjes aktuale të sigurisë në pjesën matanë Ibrit, me kërkesën e opozitës dhe këshilltarëve të tjerë. Ai ka zhvilluar takime me qytetarë çdo të enjte, ndërkohë që edhe jashtë zyrës ka takuar shumë qytetarë. Ndërsa në lidhje me takimet me media dhe shoqëri civile kur ka qenë në pyetje interesi i qytetarëve, ka patur një bashkëpunim të mirë.

Drejtorët e drejtorive kanë zhvilluar takime me qytetarë në dy raste dhe gjatë një takimi të zhvilluar me qytetarët e lagjeve të pjesës matanë Ibrit, janë diskutuar liria e lëvizjes dhe siguria, ndërsa një debat tjetër është zhvilluar rreth projektit të buxhetit komunal të zhvilluar në shumicën e lagjeve të qytetit. Në disa raste, drejtorët me ftesë të shoqërisë civile kanë marr pjesë në tryeza dhe debate për çështje të ndryshme që hyjnë në fushën e këtyre

drejtorive, por ka patur edhe raste të hezitimit ose injorimit të kërkesave të shoqërisë civile e që kanë pasur të bëjnë me raportime të ndryshme apo marrjen e ndonjë informacioni.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës gjatë vitit 2013, në 10 mbledhjet e mbajtura ka qenë prezent në 9 nga ato. Në tri raste ka raportuar rreth situatës së sigurisë dhe rreth aksionit ‘ndihmo edhe ti’ që kishte të bënte me rindërtimin e shtëpive në veri, ndërkohë që në rastet e tjera u është përgjigjur pyetjeve në fusha të caktuara të shtruar nga këshilltarët. Në raportimet rreth situatës së sigurisë, ai u është përgjigjur kërkesave të këshilltarëve të caktuar rreth masave që janë ndërmarrë konform kompetencave që ka Kryetari i komunës

Në vitin 2013, ekzekutivi komunal ka zhvilluar disa dëgjime publike me qytetarë lidhur me buxhetin por edhe mbi disa rregullore të miratuara, ku janë takuar qytetarë të lagjeve të caktuara që kishin të bëjnë planin urbanistik të Iliridës edhe Qendrës apo diskutimet rreth shpërndarjes së investimeve kapitale në vitin pasues. Në këto takime që janë mbështetur edhe nga OSBE,ka pasur prani të kënaqshme të qytetarëve, që kanë rezultuar me debate e sugjerime dhe propozime që janë vlerësuar dhe marrë për bazë. Ekzekutivi komunal po ashtu ka zhvilluar takime me banorë të lokaliteteve të ndryshme të komunës ku janë diskutuar prioritetet e fshatrave dhe lagjeve të ndryshme, madje në kornizën afatmesme buxhetore por edhe në propozim-buxhetin për vitin 2014, janë inkorporuar disa nga këto prioritetet. Vetë qytetarët janë shprehur të kënaqur me bashkëpunimin sikurse edhe përfshirjen e kërkesave dhe propozimeve të tyre nga ana e komunës. Por kjo nuk mund të thuhet për shumicën e këshilltarëve komunalë, të cilët me disa përjashtime, thuajse kanë harruar bazën dhe me votën e cilit lokalitet janë futur në Kuvend.

Urbanizmi në Komunë

Në komunën e Mitrovicës, Drejtoria për Urbanizëm vazhdon të përballet me shumë probleme sa i përket rregullimit të brendshëm urban, problemeve me prona dhe ndërtimeve pa leje. Si pasojë e mosrespektimit të ligjeve dhe rregulloreve komunale që rregullojnë çështjen e kriterëve të ndërtimit dhe evidentimit të pronave, zona urbane e qytetit të Mitrovicës ka filluar të ngulfatet dhe shëmtohet nga ndërtimet e larta të cilat tejkalojnë hapësirën e lejuar për ndërtim duke mos marrë parasysh hapësirën përreth këndeve të lojërave apo parkimeve. Kjo drejtori edhe gjatë vitit 2013 ka dhënë pak informacione për publikun, përmes pyetjeve të parashtruara nga anëtarët e Kuvendit apo kërkesave të gazetarëve. Megjithëse kjo drejtori, ka premtuar se do të paraqes raporte të shkruara, kjo gjë nuk ka ndodhur.

Mitrovica ka kohë që ka miratuar Planin Urban dhe Rregullativ ku ka përcaktuar kriteret e ndërtimeve posaçërisht në zonën e qendrës sikurse edhe në zona të caktuara të akseve rrugore në mënyrë që të mos të ketë ngulfatje dhe të kemi zhvillim të balancuar, mirëpo këto qëndrime shpesh kanë mbetur vetëm në letër. Përkundër kësaj, edhe pas kësaj kohe ka pasur ndërtime të cilat janë në kundërshtim me Planin Urbanistik dhe rregulloret komunale, ndërsa në muajin dhjetor sipas raportit janë ndaluar punimet në 3 objekte, ndërkohë që shumë tjera kanë tejkalluar etazhin e parashikuar me ligj. Qendra e qytetit është përcaktuar si zonë me etazhin “P+5”, ndërsa në vitet e fundit, të paktën 4 ndërtesa kanë tejkalluar nivelin e 8-të të katit e disa të tjera kanë arritur në 10 kate. Në anën tjetër, Plani Urbanistik kishte paraparë që të ngritën hapësira gjelbëruese, lulishte dhe parqe, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur, ndonëse nga buxheti i komunës shpesh janë ndarë mjete për këtë qëllim.



Financat në Komunë

Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim ka qenë më transparente me publikun, gjë që dëshmohet me gatishmërinë për të ofruar raporte apo dhënë qasje në kërkesat e bëra e që kishin të bëjnë me shpenzimet buxhetore për periudhën e caktuar kohore, si dhe planet për shpenzimin e buxhetit komunal.

Bazuar edhe në raportet e organizatave të tjera por edhe raportit të zyrës së buxhetit është vërejtur se edhe këtë vit, Komuna e Mitrovicës ka thelluar borxhin që e kishte prej 1.3 milionë, pasi në shumë raste ka kontraktuar punë pa i zotuar mjetet, gjë që ngarkon edhe më shumë komunën. Instituti GAP por edhe monitorimi ynë kanë konstatuar se ka rritje të shpenzimeve për dreka dhe darka, shpenzime për derivate, telefon, në kategorinë për mallra dhe shërbime etj.

Çështjet tjera nga raporti qytetar- pushtet lokal

Për dallim nga vitet e mëherëshme, në vitin 2013 pushteti lokal ka qenë më afër qytetarit, duke mbajtur dëgjimet buxhetore nëpër bashkësi lokale ndërsa këtij bashkëpunimi i ka ndihmuar edhe përzgjedhja e kryetarit dhe këshillave të lagjeve e lokaliteteve. Ekzekutivi komunal, me mbështetje të OSBE-së, ka realizuar gjithsej 16 dëgjime buxhetore, në kuadër të përgatitjeve për hartimin e buxhetit për vitin 2014.

Pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e kënaqshme, ndërsa ata kanë shprehur kërkesat e tyre për çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës së përditshme.

Në anën tjetër, ekzekutivi komunal, pas këtij cikli të dëgjimeve publike, ka përcaktuar kufijtë buxhetor, sipas të cilëve, Mitrovica, për vitin 2014 do të ketë mbi 14 milionë euro buxhet, ndërsa pjesa dërmuese planifikohet të shkojnë në kategori të pagave dhe shpenzimeve.

Nga investimet e qëndrueshme konform nevojave dhe kërkesave të vetë qytetarëve ka qenë rritja e kapacitetit prodhues të fabrikës së ujit që do të siguronte ujë 24 orë në periudhën e ardhshme 50 vjeçare kanë thënë ekspertët.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Infrastrukturë rrugore në të gjitha rrugicat brenda qytetit dhe zonat rurale	Përfundimi i Fabrikës së re të Ujit	Përgjegjësi dhe transparencë
2	Stimulim bisneseve dhe krijimin e kushteve për biznes dhe thithje të investimeve	Përfundimi I Liqenit artificial	Llogaridhënie nga drejtorët
3	Punë për 15 mijë persona	Përfundimi i Projektit të Qendrave sportive	Efikasitet nga administrata
4	Arsim cilësor; Mbështetja arsimimit me bursa	Përfundimi i kanalizimit në Kciq	Kordinim me Këshillat e fshatrave
5	Mbështetje Sportit-Kulturës	Përfundimi i objetit të Shkollës së Medicinës dhe objektit të Universitetit të Mitrovicës	Bashkëpunim me Shoqëinë Civile
6	Dhurimin e makinës së kryetarit shoqatave		

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Të shtohet përgjegjësia, transparenca dhe llogaridhënia në menaxhimin e parasë publike, sikurse edhe shtrirje të investimeve në të gjithë territorin e komunës njëtrajtësisht;
- Të ketë planifikim më të mirë dhe zvogëlim të hargjimeve në mallra dhe shpenzime si dhe shërbimeve veçmas për karburante, telefon, udhëtime jashtë vendit dhe dreka e darka zyrtare;
- Drejtoria e Shëndetësisë të sigurojë shërbime më të mira, mbështetje të rasteve të rënda shëndetësore që kanë nevojë për mjete shërimi brenda e jashtë vendit;
- Të shtohet efikasiteti i punës dhe menaxhimit në kompaninë rajonale të menaxhimit të mbeturinave me qëllim të largimit të deponive të egra dhe pastrimit më të mirë të qytetit;
- Të rritet përgjegjësia jo vetëm nga stafi ekzekutiv por edhe nga i gjithë shërbimi civil, krahas shtimit të efikasitetit dhe ofrimit të shërbimeve adekuate;
- Të ngritet efikasiteti në ofrimin e qasjes së shpejtë në dokumente në bazë të Ligjit për Qasje në Dokumente publike;
- Të intensifikohet puna dhe të plotësohet me anëtarë të rinj Këshilli për Siguri në Bashkësi dhe Komitetet konsultative me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në vendimmarrje.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Të zbatojë kriteret për ndërtim në bazë të Rregullores Komunale dhe PZHU-së;
- Të rris inkasimin e të hyrave nga dhënia e lejeve të ndërtimit;
- Të ofroj raporte të rregullta rreth punës, kërkesave edhe lejeve që lëshohen.

Drejtorisë së Financave

- Realizimi i buxhetit të bëhet konform udhëzimeve të MEF-it, dhe mos të bëhet bartje nga një kategori në tjetrën;
- Të mundësohet raport i hapur edhe për mediat dhe monitoruesit e jo vetëm për stafin e ekzekutivit dhe këshilltarët, ashtu që secili të ketë pasqyrë të qartë për shpenzimet.

Kryesuesit të Kuvendit

- Kryesuesi i Asamblesë të jetë më rigoroz në zbatimin e rregullores së Kuvendit karshi këshilltarëve që mungojnë shpesh dhe pa arsye në seanca plenare;
- Kryesuesi të distancohet nga subjekti që vjen në interes të qytetarëve dhe mos të ketë anime politike.

Anëtarëve të Kuvendit

- Të jenë zëri i qytetarëve në çështjet që janë në interes të përgjithshëm në hartimin e projekt-buxhetit, të rregulloreve edhe të planeve urbanistike në takimet publike sikurse edhe propozimin dhe sugjerimet në takimet publike,

- Të jenë të përgjegjshëm dhe transparent me votuesit e tyre në lidhje me rregulloret dhe vendimet pasi ato prekin jetën e secilit qytetar duke iu shpjeguar përfitimet apo sanksionet që mund të prodhojnë ato në jetën e përditshme;
- Të jenë të rregullt dhe aktiv gjatë diskutimit, kritik, kontribuues dhe përkrahës të pikave të rendit të ditës që ndikojnë në jetën e qytetarëve dhe mos të mbesin vetëm numër në votim;
- Të jenë bartës të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve veçanërisht nga zonat prej të cilave vijnë vetë këshilltarët;
- T'iu shmangen pengesave në kuvend si përgjigja e telefonatave apo hyrje-daljeve e shpeshta.


Mitrovica - Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	10	93	84%	94%
Janar	1	11	87%	88%
Shkurt	2	12	92%	94%
Mars	1	8	94%	82%
Prill	1	10	88%	94%
Maj	1	9	90%	82%
Qershor	1	8	79%	88%
Korrik	1	11	87%	82%
Gusht	0	0	0	0
Shtator	1	6	91%	94%
Tetor	1	8	83%	82%
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	8	64	74%	82 %
Janar	1	8	84%	94%
Shkurt	1	8	87%	88%
Mars	1	8	92%	94%
Prill	1	8	94%	82%
Maj	1	8	88%	94%
Qershor	1	8	90%	82%
Korrik	1	8	84%	94%
Gusht	0	0	0	0
Shtator	1	8	88%	82%
Tetor	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli për Siguri në Bashkësi	8		Po – 2 OJQ	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimetme publikun	8		100 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Rregullore Nr. 01/2013 për kriteret e kategorizimit të rrugëve locale	Aprovuar	Pro: 28 Kundër: 5 Abs:2
Rregullore Nr. 02/2013 për mënyrën e udhëheqjes së evidencës për rrugët publike dhe objekteve që u takojnë atyre rrugëve	Aprovuar	Pro : 27 Kundër 3 Abs 6
Rregullore Nr. 03/2013 për kompensimin e shfrytëzimit të rrugëve komunale dhe rrugëve të pakategorizuara dhe tokës që i takon këtyre rrugëve	Aprovuar	Pro: 33 Kundër:0 Abs:7
Rregullorja Nr. 04/2013 mbi kriteret për vendosjen e objekteve të përkohshme në hapësira publike	Aprovuar	Pro:24 Kundër:11 Abs: 2
Rregullorja Nr. 05/2013 për procedurat e dhënies së objekteve publike dhe tokës për shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandeve	Aprovuar	Pro: 27 Kundër:10 Abs:0
Rregullorja Nr. 06/2013 për sistemin e shkollimit joformal për arsimin fillor të mesëm të ulët në Komunën e Mitrovicës	Aprovuar	Pro:36 Kundër:0 Abs:0
Rregullorja Nr. 07/2013 për sistemin e shkollimit joformal të mesëm të lartë në Komunën e Mitrovicës	Aprovuar	Pro: 36 Kundër: 4 Abs:0
Rregullorja Nr. 09/2013 për disiplinë të nxënësve në shkollën e mesme të lartë	Aprovuar	Pro: 36 Kundër: 4 Abs:0
Rregullorja Nr. 08/2013 për disiplinë të nxënësve në shkolla fillore të mesme të ulët	Aprovuar	Pro: 35 Kundër: 6 Abs:0
Rregullorja Nr. 10/2013 për ndarjen e bursave për studentë	Aprovuar	Pro: 38 Kundër: 0 Abs:0
Rregullorja Nr. 11/2013 për ndarjen e subvencioneve	Aprovuar	Pro: 28 Kundër: 4 Abs:2
Rregullorja Nr. 12/2013 e punës së Kuvendit të Komunës së Mitrovicës Rregullorja Nr. 13/2013 për mbrojtje nga zjarri	Aprovuar	Pro: 31 Kundër: 4 Abs:0
Rregullorja Nr. 14/2013 për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat fillore të mesme të ulëta	Aprovuar	Pro: 30 Kundër: 6 Abs: 2
Rregullorja Nr. 15/2013 për organizimin e punës dhe mësimin në shkollat e mesme të larta.	Aprovuar	Pro: 31 Kundër: 8 Abs: 0
Rregullorja Nr. 16/2013 për mbrojtjen e të miturve nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre	Aprovuar	Pro: 28 Kundër: 8 Abs:0

Raporti Monitorimit 2013




Komuna


Skenderaj



Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



8. Komuna SKENDERAJ

Problemet kryesore të komunës

Komuna e Skenderajt, përkundër përparimeve të bëra në disa sektorë, sidomos në infrastrukturën rrugore, edhe më tej vazhdon të mbetet komunë e varfër ku dominon papunësia dhe mos zhvillimi ekonomik.

Skenderaj dhe qytetarët e saj vazhdojnë të kenë probleme të shumta në të gjithë sektorët e jetës, ku më të rëndësishmet vazhdojnë të mbesin:

- Braktisja e shkollimit dhe pamundësia e sigurimit të transportit për nxënës të shkollave fillore dhe të mesme;
- Realizimi i buxhetit dhe shpenzimet enorme në disa nënkategori të kategorisë për mallra dhe shërbime, me tendencë rritje në vitin 2013 krahasuar me vitin paraprak;
- Ndërtimet pa leje dhe ndërtimet jashtë planit urbanistik, ku edhe gjatë vitit 2013 janë shënuar të paktën tri raste të fillimit të ndërtimeve pa leje dhe në kundërshtim me planin rregullativ dhe Rregulloren e Komunës;
- Edhe më tej qytetarët ballafaqohen me mungesë të barërave nga lista esenciale;
- Infrastruktura si kanalizimi dhe uji i pijes ende është problem për mbi 70% të popullatës së Skenderajt në zonat rurale, ndërsa 90% e fshatrave ende nuk kanë kanalizim.

Të arriturat në vitin e kaluar

Komuna e Skenderajt gjatë vitit 2013 ka pasur edhe të arritura. Këto të arritura janë evidentuar në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, pasi që është përmirësuar dukshëm shërbimi ndaj qytetarëve për nxjerrje të dokumenteve, është ndërtuar objekti i ri i Komunës dhe janë ndërtuar dy qendra të shërbimit të ofiqarisë në Likofc dhe Turiqefc.

E arritur tjetër e Komunës së Skenderajt për vitin 2013 është edhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore. Edhe gjatë këtij viti Komuna me buxhet vetanak dhe mbështetje nga grantet qeveritare ka asfaltuar shumë segmente të rëndësishme rrugore sidomos në fshatra dhe lagje.

Vlerësimi për performancë

Kryetari i Skenderajt në mandatin e tij të dytë e veçanërisht në vitin 2013 nuk i është përmbajtur në masë të duhur obligimeve të veta. Ndër shmangiet ndaj obligimeve ndaj qytetarit duhet theksuar anulimin e takimit me qytetarë (çdo të mërkurë) që nga muaji maj, si dhe mos prezencën e vet në seancat e Asamblesë Komonale, sidomos në ato më të rëndësishme ku është diskutuar nxjerrja e rregulloreve të reja, aprovimi dhe realizimi i buxhetit etj. Nga Maji i vitit 2013, kryetari i komunës Sami Lushtaku, gjendet në paraburgim për shkak të urdhër-arrestit të lëshuar nga EULEX. Drejtoritë Komonale në masë të madhe kanë qenë efikase në kryerjen e obligimeve të veta ligjore, përveç Drejtorisë së Arsimit e cila edhe gjatë vitit 2013 është karakterizuar me probleme të shumta si në shpenzimin e buxhetit ashtu edhe në konkurset për mësimdhënës.

Këshilltarët komunal, nga opinionistët lokal, mediat dhe shoqëria civile, janë cilësuar si më të dobët që Skenderaj ka pasur ndonjëherë. Ata asnjëherë nuk i kanë ngritur në diskutim

shqetësimet e qytetarëve që përfaqësojnë, ndërsa në shumë raste kanë qenë edhe votues të vendimeve të ndryshme që kanë qenë në kundërshtim me ligjet, rregulloret por edhe vullnetin e qytetarëve.

Kryesuesi i Kuvendit, gjatë vitit 2013 ka kryer detyrat e tij konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës me përjashtim të rastit të mos-përmbushjes me kohë të obligimit ligjor për zëvendësimin e një këshilltari komunal dhe mos ndëshkimit të këshilltarëve që në seanca mungonin pa arsye.

Transparenca në Komunë

Komuna e Skenderajt viteve të fundit është vlerësuar si komunë me më së paku transparencë ndaj publikut. Mirëpo edhe përkundër faktit se kjo komunë vazhdon me avazin e vjetër, megjithatë janë vërejtur disa sinjale pozitive në këtë drejtim. Sekretaria e Kuvendit ka një bashkëpunim të mirë me Ekipin Monitorues duke i furnizuar me material të nevojshëm si dhe duke e informuar me kohë opinionin për zhvillimet në komunë, veçmas për mbledhjet e Asamblesë dhe KPF-së. Po ashtu është siguruar edhe hapësirë e nevojshme për media dhe përfaqësues të OJQ-ve. Gjatë kësaj periudhe monitoruese dhe raportuese janë vërejtur edhe dy shkelje të Ligjit dhe rregulloreve, njëra nga ekzekutivi dhe tjetra nga legjislativi. Ekzekutivi e ka shkelur një vendim të vitit 2004 të Asamblesë Komunale, e cila e kishte shpallur monument historik ish-objektin e shkollës fillore në Likofc, ndërsa Kryetari kishte marrë vendim për rrënimin e tij pa e bërë paraprakisht propozim-vendimin për ndryshimin e atij vendimi, ndërsa legjislativi ka bërë shkelje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për faktin se një këshilltar i Asamblesë Komunale ka munguar në seanca rregullisht që nga muaji Maj i vitit 2012, ndërsa vendimi për zëvendësimin e tij është marrë vetëm në prill të viti 2013, ndërsa në seancën e muajit tetor është shënuar edhe një shkelje e Ligjit për Këmbim apo dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, neni 6 pika 3, i cili nuk lejon marrjen e një vendimi të tillë gjashtë (6) muaj para përfundimit të mandatit të Asamblesë.



Komuna e Skenderajt ka të themeluar vetëm Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë dhe Fe i cili gjatë vitit 2013 nuk ka mbajtur asnjë takim, ndërsa në raportin vjetor drejtuar Asamblesë Komunale vërehet një faqe e formatit A4, në të cilin përshkruhen disa aktivitete të vogla, ndërsa në raport dominon falënderimi i këtij Komiteti Konsultativ për mbështetjen e marrë nga ana e ekzekutivit. Në Kuvendin Komunal ky raport këshilltarëve u është dhënë dy (2) minuta kohë derisa atë e ka prezantuar Kryesuesi i Asamblesë dhe i njëjti është aprovuar unanimisht pa asnjë diskutim. Madje në raportim në Asamble nuk ka qenë i pranishëm Kryesuesi i këtij Komiteti Konsultativ.

Mediat qendrore përmes korrespondentëve të tyre si dhe mediat lokale në vazhdimësi kanë qenë prezentë gjatë gjithë kohës në zhvillimet e përgjithshme në komunë. Ato në vazhdimësi e kanë përcjell punën e ekzekutivit dhe legjislativit, mirëpo nuk janë trajtuar në bazë të ligjeve në fuqi pasi gazetarët shpesh kanë qenë cak i sulmeve, ofendimeve dhe kërcënimeve nga ana zyrtarëve komunal, përfshirë Kryetarin, Nënkryetarin, disa drejtorë të Drejtorive, zyrtarin e Zyrës së Prokurimit, etj. Gazetarët kanë hasur vështirësi edhe në sigurimin e informacioneve për mënyrën e shpenzimit të parasë publike. Atyre u janë refuzuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike për këtë çështje.

Ekzekutivi komunal në Skenderaj gjatë vitit 2013 ka qenë i mbyllur për qasjen në dokumente publike dhe gjatë kësaj periudhe edhe përkundër disa kërkesave të ndryshme

për qasje në dokumente publike, asnjë prej tyre nuk është lejuar. Sipas një hulumtimi të bërë nga monitoruesit e OJQ "Prehja" në Arkivin Komunal gjatë vitit 2013 nga OJQ të ndryshme, media dhe qytetarë janë deponuar 43 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe vetëm në dy prej tyre është lejuar qasje ndërsa në 41 kërkesa tjera ose nuk është kthyer përgjigje fare ose është kthyer përgjigje negative.

Ueb-faqja e Komunës së Skenderajt çdo ditë freskohet me lajme dhe informacione të ndryshme, mirëpo edhe më tej nuk bëhen publike zhvillimet në Zyrën e Prokurimit. P.sh. ende nuk janë bërë publike kontratat e vitit 2012 dhe fillimit të vitit 2013.

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Komunës së Skenderajt gjatë vitit të fundit të mandatit të tij, përkatësisht vitit 2013 e ka anashkaluar në masë të madhe takimin me qytetarët e komunës e posaçërisht raportimet e tij tek qytetarët për rrjedhën e zhvillimeve në komunë, të arriturat dhe ngeçjet. Ai është takuar me qytetarë vetëm në rastet kur ka qenë në pyetje interesi i komunës apo partisë, por jo edhe kur ka qenë në pyetje interesi i qytetarëve, kurse me shoqërinë civile ka pasur një bashkëpunim të kufizuar. Drejtorët e drejtorive nuk kanë zhvilluar asnjëherë takime me qytetarë përpos në dy dëgjimet publike ku prezenca e qytetarëve ka qenë e vogël, ndërsa me shoqërinë civile ka pasur një bashkëpunim në nivel mesatar duke përjashtuar Drejtorinë e Arsimit e cila i ka injoruar në tërësi kërkesat e shoqërisë civile qoftë për raportime të ndryshme qoftë për marrjen e ndonjë informacioni.

Mediat nacionale dhe ato lokale i kanë kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimeve në komunë dhe aktivitetet e kryetarit dhe të drejtorive në shumicën e rasteve janë pasqyruar në media. Kryetari i Komunës së Skenderajt gjatë vitit 2013, në 9 seancat e Asamblesë komunale asnjëherë nuk ka raportuar në Kuvend as për çështjet e rëndësisë së veçantë siç janë miratimi i buxhetit për vitin tjetër apo realizimi i buxhetit për vitin paraprak, madje as nuk ka qenë i pranishëm në Asamble. Raportimi gjithnjë është bërë përmes nënkryetarit të komunës.

Në vitin 2013, ekzekutivi komunal ka pasur dy dëgjime publike me qytetarë ku prania e qytetarëve ka qenë e vogël. Edhe përkundër kësaj pjesëmarrje të vogël, cilësia e takimeve ka qenë e nivelit të mirë pasi banorët e lokaliteteve të ndryshme të komunës i kanë diskutuar bashkërisht me zyrtarët komunal prioritetet e fshatrave dhe lagjeve të tyre, madje në kornizën afatmesme buxhetore por edhe në propozim buxhetin për vitin 2014 janë marrë parasysh 10 nga 14 projektet e prezantuara nga banorët dhe ato janë futur në listën e prioriteteve të shpenzimit të buxhetit nga kategoria e investimeve kapitale.

Në anën tjetër asamblesitët e Skenderajt jo vetëm gjatë vitit 2013, por edhe gjatë gjithë mandatit të tyre nuk i kanë kontaktuar qytetarët dhe nuk kanë organizuar asnjë takim me ta. Madje 30 nga 31 këshilltarët nuk e kanë ngritur asnjëherë asnjë çështje të zonave që ata i përfaqësojnë.

Urbanizmi në Komunë

Sikur në gjithë Kosovën, edhe në komunën e Skenderajt, Drejtoria për Urbanizëm është përballur dhe vazhdon të përballet me shumë probleme sa i përket rregullimit të brendshëm urban, problemit me prona dhe ndërtimeve pa leje. Si pasojë e mosrespektimit të ligjeve dhe rregulloreve komunale, që rregullojnë çështjen e kritereve të ndërtimeve, evidentimit të pronave, zona urbane e qytetit të Skenderajt ka filluar të shëmtohet nga ndërtimet e larta. Kjo Drejtoria edhe gjatë vitit 2013 ka vazhduar të jetë e mbyllur me publikun. Edhe pse drejtoria i saj vazhdimisht nëpër takime të ndryshme është shprehur se është i gatshëm të bashkëpunoj me cilindo subjekt apo edhe qytetarë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur asnjëherë

pasi ata nuk i janë përgjigjur asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare që kanë të bëjnë me Urbanizmin.

Komuna e Skenderajt është ndër komunat që e ka të miratuar Planin Urbanistik që nga viti 2010 në të cilin parashihen ndërtime moderne konform rregulloreve dhe planeve komunale, mirëpo edhe përkundër këtij fakti edhe pas kësaj kohe ka pasur ndërtime të cilat janë në kundërshtim me Planin urbanistik dhe rregulloret komunale. Vetëm gjatë vitit 2013 janë ndërtuar së paku dy objekte të tilla afaristo-banesore që e kanë tejkaluar planin urbanistik dhe Rregulloren Komunale pasi kjo e fundit nuk lejon që ndërtimet të jenë më të larta se P+5.

Në anën tjetër, Plani Urbanistik kishte paraparë që të ngritën hapësira gjelbëruese, lulishte dhe parqe, një gjë e tillë nuk ka ndodhur ndonëse nga buxheti i komunës shpesh janë ndarë mjete për këtë qëllim. E vetmja gjë që është respektuar në përputhje me Planin Urbanistik janë rrënimet e objekteve të vjetra por në shumicën prej vendeve ku janë rrënuar ato lokale nuk është ndërtuar asgjë. Komuna e Skenderajt është ndër komunat e pakta në Kosovë që ka pasur probleme me lejet e ndërtimit gjatë viteve të pas luftës. Mirëpo kjo dukuri ka filluar të jetë më e theksuar gjatë viteve të fundit përkatësisht në pjesën e fundit të mandatit të dytë të ekzekutivit dhe legjislativit. Gjatë vitit 2013, monitoruesit e OJQ “Prehja” por edhe mediat dhe organizatat e tjera kanë vërejtur së paku tri ndërtime pa leje të cilat e kanë dëmtuar buxhetin e komunës për rreth 200 mijë euro.

Financat në Komunë

Për dallim nga Drejtoritë tjera komunale, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim në Skenderaj ka qenë më transparente me publikun. OJQ “Prehja” ka pasur qasje në të gjithë dokumentacionin që ka të bëjë me shpenzimet buxhetore për periudhën e caktuar kohore, si dhe planet për shpenzimin e buxhetit komunal.

Pas shqyrtimit të raportit vjetor (2012) për shpenzimin e buxhetit, OJQ “Prehja” ka vërejtur rritje të shpenzimeve enorme për dreka dhe darka, shpenzime për derivate, në kategorinë mallra dhe shërbime, për të cilat ka kërkuar sqarime shtesë rreth rritjeve të vërejtura. Përgjigja që ka marrë nga kjo drejtori ka qenë e lidhur me formën e raportimit, e cila sipas DEFZh-së, është formë standarde e raportimit të shpenzimit të buxhetit, e kërkuar nga Ministria e Financave të Kosovës, në formularin e së cilës nuk janë specifikuar kategoritë e shpenzimeve sipas nën-kodeve, por vetëm sipas kodeve. Një shembull ilustrues DEFZh e ka paraqitur tek shpenzimet e derivateve, të cilat sipas kodit në fjalë janë të përmbledhura së bashku me të gjitha shpenzimet për derivate që i ka bërë Komuna brenda një viti kalendarik, bashkë me Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe Shërbimin e Zjarrfikësve. Kësisoj,



sikur të ishte forma e raportimit edhe me nën-kodeve, do të dihej saktë dhe në mënyrë të detajuar se sa ka shpenzuar Komuna e sa QKMF-ja dhe Shërbimi i Zjarrfikësve. Edhe në nëntë mujorin e parë të vitit 2013 janë vërejtur rritje të shpenzimeve në shumë kategori, ndërsa në total në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2012 shpenzimet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë rritur për 16%.

Në anën tjetër ndër vërejtjet e gjetura nga na e ekipit monitorues gjatë viti 2013, disa kanë të bëjnë edhe me miratimin e buxhetit për vitin 2014. Gjetja e parë ka të bëjë me Drejtorinë e Shëndetësisë e cila në vitin 2014 në dispozicion do të ketë 1.3 milion euro, për kategorinë e investimeve kapitale në shëndetësi parashihen të investohen vetëm 45 mijë euro, që janë shumë pak në krahasim me nevojat që ka sektori i shëndetit primar në Skenderaj.

Gjetja e dytë që është mjaft shqetësuese ka të bëjë me alokimin e mjeteve për dy projekte për vitin 2014, të cilat figurojnë si projekte të përfunduara në vitin 2011, përkatësisht njëri projekt nuk ekziston fare. Fjala është për segmentin rrugor Makërmal-Likofc i cili ka qenë investimi Ministrisë së Infrastrukturës dhe ka përfunduar në vitin 2011 e për të cilin janë alokuar 230 mijë euro, dhe segmenti Likofc-Plluzhinë-Murgë i cili nuk ekziston fare e për të cilin janë alokuar 200 mijë euro.

Dëgjimet Buxhetore dhe Buxheti

Për dallim nga vitet e mëparshme, në vitin 2013, pushteti lokal ka qenë më afër qytetarit, duke mbajtur dëgjimet buxhetore nëpër bashkësi lokale. Ekzekutivi i Skenderajt, me mbështetje të OSBE-së, ka mbajtur gjithsej shtatë (7) dëgjime buxhetore, në kuadër të përgatitjeve për hartimin e buxhetit për vitin e ardhshëm 2014.

Pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e kënaqshme, të cilët kanë shprehur kërkesat e tyre për çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës. Në anën tjetër, Ekzekutivi, pas këtij cikli të dëgjimeve ka përcaktuar kufijtë buxhetor dhe sipas tyre, Komuna e Skenderajt vitin e ardhshëm do të ketë mbi dhjetë (10) milionë euro buxhet, të ndara në gjashtë (6) kategori të shpenzimeve.

Si rezultat i kësaj, Komuna e Skenderajt në kornizën afatmesme të buxhetit 2014/2016, nga 22 projekte kapitale që parashihen të realizohen, 10 prej tyre kanë derivuar nga kërkesat e qytetarëve, të cilat më pas janë përkrahur edhe nga Asambleja Komunale. Si çështje tjetër me rëndësi që vlen të përmendet është ndërtimi i objektit të ri të Komunës, mungesa e të cilit ka bërë që administrata komunale të jetë e shpërndarë në tri objekte të ndryshme në qytet.

Vlera e projektit për ndërtimin e objektit të ri të Komunës së Skenderajt është 1,840 milionë euro, të cilat janë financuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Komuna.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Hartimi i guidave specifike për promovimin e biznesit	Ndërtimi i objektit të QKMF-së, dhe ambulancave në komunë	Digjitalizimi i te gjitha shërbimeve komunale e publike
2	Subvencionim të fermerëve për rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre	Ndërtimi i ujësjetësve në lokalitetet ku ka burime uji	
3	Krijimin e kushteve për rritjen e prodhimit të bujqësore, krijimi i kushteve për ngritjen e plantacioneve të reja të pemëve, sidomos mollës, kumbullës, dardhës dhe dredhëzës.	Pajisjen e shkollave me inventar, laboratorë, teknologji informative dhe furnizimi me ujë	
4	Subvencionimi i studenteve në drejtimet deficitare dhe atyre me gjendje të rënd sociale dhe përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuar në procesin mësimorë	Krijimi i hapësirës për ndërtimin e një Parku të Biznesit	

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Të zbatohet Ligji për Arsimin Para-universitar i cili parasheh sigurimin e transportit për nxënës që udhëtojnë më shumë se katër (4) km në mënyrë që të bëhet zvogëlimi i rasteve të braktisjes së shkollimit.
- Të bëhet zvogëlimi i shpenzimeve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve veçmas për karburante, udhëtime brenda dhe jashtë vendit dhe dreka e darka zyrtare.
- Drejtoria e Shëndetësisë të sigurojë barëra nga lista esenciale dhe të angazhohet në ri-funksionalizimin e repartit të stomatologjisë.
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale të zbatohet duke marrë në konsideratë edhe zbatimin e rregulloreve komunale dhe udhëzimeve administrative, siç janë: Rregullorja e punës së Kuvendit, Rregullorja për Transparencë, Udhëzimet Administrative të ministrive përkatëse.
- Ta respektoj më shumë Kuvendin dhe të jetë i pranishëm në seancat plenare.
- Të zbatohet Ligji për Qasje në Dokumente Publike.
- Këshillat e Sigurisë në Bashkësi të ri-funksionalizohen dhe të jenë më aktiv në marrjen e obligimeve dhe përgjegjësi.
- Të bëhet përzgjedhja e kryetarëve të fshatrave dhe atyre t'u sigurohet një pagë minimale për mbulimin e shpenzimeve të transporti dhe komunikimit.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Drejtoria e Urbanizmit të zbatojë kriteret për ndërtim në bazë të Rregullores Komunale dhe Plani Zhvillimor Urban, kriteret e ndërtimeve në zonën e qytetit.
- Të inkasojë më shumë të hyra nga dhënia e lejeve të ndërtimit.

Drejtorisë së Financave

- Realizimi i buxhetit të bëhet konform udhëzimeve të MEF-it, pasi shpenzimi i buxhetit nëpër disa kategori si ajo e mallrave dhe shërbimeve vazhdimisht shënon mospërputhshmëri me kriteret e caktuara nga ministria përkatëse.
- Realizimi i buxhetit të raportohet në mënyrë digjitale për secilin subjekt të interesuar duke raportuar për shpenzimet për secilën kategori dhe nënkategori.

Kryesuesit të Kuvendit

- Kryesuesi i Asamblesë të jetë më rigoroz në zbatimin e rregullores së kuvendit karshi këshilltarëve që mungojnë shpesh dhe pa arsye në seanca plenare.

•

Asamblistëve të Kuvendit

- Të jenë më transparent me votuesit e tyre në dokumentet publike që i shqyrtojnë dhe i përkrahin për votim në asamble.
- Gjatë diskutimit të jenë më kritik apo më përkrahës të pikave të rendit të ditës dhe mos ta presin vetëm momentin e hedhjes në votim të çështjeve të ndryshme.

- Të sjellin më shumë pika për propozim sidomos për shqetësimet e qytetarëve nga zonat në të cilat ata janë votuar.
- Të respektojnë më shumë Kuvendin dhe seancat e tij dhe t'iu shmangen injorimeve në forma të ndryshme si telefonata apo hyrje-dalje të shpeshta në sallë.


Skenderaj Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	8	24	74%	%
Janar	1	3	80.6 %	95 %
Shkurt	1	4	76.4 %	95 %
Mars	1	5	76.4 %	90 %
Prill	1	2	77.5 %	90 %
Maj	1	2	68.2 %	90 %
Qershor	1	1	65.1 %	90 %
Korrik	1	2	74.4 %	85 %
Gusht	0			
Shtator	1	5	71.3 %	85 %
Tetor	PA		0	0
Nentor	PA		0	0
Dhjetor	PA		0	0
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	9	24	74%	%
Janar	1	3	87 %	100 %
Shkurt	1	4	87 %	100 %
Mars	1	5	87 %	100 %
Prill	1	2	87 %	100 %
Maj	1	2	74 %	100 %
Qershor	1	1	74 %	100 %
Korrik	1	2	87 %	100 %
Gusht	1		87 %	100 %
Shtator	1	5	87 %	100 %
Tetor	PA		0	0
Nëntor	PA		0	0
Dhjetor	PA		0	0
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli i Sigurisë në Bashkësi	9		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	7		120 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
projekt-statuti i qendrës për punë sociale në Skënderaj	Aprovuar	Pro: <u> 21 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
Plani Rregullues....	Aprovuar	Pro: <u> </u> Kundër: <u> </u> Abs: <u> </u>
Korniza afatmesme buxhetore 2014-2016	Aprovuar	Pro: <u> 21 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
Raporti i Auditorit.....	Aprovuar	Pro: <u> </u> Kundër: <u> </u> Abs: <u> </u>
Vendimi për shpalljen e zonës më interes publik ngastrat 850/1 dhe 852/1	Aprovuar	Pro: <u> 26 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
Vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale për 99 vjet	Aprovuar	Pro: <u> 24 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
vendim për caktimin e lokacionit për stacionin e autobusëve vendim për dhënien e tokës në shfrytëzim për 40 vite, për	Aprovuar	Pro: <u> 24 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
Propozim vendim për ndërrimin e pronës komunale	Aprovuar	Pro: <u> 22 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
Vendim për shpalljen Qytetar Nderi i Komunës së Skënderajt, Edi Rama vendim për shpalljen Qytetar Nderi i Komunës së Skënderajt	Aprovuar	Pro: <u> 22 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
Raporti financiar i realizimit të buxhetit, janar-qershor 2013	Aprovuar	Pro: <u> 24 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
Rregullore për Tatimin në Pronën e Paluajtshme	Aprovuar	Pro: <u> 23 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
Buxheti për vitin 2014	Aprovuar	Pro: <u> 23 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>
vendim për këmbimin e pronës komunale ngastra 692/35 me pronën private ngastra 692/16	Aprovuar	Pro: <u> 23 </u> Kundër: <u> 0 </u> Abs: <u> 0 </u>

Raporti Monitorimit 2013




Komuna Shtime




Public Organisation
for Local Initiatives and Supports
POLIS

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



9. Komuna SHTIME

Problemet kryesore të komunës

Komuna e Shtimes, sikur edhe komunat tjera në Kosovë, nuk dallon shumë sa i përket problemeve dhe sfidave me të cilat ballafaqohen çdo ditë qytetarët e saj. Disa probleme janë të zgjidhshme nga niveli lokal i qeverisjes, e disa të tjera tejkalojnë kompetencat komunale dhe mbeten preokupim i institucioneve qendrore. Nga periudha e monitorimit të Kuvendit Komunal të Shtimes dhe mbledhja e opinionëve nga bashkëbisedimi me qytetarë të shumtë vërehet se kjo komunë përballet me sfida dhe probleme të shumta.

Probleme themelore mbeten:

- Zhvillimi ekonomik lokal;
- Trajtimi i rasteve sociale;
- Ndërtimet pa leje;
- Pajisja me leje e kompanive të nxjerrjes dhe përpunimit të gurit ndërtimor

Sa i përket zhvillimit ekonomik dhe rritjes së punësimit, Komuna e Shtimes është e orientuar të ndikoj me vendosmëri në stimulimin e këtyre dy faktorëve që ndikojnë në mirëqenien e përgjithshme. Varfëria dhe rastet sociale janë kategori që nuk mund të gjejnë zgjidhje të duhur vetëm nga niveli komunal. Gjatë monitorimit të Kuvendit Komunal në pothuajse secilën seancë ka pasur paraqitje të kërkesave të qytetarëve, për ndihma të ndryshme sociale. Shumica prej tyre kanë të bëjnë me çështjet e banimit, mbulim të tërësishëm apo pjesshëm të ndërtimit të shtëpisë, mbulim të nevojave elementare të jetesës, etj.

Problemi tjetër ka të bëjë me ndërtimet pa leje në Komunën e Shtimes. Edhe përkundër faktit që Komuna ka nxjerrë dokumentet e saja që rregullojnë çështjet e planifikimit urban dhe zhvillimor, dhe miratimit të Ligjit (të ri) për ndërtimet, kjo dukuri duket se vazhdon tutje. Një konstatim i tillë vjen edhe nga numri i vogël i lejeve të lëshuara urbanistike dhe ndërtimore, numri i gjobave ndërtimore të lëshuara nga Inspektorati dhe të hyrat financiare nga ndërtimet.

Duke qenë Komuna e Shtimes ka një mjedis gjeografik me kodrina të shumta dhe potenciale gurore, atje operojnë shumë kompani të nxjerrjes dhe përpunimit të gurit ndërtimor. Sado që këto kompani janë të pajisura me leje për operim nga autoritetet gjegjëse qendrore dhe kanë pëlqim nga ato lokale për shfrytëzim të masës gurore, pozicionimi i tyre afër vendbanimeve paraqet pengesë për qytetarët e Shtimes. Kjo çështje ndonjëherë është ngritur edhe në Kuvend, varësisht nga shqetësimet e qytetarëve dhe porositë e tyre që iu janë drejtuar asambleistëve të caktuar. Ndotja e shkaktuar nga pluhuri dhe zhurma është shqetësimi më i madh për qytetarët.

Siguria publike është gjithashtu një problem për banorët në lagjet dhe fshatrat e Shtimes. Gjatë takimeve të rregullta të Këshillit për Siguri në Bashkësi është theksuar se siguria ka një stabilitet por sigurisht duhet bërë më shumë angazhime për ta përmirësuar edhe më tutje. Edhe në kuadër të legjislativit është diskutuar çështja e sigurisë, dhe janë theksuar rastet më të shpeshta që paraqesin rrezik për qytetarët, si vjedhjet e shtëpive, vjedhjet e pusetave në rrugë, ndriçimi publik etj.

Të arriturat në vitin e kaluar

Para së gjithash miratimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2014 – 2018, paraqet një udhërrëfyes drejt zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies qytetare. Natyrisht, ky dokument kërkon që të zbatohet i tëri duke llogaritur pjesën financiare që është një vlerë prej mbi 20 milionë euro investime për periudhën pesë(5) vjeçare. Mos arritja e investimeve të tilla, e bënë tërë këtë strategji vetëm një dokument të hartuar mirë.

Arritje tjetër është fitimi i një donacioni nga Komisioni Evropian për ndërtimin e një Qendre Agrobiznesi e cila do të shërbej për ruajtjen e produkteve bujqësore (pemëve dhe perimeve). Ky lloj investimi ndikon që fermerët ekzistues të jenë më të motivuar për të vazhduar dhe zgjeruar veprimtaritë e tyre ekonomike, por edhe stimulimin e të tjerëve për t'u marrë me veprimtari agrobiznesore.

Rritja e të hyrave vetanake komunale për vitin 2013, është një e arritur tjetër për ekzekutivin komunal. Gjatë këtij viti fiskal, Komuna e Shtimes ka arrit të vjelë më shumë të hyra kryesisht nga tatimi në pronë e cila ka tejkaluar hendekun e mundshëm të krijuar nga heqja e taksave biznesore. Si rezultat i kësaj, buxheti komunal ka pasur një stabilitet të theksuar, por njëkohësisht është rritur performanca e sektorit financiar për të inkasuar më shumë nga borxhet dhe taksat ndaj komunës.

Zhvillim tjetër është procesi i emërimit të rrugëve dhe shesheve të Komunës së Shtimes. Ky proces megjithëse ka kaluar me shumë pakënaqësi qytetare, ai ka arritur të përmbyllet me sukses dhe brenda një afati optimal kohor, si kriter për integritet evropian (liberalizim vizash) dhe për të fituar një grant për shenjzëzim (vendosje të tabelave me emra dhe numra). Ky grant është fituar nga qeveria norvegjeze dhe tashmë ky proces është duke ndodhur.

Vlerësimi për performancë

Kryetari – Performanca e Kryetarit duhet të vlerësohet në bazë të kostos së bërë dhe rezultateve të krijuara. Kryetari duket se ka qenë i angazhuar për të sjellë rezultate dhe performancë të mirë në qeverisje. Kjo është vërejtur edhe gjatë seancave të Kuvendit, kur Kryetari nuk është pajtuar me opinionin e ndonjë Drejtori dhënë para Kuvendit, gjë që mund të shihet si vërejtje e Kryetarit bërë stafit të tij. Megjithatë, duhet të kërkohet më shumë përkushtim gjatë gjithë qeverisjes. Mirëpo, në anën tjetër, shohim shpenzime të mëdha buxhetore në kategorinë mallra dhe shërbime, edhe në kuadër të Zyrës së Kryetarit, ku vetëm kjo zyrë ka shpenzuar 18,000.00 euro për gjashtë muajt e parë të vitit 2013.

Drejtoritë – Në kuadër të Drejtorive të Urbanizmit dhe të Ekonomisë, vërejmë se ka mundur të bëhet punë më shumë në rritjen e efikasitet në leje ndërtimore, kontrolli i ndërtimeve pa leje, rritja e të hyrave nga taksat për leje ndërtimore, zvogëlimi i shpenzimeve të tilla si udhëtime, telekomunikimit, karburante, marketingut e shpenzimet tjera dhe rritja e subvencioneve të tjera që do të sillnin zhvillim.

Këshilltarëve Komunal – do të duhej të ishin më aktiv në ushtrimin e detyrave të tyre, duke u bazuar në përgjegjësinë dhe rolin përfaqësues që mbajnë. Angazhimi i tyre në shumicën e rasteve është ndërlidhur me dokumentet që ka sjellë në Kuvend, ekzekutivi komunal. Nuk kemi parë ndonjë nismë serioze dhe reale të asambleistëve për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat dhe nevojat qytetare. Përjashtim është vetëm nisma për heqjen e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Shtimes.

Kryesuesit të Kuvendit – Në përgjithësi, Kryesuesi ka menaxhuar mirë me seancat e Kuvendit Komunal. Ka ndikuar mjaft në ruajtjen dhe kultivimin e kohezionit në mes të opozitës dhe pozitës. Gjithashtu është vërejtur se ka qenë më i vendosuri nga legjislativi për të ruajtur rolin dhe përgjegjësinë ndaj ekzekutivit. Është përpjekur maksimalisht që

ekzekutivi mos të mund të ndikoj në punën e Kuvendit, kryesisht kur kanë mundur të shkelen procedurat dhe rregullorja e punës.

Transparenca në Komunë

Seancat plenare janë mbajtur në pajtueshmëri me Ligjin për Vetë-qeverisjen Lokale dhe Rregulloren e Punës. Gjatë vitit 2013 janë mbajtur 9 seanca të rregullta dhe dy seanca të jashtëzakonshme. Sa i përket procedurave të bërjes publike apo shpalljes së njoftimeve për kohën dhe agjendën e seancave, ato kanë vazhduar të bëhen konform Rregullores për Transparencë. Pas publikimit të Raportit Monitorues paraprak të OJQ POLIS, disa vërejtje janë marrë në konsideratë nga Sekretariati i Kuvendit Komunal. Siç është për shembull: publikimi i njoftimeve në hapësirat më të frekuentuara nga qytetarët në Komunën e Shtimes. Seancat plenare gjatë këtij viti janë mbajtur me transparencë të plotë sa i përket pjesëmarrjes së publikut. Natyrisht që pjesëmarrja qytetare nuk është shumë e kënaqshme, kjo ndoshta si pasojë e mosgatishmërisë së tyre për pjesëmarrje në aktivitete të tilla apo mos marrjes së informacioneve për seancat e Kuvendit.

Në Komunën e Shtimes nuk ekziston asnjë Komitet Konsultativ i themeluar nga Kuvendi. Komitetet Konsultative janë të parapara me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, derisa karakteri jo “obligativ” për themelimin e tyre ka bërë që kjo Komunë të mos themelojë asnjë të tillë. Këto trupa do të përbëheshin nga ekspertë të lëmive të ndryshme, e të cilat do të ndihmonin Kuvendin, por edhe Ekzekutivin në nxjerrjen e akteve komunale sa më lehtë të aplikueshme dhe në të mirë të shoqërisë.

Mediat lokale janë të pranishme pothuajse gjatë gjithë seancave plenare të Kuvendit të Shtimes. Zakonisht janë korrespondentë lokal të gazetave ditore dhe nga medime lokale (radio). Qasja e tyre është e pa penguar në vëzhgimin e seancave, duke pasur një trajtim të barabartë me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe institucione tjera të interesuara.

Ekipi ynë monitorues i Kuvendit Komunal, Komiteteve të saj dhe disa Drejtorive komunale nuk ka hasur në asnjë pengesë për të poseduar ndonjë dokument të kërkuar.

Komuna e Shtimes vazhdon të menaxhoj dy ueb-faqe zyrtare që mbulojnë aktivitetet e komunës dhe të krijoj një komunikim sa më efektiv dhe transparent me qytetarët. Përmbajtja e ueb-faqeve nuk përfshinë të gjitha dokumentet dhe materialet të cilat janë të qasshme për publikun. Dokumentet e miratuara nga legjislativi nuk janë të vendosura deri në seancën e fundit të Asamblesë. Madje dokumentet dhe vendimet gjenden vetëm në njërën ueb-faqe (zyrtare nga MAPL), ato janë në formatin Word në formën e prezantuar në Kuvend. Në mënyrën më të mirë do të duhej të ishin të ndara individualisht (jo në formën ZIP) dhe të skenuara pas marrjes së aprovimit final dhe të nënshkruara dhe vulosura nga Kryesuesi dhe të shënjuara me numrin protokolar. Gjithashtu, këto ueb-faqe nuk përmbajnë dokumentet e shqyrtuara pas muajit qershor. Për seancat e muajve korrik, gusht, shtator dhe tetor nuk gjendet asnjë dokument.

Pas rekomandimeve të mëhershme rreth kësaj çështjeje, ueb-faqja komunale pati filluar të mirëmbahej dhe ngarkohej me dokumente zyrtare dhe publike, por kjo ngecje përsëri është shfaqur.

Llogaridhënia në Komunë

Duke u bazuar në obligimet që rrjedhin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim dhe llogaridhënie para qytetarëve nga ana e ekzekutivit duket se kjo praktikohet nga ana e Kryetarit të Komunës. Sikurse është e specifikuar me aktet normative, Kryetari apo përfaqësuesi i tij/saj në emër të Komunës mbajnë takime me qytetarë së paku dy herë në vit.

Për vitin 2013, Kryetari i Komunës ka mbajtur takimin me qytetarë për t'i informuar lidhur me aktivitetet e zhvilluara nga Komuna për periudhën e gjashtëmuajorit të parë. Obligimi i raportimit të drejtorëve komunal është që të raportojnë tek Kryetari, më pastaj Kryetari përcjellë informatat dhe jep llogari para qytetarëve.

Raportimi i Kryetarit në Asamblenë Komunale në Shtime bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Derisa obligimet ligjore kërkojnë që Kryetari ose përmes zyrtarëve gjegjës, raportimin financiar ta bëjë rregullisht para asambleistëve. Kjo praktikë e raportimit të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore ndjeket në periudha tre, gjashtë, nëntë mujore dhe në fund raportimi vjetor. Në kuadër të këtyre aktiviteteve raportuese në secilin rast merr pjesë edhe Kryetari. Zakonisht raportimi bëhet nga Zyrtarja Kryesore Financiare, megjithatë kur asamblesitët kanë kërkesa apo pyetje për informacione shtesë, përgjegjësinë për të dhënë shpjegime e merr Kryetari.

Raportimi i Kryetarit nuk mbetet vetëm me pjesëmarrjen e tij gjatë raportimit financiar. Ai është shumë i rregullt me pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e Kuvendit Komunal. Madje shpeshherë ka marrë pjesë edhe në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa. Gjatë pjesëmarrjes së tij në seanca plenare, asambleistët shpesh i bëjnë pyetje Kryetarit e që kryesisht lidhen me pikat e rendit ditës. Megjithatë ka raste kur pyetje janë bërë edhe jashtë pikave të rendit të ditës, duke specifikuar nga asambleistët se po e shfrytëzojmë prezencën e Kryetarit për të marrë sqarime.

Gjithashtu, Drejtorët bëjnë një pjesë të raportimit (informimit) të asambleistëve në rastet kur në shqyrtim janë çështje apo akte që bijnë nën përgjegjësitë e tyre. Përveç, që zakonisht bëjnë paraqitjen dhe arsyeshmësinë e propozimit të aktit të caktuar, ata ndonjëherë pyeten për informacione shtesë për fushë-veprimtarinë e drejtorisë që mbulojnë.

Demokracia pjesëmarrëse, ku qytetarët janë të konsultuar dhe aktiv në vendimmarrje duket se funksionon vetëm sa për të përmbushur kërkesën që rrjedhë nga ligji.

Monitoruesit tanë ka arritur të marr pjesë në dy prej tubimeve me qytetarë, duke vlerësuar pjesëmarrjen dhe cilësinë e takimeve të tilla. I pari ka qenë takim konsultativ me qytetarë për të diskutuar propozimin e emërtimeve të rrugëve dhe shesheve, takim ky në të cilin, nuk janë përfillur procedurat e organizmit në bazë të Rregullores për Transparencë. Pasi është ftuar publiku vetëm një javë para takimit, me rregullore, kjo do të duhej bërë së paku 14 ditë para se të mbahet ai takim. Pastaj duhet që institucioni të organizon takimin të marrë shënime rreth sugjerimeve të qytetarëve dhe për një periudhë prej dy javësh të përpunoj ato dhe të i përfshijë në dokumentin e caktuar. Kjo nuk ka ndodhur, pasi përgjegjësit kryesor të këtij procesi nuk e kanë drejtuar këtë takim, dhe seanca e radhës e jashtëzakonshme e Kuvendit është mbajtur vetëm tri (3) ditë më vonë duke mos përfillur asnjë nga propozimet e qytetarëve. Madje udhëheqësit e lagjeve të Shtimes (5 lagje gjithsejtë sa ka qyteza e Shtimes), përveç vërejtjeve dhe sugjerimeve patën dhënë edhe një kritikë drejtë Komisionit se jo vetëm që asnjë nga kryetarët e lagjeve që nuk janë njoftuar, por as nuk kanë mbajtur asnjë tubim me qytetarë lidhur me këtë proces. Si rrjedhojë e këtij procesi konsultativ jo cilësorë, në vazhdimësi kemi pasur ankesa nga qytetarë të fshatrave për pakënaqësi lidhur me emërtimet e vendosura, sikur janë pakënaqësitë nga fshati Davidovc dhe Vojnoc.

Tubimi tjetër me publikun është ai i organizuar nga Kryetari i Komunës në bazë të obligimit ligjor për të informuar qytetarët për periudhën gjashtë mujore të aktiviteteve të komunës. Para së gjithash ky dëgjim është thirrur nga Kryetari e në kuadër të saj më vonë është futur edhe një pikë tjetër për diskutim, respektivisht konsultim. Me 24 Qershor, në bazë të vendimit të Kuvendit, KPF dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, ka pasur për obligim të mbajë takim konsultativ me qytetarë të Shtimes, Davidovcit dhe Belincit, për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014-2016. Ky takim kishte dështuar në mungesë të pjesëmarrjes së qytetarëve, dhe si shkak i kësaj ishte inkorporuar në kuadër të dëgjimit publik. Pjesa më e

madhe e pjesëmarrësve ishin zyrtarë të administratës komunale, të cilët më tepër ishin aty për të rritur numrin e pjesëmarrësve në atë takim se sa që ishin të interesuar për të dhënë ndonjë kontribut.

Urbanizmi në Komunë

Kjo drejtori ka të nxjerrë aktet kryesore komunale që rregullojnë veprimtarinë urbanistike në komunë. Plani Zhvillimor Urban dhe Plani Zhvillimor Komunal janë dokumente që vlejné për periudhën deri në vitin 2020 dhe të cilat japin në detale kahjet zhvillimore dhe urbanistike.

Ajo që mbetet sfidë për këtë drejtori është lëshimi i lejeve ndërtimore. Nga numri i lejeve ndërtimore të lëshuara për vitin 2013 deri në periudhën që raportojmë vërehet se ai është numër shumë i vogël. Janë vetëm 13 leje për tërë vitin 2013, që si duket është numër aq i vogël, sa që mund të konstatojmë se në Komunën e Shtimes ose nuk ka zhvillim, rrjedhimisht ndërtime të reja fare, ose këtu ndërtohet pa leje ndërtimore. Kjo e dyta duket të jetë më e saktë, duke marrë parasysh edhe një pohim të Drejtorit për Urbanizëm, se ndërtimi i objekteve pa leje është një fenomen dhe sfidë edhe për Shtimen. Prandaj, konsiderojmë se ky fenomen përveç që ndikon në degradim të planeve zhvillimore dhe urbanistike, ajo ndikon edhe në të hyrat komunale që do të vinin nga pagesa e taksave komunale për leje ndërtimore.

Nga diskutimet e asambleistëve herë pas here ngritën shqetësime të tyre dhe qytetarëve lidhur me cilësinë dhe funksionalitetin e projekteve infrastrukturore të përfunduara, të tilla si rrjeti i ujësjellësit i ngritur si çështje nga një prej asamblistëve.

Shqetësime që ndërlidhen me këtë fushë janë ngritur edhe nga qytetarët, si në raste të uzurpimeve të pronës apo edhe të shpronësimit, që kanë dalë si shqetësime edhe nga anketimi ynë.

Gjithashtu, kjo drejtori ka sponsorizuar ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha për vitin 2013, përmes së cilës taksat dhe tarifat për ndërtim janë përshtatur me Ligjin e Ndërtimit. Me këtë, Komuna ka shkuar në minimumin e taksës së lejes ndërtimore në 1.5 euro/m².

Financat në Komunë

Sa i përket financave komunale nga të dhënat e disponueshme për periudhën raportuese Janar – Qershor, del që trendi i mbledhjes së të ardhurave kryesisht nga Tatimi në Pronë dhe Taksa mbi Automjetet janë ato që kanë tejkaluar pritjet e vlerësuara apo 50% të planifikuar. Mbetet po kështu sfidë e madhe, mbledhja e taksave nga lejet ndërtimore e cila nëse vazhdon me këtë trend, del që deri në fund të këtij viti fiskal nuk do të tejkaloj 12% të asaj që është planifikuar. Nga kjo mund të konkludohet se planifikimi buxhetor duhet të bëhet sa më real.

Në ndërlidhje me këtë do të ishte mirë që të bëhej një planifikim financiar për vitet vijuese që të parashihet mbulimi i pagesës për Kryetarët e Fshatrave dhe Lagjeve, dhe anëtarëve të Komiteteve Konsultative, në mënyrë që nga reduktimi i shpenzimeve të mbulohet pagesa për këto struktura. Kjo do të ndikonte në performancë më të mirë të komunës dhe zhvillim të qeverisjes demokratike konsultative dhe pjesëmarrëse nga qytetarët.

Sa i përket zhvillimit ekonomik, Drejtoria komunale për Zhvillim Ekonomik ka hartuar Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal dhe ka marrë pëlqimin nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për Zonën Ekonomike – të quajtur Parku Teknologjik. Sa i përket këtij parku, atje sot janë duke ushtruar veprimtarinë afariste dy subjekte.

Çështjet prioritare për zhvillim demokratik në Komunën e Shtimes dhe mirëqenien e qytetarit

Përfundimi i infrastrukturës fizike në Zonën Ekonomike – Parkun Teknologjik, paraqet një çështje prioritare për Komunën e Shtimes. Megjithëse, atje janë bërë investime në vazhdimësi ajo ende nuk është përfunduar. Me kompletimin e saj pritet të vijnë investime dhe investitorë të rinj, të jashtëm dhe të brendshëm, duke marrë parasysh edhe lehtësirat për bizneset që kanë filluar të aplikohen me heqjen e taksës për bizneset.

Kompletimi i infrastrukturës fizike (rrjetet kanalizimi të ujërave fekale dhe atmosferike, rrjetet të ujësjellësit, dhe asfaltim të rrugëve) duhet të jenë prioritete tjera për ekzekutivin komunal, planifikuar po ashtu edhe me Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal. Në kuadër të kësaj janë planifikuar edhe investimet në të ashtuquajturën Bujqësi Intensive, për të cilat duhet me nguti të aplikohen, në mënyrë që këto investime të ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm.

Çështje me rëndësi është edhe nxjerrja e një Rregulloreje të veçantë për Kompensimin e të gjithë të angazhuarve në trupat që ndihmojnë punën e qeverisjes lokale. Në kuadër të kësaj rregullore të caktohet një shumë kompensimi monetar për kryetarët e Fshatrave dhe Lagjeve ashtu sikur është e specifikuar me Rregullore.

Një shqetësim që është vërejtur është se gjatë seancës vendoset që rekomandimet e KPF-së të hedhen në votim në bllok, ashtu sikur janë aprovuar në KPF. Kjo praktikë minimizon debatin në Asamble dhe rolin e asambleistit pasi nuk jep mundësinë e shprehjes së lirë të opinionit dhe të drejtën e votimit për ndonjë pikë apo kërkesë. Kjo duhet të jetë një praktikë legislative që nuk bënë të përsëritet në të ardhmen.

Kompensimi i shpronësimeve për pronat që i janë marrë qytetarëve për qëllime publike është një e metë tjetër që i atribuohet kryesisht ekzekutivit komunal. Kjo është një e drejtë e patjetërsueshme për secilin individ, që prona është e paprekshme nga kushdo qoftë. Nëse kjo prekje bëhet për të mirën publike, kompensimi të bëhet sa më shpejt, pasi po aq sa është e drejtë qytetare për posedim prone, po aq është edhe përgjegjësi instiucionale që të bëhet shpronësimi me rastin e marrjes së saj.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Krijimi i një klime më të favorshme për zhvillim të biznesit	Fushë sporti (nuk ka specifikuar se të cilës lëmi sportive)	Do të vazhdoj me qeverisjen transparente
2	Nxitja e zhvillimit të bujqësisë intensive	Ndërtimi i Rrugës Transit	Qeverisje të hapur ndaj qytetarëve sikur ka vepruar deri më tani.
3	Përmirësimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturës	Përfundimi i rrugëve nëpër fshatra	
4	Zhvillimi i Turizmit Rural	Ndërtimi i shkollave atje nuk nevojë të ndërtohen një e re	
5	Krijimi i Drejtoratit të veçantë për Kulturë, Rini dhe Sport	Ujësjetësi dhe kanalizimi në Pjetërshticë dhe në fshatra tjera ku mungon	
6		Krijimi i katër zonave të reja të biznesit	

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Kryetari të ndërmarrë nismën për Themelimin e Komiteteve Konsultative duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Udhëzimin Administrativ për Themelimin e Komiteteve Konsultative.
- Të kërkojë më tepër përgjegjësi nga zyrtarët e tij që dokumentet publike të jenë të qashme me kohë në ueb-faqen e Komunës. Përveç dokumenteve dhe akteve që nxjerrë Kuvendi aty të paraqiten edhe vendimet që nxjerrë Kryetari dhe Drejtorët.
- Të kërkojë performancë më të mirë nga drejtorët komunal ngase duke u bazuar në të dhënat nga pasqyrat buxhetore shohim se të hyrat e planifikuara nga pjesa e lejeve ndërtimore për gjashtë muajt e parë janë realizuar në masën prej 5.85%.
- Të ndikoj në uljen e shpenzimeve kryesisht nga kategoria mallra dhe shërbime. Nën këtë kategori shpenzimet e udhëtimit, telekomunikimit, lëndëve djegëse, shërbime kontraktuale dhe reprezentacionit kanë një trend të rritjes në raport me dy vitet e kaluara, duke i krahasuar raportet e shpenzimeve nëntë (9) mujore.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Të ndërmarrë masa që Plani Zhvillimor Urban dhe Komunal të zbatohet në tërësi, duke koordinuar aktivitetet me Inspektoratin komunal në mënyrë që ndërtimet pa leje të ndërpriten.
- Të bëjë një mbikëqyrje më të përpiktë tek implementimi i projekteve kapitale në infrastrukturë. Nuk mjafton vetëm të përmbyllen projekte, më e dobishme është që ato që kryhen të jenë cilësore dhe funksionale.

Drejtorisë së Financave

- Sektori financiar duhet të vazhdoj performancën e mirë në vjeljen e tatimit në pronë, por duhet të rrisë performancën në vjeljen e taksave për lejet ndërtimore. Këtu kërkohet gjithashtu një koordinim më i mirë në mes Drejtorisë së Urbanizmit dhe Inspektoratit.
- Të planifikojë shpenzime më të pakta për vitet vijuese, kryesisht duke zvogëluar planifikimet për shpenzime në kategorinë e mallrave dhe shpenzimeve.
- Me rastin e vendosjes së bizneseve apo investitorëve në Zonën Ekonomike – Parku Teknologjik, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik të përfillë procedurat dhe kriteret e parapara me legjislacionin primar dhe sekondar të nivelit qendror dhe atë të nivelit lokal.

Kryesuesit të Kuvendit

- Në rastet kur merren vendime me gjithëpërfshirëse, kryesuesi duhet të kërkojë forma të gjetjes së konsensusit edhe me partitë opozitare.
- Të ndikoj në mbarëvajtjen e seancave në Kuvend, kryesisht në mbajtjen e rendit, duke mos lejuar pengimin e seancës përmes përdorimit të telefonave mobil nga asambleistët dhe/ose lëvizjeve të shpeshta gjatë seancës.

Asamblistëve të Kuvendit

- Diskutimet e tyre të jenë më cilësore dhe më përmbajtjesore që mund të bëhet duke analizuar me kujdes materialin e pikave të propozuara për rend dite dhe duke marrë informata shtesë për secilën çështje që është në diskutim.
- Të mbajnë më shumë takime me qytetarë për tu njohur me problemet eventuale të tyre dhe për të përfaqësuar në Kuvend kërkesat e tyre.
- Asamblesitët të ndërmarrin nisma për t'i informuar qytetarët lidhur me zhvillimet komunale qoftë të legjislativit qoftë të ekzekutivit në përgjithësi apo përmes bashkëpunimit me shoqëri civile.
- Asambleistët të kërkojnë më shumë informata nga Ekzekutivi përmes kërkesave me shkrim, në mënyrë që të arrihet një mbikëqyrje më e madhe ndaj ekzekutivit nga legjislativi, që njëherit është përgjegjësi e tyre.


Shtime Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	9	28	93.44 %	92.87 %
Janar	1	4	90%	P/A
Shkurt	1	3	100%	100%
Mars	1	3	95%	86%
Prill	1	3	86%	100%
Maj	1	1	90%	86%
Qershor	0	0	0	0
Korrik	1	4	100%	100%
Gusht	1	3	90%	100%
Shtator	1	6	90%	71%
Tetor	1	1	100%	100%
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	8	27	90.50 %	83.33 %
Janar	1	4	P/A	P/A
Shkurt	1	3	P/A	P/A
Mars	1	3	86%	0%
Prill	1	3	100%	100%
Maj	1	1	100%	100%
Qershor	1	3	100%	100%
Korrik				
Gusht	1	3	71%	100%
Shtator	1	6	86%	100%
Tetor		1		
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja	
Këshilli i Sigurisë në Bashkësi	3		(Po)	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Dëgjimet publike	8		36 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Rregullore për Themelimin dhe Funksonimin e KVRL-së në Komunën e Shtimes	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Rregullore për Fuqizimin dhe Promovimin e Vullnetarizmit në Komunën e Shtimes	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Rregullore për Tatimin në Pronën e Paluajtëshme për vitin 2014	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Korniza Afatmesme Buxhetore 2014-2016 e Komunës së Shtimes	Aprovuar	Pro: 21 Kundër: 0 Abs: 0
Plani Buxhetor Komunal 2014-2016	Aprovuar	Pro: 18 Kundër: 0 Abs: 1
Strategjia e Zhvillimit Ekomic Lokal 2014-2018		Pro: 17 Kundër: 0 Abs: 2
Statuti i Qendrës për Punë Sociale në Shtime	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Plani i Veprimit për Integrimin e Komunitetit Ashkali dhe Rom 2013-2015	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për Emërtimin e Rrugëve dhe Shesheve në Komunën e Shtimes	Aprovuar	Pro: 13 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për Emrat Rezervë të Rrugëve dhe Shesheve në Komunën e Shtimes	Aprovuar	Pro: 13 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim Për Aprovimin e Raportit Financiar për vitin 2012	Aprovuar	Pro: 12 Kundër: 7 Abs: 0
Vendim Për Aprovimin e Raportit të Punës së Kuvendit për vitin 2012	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për Aprovimin e Raportit Financiar të OVL-së	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për Kompenzimin e Komisioneve të Kuvendit	Aprovuar	Pro: 21 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për Aprovimin e Raportit Financiar Janar-Mars 2013	Aprovuar	Pro: 17 Kundër: 2 Abs: 0
Vendim për Aprovimin e Raportit Financiar Janar-Qershor 2013	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim Për Rishikimin e Buxhetit për vitin 2013	Aprovuar	Pro: 20 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për Shpalljen e Zonës Ekonomike (Rikonfirmim)	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për Aprovimin e Subvencioneve dhe Transfereve sipas Buxhetit të vitit 2014	Aprovuar	Pro: 15 Kundër: 4 Abs: 0


Raporti Monitorimit 2013




Komuna Viti



Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



10. Komuna VITI

Problemet kryesore të komunës

Qeveria komunale në Viti, ka funksionuar me të gjitha drejtoritë e themeluara në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal. Por, ekzekutivi i komunës gjatë këtij mandati në punën e tij është shoqëruar me probleme dhe mangësi të shumta, ku më kryesoret mund të veçohen:

- Vonesat në miratimin e statutit të ri të komunës;
- Problemet që rrjedhën në administratën komunale pas miratimit të këtij statuti, që quan edhe në zëvendësimet e udhëheqësve të disa drejtorive;
- Pasojat e vendimeve të jashtëligjshme që ishin marrë në kohë të mëhershme siç ishte vendimi i njëanshëm për ndarjen e ndërmarrjes komunale për menaxhim të mbeturinave nga ndërmarrja rajonale;
- Formimi i jashtëligjshëm i një komisioni për prokurim publik;
- Rregullorja për funksionim të administratës komunale;
- Mos zbatimi i procedurave të prokurimit me rastin e dhënies së 60 mijë eurove për kompaninë zvicerane VDS për ndërtimin e pendës mbi lumin Morava;
- Vendimi për kushtëzim të shërbimeve për qytetarë me pagesën e faturave të mbeturinave;
- Vendimet për dhënie me koncesion të pronës komunale.

Të gjitha këto probleme bënë që organet e drejtësisë të ngrejné aktakuza për drejtuesit e komunës dhe shërbyes tjerë civil.

Probleme tjera që përcjellën Komunën e Vitisë ishin: cilësia e dobët e projekteve të infrastrukturës, që shkaktuan pakënaqësi te qytetarët ku vërejtjet më të mëdha u evidentuan për projektet që kanë të bëjnë me rregullimin e trotuarit Viti-Drobesh, asfaltimit të rrugës në Lagjen e Sokolëve në Verban, kanalizimin në Budrikë dhe Radivojc, shkollën në Remnik, shtrirjen e gypave të ujësjellësit në Sadovinë, trotuarin në Sllatinë të Epërme etj. Në anën tjetër probleme të mëdha mbesin edhe mungesa e ujit të pijes si në zonat ku nuk kanë rrjet të ujësjellësit ashtu edhe në ato zona ku është i shtrirë ky rrjet për shkak të sasisë së pamjaftueshme të ujit si dhe problemeve me menaxhim të ujësjellësit, problemet në arsim, pasi me gjithë investimet që janë bërë në të kaluarën në ndërtimin e shkollave të reja si dhe për përmirësimin e kushteve në objektet shkollore, një numër mjaft i madh i shkollave funksionojnë në kushte të vështira. Objektet shkollore në Sllatinë të Epërme dhe Pozheran, për shkak kushteve jo të mira nga Inspektoriati kanë marr vërejtjen që të mbyllen. Shkollat si në Verban, Smirë dhe në disa lokalitete ballafaqohen me mungesë të ujit për pije. Qendra e Mjekësisë Familjare në Pozheran vepron në kushte të vështira higjieno –teknike. Në përjashtim të punkteve shëndetësore në Letnicë, dhe Sadovinë punktet shëndetësore funksionojnë vetëm me personel teknik.

Të arriturat gjatë vitit 2013

Të arriturat kryesore të komunës gjatë vitit të kaluar ishin në këta sektorë:

Zyra e kryetarit dhe Kuvendi Komunal – Me propozim të kryetarit të komunës dhe me vendim të Kuvendit Komunal, të gjitha bizneset në Komunën e Vitisë, janë liruar nga të gjitha taksat komunale. Kjo masë ka ndikuar në regjistrimin e 232 bizneseve të reja që kanë mundur inkuadrimin e 281 punëtorëve të rinj.

Drejtoria e zhvillimit ekonomik – Me propozim të Drejtorisë Komunale për Zhvillim Ekonomik, në Komunën e Vitisë është hequr vendimi për participim të qytetarëve në projekte të infrastrukturës, dhe shpërndarja e investimeve kapitale është bërë në bazë të shkallës së inkasimit të tatimit në pronë. Ky vendim ka ndihmuar qytetarët që në vend se të paguajnë dyfish për projektet që realizohen në lokalitetet e tyre, për participim si dhe obligimin që kanë në tatimin në pronë, të paguajnë vetëm obligimet që kanë në tatimin në pronë. Kjo masë ka ndikuar që komuna e Vitisë të realizoj shkallën e inkasimit të tatimit në pronë rreth 21% më shumë se vitin e kaluar.

Zyra e kryetarit, Kuvendi Komunal, zyra për koordinim me këshilla të fshatrave dhe zyra e informimit – Me propozim të kryetarit të komunës, Kuvendi Komunal i Vitisë ka miratuar rregulloren e re për zgjedhjen e Këshillave të Fshatrave. Në bazë të kësaj rregullore zyra e kryetarit në bashkëpunim me zyrën për koordinim me fshatra, zyrën e informimit dhe në mbështetje të projektit të qeverisë zvicerane LOGOS, për herë të parë ka zgjedhur këshillat e fshatrave me votë të drejtpërdrejtë të qytetarëve.

Performanca e Kryetarit të Komunës së Vitisë, z. Nexhmedin Arifi–Kryetari i komunës së Vitisë, Nexhmedin Arifi, në dy vitet e fundit të mandatit të tij qeverisës është ballafaquar me kundërshti dhe përçarje me kryesinë e partisë që i takon, dhe kjo ka ndikuar që gjatë këtij mandati të ketë ndryshime në pozitat e nënkryetarit të komunës dhe drejtorisë për ekonomi dhe financa. Këto kundërshtime të kryetarit Arifi, me kryesinë e partisë së tij, kanë ndikuar në masë të madhe në tërheqjen e investimeve nga qendra.

Performanca e Drejtorive Komunale në Komunën e Vitisë–Drejtoritë komunale kanë funksionuar në bazë të marrëveshjes së koalicionit mes PDK-së dhe AAK-së, ku nga 10 drejtori, 8 janë qeverisë nga PDK dhe 2 nga AAK. Si dobësi që është evidentuar në punën e drejtorive komunale, ishte mungesa e rregulloreve të brendshme të punës, ku do të përshkruhej roli dhe detyrat e drejtorisë, mangësi kjo që ka ndikuar shpesh edhe në ngatërrim të kompetencave mes tyre si dhe në performancën e tyre.

Performanca e këshilltarëve të Kuvendit Komunal të Vitisë–Pjesa dërrmuese e këshilltarëve të KK-së, gjatë mandatit të tyre, në përjashtim të votimit, nuk kanë luajtur ndonjë rol aktiv në seancat e Kuvendit dhe komiteteve të Kuvendit Komunal. Në shumicën e rasteve iniciimi dhe diskutimi i pikave të rendit të ditës, është bërë kryesisht nga udhëheqësit e grupeve të këshilltarëve, apo dy- tre këshilltarë të tjerë.

Performanca e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë–Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë, mbledhjet e Kuvendit si dhe të Komitetit për Politikë dhe Financa, në shumicën e rasteve i ka kryesuar në bazë të rregullores së punës së Kuvendit Komunal. Të metat që janë evidentuar në kryesimin e seancave të Kuvendit Komunal nga ana e kryesuesit janë të natyrës teknike.

Transparenca në Komunë

Komuna e Vitisë, edhe gjatë vitit 2013, ka pasur ngecje të theksuara në aspektin e përmbushjes së akteve nënligjore për transparencë. Njoftimet publike për mbledhjet e Kuvendit Komunal, në të shumtën e rasteve në ueb-faqen zyrtare të komunës, janë publikuar dy ditë para mbajtjes së seancave, kurse për mbledhjet e KPF-së nuk ka pasur njoftime fare. Edhe pse në 10 lokalitete të ndryshme të komunës ekzistojnë edhe tabelat publike të dedikuara për informim të qytetarëve rreth komunës, në këto tabela nuk ka pasur asnjëherë njoftime apo informatë që ka të bëjë me seancat e Kuvendit Komunal.



Kuvendi Komunal i Vitisë, gjatë mandatit të vetë nuk ka formuar asnjë komitet konsultativ. Shoqëria civile, në bazë të rekomandimeve që kanë dal nga takimi i përbashkët i përfaqësuesve institucional dhe OJQ-ve lokale, i datës 11 qershor 2013, ka iniciuar themelimin e Komitetit Konsultativ për Ambient dhe Pronë, por kërkesa me shkrim e OJQ-ve lokale nuk është marrë asnjëherë në shqyrtim nga Kryetari i komunës dhe kryesia e Kuvendit Komunal.

Seancat e Kuvendit Komunal të Vitisë, në përgjithësi ishin të hapura për publikun dhe për mediat. Seancat e kuvendit komunal u transmetuan drejtpërdrejtë përmes video-linkut qeveritarë si dhe të incizuara në Radiotelevizionin Iliria. Mediat kanë pasur qasje të lirë në mbledhjet e Kuvendit dhe komiteteve obligative. Pjesëmarrje të rregullt në mbledhjet e Kuvendit Komunal kanë pasur: RTV Iliria, Koha Ditore, Radio Kosova si dhe TV Vali.

Në bazë të ligjit për qasje në dokumente publike, 03/L-215 dhe udhëzimit administrativ, 3/2006, Komuna e Vitisë në vitin 2012, ka angazhuar një zyrtarë komunal nga zyra e informimit publik, që të merret me këtë çështje dhe përmes ueb-faqes zyrtar ka siguruar informatat e nevojshme për qytetarë për të drejtat dhe mënyrë në qasjes në dokumente zyrtare. Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Vitisë, përmban një përkthim të dobishëm për qytetarët në atë se si t'u qasen dokumenteve publike. Në bazë të raporteve të zyrës për informim publik gjatë vitit 2012, në komunën e Vitisë janë parashtruar 16 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare. Nga ky numër kërkesash, 3 prej tyre nuk kanë marr përgjigjen e kërkuar nga komuna. Kurse në periudhën janar-tetor 2013, janë parashtruar 12 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

Ueb faqja zyrtare e Komunës së Vitisë, përmban të dhënat kryesore për komunën, kuvendin komunal, lajme dhe informacione, shërbimet komunale, buxhetin, vendimet, rregulloret komunale si dhe shënime tjera të nevojshme për qytetarë. Por, ueb-faqja nuk freskohet sa duhet edhe me shënime tjera të nevojshme për qytetarë sidomos me informacionet që kanë të bëjnë me prokurimin publik, ku mungojnë informatat rreth, shpalljes së tenderëve dhe kontratave të nënshkruara mes komunës dhe operatorëve të ndryshëm në komunë, raportet e auditorit gjeneral, procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, numrat e kontaktit të këshilltarëve komunal, institucioneve tjera që nuk janë përgjegjësi e komunës por që ofrojnë shërbime për qytetarë brenda territorit të komunës, OJQ-ve lokale dhe përfaqësuesve të fshatrave etj.

Llogaridhënia në Komunë

Kryetari i Komunës dhe drejtoritë komunale, kanë përmbushur obligimin ligjor për raportim para qytetarëve dhe shoqërisë civile. Kryetari i komunës ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale, së paku dy herë në vit, ka organizuar takimet publike me qytetarë ku ka raportuar për punën e ekzekutivit të komunës. Pos këtyre takimeve, Kryetari i komunës dhe drejtoria për ekonomi dhe financa, në bashkëpunim me projektin e qeverisë zvicerane LOGOS, ka organizuar edhe takimet publike me qytetarë dhe shoqërinë civile, për ekzekutimin e Kryetari i komunës dhe drejtoritë komunale, kanë shfrytëzuar kontratën e rregullt me RTV Iliria për të prezantuar aktivitetet e komunës në media. Por edhe pse me plan të punës së zyrës së informimit publik ishin paraparë konferencat e rregullta mujore për media të Kryetarit dhe drejtorëve komunal, kjo pikë e planit të kësaj zyre nuk është realizuar.

Ashtu siç parasheh Ligji, Kryetari i komunës, ka paraqitur raportin gjashtë mujor dhe vjetor të punës në Asamblenë komunale. Raporti i punës së kryetarit në formë të shtypur (hard-copy), me materialet tjera i janë përcjellë këshilltarëve, kurse në seancën raportuese Kryetari, ka paraqitur në pika të shkurtra raportin dhe i është përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të këshilltarëve që kishin të bënin në lidhje me raportin e paraqitur. Kryetari

dhe drejtoria për ekonomi, në bazë të rregullta 3 mujore kanë raportuar para asamblese komunale edhe për pasqyrat financiare mbi shpenzimet dhe të hyrat e buxhetit komunal.

Kryetari i komunës dhe drejtoritë komunale, gjatë vitit 2013, kanë realizuar 12 takime apo dëgjime publike me qytetarë. Prej tyre 1 takim kishte të bënte me raportin e punës së kryetarit në gjashtë mujorin e parë, 1 për ekzekutimin e buxhetit komunal për vitin 2012, dhe 10 takime që kishin të bënin me planifikimin e buxhetit komunal. Në takimet publike me qytetare, kryetari i komunës ka raportuar për punën dhe angazhimet e administratës komunale me theks të veçantë për projektet që komuna ka implementuar apo implementon në lokalitete të ndryshme. Kurse, qytetarët kanë pyetur rreth angazhimeve të komunës për familjet e pastreha, ngecjet në realizimin e projekteve të premtuara nga komuna, problemet me pagat në arsim, si dhe për projektet që komuna planifikon t'i realizojë në të ardhmen. Kurse, në debatet publike për planifikim të buxhetit, zyrtarët komunal kanë prezantuar Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014-16 dhe listën e projekteve të planifikuara nga komuna për investime nëpër lokalitete gjatë vitit 2014. Vërejtjet kryesore të qytetarëve janë fokusuar në vonesat për realizimin e projekteve kapitale, cilësinë e projekteve që kanë të bëjnë me investime kapitale, mos shpërndarjen e duhur të investimeve kapitale nëpër lokalitete. Komuna procesin e planifikimit të buxhetit, e ka zhvilluar në konsultim me qytetarët dhe ka marr parasysh kërkesat që dalin nga qytetarët për investime në infrastrukturë. Këshilltarët komunal, shumë pak janë konsultuar me qytetarët për të iniciuar ndonjë vendim në kuvendin komunal. Asamblistët, pos që nuk kanë konsultuar bazën, nuk ishin prezent edhe në takimet publike që komuna ka organizuar nëpër lokalitete të ndryshme për planifikim të buxhetit apo të ndonjë natyre tjetër.

Urbanizmi në Komunë

Kompetencat: Drejtoria për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të planifikon zhvillimin hapësinor dhe urbanistik zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e planit zhvillimor dhe urban të Komunës së Vitisë në fuqi, harton programe dhe planifikime dhe propozon miratimin e planeve rregulluese urbane për qytetin e Vitisë dhe vendbanimeve tjera policentrike të Komunës në kuadër të PZHU-së të komunës dhe të tërësive tjera urbanistike, merret me planifikimin urban dhe rural të komunës dhe të shfrytëzimit të tokës në parametrat e planifikimeve, përcjell planifikimin urbanistik, projektimin dhe zbatimin e tyre, përgatit plane të detajuara urbanistike –projekte urbanistike –arkitektonike, për lagje dhe tërësi të caktuara të qytetit të Vitisë dhe të komunës në përgjithësi, jep pëlqime dhe leje ndërtimore etj.

Aktivitetet: DUPMM në kuadër të kompetencave që ka, gjatë këtij vitika zhvilluar këto aktivitete: shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve si dhe pajisjen e tyre me leje urbane dhe leje ndërtimi, mbikëqyrjen e implementimit të planit zhvillimor komunal dhe urban, përgatitjen e planit rregullativ urban për zonën veriore të qytetit të Vitisë, përgatitjen e raporteve të rregullta për kryetarin e komunës, organizmin e aksioneve për pastrim të ambientit, regjistrimin e adresave të qytetarëve në mënyrë hartografike dhe elektronike.

Kërkesat e qytetarëve: DUPMM, gjatë periudhës janar – nëntor 2013, ka pranuar 46 kërkesa të ndryshme nga qytetarët, prej të cilave 29 janë miratuar, 9 janë refuzuar dhe 8 janë në proces. Kërkesat e qytetarëve ishin të natyrave: kërkesa për leje urbane, kërkesa për ndërtim, kërkesa për informata të ndryshme rreth PZHU-së.

Lejet e ndërtimeve: Gjatë periudhës janar –nëntor 2013, DUPMM, ka shqyrtuar 22 kërkesa për leje urbane si dhe 16 kërkesa për leje ndërtimi. Prej këtij numri të kërkesave, 6 ishin për leje ndërtimi nga të cilat 5 janë miratuar, kurse 1 është në proces. Ndërsa për leje urbane kanë aplikuar 16 qytetarë prej të cilëve 10 kërkesa janë miratuar ndërsa 6 janë refuzuar.

Raportet: DUPMM krahas raportimit narrativ për aktivitetet e kësaj drejtorie ka publikuar edhe raportin për të hyrat vetanake. Në bazë të këtij raporti DUPMM për vitin 2013, kishte planifikuar të hyra nga lejet e ndërtimit, lejet urbanistike, lejet e përdorimit dhe lejet për rrënim në shumën prej 45 mijë e 500 euro. Nga kjo shumë për periudhën janar – shtator 2013, DUPMM ka inkasuar vetëm 3 mijë e 72 euro e 35 cent, apo 6.75% të planit.

Planet Urbanistike; Komuna e Vitisë në vitin 2010 ka miratuar Planin zhvillimor Komunal dhe Urban. Mbi bazën e këtij plani në vitin 2012 janë miratuar planet rregulluese urbane për zonën lindore dhe qendër. Kurse, Kuvendi Komunal i Vitisë më 14 gusht 2013, ka miratuar vendimin për shpalljen e shqyrtimit publik për planin rregullues urban për zonën veriore të qytetit të Vitisë. Më 23 shtator 2013 është mbajtur debati publik rreth këtij plani, i cili është miratuar më 02 tetor 2013. Planin rregullues urban përfshinë një sipërfaqe prej 102 hektarëve të zonës veriore të qytetit të Vitisë.

Problemet: DUPMM si problem kryesor ka mos zbatimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban si dhe planeve rregulluese urbane për tri zonat e qytetit të Vitisë, ndërtimet pa leje, si dhe mbrojtjen e ambientit nga hedhja mbeturinave në deponitë ilegale. Këto probleme vijnë si pasojë e krizës ekonomike, mos efikasiteti i inspeksionit për ndaljen e ndërtimeve pa leje në terren, taksës për shndërrimin e tokës bujqësore, mungesës së deponive për mbeturina të ngurta, mos efikasitetit në punë të ndërmarrjes komunale për mbeturina.

Financat në Komunë

Kompetencat: Drejtoria për financa dhe ekonomi është përgjegjëse për hartimin, propozimin e vendimeve dhe rregulloreve komunale për çështjet financiare, për mbikëqyrjen e sistemeve dhe procedurave për ekzekutimin e buxhetit, për procedurat dhe raportet e kontabilitetit, për mbajtjen e llogarive dhe raporteve vjetore financiare, për planifikimin e prokurimeve në afatet ligjore, për përgatitjen e projekt buxhetit para paraqitjes së tij në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe në Kuvendin e Komunës për miratim, për procedurat dhe përgatitjet për rishikimet buxhetore, për planifikimin e të hyrave vetanake etj.

Vendimet: DFE gjatë vitit 2013 ka miratuar këto vendime: Vendimi për pasqyrat financiare të buxhetit komunal dhe bilanci i gjendjes për periudhën janar - dhjetor 2012, vendimi për bartjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake, vendimi për pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar – mars 2013, vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) të Komunës së Vitisë 2014 -16, vendimi për rishikimin e buxhetit gjashtë mujor për vitin 2013, vendimi për pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar – qershor 2013, vendimi për aplikimin e kriterëve për prioritizimin e investimeve kapitale në komunat partnere.

Problemet: DFE me gjithë vlerësimet pozitive të auditorit gjeneral rreth shpenzimit të parasë publike për vitin 2012, edhe gjatë këtij viti nuk ka arritur që të ushtroi një kontroll më të madh tek shpenzimet komunale apo të luksit. Sipas pasqyrave financiare, Komuna e Vitisë, gjatë nëntëmuajorit të këtij viti, ka rritje të shpenzimeve për 199 mijë e 190 euro e 73 cent, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar euro. Në bazë të pasqyrave financiare, rritja e shpenzimeve të buxhetit komunal është tek kategoria e mallrave dhe shërbimeve si dhe tek investimet kapitale. Shpenzimet në tre muajorin e tretë të këtij viti, krahasuar me vitin e kaluar, janë më të mëdha për shërbime, mallra dhe komunale në shumë prej 32 mijë e 480 euro dhe për investime kapitale në shumë prej 192 mijë e 979 euro.



Komuna e Vitisë paguan rreth 35 mijë euro dënime nga gjykata

Komuna e Vitisë, në vitin 2013 ka shpenzuar 34 mijë e 79 euro për vendime të gjykatave, shpenzim ky që është i përafërt me vitin e kaluar, ku komuna për shkak të vendimeve të Gjykatës kishte paguar shumën prej 37,788.63 euro. Shpenzimi i këtyre mjeteve të buxhetit komunal, është bërë për shkak se komuna gjatë vitit 2008 -10, ka larguar punëtorë nga shërbimi civil pa përfillur procedurat ligjore si dhe për shkak se nuk iu ka përmbytur kontratat të nënshkruara me operatorë të ndryshëm ekonomik që kanë kryer shërbime për komunën. Këto mjete janë shpenzuar nga kodi i të hyrave vetanake, mjete këto shumë të nevojshme për ndarje të subvencioneve për studentë apo për skamnorë.

Kuvendi Komunal për gjatë gjithë mandatit nuk funksionalizon komitetet jo obligative

Kuvendi Komunal përgjatë gjithë mandatit katër vjeçar nuk ka arrit të funksionalizojë komitetet jo obligative. Këto komitete edhe pse në përbërjen e tyre kishin edhe anëtarë nga shoqëria civile, për shkak të neglizhencës së kryetarëve dhe anëtarëve të tyre nuk arritën që të kryejnë funksionin për çka ishin thirrur dhe për katër vite ishin jashtë funksionit.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Zhvillimi ekonomik dhe zbutja e papunësisë	Ndërtimi i objekteve të shkollave fillore në fshatin Pozheran dhe Beguncë	Organizimi i takimeve të rregullta me shoqërinë civile dhe qytetarë në lokalitete të komunës
2	Ngritja e cilësisë në arsim	Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në Pozheran	Transparencë të plot për mediat
3	Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore	Ndërtimi i palestrës sportive në Viti	Rritja e niveli të bashkëpunimit kryetar – kuvend komunal
4	Rritja e subvencioneve në bujqësi në shumën deri në 500 mijë euro	Ndërtimi i fushave të vogla sportive në shumicën e fshatrave	Zbatim të ligjit dhe rregulloreve për raportim në Kuvendin Komunal dhe para qytetarëve
5	Përkrahja e aktiviteteve kulturore e sportive	Rregullimi i sistemit të ujësjellësit në Viti	Fuqizimi i rolit të gruas dhe rinisë

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

Kryetari i komunës për përmirësimin e gjendjes në komunë duhet të marr parasysh këto rekomandime:

- Rritja e cilësisë së projekteve të infrastrukturës – Kontroll më i shtuar mbi zyrën e prokurimit publik, pastaj angazhimi i një kompanie të specializuar për mbikëqyrje të projekteve si dhe përfshirja e përfaqësuesve nga komuniteti dhe shoqëria civile në komisionet vlerësuese dhe mbikëqyrëse të projekteve.
- Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi – Realizimi i projektit për ndërtimin e objektit të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Pozheran si dhe funksionalizimi i punkteve shëndetësore nëpër fshatra ku do të ofroheshin shërbime si kontrolli mjekësorë ashtu edhe asistencë teknike. Funksionalizimi i repartit të gjinekologjisë me staf profesional.
- Furnizimi me ujë të pijes – Riparimi i gypave të ujësllësit në Viti dhe Letnicë si dhe shtimi i kapaciteteve prurëse të ujit nga burimi në fabrikën për përpunim të ujit. Përfundimi i projekteve që kanë të bëjnë me rregullimin e rrjetit të ujësllësit në fshatrat Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Poshtme, Sadovinë e Çerkezëve, Sadovinë e Jerlive, Gërmovë, Goshicë e Tërstenik si dhe realizimi i projekteve të reja në Smirë, Vërban etj. Nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë rajonale të ujërave “Hidromorava”, që ajo të marr përsipër mbikëqyrjen e rrjeteve të ujësllësit të instaluar nëpër fshatra.
- Përmirësimi i cilësisë në arsim - Realizimi i projektit për shkolla të reja në Pozheran e Beguncë. Transferimi i kompetencave në shkolla që ato vetë të menaxhojnë buxhetin që dedikohet për shkolla. Hapja e drejtimeve të reja profesionale në bazë të nevojave të tregut të punës. Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë apo ndërmarrjet private për mësim praktik të nxënësve që ndjekin drejtimit profesional. Vendosja e një disipline në mësimdhënie dhe mësim - nxënie. Përmirësimi i raporteve në trekëndëshin shkollë-nxënës- prind.
- Përmirësimi i situatës në ruajtjen e ambientit dhe grumbullimit të mbeturinave – Përfundimi i procedurave për formimin e ndërmarrjes publike për menaxhim të mbeturinave. Zbatimi i planit komunal për menaxhim të mbeturinave të hartuar nga projekti LOGOS. Hapja e deponive për grumbullim të mbeturinave të ngurta ashtu siç parasheh plani zhvillimor komunal. Fuqizim i rolit të inspeksionit për ambient.
- Zbatimi i ligjshmërisë në komunë – Fuqizimi i zyrës ligjore dhe konsultimi i vazhdueshëm i kësaj zyre me rastin e aprovimit të vendimeve nga zyra e kryetarit apo Kuvendi Komunal, si dhe ngritja e nivelit të bashkëpunimit me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, për një qeverisje efektive.
- Rritja e nivelit të bashkëpunimi me Kuvendit Komunal – Kryetari i komunës në bashkëpunim me kryesinë e kuvendit komunal duhet të përgatisë agjendën e punës së kuvendit komunal. Kryetari i komunës ashtu siç parasheh ligji për vetëqeverisje lokale, duhet të raportojë rregullisht para kuvendit komunal. Kryetari të gjitha vendimet duhet t'i kalojë përmes kuvendit komunal.
- Rritja e nivelit të transparencë dhe konsultimeve me qytetar – Kryetari i komunës duhet të caktojë një ditë në javë për punë me qytetarë. Kryetari duhet të përgatitë një orar të rregullt të takimeve me qytetarë nëpër lokalitete. Kryetari duhet që të

raportojë në baza gjashtë mujore para qytetarëve për punën e komunës. Kryetari në bashkëpunim me drejtorinë për financa dhe zyrën e informimit publik, duhet që të përgatisë planin e veprimit për planifikimin e buxhetit me pjesëmarrje të qytetarëve.

- Funkcionalizimi i Këshillit Komunal në Bashkësi – KKSBB si mekanizëm konsultativ për siguri në bashkësi që udhëhiqet nga vetë kryetari i komunës, duhet të hartoi planin vjetor të veprimit, ku në detale do të planifikoheshin aktivitetet e këtij këshilli.
- Mbështetja e iniciativave për funksionimin më të mirë të Këshillave Lokale – Kryetari i komunës ashtu siç parasheh edhe rregullorja komunale për emërimin dhe funksionin e këshillave lokale, duhet të mbajë kontakte të rregullta me kryetarët e këshillave lokale. Kryetari i komunës, duhet t`iu siguroi kushte për punë këshillave lokale. Kryetari i komunës para çdo iniciative në komunitet duhet të konsultoi përfaqësuesit e zgjedhur të këshillave lokale.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Të përmirësuar situatën në aspektin e urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit në komunë në të ardhmen duhet të ndërmerret këto masa:
- Të zhvilloi një fushatë informuese dhe vetë-dijësuese për qytetarë rreth planeve urbane,
- Të gjitha tabelat për shpallje publike të vendosë njoftimet e nevojshme për planet urbane si dhe kriteret për nxjerrjen e lejeve urbane dhe atyre për ndërtim,
- Të bashkërendoi aktivitetet me të gjithë mekanizmat institucional, përfshirë këtu zyrën e kryetarit të komunës, kuvendin komunal, drejtorinë komunale, policinë dhe gjykatat për të parandaluar dukurinë e ndërtimeve pa leje dhe për mbrojtje të ambientit
- Krijimi i kushteve teknike (staf, vetura, pajisje etj) nga zyra e kryetarit të komunës që inspeksioni komunal të jetë më aktiv në terren që të evidentojnë dhe ndalojnë ndërtimet pa leje dhe ndotjen e ambientit
- Objektet që janë ndërtuar pa leje komuna mos t`iu lejoj që të kyçen në rrjetin elektrik apo në sisteme të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Komuna nuk duhet t`i regjistrojë objektet e ndërtuara pa leje në tatimin në pronë,
- Komuna përmes përfaqësuesit të saj në bordin e ndërmarrjes publike për mbeturina “Eco-higjiena”, duhet të bëjë më shumë trysni që kjo kompani të ushtroi veprimtarinë e saj ashtu siç parashihet me marrëveshje mes komunës dhe kompanisë.

Drejtorisë së Financave

- Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatim dhe transparencë në buxhetin komunal, duhet të marr këto masa:
- DFE në të ardhmen duhet që të vendosë një kontroll më të shtuar për një disiplinë më të madhe financiare, sidomos tek kodet buxhetore që kanë të bëjnë me shpenzimet për dreka zyrtare, derivate dhe mirëmbajtje të veturave zyrtare dhe në furnizimet për zyre.
- DFE në planin e punës së saj duhet të përfshijë të gjitha rekomandimet që dalin nga auditori gjeneral për menaxhim financiar, sidomos ato rekomandime që kanë

të bëjnë me përfshirjen e pagesave të palëve të treta, sistemin e faturimit, bilancin e gjendjes etj.

- DFE në planin e veprimit për planifikimin e buxhetit komunal, duhet të planifikoi aktivitetet që kanë të bëjnë me organizimin e takimeve nëpër fshatra, takime me shoqërinë civile, grupet e interesit (fermerë, klube sportive, biznese etj), emisione në media, përgatitjen dhe shpërndarjen e posterëve dhe broshurave me shënime për buxhetin,
- DFE në bashkëpunim me zyrën e kryetarit dhe drejtoritë komunale si dhe me shoqërinë civile, duhet të hartoi një strategji zhvillimore afat shkurtër dhe afat mesëm të komunës e cila bazohet në planin zhvillimor komunal.

Kryesuesit të Kuvendit

- Kryesuesi i Kuvendit Komunal, për menaxhim të seancave të Kuvendit Komunal dhe funksionalizim të komiteteve, duhet tu përmbahet këtyre rekomandimeve:
- Kryesuesi i Kuvendit Komunal, gjatë menaxhimit të seancave të Kuvendit Komunal, duhet të respektojë në përpikëri rregulloren e punës së Kuvendit Komunal, dhe duhet të marr masën që parasheh ndaljen e mëditjes për këshilltarët komunal që vonohen apo lëshojnë seancat para kohe.
- Kryesuesi i KK-së, duhet që të insistoi në formimin, funksionimin dhe krijimin e kushteve për punë të komiteteve obligative dhe komiteteve tjera të Kuvendit komunal.
- Kryesuesi i KK-së duhet që të jetë i hapur ndaj kërkesave për formimin e komiteteve konsultative dhe që këtyre komiteteve t`iu siguroi kushte për punë.
- Kryesuesi i KK-së, duhet të shpërndajë planin vjetor të punës së Kuvendit Komunal me të gjitha komitetet e kuvendit komunal dhe komitetet konsultative.
- Kryesuesi i KK-së, para nxjerrjes për shqyrtim të vendimeve apo rregullore të ndryshme duhet të marr mendimin me shkrim nga komiteti përkatës apo nga komiteti konsultativ.
- Kryesuesi i KK-së, duhet tu sigurojë kushte për pjesëmarrje në seanca të qytetarëve dhe OJQ-ve, duke iu mundësuar edhe qasjen në materialet e Kuvendit komunal dhe komiteteve.

Asamblistëve të Kuvendit

- Këshilltarët e Kuvendit Komunal, për punë më efektive në seancat e KK-së dhe komiteteve duhet t`iu përmbahen këtyre rekomandimeve
- Këshilltarët komunal në çdo seancë të KK-së me vete duhet të kenë statutin e komunës dhe rregulloren e punës së KK-së, dhe duhet t`i konsultojnë këto akte si gjatë procesit të diskutimeve ashtu edhe me rastin e votimit,
- Këshilltarët komunal para seancave duhet ta shqyrtojnë materialin e punës së KK-së apo komiteteve dhe diskutimet t`i fokusojnë në pikat e rendit të ditës e jo në tema tjera të pa rëndësishme.
- Këshilltarët komunal mund ta shfrytëzojnë mundësinë për të ngritur çështje në KK apo komitete në fillim të seancave apo mbledhjeve.
- Këshilltarët komunal duhet të krijojnë një raport bashkëpunimi me shoqërinë civile, duke iu përgjigjur kërkesave të OJQ-ve që të jenë pjesë e debateve apo aktiviteteve tjera që organizohen nga shoqëria civile, pasi kjo u mundëson që të njohin më mirë nevojat dhe problemet në komunitet

Viti - Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja


Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	9	28	80.80 %	32.30 %
Janar	0	0	0	0
Shkurt	1	2	92 %	33 %
Mars	2	3	80 %	33 %
Prill	1	3	89 %	37 %
Maj	1	4	96 %	40 %
Qershor	1	4	89 %	33 %
Korrik	1	3	92 %	37 %
Gusht	1	4	81 %	33 %
Shtator	1	4	93 %	37 %
Tetor	1	1	96 %	40 %
Nëntor	0	0	/0	/0
Dhjetor	0	0	/0	/0
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	7	23	74.30 %	20 %
Janar	0	0	0	0
Shkurt	1	6	90 %	20 %
Mars	0	0	0	0
Prill	1	2	80 %	20 %
Maj	1	2	90 %	20 %
Qershor	1	2	90 %	20 %
Korrik	2	8	80 %	20 %
Gusht	0	0	0	0
Shtator	1	3	90 %	20 %
Tetor	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli i Sigurisë në Bashkësi	4		PO	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	14		37 persona	

Rregulloret dhe Vendimet e Kuvendit Komunal

Dokumenti	Statusi	Votimi
Pasqyrat financiare të Buxhetit Komunal dhe Bilanci i gjendjes,për periudhën Janar-Dhjetor 2012	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për formimin e Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punën në zgjedhjen e këshillave lokale	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0
Raporti vjetor i punës së Kryetarit të Komunës ,për periudhën Janar-Dhjetor 2012	Shyrtuar	Nuk pati votim
Vendimi për bartjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake	Aprovuar	Pro: 22 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për themelimin e ndërmarrjes publike komunale	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për ndarjen e banesave me programet veçanta të banimit	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën janar – mars 2013	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për shpallje zonë me interes të përgjithshëm të ngastrave kadastrale me numër 1467 – 3 , 1468-0 dhe 1055-3 në zonën kadastrale në Pozheran	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja për barazi gjinore	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për shfuqizimin e vendimit , bartje e të drejtës së shfrytëzimit të paluejtshmërisë (tokë) në pronësi shoqërore pronë e komunës së Vitisë në shfrytëzuesin e përkohshëm Bashkësia Islame –Viti, për çerdhe të fëmijëve në fshatin Drobesh	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e Komunës së Vitisë	Aprovuar	Pro: 18 Kundër: 2 Abs: 0
Vendimi për rishikimin e buxhetit gjashtë mujor për vitin 2013	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 1 Abs: 0
Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e monumentit përkujtimor për dëshmorin Florim Maliqi në ngastraën kadastrale 248 -0, zona e kadastrave Sadovinë e Qerkezëve	Aprovuar	Pro: 18 Kundër: 0 Abs: 0
Raporti gjashtë mujor i kryetarit të Komunës së Vitisë	Shyrtuar	Nuk pati votim
Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar – qershor 2013	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abs: 0
Raporti i punës së Këshillit Komunal për parandalimin e dukurive negative në Komunën e Vitisë	Shyrtuar	Nuk pati votim
Raporti i auditorit mbi pasqyrat financiare të Komunës së Vitisë për vitin 2012	Shyrtuar	Nuk pati votim
Raporti i Inspektimit për tatimin në pronë në Komunën e Vitisë për vitin 2012	Shyrtuar	Nuk pati votim


Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik të planit rregullues për zonën veriori të qytetit të Vitisë	Aprovuar	Pro: 19 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për aplikimin e kritereve për prioritetizimin e investimeve kapitale në komunat partnere	Aprovuar	Pro: 20 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për Buxhetin 2014 -2016	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoha 2014	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja për tatimin e pronës së paluajtshme 2014	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për ndarjen e një lokacioni për strehim të qenve endacak në fshatin Binçë	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimi për planin rregullues urban për Zonën Veriore të qytetit të Vitisë	Aprovuar	Pro: 26 Kundër: 0 Abs: 0

Raporti Monitorimit 2013




Komuna Malishevë

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



11. Komuna MALISHEVË

Problemet kryesore të komunës

Edhe komuna e Malishevës, si edhe shumë komuna tjera në Republikën e Kosovës, është përballur me sfida dhe probleme të ndryshme, ku ndër më kryesoret mund të veçohen:

- Problemet me rriqra (pickimi i rriqrave) – Vetëm në vitin 2013 në komunën e Malishevës kanë vdekur nëntë (9) persona nga pickimi i rriqrave. Vlen të theksohet se Malisheva është shpallë nga Instituti i Shëndetit Publik si zonë endemike e shkallës së lartë nga pickimi i rriqrave, të cilët janë shkaktarët kryesorë të përhapjes së infektiveve me sëmundjen e etheve hemorragjike.
- Mungesa e ujit të pijes në disa fshatra - Edhe pse janë marrë disa masa nga ana e komunës për zbutjen e problemit të ujit të pijes, Malisheva si dhe disa fshatra përreth saj ende vazhdojnë të përballen me këtë problem. Shumë fshatarë janë të detyruar të bëjnë zgjidhje individuale në hapjen e puseve, punë kjo që është mjaftë e kushtueshme për standardin e banorëve të kësaj komune.
- Mungesa e ndriçimit publik – Përveç dy apo tri rrugëve të cilat kanë ndriçim, rrugët tjera nuk janë të përfshira në sistemin e ndriçimit publik.
- Mungesa e çerdhes publike – Pothuajse nga të gjitha qeveritë e dala që nga pas lufta në komunën e Malishevës, nuk e kanë parë të udhës që të marrin masa në ndërtimin e asnjë çerdheje publike. Vlen të ceket se për këtë çështje disa herë ka pas edhe reagim të qytetarëve, e po ashtu edhe nga ana e asambleistëve.
- Mungesa e kanalizimit në disa vendbanime - problem ky i cili është shumë i theksuar sidomos në fshatrat e Malishevës, ku një numër i konsiderueshëm i tyre ende vazhdojnë të përballen me mungesë kanalizimi.

Të arriturat në vitin e kaluar

Një çështje tepër e rëndësishme që ka ndodhur gjatë vitit të kaluar në komunën e Malishevës ka qenë përrurimi i nënstacionit të pompimit të ujit në fshatin Carrallukë, nënstacion ky i cili do të bëjë zgjidhjen e problemit të ujit të pijes për këtë fshat si dhe një pjese të qytezës së Malishevës, investim ky i bërë në bashkëpunim në mes të komunës së Malishevës dhe “Hidroregjionit Jugorë”, vlera e së cilës kap shumën e 30 mijë eurove.

Edhe përkundër investimeve të tjera të domosdoshme që duhet të bëhen në të ardhmen në përmirësimin e kushteve në Arsim, në vitin e kaluar ne mund të konsiderojmë se po ashtu ka pasur edhe disa përpjekje në rregullimin e infrastrukturës së arsimit, si në ndërtimin dhe riparimin e disa shkollave, projekte këto që do të ndikojnë në dobi të mbarëvajtjes së procesit mësimor më kualitativ.

Po ashtu arritja e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes të Komunës së Malishevës dhe Organizatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për renovim dhe pajisje të Qendrës Rinore në Malishevë, investimi ky i cili do të ndikojë në fuqizimin dhe zhvillimin e rinisë së kësaj komune.

Vlerësimi për performancë

Kryetari- Kryetari i Komunës së Malishevës, përgjatë këtij viti ka qenë i angazhuar mesatarisht, bazuar edhe në anketa të qytetarëve, ku më sfiduese ka qenë fakti se ai nuk është ballafaquar për së afërmi me problemet që kanë pasur qytetarët. Ai më tepër e ka

ndjekur agjendën zyrtare, ku përveç takimeve të tij të caktuara javore me disa qytetarë nuk ka zhvilluar takime për së afërmi me ta, kur dihet se komuna e Malishevës përbëhet prej rreth 45 fshatrave.

Drejtoritë – Krahasuar me drejtoritë tjera në komunën e Malishevës, performancë më të kënaqshme kanë treguar drejtoria e Administratës, sidomos në lidhje me vendimin për zgjatjen e orarit të punës për shërbimin në ofiqari për marrjen e dokumenteve të kërkuara, në veçanti mërgimtarët, si dhe ajo e Shëndetësisë sidomos në ballafaqim me problemin e etheve hemorragjike.

Këshilltarët Komunal – Marrë në përgjithësi pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të komunës së Malishevës në lidhje me pikat e rendit të ditës ka qenë nën trendin mesatar, e më shqetësuese tek kjo çështje ka qenë niveli i ulët i debatit dhe diskutimeve, mos-përgatitja adekuate e asambleistëve me materialet apo dokumentet e ndryshme për pikat e rendit të ditës, marrja e fjalës në shumë raste vetëm nga shefat e grupeve parlamentare dhe mos shfrytëzimi i mundësisë për debat edhe nga asambleistët tjerë e sidomos atyre femra. Po ashtu, sipas fletënotimit të KDI-së për gjysmën e parë të vitit 2013, 3 nga 31 anëtarët e Kuvendit të Komunës së Malishevës asnjëherë nuk kanë diskutuar në foltoren e Kuvendit.

Kryesuesin e Kuvendit – Kryesuesi i Kuvendit të komunës së Malishevës është treguar mjaftë parimor dhe tolerant, i cili ka bërë një punë që është për tu vlerësuar, mirëpo toleranca e tij në disa raste është keqkuptuar dhe keqpërdorë nga asambleistët caktuar të cilët edhe kanë bërë që punimet e mbledhjes të pengohen, stërzgjatjen dhe të devijohet nga rendi i ditës dhe të ketë vonesa në fillim të seancave. Po ashtu, gjatë vitit 2013 në disa raste thirrja për mbledhje të asamblesë është bërë jashtë rregullores së Kuvendit si dhe në kundërshtim me Ligjin për Qeverisje Lokale.

Transparenca në Komunë

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ 2008/9, komuna e Malishevës që nga mesi i vitit 2010 e ka të miratuar rregulloren për transparencë, rregullore kjo e cila mjaft qartë e parasheh se si duhet të veprohet. Transparenca në komunën e Malishevës ende vazhdon të jetë në nivel jo të kënaqshëm, që manifestohet me mos informim të dëshiruar karshi qytetarëve, mos përfshirja e duhur e qytetarëve në vendimmarrje si dhe mungesa e dialogut të mirëfilltë me ta nga ana e komunës së Malishevës sidomos për çështjet që i atakon drejtpërdrejt ata.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), si monitorues i kësaj komune ka pas raste kur është përballur me disa vonesa sa i përket kthimit të përgjigjeve për qasje në dokumente publike, siç janë raportet e disa drejtorive apo edhe dokumente tjera të rëndësishme. Mirëpo, edhe pse për ne si OJQ ka qenë më e lehtë për t'u qasur këtyre dokumente, e njëjta gjë nuk ka vlejtur edhe për qytetarët e thjeshtë, të cilët e kanë pasur mjaft të vështirë për të pasur qasje në dokumente, qoftë edhe në interesimin e tyre për projekte që janë bërë në komunitetin ku ata jetojnë.

Të qenit i informuar rreth projekteve komunale ndihmon qytetarët që të identifikohen dhe të lidhen me komunitetin, prandaj shpërndarja e informatave tek qytetarët në komunën e Malishevës përgjatë kësaj periudhe ka vazhduar të jetë e njëjtë. Mos azhurnimi dhe freskimi i ueb-faqes zyrtare së komunës është mjaft shqetësues sa i përket transparencës së komunës karshi qytetarëve. Mungesa e raporteve të pothuaj shumicës dërrmuese të drejtorive,



mungesa e procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë, mos transmetimi i drejtpërdrejt i mbledhjes në ndonjë medium lokal apo edhe regjional, informacionet për projektet kapitale janë vetëm disa nga mangësitë sa i përket mirëmbajtjes dhe pasurimit me informacione të ueb-faqes zyrtare të komunës.

Llogaridhënia në Komunë

Raportimi i Kryetarit dhe Drejtorëve

Raportimi i kryetarit të komunës së Malishevës para qytetarëve, shoqërisë civile dhe medie, qoftë ato lokale apo qendrore ka qenë tepër i mangët, ose nuk ka ekzistuar fare. Po ashtu, një mos-përgjegjshmëri apo mos-llogaridhënie është treguar edhe nga ane e drejtorive komunale në Asamble, ku në përjashtim të dy apo tri drejtorive, siç janë Drejtoria e Shëndetësisë, Ekonomisë dhe Financave, drejtori tjera të caktuara edhe pse me presion të Asamblesë kanë paraqitur ndonjë raport ai ka qenë tepër i mangët dhe tejet sipërfaqësor, ndërsa një numër i konsiderueshëm i drejtorive asnjëherë nuk kanë raportuar para Asamblesë si organi më i lartë i qeverisjes lokale, duke pasur parasysh që ekzekutivi i Malishevës udhëhiqet nga gjithsej 11 drejtori komunale, prandaj kjo ka pamundësuar që brengat dhe problemet e qytetarëve nëpërmjet të zgjedhurve të tyre të adresoheshin aty ku duhet, dhe ku do të mund të shqyrtoheshin.

Ajo çka vlen të ceket është kërkesa disa mujore e asambleistëve të opozitës, të cilët disa herë kanë kërkuar nga Drejtoria Komunale e Arsimit që të ketë një raport të detajuar në lidhje me përfundimin e vitit shkollor 2012/2013, dhe fillimin e vitit shkollor 2013/2014, sidomos në lidhje me konkursin e fundit për mësimdhënës, konkurs ky i cili kishte ndikime politike në përzgjedhje të mësimdhënësve, por që ky raport asnjëherë nuk u paraqit para asamblesë.

Sa i përket raportimeve të rregullta, Kryetari i Komunës së Malishevës gjatë vitit 2013, para Asamblesë komunale ka raportuar vetëm një herë në seancën e rregullt të datës 25.04.2013, i cili ka paraqitur raportin e punës së tij dhe qeverisë komunale për vitin e kaluar 2012, raport ky i cili për nga përmbajtja nuk ka ndryshuar edhe aq nga vitet e kaluara. Gjatë shqyrtimit të këtij raporti për vitin e kaluar 2012, Kryetari i komunës së Malishevës z. Isni Kilaj, në lidhje me interesimin e asambleistëve, ka deklaruar se komuna e Malishevës është një ndër komunat e vetme që ka menaxhuar mirë paratë publike dhe nuk ka trashëguar as edhe 1 euro borxh. Ndërsa në Raportin e Auditimit nga zyra e Auditorit të Përgjithshëm, i dalë në korrik të vitit 2013 figuron se në komunën e Malishevës, pasqyra e faturave (obligimeve) të pa paguara të organizatës buxhetore për vitin 2012 është 160 mijë e 828 euro.

Ndërsa kur bëhet fjalë për takimet publike të Kryetarit të Komunës me qytetarë, në Rregulloren për Transparencë të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës në dhjetor të vitit 2010 në nenin 7, pika 1, thuhet qartë se Kryetari i Komunës, duhet të mbajë të paktën dy tubime publike me qytetarë (brenda vitit) për çështje të interesit të përgjithshëm e që lidhen drejtpërsëdrejti me publikun siç janë, përdorimi i buxhetit komunal, zhvillimi ekonomik, përdorimin e pronës, planifikim hapësinor, investimet, të hyrat komunale etj. Ndërsa në nenin 7, pika 4 po ashtu mjaft e rëndësishëm në lidhje me këtë temë ceket qartë se: pjesëmarrës duhet të jenë udhëheqësit kryesorë të komunës që nënkupton prezencën e Kryetarit dhe të gjitha drejtorive.

Kryetari i komunës së Malishevës kishte aplikuar një metodë të takimeve me qytetarë, ai kishte zgjedhur ditën e enjte si ditë ku për dy orë rresht, qytetarët mund të trajtonin problemet e tyre, mirëpo ky lloj i takimit ishte kundërshtuar nga shumë qytetarë të cilët ankoheshin se për të takuar Kryetarin ose duhet ta njohësh atë ose duhet të gjendet ndonjë

lidhje sepse përndryshe nuk ke mundësi ta takosh atë. Nga takimi publik i Kryetarit me qytetarët e Komunës së Malishevës, i cili ishte paraparë të mbahet me datën 27 qershor 2013, duke filluar në ora 10:00, por që kishte dështuar të mbahet për shkak të mos pjesëmarrjes së qytetarëve, mirëpo ajo që binte në sy ishte se në sallën që ishte paralajmëruar të mbahet takimi me qytetarët, mungonte i tërë ekzekutivi si dhe vet Kryetari i komunës, i cili diku rreth 1 orë pas takimit të paraparë u paraqit në objektin e komunës, andaj kjo situatë lë për të kuptuar se mungesa e dialogut të mirëfilltë me qytetarët e komunës është një çështje tepër serioze dhe që duhet të rishikohen mundësitë e përmirësimit të kësaj gjendje.

Ndërsa është mbajtur një dëgjim tjetër publik i organizuar nga drejtoria për Ekonomi dhe Financa , e i cili është karakterizuar me një numër tejet të ulët të qytetarëve. Po ashtu edhe aktivitetet e asambleistëve lidhur me takimet me qytetarët nuk kanë qenë në nivel të dëshiruar, andaj disa nga ta nuk iu kanë përmbajtur premtimeve se në rast të fitores së tyre gjatë mandatit 2009-2013, ata në Asamble dhe jashtë saj do t'i përfaqësonin dhe mbronin interesat e tyre, por kjo nuk u dëshmuar nga të gjithë duke pasur parasysh se në disa raste këta të fundit kishin marrë edhe vendime që nuk përfaqësonin interesat e qytetarëve.

Vlen të ceket se qasja ndaj qytetarëve të komunës së Malishevës, si nga ana e Kryetarit të komunës, asamblistëve, udhëheqësve të partive politike në përgjithësi kishte ndërruar dhe ishte më e ngrohtë me fillimin e fushatës elektorale 2013, qasje kjo që dallonte në mënyrën se si ata premtorin për mandatin e ri të radhës.

Urbanizmi në Komunë

Përmes një kërkesë zyrtare, monitoruesit e KDI-së kanë kërkuar nga organet gjegjëse komunale që të mundësohet qasja në dokumentet publike përkatësisht në draft-Planin Zhvillimor Komunal në komunën e Malishevës, mirëpo përgjigjja që është marrë nga komuna e Malishevës njofton që grupi i cili është duke punuar në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, ende nuk e ka dorëzuar draftin e këtij plani. Edhe pse më herët po nga drejtoria e Urbanizmit, është thënë që ky plan është dashur të përfundoj deri në fund të vitit 2013 dhe të miratohet nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës.

Në mungesë të Planit Zhvillimor Komunal, Komuna e Malishevës ka vepruar me Planin Zhvillimor Urban dhjetë vjeçar (2004-2014) plan ky që ka determinuar vetëm zhvillimin e qytezës së Malishevës. Mirëpo ekzekutivi komunal nuk ka arritur të hartojë më shumë se tri Plane Rregullative të qytezës së Malishevës, plane këto që në vija ekzakte determinojnë urbanizmin e këtij qyteti dhe mungesa e tyre ka rezultuar në ndërtime tejet të egra.

Komuna e Malishevës, respektivisht Drejtoria për Urbanizëm gjatë vitit 2013, ka pranuar gjithsejtë 55 kërkesa nga qytetarë dhe subjekte të ndryshme në këtë komunë, siç janë kërkesa për leje ndërtimore, ekspertizë-incizim, pranime teknike, shikim tereni, eliminim defekti kabllor etj, ndërsa janë dhënë (aprovuar) vetëm pesë leje ndërtimore.

Financat në Komunë

Komuna e Malishevës për vitin kalendarik 2013, ka miratuar një buxhet prej 10.2 milion eurove i cili ka pësuar një ngritje të lehtë në krahasim me vitet paraprake. Kur bëhet një krahasim për këtë periudhë të shkuar kohore buxheti i kësaj komune ka pësuar një ngritje prej rreth 2 milion e 500 mijë euro.

Komuna e Malishevës, edhe pse me vonesë në disa raste, në vazhdimësi para Kuvendit ka shqyrtuar raportet tre mujore financiare, raporte këto të cilat kanë marrë vërejtje të shumta, sidomos në kategorinë e shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime, konkretisht në shërbimet e udhëtimit brenda dhe jashtë vendit, shpenzimet telefonike, dreka zyrtare, e po ashtu shpenzime të mëdha dhe tepër brengosëse të kjo kategori ende vazhdojnë të jenë

shpenzimet e karburantit për vetura. Po ashtu është vërejtur se në këto raporte ka një mungesë të transparencës edhe sa i përket kategorisë buxhetore tek Investimet Kapitale, ku në të shumtën e rasteve mungojnë informacionet më të rëndësishme dhe përshkrimi i projekteve bëhet në tërësi, si ndërtimi i rrugëve, ndërtesat, trotuaret etj, dhe nuk specifikohet se sa rrugë ose cilat rrugë janë ndërtuar.

Po ashtu, vlen të ceket se Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për komunën e Malishevës për vitin 2012 ka adresuar një numër të konsideruar të gjetjeve, ku për secilën prej tyre ka dhënë edhe rekomandimet e tija se si duhet të veprohet në të ardhmen, në ato fusha ku ka pasur më së shumti ngecje.

Miratimi i Planit të Veprimit Rinor Lokal

Një çështje mjaft inkurajuese që ka ndodhur gjatë kësaj legjislature ka qenë miratimi i kërkesës së Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për miratimin e Planit të Veprimit Rinor Lokal, plan ky i cili është bazuar në strategjinë e Ministrisë së Kulturës e që do të ketë ndikim në angazhimin e rinisë në vendimmarrje dhe në aktivitete të tjera që i parasheh ky plan.

Vendimi për vazhdimin e ndarjes së Mjeteve financiare për disa raste sociale, si dhe familje me nevoja të ndryshme

Çështje sa e rëndësishme aq dhe mjaft humane mund të konsiderohet vendimi për vazhdimin e ndarjes së mjeteve financiare në emër të katër familjeve të Dëshmorëve në Komunën e Malishevës, të rënë jashtë kufijve të Republikës së Kosovës. Me këtë vendim do të mundësohet që familjeve të Dëshmorëve tu ndahen mjete financiare në shumën prej 350 euro në muaj për periudhën 1 vjeçare, deri në dhjetor të vitit 2013, deri sa të bëhet një zgjidhje përfundimtare për këtë kategori nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Po ashtu, nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës janë përkrahur edhe një numër i konsiderueshëm i qytetarëve të cilët kanë pasur nevoja të ndryshme, si sëmundje të rënda apo edhe ato me probleme sociale.

Vendimi për caktimin e mbeturinave Inerte

Si çështje mjaft inkurajuese që vlen të theksohet për komunën e Malishevës gjatë kësaj ka qenë edhe vendimi i Kuvendit të Komunës për caktimin e Deponisë së mbeturinave inerte, në ish-lokacionin e shfrytëzuar nga Miniera e Boksitëve në mes të fshatrave Panorc dhe Llapçevë, komuna e Malishevës.

Prandaj kjo do të ndikojë drejt-për-drejt që të ketë një ambient më të pastër pasi këto mbetje janë hedhur përgjatë rrugëve magjistrale, dhe do të evitohet rrezikun që nga kjo gropë e krijuar nga dora e njeriut që ka nxjerrë minerale të boksitit dhe ka pas mundësi reale që të pësojnë fëmijët për arsye të ruajtjes së bagëtive në atë vend.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Përmirësim të arsimit	Projekti i ujësjellësit për fshatin e Drenocit, Projekti ideor faza e parë.	Kryetari më popullor që ka pas ndonjëherë kjo komunë
2	Infrastrukturë rrugore dhe përcjellëse	Shkolla Fillore në Gurishtë, në Damanek, Carrallukë, Bubavec dhe Gullobovcit	Mbizotërimi i transparencës dhe llogaridhënies në qeverisje
3	Investim në bujqësi	Akumulacioni i ujërave të shpella e Panorcit (2015-2016).	Bashkëqeverisje me qytetarët
4	Parandalim e rriqrave, marrja e masave me kohë	Kolektori i ujërave të zeza, Faza e IV, viti 2015	
5	Dyfishimi i buxhetit për sport, mbështetja për klubet e sportit, sidomos sportistët që garojnë jashtë vendit	Ndërtimi i fushës së sportit në fshatin Banjë, viti 2015	
6	150 mijë euro bursa studentore në 2014		

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Spërkatja e zonave më problematike për përhapjen e rriqrave duhet të bëhet me kohë dhe të mos jetë selektive, si dhe të gjenden format më të mira për luftimin e këtij virusi vdekjeprurës;
- Të merren seriozisht me mungesën e ujit të pijes në disa fshatra të komunës së Malishevës, dhe që në vitin e parë të mandatit, t'i shikojnë mundësitë buxhetore, apo gjetjen e ndonjë donacioni;
- Të mos lejohet hedhja e mbeturinave në deponi ilegale, sidomos tash kur me vendim të Kuvendit është caktuar edhe vendi për hedhjen e mbeturinave inerte. Edhe inspektorët komunal të jenë më aktiv dhe të trajtojnë si duhet këtë problem;
- Të jetë më i kujdesshëm në menaxhimin dhe shpenzimin e parasë publike, të shërbej si shembull se si të shpenzohet paraja publike e jo të ndodhë e kundërta,
- Të respektohet legjislacioni në fuqi lidhur me raportimet financiare në Kuvendin e Komunës së Malishevës;
- Të ketë një bashkëpunim më të madh me organizatat e shoqërisë civile, dhe qytetarët sidomos në vendimmarrje, dhe jo vënia e pushtetit në krah të grupeve të caktuara.
- Të jetë më i afërt dhe bashkëpunues me anëtarët e Kuvendit të Komunës në mënyrë që mos të mungoj transparenca dhe llogaridhënia;
- Të konsultohet me qytetarë dhe të marrë parasysh shqetësimet e tyre në hartimin e buxhetit dhe investimin e projekteve kapitale;
- Në bazë të udhëzimit administrativ të bëj Organizimin e Komiteteve Konsultative.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Miratohet sa më parë Plani Zhvillimor Komunal;
- Inicijë hartimin e sa më shumë Planeve Zhvillimore Urbaneve të Qendrave më të mëdha;
- Ndëshkohet mos respektimi i kritereve të ndërtimit nga institucionet përkatëse, si Drejtoria e Inspektoratit dhe organet tjera të ndjekjes.

Drejtorisë së Financave

- Transparenca më të madhe në lidhje me shpenzimin e buxhetit, sidomos te kategoria Mallra dhe Shpenzime, si dhe te Investimet Kapitale.
- Përgatiten me kohë dhe sipas afateve ligjore raportet tre mujore financiare të të hyrave dhe shpenzimeve.

Kryesuesit të Kuvendit

- Bashkëpunimi më i madh dhe forcimi i marrëdhënieve në mes të Kryesuesit të Kuvendit, opozitës si dhe OJQ-ve, sidomos atyre vendore që veprojnë në Komunën e Malishevës

- Respektohen më shumë afatet ligjore në caktimin e datës dhe afatin për caktimin e mbledhjes, si dhe të sigurohet që mos të mungoj asnjë material në lidhje me pikat e rendit të ditës,
- Bëhet urë lidhëse dhe të krijohet bashkëpunim të mirë në mes të anëtarëve të Kuvendit, kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale, sidomos kur anëtarët kërkojnë sjelljen e raporteve të ndryshme në Kuvend.

Asamblistëve të Kuvendit

- Bëjnë konsultime më të shpeshta me qytetarë, dhe të mundohen të ndikojnë në zgjidhjen e problemeve të tyre,
- Kërkohe ri-funksionalizimi i Komitetit për Arsim dhe ai për Shëndetësi;
- Jenë më aktiv gjatë pjesëmarrjes në diskutime në lidhje me pikat e rendit të ditës, si dhe në parashtrimin e pyetjeve për anëtarët e Kuvendit të Komunë së Malishevës.


Malishevë - Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	10	67	78%	90%
Janar	1	4	80 %	0.9 %
Shkurt	1	3	81 %	0.8 %
Mars	1	4	81 %	0.9 %
Prill	1	3	80 %	0.9 %
Maj	1	5	68 %	0.8 %
Qershor	2	5	70 % - 81 %	0.9 % - 0.9 %
Korrik	0	0	00 %	%
Gusht	1	4	90 %	0.9 %
Shtator	1	2	84 %	10 %
Tetor	1	1	87 %	0.9 %
Nëntor	0		%	%
Dhjetor	0		%	%
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)	7		74%	%
Janar	1	2	100 %	1 – 100 %
Shkurt	1	4	85 %	1
Mars	1	3	85 %	1
Prill	1	5	100 %	1
Maj	0	0		0
Qershor	1	5	100 %	1
Korrik	0	0		0
Gusht	1	4	85 %	1
Shtator	1	2	100 %	1
Tetor	0	0		0
Nëntor	0	0		0
Dhjetor	0	0		0
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi	3		(Po)	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	1		20 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Rregullore - Projekt Rregullorja për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoha Komunale - 2013	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 10 Abstenim: 0
Rregullore - Projekt Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme, për vitin 2014	Aprovuar	Pro: 25 Kundër: 0 Abstenim: 1
Draft-Plani i Punës së KKS-së	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 9 Abstenim: 0
Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2013	Aprovuar	Pro: 17 Kundër: 0 Abstenim: 11
Plani i veprimit rinor lokal	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 11 Abstenim: 1
Raporti vjetor i punës, i Kryetarit dhe Qeverisë Komunale për vitin 2012	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 8 Abstenim: 1
Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-mars 2013	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 10 Abstenim: 0
Raporti i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2013	Shqyrtuar	Pro: 0 Kundër: 0 Abstenim: 0
Korniza afatmesme Buxhetore 2014-2016	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 0 Abstenim: 0
Raporti i Auditorit të Pavarur të Komunës 2011	Shqyrtuar	
Raporti i Auditimit mbi pasqyrat financiare 2012	Shqyrtuar	
Raporti i planifikimit nga zyra e Prokurimit 2013	Shqyrtuar	
Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi	Aprovuar	Pro: 13 Kundër: 0 Abstenim: 10
Vendimi për vazhdimin e ndarjes së mjeteve financiare në emër të katër familjeve të Dëshmorëve të Komunës së Malishevës	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abstenim: 10
Vendimi për formimin e Komisionit për Çështjen e Sh.k.p "BENAF"	Aprovuar	Pro: 24 Kundër: 0 Abstenim: 0
Formimin e Komisionit Komunal të Aksionerëve	Aprovuar	Pro: 14 Kundër: 1 Abstenim: 10
Vendim për caktimi e deponimë së mbeturinave inerte.	Aprovuar	Pro: 17 Kundër: 0 Abstenim: 8
Vendimi për formimin e Këshillit Organizativ, për shënimin e 16 Qershorit, Ditës së Çlirimit dhe Dëshmorëve	Aprovuar	Pro: 16 Kundër: 9 Abstenim: 0
Vendimi për themelimin e Komisionit Hetimor për shkollën e mesme profesionale "Lasgush Poradeci"	Aprovuar	Pro: 27 Kundër: 0 Abstenim: 0
Vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës	Aprovuar	Pro: 13 Kundër: 8 Abstenim: 1

Raporti Monitorimit 2013




Komuna Junik

SHOQATA E INTELEKTUALËVE TË PAVARUR




ASSOCIATION OF INDEPENDENT INTELLECTUALS

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



12. Komuna e JUNIKUT

Problemet kryesore të komunës

Komuna e Junikut ka resurse të mira zhvillimore, qoftë turistike apo bujqësore. Këtë privilegj ia mundëson masivi i bjeshkëve, sikurse edhe toka e plleshme bujqësore. Kjo komunë pasi ka resurse të shumta turistike, ka pretendime të bëhet komunë turistike, duke hapur edhe qendrën rajonale për turizëm.

Problemet me të cilat përballet kjo komunë janë të natyrave të ndryshme, si:

- Pastrimi nga mbeturinat inerte dhe llojet e tjera të hedhura përgjatë rrugëve, lumenjve, hapësirave të gjelbëruara dhe hapësira të tjera, të cilat i japin imazh të keq kësaj komune.
- Ruajtja e pasurisë kombëtare, Bjeshkët e Nemuna,
- Papunësia,
- Trajtimi i ujërave të zeza,
- Mungesa e palestrës sportive,
- Tregu i gjelbër,
- Stacioni i autobusëve

Të arriturat në vitin e kaluar

Komuna e Junikut, pasi ka kaluar me sukses fazën e tranzicionit si pilot njësi komunale, ka arritur të hartojë dokumente të rëndësishme zhvillimore, siç është Vizionimi i Junikut, Plani Urban dhe Zhvillimor, Plane Rregulluese, si dhe ka instaluar një administratë në shërbim të qytetarëve të saj. Po ashtu, kjo komunë ka realizuar edhe projekte të ndryshme, si: kanalizimi i ujërave të zeza, ujësjellës, infrastrukturë rrugore, kanale të ujitjes dhe projekte të tjera që e kanë përmirësuar jetën e banorëve të këtushëm. Projekt me rëndësi të madhe zhvillimore konsiderohet projekti “Hapja e qendrës rajonale të turizmit”, projekti për ndërtimin e fabrikës për grumbullimin dhe trajtimin e frutave malore, rregullimi i një pjese të shtratit të lumit Erenik etj.

Kryetari i Komunës, Agron Kuçi, që vjen nga radhët e AAK-së, vazhdimisht është shprehur i hapur për bashkëpunim, qoftë me media apo edhe në shoqëri civile. Ai, me një buxhet të vogël të investimeve kapitale (rreth 200 mijë euro), ka arritur të realizojë projekte disa milionëshe, projekte të përkrahura nga qeveria qendrore dhe donatorë të tjerë, vendorë dhe ndërkombëtarë. Mirëpo, Kuçi, në raste ishte i ndikuar nga faktorët politikë, kryesisht nga partia e tij, gjë që ishte kritikuar nga opozita dhe qytetarët. Kryetari i Komunës, gjatë mandatit të tij, ka bërë disa herë ndërrime të drejtorëve të drejtorive, siç është rasti me drejtorin e Arsimit, të Shëndetësisë, njëkohësisht edhe ka shtuar Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik.

Si komunë e vogël, me një numër të vogël të stafit administrativ, ka bërë që kjo komunë të ketë numër më të vogël të drejtorive (shtatë sosh), që kryesisht janë drejtorë politikë, të AAK-së dhe PDK-së. Performanca e drejtorëve, është kryesisht pozitive, çka do të thotë se një pjesë e tyre ishin më aktivë, krahasuar me kolegët e tyre. Duhet përmendur se, njëri nga drejtorët e tanishëm, ishte drejtor edhe në mandatin e kaluar, kur komuna e Junikut qeverisej nga LDK-ja.

Këshilltarët komunalë si përfaqësues të qytetarëve, janë të obliguar që shqetësimet e qytetarëve t'i ngrenë në nivel diskutimi dhe të marrin vendime në interes të përgjithshëm të

banorëve të kësaj komune, në përputhje me bazën ligjore. Angazhimet e këshilltarëve ishin të nivelit të mirë, duke përjashtuar gjininë femërore, që dukej më pasive. Mirëpo, llogaridhënia e tyre ndaj qytetarëve ka munguar, kur kemi të bëjmë me takimet e drejtpërdrejta me qytetarët, me qëllim të ballafaqimit dhe marrjen me shqetësimet e tyre.

Menaxhimi i seancave të Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, bëhet nga kryesuesi i Kuvendit, sipas mandatit që i takon. Mirëpo, nga data 30 maj 2013, në mungesë të kryesuesit, ka menaxhuar këshilltari më i vjetër, i cili ka menaxhuar edhe disa nga takimet e KPF-së, përkundër asaj që ai nuk ishte anëtar i këtij komiteti. Si në seancat e Kuvendit, ashtu edhe në takimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, kishte hapësira të mjaftueshme për diskutime dhe shprehje të ideve. Nuk ka pasur raste kur kryesuesi është detyruar të ndërmarrë masa për ndërprerje të diskutimeve, sikurse që nuk kishte raste kur kryesuesi është detyruar të ndërpresë fjalën e këshilltarëve, për shkak të tejkalimit të minutazhit të paraparë. Duhet cekur edhe gjuhën e përdorur nga këshilltarët, që kryesisht ishte një gjuhë e respektit, pa ndonjë fyerje të veçantë, as ndaj kryesuesit, por as ndaj njëritjetrit. Kryesisht, akuzat ishin të drejtuara kah ekzekutivi komunal, si nga ana e opozitës, ashtu edhe pozitës, por jo ndaj kolegëve të tyre.

Transparenca në Komunë

Komuna e Junikut ka kohë që bënte lajmërimin e seancave të Kuvendit, duke shfrytëzuar faqen zyrtare dhe njoftimet publike sikurse edhe monitorin e vendosur në hyrje të komunës. Me posterët e përgatitur nga OSBE-ja, bëjnë njoftimin e qytetarëve për takimet, qofshin takime të rregullta, apo edhe për diskutime me publikun. Bashkëpunimi me media ishte në nivel, varësisht edhe nga interesimi i palës tjetër. Monitorimin e punës së komiteteve dhe seancave plenare, e bëjnë SHIP-i dhe OSBE-ja, duke pasur një qasje të duhur të gjithë anëtarët e legjislativit komunal.

Po ashtu, në seancat e Kuvendit, kohë pas kohe kishte edhe qytetarë të cilët përcjellin punimet e legjislativit të tyre. Mirëpo, Komuna e Junikut, për shumë kohë ishte pa zyrtar të informimit, çka edhe është reflektuar dukshëm në mbulimin e ngjarjeve ditore, freskimin e faqes zyrtare, si dhe, komunikimin me media. Përkundër faktit se Kuvendi ka miratuar një numër të madh të vendimeve dhe rregulloreve, vetëm një pjesë e tyre është e prezantuar në faqen zyrtare, sikurse që mungonin edhe raportet financiare.

Edhe pse, me ndërmjetësimin e OSBE-së dhe insistimin e organizatave të shoqërisë civile, janë mbajtur disa tryeza me qëllim të implementimit të udhëzimit administrativ për krijimin e komiteteve konsultative, Juniku, sikurse shumica e komunave të Kosovës, nuk ka të formuar asnjë komitet konsultativ. Në këtë komunë, vërehet edhe një aktivitet shumë i vogël i shoqërisë civile dhe grupeve të tjera shoqërore.

Komuna e Junikut është e hendikepuar për nga mbulimi medial, përkundër përpjekjeve të disa medimeve që të mbulojnë ngjarjet, ngase, shumë pak media të shkruara kanë korrespondentë të angazhuar për këtë komunë. Trajtimi i mediave nga ana e legjislativit dhe ekzekutivit komunal ishte në nivel të mirë, kishte bashkëpunim dhe trajtim të duhur.

Mungesa e interesimit të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme për qasje në dokumente zyrtare ka bërë që një numër i vogël i kërkesave të adresohen në këtë komunë.



Faqja zyrtare e Komunës së Junikut, kryesisht freskohet me aktivitetet e zhvilluara nga kreu komunal, si dhe njoftime të aktiviteteve të ndryshme komunale. Po ashtu, në faqen zyrtare janë të vendosura edhe disa nga dokumentet bazë, siç është: Statuti i Komunës, Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban, sikurse edhe disa nga strategjitë zhvillimore komunale. Mirëpo, kjo faqe nuk ishte e pasuruar në nivel të kënaqshëm, duke mos prezantuar raportin financiar, projekte dhe dokumente të tjera me interes për publikun.

Llogaridhënia në Komunë

Këshilltarët komunalë si përfaqësues të qytetarëve pasi që kanë marrë edhe besimin e tyre për përfaqësim në nivel komunal, duhet të jenë të përgjegjshëm, ndaj atyre që ua kanë dhënë besimin. Ata (këshilltarët) janë të obliguar që shqetësimet e qytetarëve t'i parashtrajnë për diskutim dhe t'i marrin vendimet e duhura në bazë të hapësirave ligjore. Gjatë seancave të Kuvendit, vërehet një angazhim më i vogël i gjinisë femërore, që shpesh lë të kuptohet se as që u interesojnë diskutimet e të tjerëve.

Është me rëndësi të ceket shfrytëzimi racional i kohës, duke mos lënë hapësirë për vonesa, as në fillimin e seancave, sikurse edhe në diskutimet e tyre. Pothuajse çdoherë seancat fillojnë me një vonesë prej 4-5 minutash, sipas kohës së paraparë.

Rregullorja për Këshillat lokale ende nuk është përgatitur, mirëpo, këtë mungesë e ka kushtëzuar edhe mungesa e buxhetit të duhur për implementim. Ndërsa në terren, nuk janë vërejtur aktivitete të këshilltarëve komunalë, me qëllim të takimit të tyre me qytetarë.

Bazuar edhe në Ligjin e vetëqeverisjes lokale dhe Statutin Komunal, kryetari i Komunës është i obliguar së paku dy herë në vit, të raportojë para qytetarëve për angazhimet e tij dhe stafit, raport që duhet prezantuar edhe me shkrim. Gjatë këtij viti, kryetari i Komunës ka raportuar për vitin paraprak, ndërsa raportimi gjashtëmuor nuk ka ndodhur, si rezultat i asaj që ky vit ishte edhe vit i zgjedhjeve lokale.

Gjatë hartimit të planit rregullues për lagjet Krasniqe dhe Bajraktar, Komuna e Junikut, përkatësisht Drejtoria për Urbanizëm ka organizuar dëgjim publik me qytetarë të këtyre lagjeve. Pjesëmarrja e qytetarëve, sipas njoftimeve të marra, ishte e kënaqshme, duke dhënë edhe kontributin e duhur, edhe me propozime konkrete.

Urbanizmi në Komunë

Komuna e Junikut, fillimisht kishte statusin, si pilot njësi, ndërsa në ndërkohë ka fituar statusin si komunë me të gjitha të drejtat. Gjatë kësaj kohe, kjo komunë, në shumë sektorë, kishte shërbime të përbashkëta dhe të ndërlidhura me Komunën e Deçanit. Së pari, Plani Zhvillimor Komunal ishte i punuar nën ombrellën e Deçanit, gjë që është dashur që ky plan të ndryshojë, bazuar në specifikat që ka Juniku. Falë përkrahjes së marrë nga donatorët, Juniku ka arritur të hartojë edhe Planin Urban, sikurse edhe disa plane rregullative, bazuar në PZHU.

Financat në Komunë

Ekzekutivi Komunal, përkatësisht Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka raportuar për shpenzimet buxhetore, qoftë të tremujorit, gjashtëmuorit apo atë vjetor. Mirëpo, reagimet e këshilltarëve të pozitës dhe opozitës, janë në atë se, ky raport është vetëm përmbledhës dhe nuk është i detajuar, çka kufizon qasjen e këshilltarëve për mënyrën e shpenzimeve. Sipas përfaqësuesve të LDK-së, mosprezantimi i raportit të shpenzimeve në mënyrë analitike, është fakti më i mirë i keqpërdorimit të parasë publike, njëkohësisht edhe i fshehjes së këtyre keqpërdorimeve. Ata, kanë kërkuar nga kryetari i Komunës që, përmes drejtorit të Buxhetit, të prezantojë raportin detal të shpenzimeve për secilën linjë buxhetore. Në seancën e fundit të Kuvendit, ku ishte debatuar edhe për projektbuxhetin e vitit 2014, është

kërkuar të bëhen plotësime dhe ndryshime në këtë projektbuxhet, që më pas, është përkrahur nga të gjithë këshilltarët komunalë të pranishëm. Duhet përmendur se në faqen zyrtare të Komunës, mungon prezantimi i raportit të shpenzimeve, sikurse që mungojnë edhe informacione të tjera që lidhen me punën e ekzekutivit dhe të legjislativit komunal.

Vendime të rëndësishme

Vendimi për shpalljen e parcelës kadastrale 3262, me interes publik, ka mundësuar që në mënyrë institucionale të bëjë zgjidhjen e kontestit për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza, i cili pengohej vazhdimisht nga një person privat i kësaj komune, projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian.

Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e taksave vjetore për ushtrim të veprimtarisë afariste, që ka për qëllim përkrahjen e bizneseve të vogla dhe të mesme, bazuar edhe në ligjshmërinë e Kosovës.

Themelimi i KKSB-së, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 i MPB-së dhe Nr. 03/2012 i MAPL-së, konsiderohet vendim i rëndësishëm, duke përmbushur edhe kushtin ligjor për krijimin e tij, por edhe duke bërë përpjekje për përafrim me qytetarë për një siguri më të mirë për të gjithë qytetarët.

Vendimi për ndarjen e çmimit “Kuvendi i Junikut” për Richard Holbrookun, qytetar nderi i kësaj komune, për kontributin e dhënë për lirinë e Kosovës, vendim i propozuar nga kryetari i Komunës, ka marrë përkrahjen e gjithë këshilltarëve komunalë, pasi që, Holbrooke konsiderohet si njëri ndër miqtë më të mëdhenj të popullit shqiptar. Këtë vendim, kryetari Kuçi e arsyeton edhe me faktin se Holbrooke kishte ardhur në vitin 1998 në Junik, ku ishte takuar me përfaqësues të UÇK-së, duke dhënë edhe mbështetjen e duhur për liri dhe pavarësi të Kosovës.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Ndërtimi i identitetit vizual dhe implementimi i master planeve në përputhje me fizibilitetin	Fabrika për grumbullimin dhe përpunimin e frutave të malit	Konsultim i vazhdueshëm me qytetar, në të gjitha proceset e vendimmarjjes
2	Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	Ndërtimi i kompleksit turistik “Moronica”,	Transparencë e plotë e shpenzimeve buxhetore dhe realizimit të projekteve me interes për qytetarët
3	Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm		

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Në afat sa më të shkurtër, të bëhet emërimi i një zyrtari për informim, i cili do të pasurojë me të dhëna zyrtare edhe faqen e kësaj komune,
- Vendimet dhe rregulloret komunale të publikohen në faqen zyrtare të Komunës, të cilat të mund të shikohen, apo edhe të shkarkohen nga të interesuarit,
- Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi të funksionalizohet dhe të veprojë në përputhje me udhëzimin administrativ të ministrisë përkatëse,
- Kryetari Komunës të mbajë takime nëpër lokalitete të ndryshme, duke bërë transparente punën e tij dhe të stafit të tij, ashtu siç parasheh edhe ligji, ku thuhet “së paku dy takime me qytetarë”,
- Pas aprovimit të Rregullores për funksionimin e këshillave të fshatrave, të bëjë implementimin e saj, duke plotësuar edhe një kusht ligjor.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Drejtoria për Urbanizëm, së bashku me Inspektoratin komunal, të mos lejojnë ndërtime të cilat nuk janë në përputhje me Planin Zhvillimor Urban dhe planet rregulluese, në të kundërtën të bëjnë plotësime dhe ndryshime në këto dokumente, të bazuara në ligje,
- Me fanatizëm të ruhet kompleksi turistik “Moronica”, duke bërë investime në rregullimin e saj, dhe në përputhje me Planin rregullues.

Drejtorisë së Financave

- Raportet e shpenzimeve të detajohen, njëkohësisht edhe të vendosen në faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesit të Kuvendit

- Kryesuesi i Kuvendit, në takime të drejtpërdrejta apo edhe në forma të tjera, të inkurajojë organizatat e shoqërisë civile që të jenë më aktive në mbikëqyren e organeve komunale dhe të bëhen pjesë e proceseve të vendimmarrjes.

Asamblistëve të Kuvendit

- Këshilltarët komunalë të arsyetojnë besimin e marrë nga qytetarët, duke ngritur çështje të cilat ndërlidhen me ta, dhe jo të prezantohen në seanca, vetëm figurativisht,
- Këshilltarët komunalë të mbajnë takime të drejtpërdrejta me qytetarë, me qëllim të njohjes me hallet që i kanë ata,
- Të shqyrtohet, të aprovohet dhe të zbatohet Rregullorja për funksionimin e këshillave të fshatrave duke bërë ndërlidhjen e fshatrave me institucionet komunale, përmes të zgjedhurve të tyre.


Junik - Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	12	67	%	%
Janar	0	0	0	0
Shkurt	0	0	0	0
Mars	1	4	93	100
Prill	1	3	100	100
Maj	1	4	87	100
Qershor	1	2	93	100
Korrik	1	2	93	100
Gusht	0	0	0	0
Shtator	1	4	93	100
Tetor	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0
Komiteti për Politikë dhe Financa (Gjithsej)				
Janar	0	0	0	0
Shkurt	0	0	0	0
Mars	1	4	80	0
Prill	1	3	60	0
Maj	1	3	80	100
Qershor	1	3	80	100
Korrik	1	2	80	100
Gusht	0	0	0	0
Shtator	1	5	60	100
Tetor	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor				
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile	
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi			Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Dëgjimet publike			Mbi 40 persona	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave në territorin e komunës së Junikut	Shqyrtuar	Pro: 15 Kundër: 0 Abs: 0
Rregullorja e punës së Kuvendit komunal	Aprovuar	Pro: 15 Kundër: 0 Abs: 0
Vendimit për shpalljen e parcelës kadastrale 3262 interes publik i komunës së Junikut	Aprovuar	Pro: 15, kundër: 0, Abs: 0
Vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale nga institucionet e Kosovës, presidencës, Kuvendit dhe Qeverisë	Aprovuar	Pro: 8, Kundër: 5 Abs: 0
Themelimi i KKSB-së sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 i MPB-së dhe Nr. 03/2012 i MAPL-së	Aprovuar	Pro: 7, Kundër: 6, Abs: 0
Vendimit për ndarjen e çmimit „Kuvendi i Junikut” për Richard Holbrooke.	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 0, Abs: 0
Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e taksave vjetore për ushtrim të veprimtarisë në biznes	Aprovuar	Pro: 13, Kundër: 0 Abs: 0
Planit Rregullues Urban Njësia “Krasniq dhe Bajraktar”,	Aprovuar	Pro: 14, Kundër: 0 Abs: 0
Projekt Propozimit nga Kompania Triangle General Contractors Inc,	Dhënë pëlqimin	Pro: 14, Kundër: 0 Abs: 0
Buxhetit për Vitin 2014	Aprovuar	Pro: 14, Kundër: 0 Abs: 0
Rregullores mbi tatimin në pronë për vitin 2014	Aprovuar	Pro: 14, Kundër: 0 Abs: 0
Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Junikut	Ishte shtyrë shqyrtimi i saj	Pro: 14, Kundër: 0 Abs: 0


Raporti Monitorimit 2013




Komuna

Mamushë

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



13. Komuna MAMUSHË

Problemet kryesore të komunës

Komuna e Mamushës është një ndër komunat pilot-projekt, e cila në vitin 2010 mori kompetencat e plota. Kjo komunë kryesisht banohet nga qytetarë të komunitetit turk dhe nga disa familje shqiptare. Në këtë komunë, banorët merren kryesisht me bujqësi, një numër të konsiderueshëm të rinisë gjenden në Turqi, të cilëve u është mundësuar të studiojnë në nivele të ndryshme, e të cilët kthehen përsëri në vend. Prandaj, kjo komunë i ka kapacitetet e duhura, mirëpo duhet një menaxher i mirë për të udhëhequr me vendin dhe njerëzit. Kjo komunë ka një sërë problemesh të cilat deri më tani nuk kanë pasur zgjidhje, pavarësisht se ishin kërkesë e qytetarëve.

Komuna ballafaqohet me këto probleme:

1. Rregullimi i shtratit të lumit Toplluhë,
2. Mungesa e një çerdheje për fëmijë, po ashtu edhe mungesa e Shtëpisë së Kulturës dhe e një qendre rekreative,
3. Mungesa e ujit të pijes, mungesa e infrastrukturës ujore, por edhe rregullimi i rrugëve me një cilësi të lartë që të jenë më jetëgjatë,
4. Mungesa e ndihmesës nga ana e Komunës ndaj fermerëve vendas që të shiten prodhimet e tyre,
5. Mungesa e stafit mjekësor në Qendrën e Mjekësisë Familjare në orët e pasdites, pra ndërrimi i dytë,
6. Edhe pse e formuar, KVRL-ja e Komunës së Mamushës ka stagnuar dhe nuk ka përkrahje të mjaftueshme për funksionalizim të saj.

Të arriturat në vitin e kaluar

E arritur e Komunës së Mamushës për vitin 2013 mund të konsiderohet përmirësimi i infrastrukturës rrugore. Edhe gjatë këtij viti, Komuna, me buxhet vetanak dhe me mbështetje nga grantet qeveritare ka asfaltuar shumë segmente të rëndësishme rrugore, njëkohësisht duke rregulluar edhe infrastrukturën ujore.

Pastaj si e arritur hyn edhe rregullimi i shtratit të lumit Toplluhë, i cili deri më tani ishte një pellg plehrash, pastrimi dhe rregullimi i varrezave, rregullimi i sallës sportive në shkollën e mesme në këtë komunë etj.

Vlerësimi për performancë

Kryetari i Komunës së Mamushës, z. Arif Bütiq konsiderohet si bashkëpunues me monitoruesit e shoqërisë civile. Mirëpo, duhet të jetë më vigjilent në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi që i takojnë si kryetar komune, të jetë i pranishëm gjatë seancave. Po ashtu të jetë i përgjegjshëm për takimet të cilat i aranzhon me pjesëtarë të shoqërisë civile, mos të ketë neglizhencë nga ana e tij ndaj zyrtarëve të ndryshëm.

Drejtorive - Edhe pse Komuna ka 6 drejtori, ato janë të ngarkuara me më shumë departamente dhe puna e tyre është e vështirë, mirëpo edhe këto duhet të jenë më efikase

dhe eficiente në punën e tyre, e sidomos Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ngase akoma duhet t'i përmirësojë të dhënat nëpër raporte financiare.

Këshilltarëve komunalë- gjatë mandatit të tyre, me përjashtim të votimit, nuk kanë qenë shumë aktivë në seancat e Kuvendit dhe komiteteve të ndryshme. Në disa raste janë diskutuar në mes tyre çështje personale, gjë që ka sjellë edhe acarime në mes vete.

Kryesuesit të Kuvendit- nuk e ka përkushtimin e duhur për të menaxhuar seancat, mungesa e saj prej 2 muajsh ka ndikuar sadopak për të mos u mbajtur 2 seanca, ndërsa toleranca e saj ndonjëherë është keqpërdor nga asambleistët.

Transparenca në Komunë

Gjatë monitorimit 1-vjeçar të Komunës së Mamushës, është vërejtur që karakterizojnë mangësi të mëdha, mungesa e përkthyeses nga gjuha turke në gjuhën shqipe dhe anasjelltas, kjo po ndikon që dokumente të ndryshme të jepen vetëm në gjuhën turke, si dhe nuk ka përkthim simultant gjatë seancave të Asamblesë dhe komiteteve të ndryshme, mungesa e kulturës së debatit në seanca, gjatë diskutimit nuk flitet sipas renditjes që e cakton kryesuesja, poashtu nuk respektohet pastaj edhe minutazhi për diskutim. Mangësi tjetër është edhe mungesa e një zyre për informim apo zyrtari, sepse informatat e nevojshme jepen nga zyrtarë të ndryshëm, sikurse që me përpilimin e procesverbaleve merret zyrtari i Të Drejtave të Njeriut dhe Integriteteve Evropiane. Ndër të tjera duhet të ceket që zyrtarët administrativë duhet të jenë më bashkëpunues me shoqërinë civile.

Kryesuesja e Asamblesë Komunale duhet të insistojë që përpilimi i procesverbaleve, në të cilët është numri i asambleistëve të cilët votojnë, i ndryshëm nga ai në listat ku japin nënshkrimet asambleistët për vërtetimin e prezencës së tyre të evidentohet dhe të merren masa.

Komuna e Mamushës akoma nuk ka formuar komitete konsultative, mirëpo kryetari i Komunës ka deklaruar që është i nevojshëm formimi i tyre dhe se do të formohen në ditët në vijim.

Kur bëhet fjalë për prezencën e mediave dhe trajtimin e tyre, mund të theksohet që në shumicën e veprimeve që ka ndërmarrë legjislativi dhe ekzekutivi i Komunës së Mamushës, nuk kanë qenë prezente mediat. Mosprezenca e tyre është bërë duke mos bashkëpunuar dhe informuar mediat lokale të Prizrenit, por edhe nga mosinteresimi i mediave për punën e Kuvendit (që të jenë prezentë në seanca e dëgjime publike) në Komunën e Mamushës. Gjithë veprimtarinë e Komunës e monitorojmë OJQ-të nga qyteti i Prizrenit duke dalë me komunikata për çështje të ndryshme në Komunën e Mamushës dhe plasimi i tyre nëpër portale të ndryshme lokale. Poashtu problemit të mosprezencës së mediave në Mamushë i kontribuon edhe fakti që Komuna e Mamushës nuk ka TV lokal që do të ishte informator i drejtpërdrejtë i qytetarëve të kësaj komune për punën e Kuvendit Komunal.

Sa i përket qasjes në dokumente zyrtare në Komunë, mund të konsiderohet pozitive ngase nga kërkesat e bëra, ato janë shqyrtuar dhe iu janë përgjigjur në kohën e duhur brenda 7 ditësh. Mirëpo, përkundër faktit që ka rregullsi në këtë aspekt, duhet theksuar se mungojnë zyrtarët adekuatë që ky proces të realizohet sipas rregullave, ngase mungon një zyrtar i protokollimit, poashtu mungon edhe zyrtari i informimit. Mungesa e këtyre zyrtarëve bën që sekretarja e kryetarit të kryejë funksionin e protokolluesit, si dhe të informohet nga zyrtarë të ndryshëm.

Një ndër mangësitë e Komunës së Mamushës konsiderohet edhe mosazhurnimi i ueb-faqes të Komunës së Mamushës dhe ka informata të pakta e po ashtu mungojnë edhe informatat për seanca, komitete, mungojnë raportet financiare, procesverbalet, pothuajse mungojnë të gjitha informatat e duhura.

Llogaridhënia në Komunë

Ndër shqetësimet e tjera është fakti që gjatë kësaj periudhe kanë munguar drejtorët e drejtorive gjatë seancave, ku me përjashtim të drejtorit të Buxhetit dhe të Financave që ishte prezent në shqyrtimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2016, asnjë drejtor tjetër nuk ka treguar gatishmëri që të jetë prezent gjatë seancave të Asamblesë, edhe pse Komuna e Mamushës ka gjashtë drejtorë, gjë që do t'u mundësonin asambleistëve që shqetësimet e tyre dhe të qytetarëve t'i paraqesin në adresë të duhur. Kryetari nuk raporton për punët e realizuara, apo vendimet e marra.

Shqetësim tjetër mjaft serioz është që kryetari nuk i përmbush obligimet e tij duke u dhënë llogari asambleistëve dhe qytetarëve për punën që e realizon në baza mujore dhe vjetore. Në pak seanca është parë të jetë prezent kryetari.

Në këtë rast, kryetari i Mamushës ka bërë shkeljen e Ligjit për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë, neni 45.5, i cili thotë “Kryetari i Komunës duhet t'i përgatisë dhe t'i dorëzojë Kuvendit Komunal raporte tremujore të cilat e mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit, i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen Kuvendit Komunal dhe një kopje duhet t'i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga kryetari i Komunës në faqen e internetit të Komunës.

Gjithashtu, duhet theksuar që kryetari i Mamushës ka dërguar në Kuvend për shqyrtim dhe është miratuar formimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), më 17 maj 2013. Mirëpo, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 27/2012, neni 9 paragrafi 1.1, i cili thotë “ndër detyrat dhe përgjegjësitë e kryesuesit të KKSB-së që në këtë rast është kryetari, janë: brenda tridhjetë (30) ditësh nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi administrativ, përmes mediave publike, fton komunitetet përkatëse për të bërë propozimet e anëtarëve të tyre në KKSB”. Prandaj, konsiderojmë që kryetari ka bërë shkelje si për themelimin e KKSB-së, kur merret parasysh që ky udhëzim administrativ ka hyrë në fuqi më 22 gusht 2012, poashtu as në mbledhjen e parë që e kanë organizuar për të bërë propozimet e anëtarëve të tyre në KKSB, nuk janë ftuar as mediat, e as shoqëria civile.

Për tërë vitin, Komuna e Mamushës ka mbajtur vetëm një debat publik, për shqyrtim publik të Planit Zhvillimor Komunal, i thirrur nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Në këtë takim ishin të pranishëm Drejtoria për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër (bartës të projektit), qytetarë, kryetari i Komunës, shoqëria civile, UN-HABITAT-i, drejtorët e drejtorive të Komunës, anëtarët e grupit punues të PZHK-së etj. Qytetarët shprehën shqetësimet e tyre që mos të bëhen plane në favor të simpatizuesve, poashtu deklaruan që janë të pajtimit edhe nëse nevojitet hapje e rrugës nëpër parcela private që të realizohet ky plan. Mirëpo, shqetësim serioz që ngrihet nga qytetarët, është që mos të dëmtohet pa kontroll toka bujqësore duke ndërtuar objekte në to, sepse prodhimet që i kultivojnë në ato pjesë janë burimi kryesor i ardhurave në shumicën e familjeve në këtë komunë. Sa u përket aktiviteteve ku asambleistët mund të kontaktonin me qytetarë, nuk është parë asnjë aktivitet i tillë, dhe kjo ka rrjedhur edhe si pasojë e mosvetëdijesimit të qytetarëve se e kanë një adresë tjetër ku mund t'i shfaqin shqetësimet e tyre. Edhe përkundër faktit që kanë të drejtë të jenë të implikuar në çdo veprim të ekzekutivit dhe legjislativit, nuk vërehet ndonjë interesim nga ana e tyre.

Urbanizmi në Komunë

Drejtoria Komonale e Urbanizmit ka nisur hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, për të cilin pritet që Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor ta dërgojë pëlqimin e saj si dhe rekomandimet e saj, që pastaj të shqyrtohet në Asamble. Kjo drejtori ka inkorporuar Planin Rregullativ në Planin Zhvillimor Urban.

Kjo drejtori ka mbajtur dëgjimin publik për Planin Zhvillimor Komunal, ku kanë qenë të pranishëm një numër i konsiderueshëm i qytetarëve e zyrtarëve dhe ku kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre.

Ajo që duhet të theksohet është që kjo drejtori nuk ka kompetenca ende për të lëshuar leje ndërtimi, ngaqë akoma nuk është bërë destinimi i tokës. Mamusha, tashmë qendra ekzistuese, llogaritet si urbane, ndërsa pjesa tjetër, tokë bujqësore. Në këtë të fundit, nuk do të lejohet ndërtimi i objekteve, do të lejohet vetëm punimi dhe kultivimi nga fermerët. Mirëpo, para shumë vitesh, në tokat pjellore janë ndërtuar disa shtëpi dhe para 3 vitesh vetë Ministria e MPH-së kishte urdhëruar prishjen e atyre objekte ngaqë drejtorja përkatëse ende nuk i ka ato kompetenca.

Financat në Komunë

Komuna e Mamushës bën pjesë në komunat të cilat nuk i kryejnë detyrat dhe obligimet që ia obligon ligji. Njëra ndër parregullsitë që KDI-ja ka potencuar është mosraportimi i kryetarit në Kuvend për raporte tremujore, i cili mbyll vitin fiskal deri në tremujorin që sapo ka përfunduar. Mirëpo, mosraportimi në baza tremujore e karakterizon tërë vitin dhe nga kjo del që, kryetari është shkelës i ligjit (neni 45.5, Ligji për Manaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë).

Gjithashtu, zyrtarët e drejtorisë përkatëse duhet të angazhohen maksimalisht në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve ngase në Raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm mbi pasqyrat financiare të Komunës së Mamushës për vitin 2012, janë gjetur një sërë parregullsish.

Në Komunën e Mamushës, përkundër faktit që janë paraqitur një numër rekomandimesh në vitin e mëparshëm nga ana e ZAP-it, ku nga këto rekomandime vetëm një prej tyre është adresuar dhe tri të tjera janë adresuar pjesërisht brenda vitit 2012. Kjo nënkupton që akoma kjo drejtori ka për të zgjidhur detyra, dhe qëviti 2013 i ka gjetur me detyra të pazgjidhura të viteve të mëparshme.

Poashtu për t'u përmirësuar funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontroleve të brendshme, është rekomanduar që Komuna e Mamushës të sigurojë zbatimin e Ligjit Nr. 24/2-042, Ligji për prokurim publik, ngaqë janë disa prokurime që janë emëruar si shpenzime kapitale, e jo shpenzime për mallra dhe shërbime. Pastaj të ketë një sistem faturimi për të gjitha llojet e taksave, të merren masa për t'u rritur mbledhja e të hyrave nga taksat e ndryshme, si dhe një listë e plotë e pronave, ndërtesave dhe pajisjeve të Komunës.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapitale	Transparencë, Llogaridhënie
1	Përmirësimi i performancës në arsim, shëndetësi, kulturë, etj.	Shtimin e numrit të serave	Mundësimin e marrjes së dokumenteve në gjuhën turke
2	Themelimi i një Universiteti në Mamushë	Regullimi i sistemit të ujitjes për tokat bujqësore.	Liria e të shprehurit për të dy komunitetet
3	Ngritja e kualitetit të jetesës		Ngritjen e nivelit të gjuhës turke që jetë e barabartë me gjuhët tjera

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës

- Të krijojë vende të reja pune në e Qendrën e Mjekësisë Familjare në Mamushë, ngase në raste urgjente, gjatë natës, Qendra është e mbyllur dhe qytetarët detyrohen të marrin rrugë deri te qendra e ndonjë komune tjetër,
- Të bëjë planifikime për pastrimin dhe largimin e mbeturinave nga rrugët e Mamushës ngase akoma nuk ka vend adekuat për hedhje të mbeturinave dhe kjo shkakton kundërmim,
- Ta respektojë më me përpikëri Ligjin e vetëqeverisjes lokale, duke filluar nga llogaridhënia, transparenca rreth punës së tij dhe vendimeve të ndryshme, poashtu dhe raportimet për punën që e zhvillon në baza mujore dhe vjetore, duke zbatuar rregulloret komunale dhe udhëzimet administrative,
- Të ketë përfshirje më të madhe të qytetarëve, duke thirrur takime më të shpeshta, të cilët do të jenë të informuar se si menaxhohen taksat e paguara nga ata,
- Të funksionalizohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, sepse ky këshill përfshin të gjithë akterët relevantë, të cilët do të mund të identifikonin çështjet negative dhe të rezikshme në këtë komunë dhe do t'u ndihmonte në marrjen e masave për të gjitha shqetësimet që paraqiten në fushën e sigurisë,
- Të funksionalizohen këshillat lokalë, sepse kjo shërben për inkuadrimin e rinisë dhe këta këshilla janë indikatorë për hartimin e politikave e planeve të veprimit për rini e sektorë të tjerë.

Drejtorisë së Urbanizmit

- Me hyrjen në fuqi të Planit Zhvillimor Komunal, kjo drejtori obligohet të realizojë me përpikëri këtë plan dhe në tokat pjellore duhet të mos lejohen të ndërtohen objekte të ndryshme,
- Kjo drejtori duhet të zhvillojë fushatë informuese për qytetarët rreth planeve urbane duke vendosur njoftime nëpër tabela për shpallje publike,
- Duhet të inspektohen nga inspektorët komunalë punët gjatë ndërtimeve të objekteve, duke kontrolluar edhe lokacionet më të thella.

Drejtorisë së Financave

- Gjatë raportimeve për shpenzime buxhetore nëpër periudha të caktuara të vitit, të prezantohen në mënyrë të deshifruar të gjitha shpenzimet buxhetore,
- Të bëjë hapa më të mëdhenj në vjeljen e të hyrave vetanake, duke rritur edhe vjeljen e taksave për leje ndërtimi,
- Në planin e punës së saj të përfshijë të gjitha rekomandimet që kanë dalë nga Auditori Gjeneral për menaxhimin financiar.

Kryesuesit të Kuvendit

- T'i evitohet sa më shumë që mundet mungesat në seancat e Kuvendit, sepse këto mungesa shkaktojnë mosmenaxhim të mirë në informimin e shoqërisë civile dhe OSCE-së dhe shkakton kaos në seanca kur udhëhiqet nga anëtarë të tjerë të Kuvendit,

- Kryesuesi gjatë menaxhimit të seancave të Kuvendit Komunal, duhet të respektojë me përpikëri Rregulloren e punës të Kuvendit, sidomos anëtarët duhet ta marrin fjalën në minutazhë aq sa iu lejohet,
- Të thellohet bashkëpunimi me OJQ-të në organizimin e takimeve me qytetarë që së bashku ta informojnë qytetarin dhe ta bëjnë pjesë në vendimmarrje,
- Të ketë qasje neutrale gjatë udhëheqjes së seancave duke qenë e barabartë me të gjithë kuvendarët, e duke përfshirë të gjitha partitë politike.

Asamblistëve të Kuvendit

- Asambleistët duhen të kenë takime të shpeshta me qytetarë, që problemet e tyre të adresohen në Kuvend nga ta, që ata të bëhen zëri i qytetarëve brenda Kuvendit, duke mos harruar faktin se nga besimi dhe votat e tyre, ata janë pjesë e Kuvendit,
- Asambleistët duhet të krijojnë raporte bashkëpunimi me shoqërinë civile, duke u takuar me OJQ-të në takime të ndryshme, gjë që mundëson informimin më të mirë me nevojat dhe problemet e qytetarëve,
- T'i shqyrtojnë mjaftueshëm dokumentet e dërguara nga Sekretariati i Kuvendit para se të mbahen takimet,
- Asambleistet femra të ngrenë zërin e tyre në Kuvend, duke diskutuar në mënyrë të barabartë në foltoren e Kuvendit.


Mamushë - Mbledhjet e Kuvendit dhe Pjesëmarrja

Lloji i Takimeve	Numri	Pika në Rend dite	Pjesëmarrja e përgjithshme	Pjesëmarrja e Grave
Seanca plenare (Gjithsej)	6	67	%	%
Janar	1	1	93%	80%
Shkurt	1	1	93%	100%
Mars	1	2	93%	100%
Prill	0	0	0	0
Maj	1	1	100%	100%
Qershor	1	2	93%	80%
Korrik	0	0	0	0
Gusht	0	0	0	0
Shtator	1	5	93%	100%
Tetor	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0
KPF (Gjithsej)	6	67	100%	40%
Janar	1	1	100%	40%
Shkurt	1	1	100%	40%
Mars	1	2	100%	40%
Prill	0	0	00	0
Maj	1	1	100%	40%
Qershor	1	2	100%	40%
Korrik	0	0	0	0
Gusht	0	0	0	0
Shtator	1	5	100%	40%
Tetor	0	0	0	0
Nëntor	0	0	0	0
Dhjetor	0	0	0	0
	Gjithsej Takime		Pjesëmarrja	
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi	1		-	
	Gjithsej		Pjesëmarrja Mesatare	
Takimet me publikun	1		30	

Rregulloret dhe Vendimet

Dokumenti	Statusi	Votimi
Rregullorja për Tatimin në Pronë për vitin 2014	Aprovuar	Pro: 12 Kundër: 2 Abs: 0
Miratimi dhe shqyrtimi i Planit të punës së asamblesë komunale për vitin 2013	Aprovuar	Pro: 14 Kundër: 0 Abs: 0
Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2014-2016	Refuzuar	Pro: 7 Kundër: 8 Abs: 0
Miratimi i Analizës preliminare të kërkesave financiare për KK Mamushë për vitin 2014-2016	Aprovuar	Pro: 12 Kundër: 2 Abs: 0
Vendim për themelimin e Këshillit Komunal për siguri në Bashkësi.	Aprovuar	Pro: 15 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për Transfer, Harmonizim dhe Ridestinim të mjeteve.	Aprovuar	Pro: 13 Kundër: 1 Abs: 0
Vendim për hartimin e PLMV-së.	Aprovuar	Pro: 12 Kundër: 2 Abs: 0
Vendim për binjakëzimin e Komunës së Mamushës me Komunën Karacabey të Turqisë	Aprovuar	Pro: 14 Kundër: 0 Abs: 0
Raporti Financiar i vitit 2012	Aprovuar	Pro: 14 Kundër: 0 Abs: 0
Vendim për hartimin e PLVM-së	Aprovuar	Pro: 12 Kundër: 2 Abs: 0
Shqyrtimi i Propozimit për Analizën Preliminare të kërkesave financiare për KK Mamushë për vitet 2014-2016	Aprovuar	Pro: 12 Kundër: 2 Abs: 0


Raporti Monitorimit 2013




Komuna
Graçanicë

SDY

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



14. Komuna GRAÇANICË

Problemet kryesore në komunë

Vetëqeverisja lokale paraqet nivelin e qeverisjes, e cila është më pranë qytetarëve. Vetëqeverisja lokale ka për detyrë të zgjidhë problemet e përditshme të qytetarëve siç janë: shëndetësia, arsimi, kanalizimi, transporti publik, terrenet sportive, shkollat, ngrohja si dhe të gjitha problemet e tjera me të cilat ballafaqohen qytetarët.

Ky raport mbi monitorimin e Kuvendit Komunal të Graçanicës vlerëson punën e pushtetit lokal. Qëllimi i monitorimit është që t'u afrohet puna e Kuvendit Komunal të Graçanicës qytetarëve, përfshirja e shoqërisë civile në punën e Kuvendit Komunal, si dhe pasqyrimi i problemeve me të cilat ballafaqohet komuna. Duke shfrytëzuar rezultatet e raportit, do të mund të hartohet iniciativa sipas nevojave konkrete të vetë atyre dhe me këtë do të nxitej një punë më e mirë e Komunës. Raporti është rezultat i monitorimit nëntëmujor, në kuadër të projektit "Përfshirja civile për transparencë dhe përgjegjësi në nivelin lokal", i hartuar nga ana e organizatës joqeveritare Rinia Demokratike Serbe (Srpska Demokratska Omladina - SDO) në koordinim me Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), të financuar nga UNDEF-i.

Pas mbikëqyrjes aktive nëntëmujore të puës së Kuvendit Komunal të Graçanicës, takimeve me qytetarë dhe me organizata të shoqërisë civile, kemi konstatuar se ekziston një numër i madh i problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët e komunës së Graçanicës.

Problemet kyçe në komunën e Graçanicës:

- 1.Shkalla e lartë e papunësisë,
- 2.Mungesa e medikamenteve dhe materialeve mjekësore në institute shëndetësore,
- 3.Problemet me komunalie (furnizimi me ujë, furnizimi me energji elektrike, bartja e mbeturinave),
- 4.Siguria në bashkësi.

Në mesin e problemeve të shumta në komunën e Graçanicës, problemi më i madh gjithsesi është punësimi, gjegjësisht papunësia dhe mungesa e vendeve të punës. Aktualisht nuk dihet numri i saktë i të papunëve, por të dhënat jozyrtare tregojnë se ky numër aktualisht është mbi 30%. Problemi i dytë domethënës është mungesa e aparateve mjekësore për punën normale të institucioneve shëndetësore. Problemi me mungesën e medikamenteve është parashtruar kur Agjencia Kosovare i Barnave ka pamundësuar furnizimin me furnizime mjekësore nga Serbia qendrore të gjitha institucioneve shëndetësore në Kosovë, të cilat financohen nga buxheti i Republikës së Serbisë. As edhe pas nëntë muajsh, ky problem nuk është zgjidhur, qytetarët janë të detyruar që të gjenden vetë që t'i gjejnë barnat, të cilat kryesisht duhet t'i blejnë nga barnatoret private me çmime shumëfish më të larta. Restriksionet e ujit dhe të rrymës, si dhe grumbullimi i mbeturinave janë probleme që janë paraqitur dhe mbeten të pranishme edhe më tutje për qytetarët e komunës së Graçanicës. Problemi i furnizimit me ujë është një prej problemeve më të mëdha në komunën e Graçanicës, ku restriksionet e ujit janë të përditshme.

Në komunën e Graçanicës, më shumë se 95% e qytetarëve i paguajnë llogaritë e tyre për energjinë elektrike, dhe është në radhën e komunave të cilat i paguajnë borxhet e energjisë elektrike më me rregull. Edhe përkundër kësaj, në komunën e Graçanicës, restriksionet e energjisë elektrike janë më të shpeshta. Një prej problemeve komunale, i cili ishte i pranishëm gjatë vitit 2013, ishte edhe mosgrumbullimi i mbeturinave nga vendbanimet e komunës së Graçanicës si dhe në vetë Graçanicën. Ky problem është paraqitur për shkak të

mosekzistimit të hapësirës, e cila do të duhej të shërbente si deponi për hedhjen e mbeturinave. Deri para pak kohësh, problemi më i madh në bashkësi ishte siguria e qytetarëve. Në anketë me qytetarët, të cilën e kanë kryer organizatat e shoqërisë civile në territorin e komunës së Graçanicës, qytetarët kanë cekur sigurinë si një prej problemeve më kryesore. Qytetarët kanë theksuar se ky problem është dukshëm më i vogël në raport me vitet paraprake, por edhe më tutje është në një nivel të pakënaqshëm.

Të arriturat e vitit të fundit

Integrimi i bashkësive pakicë në jetën shoqërore dhe politike në komunën e Graçanicës konsiderohet një e arritur e rëndësishme. Në veçanti mendohet në bashkësinë e romëve dhe të shqiptarëve, por edhe në bashkësitë e tjera pakicë. Në këtë rast, integrimi i referohet pjesëmarrjes së bashkësive pakicë në vendimmarrje në nivel lokal, nga çka mund të konstatohet se bashkësia shumetnike është sjellë në nivelin në të cilin mund të funksionohet.

Sipas hulumtimeve të deritanishme të kryera nga organizatat e shoqërisë civile, konstatohet se projektet të cilat qytetarët i konsiderojnë si të arritura të mëdha janë nga sektori i urbanizmit, gjegjësisht realizimi i projekteve të infrastrukturës, siç është ndërtimi i rrugëve, rindërtimi dhe revitalizimi i shtëpive të rrënuar të kulturës, objekteve fetare, si dhe rregullimi i rrugëve.

Vlerësimi i punës

Kryesuesi i Kuvendit: Mungesa e transparencës dhe e llogaridhënies ndaj qytetarëve, gjegjësisht moskonsultimi dhe pamundësia e qasjes së zyrës së kryesuesit lidhur me pyetjet me interes të përgjithshëm dhe personal të qytetarëve të komunës së Graçanicës i ka shënuar muajt paraprakë.

Drejtoritë: Drejtorive të caktuara u mungon transparenca, pasi që në shumë raste nuk i kanë respektuar të drejtat civile të qytetarëve, siç janë qasja në dokumente të rëndësishme publike në Komunën e Graçanicës. Drejtorët e drejtorive të caktuara nuk kanë mundur t'iu përgjigjen kërkesave për qasje në dokumente të rëndësishme publike pa konsultime me zyrën e kryetarit.

Këshilltarët e Kuvendit: Papërgjegjësia kundrejt qytetarëve të cilët i kanë zgjedhur, ishte veçoria e disa këshilltarëve të Kuvendit Komunal të Graçanicës. Këtë e vë në pah edhe shumica e vendimeve të miratuara me shumicë absolute të votave, pa analizë paraprake të problematikës, nga çka mund të konkludohet mungesa e aftësisë dhe e profesionalizmit e një pjese të këshilltarëve.

Kryesuesi i Kuvendit: Kryesuesi i Kuvendit të Graçanicës ka udhëhequr mbledhjet duke respektuar dispozitat ligjore, ka qenë i pranishëm në shumicën e takimeve publike, ku ndër të tjera ka shprehur edhe mendimin e vet. Mirëpo, me anketën e realizuar, 40% e të anketuarve nuk kanë ditur se kush është kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, me çka mund të konstatohet se puna e kryesuesit të Kuvendit nuk ishte transparente në masë të duhur.

Transparenca në Komunë

Komuna e Graçanicës ka një rregullore të kompletuar mbi transparençën, posedon një numër të konsiderueshëm të resurseve, mirëpo mungojnë edhe disa gjëra në mënyrë që transparenca të jetë në nivelin e kënaqshëm. Njoftimet për publikun për mbledhjet e

caktuara plenare Kuvendi i Graçanicës i shpall në ueb faqen e saj⁴. Afati për shpalljen e njoftimeve është përcaktuar me rregulloren mbi transparencën. Për t'u njoftuar me vendimet e Kuvendit, qytetarët duhet personalisht t'i kërkojnë procesverbalet dhe vendimet e Kuvendit nga zyrtarët e Komunës, pasi që në ueb faqen e Komunës së Graçanicës nuk ekzistojnë procesverbalet dhe vendimet e Kuvendit për pesë takimet e fundit të Kuvendit Komunal. Edhe pse qytetarëve u lejohet prania në mbledhjet e Kuvendit, në mënyrë që të mund t'i parashtrorjnë problemet e tyre, një numër shumë i vogël i qytetarëve ka qenë i pranishëm në mbledhjet e Kuvendit Komunal. Për dallim nga seancat plenare, për takimet e rregullta të komiteteve të Kuvendit të Graçanicës, nuk ka pasur njoftime, ashtu që gjatë monitorimit tonë nëntëmuor të komiteteve, në punën e tyre nuk kanë marrë pjesë qytetarët e Graçanicës. Procesverbalet nga mbledhjet e komiteteve nuk mund të gjenden në ueb-faqet zyrtare të Komunës së Graçanicës, ashtu që qytetarët e interesuar duhet personalisht të kërkojnë qasje në to.

Prania e mediave në mbledhjet e Kuvendit Komunal nuk është në nivel të kënaqshëm, gjë që vihet në pah nga fakti se në 12 mbledhjet plenare të vitit 2013, vetëm në dy sosh është shënuar prania e mediave. Thënë në përgjithësi për Komunën, mediat kanë përcjellë punën e saj, gjithashtu është vërejtur edhe raportimi i mediave mbi tubimet publike. Edhe pse me rregullore për transparencë parashihet që dokumentet me rëndësi publike duhet t'i vihen në dispozicion publikut, qasja në dokumentacion publik të Komunës së Graçanicës ende nuk është e mundur. Ueb-faqja zyrtare e Komunës së Graçanicës azhurnohet përditë me të arritura aktuale, si dhe me lajme që prekin Komunën. Mirëpo, ashtu siç e përmendëm, ueb-faqet e Komunës së Graçanicës që prej një kohe mjaft të gjatë nuk janë azhurnuar me procesverbale dhe vendime të mbledhjeve të Kuvendit Komunal, si dhe me raportet financiare dhe me projektet kapitale të planifikuara.



Si dëshmi e kësaj flet fakti se azhurnimi i fundit me vendime është bërë për mbledhjen e Kuvendit Komunal të 11 qershorit 2013. Sipas mendimeve të organizatës së shoqërisë civile dhe bashkësisë lokale, transparenca në Komunën e Graçanicës nuk është në nivelin e duhur. Kërkohej një prani më e madhe e mediave, në mënyrë që qytetarët të jenë më të informuar me vetë punën e Kuvendit. Përfaqësuesit e OJQ-së Rinia Demokratike Serbe ua kanë vënë në pah përfaqësuesve të pushtetit lokal nevojën e shfrytëzimit të mediave për të informuar qytetarët mbi organizimin e debateve publike, komiteteve konsultative dhe mbledhjeve të Kuvendit.

Llogaridhënia në komunë

Sipas Statutit të Komunës së Graçanicës, kryetari i Komunës është i obliguar që të parashtrorjë raport para Kuvendit Komunal çdo gjashtë muaj mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës, si dhe t'i parashtrorjë raport Kuvendit mbi punën e organeve ekzekutive çdo 3 muaj. Për nëntë muajt e monitorimit të Kuvendit Komunal të Graçanicës nga ana jonë, kryetari Bojan Stojanović nuk ka marrë pjesë në punën e Kuvendit Komunal. Raportet e rregullta të kryetarit për gjysmën e parë të vitit 2013 si dhe raportet e rregullta financiare tremujore para Kuvendit Komunal i parashtronte drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Fiannca, Slaviša Ničić. Drejtorët e drejtorive të tjera ishin kohë pas kohe të pranishëm në takimet e Kuvendit Komunal të Graçanicës, kryesisht kur duhet t'i parashtronin raport Kuvendit mbi shpenzimet kapitale të Drejtorisë, si dhe kur Kuvendi kërkonte shpjegime lidhur me problemet në Komunë.

Gjatë monitorimit nëntëmujor, nuk jemi njoftuar se kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Goran Lazić ka parashtruar ndonjë raport për punën. Mirëpo, ajo që është më me rëndësi, përgjegjësia e Kuvendit Komunal ndaj qytetarëve dhe shoqërisë civile gjithsesi ka munguar. Nuk ishte praktikë e kryetarit të Komunës, si dhe e drejtorëve të drejtorive që raportet e veta të punës t'i ndajnë me qytetarë dhe me shoqërinë civile. Mundësia e qytetarëve dhe e shoqërisë civile që të fitojnë qasje në punën e organeve ekzekutive aktualisht lejohet me kërkesë direkte në Komunë, pasi që ueb-faqja e Komunës së Graçanicës nuk i ka azhurnuar raportet nga viti 2013. Përkundër faktit që zyrtarët e Komunës së Graçanicës jo rrallë ishin të pranishëm në media, prania e tyre është shënuar kryesisht në rastet kur ata e konsideronin me rëndësi për bashkësinë lokale, dhe me këtë bashkësia lokale nuk ishte njoftuar në tërësi mbi punën e Komunës së Graçanicës. Komuna e Graçanicës ka mbajtur gjithsej 23 tubime publike.

Sugjerimet, rekomandimet dhe komentet, të cilët ishin të pakta në numër, janë marrë në shqyrtim nga ana e Kuvendit. Gjithashtu, Komuna e Graçanicës organizon "Ditën e dyerve të hapura", dy herë në muaj, ku qytetarët mund të flasin për problemet e veta me zyrtarë të Komunës së Graçanicës. Mirëpo, për shkak të mosinformimit të qytetarëve, prania në këto takime është shumë e ulët. Ajo që është shqetësuese është mosinteresimi dhe mosinformimi i qytetarëve lidhur me mundësinë për të shprehur mendimin e vet, dhe me këtë edhe të marrin pjesë në vendimmarrje mbi çështje me rëndësi për bashkësinë lokale. Prandaj, llogaridhënia e qeverisë lokale ndaj qytetarëve nuk është në nivelin e duhur. Kërkohej që zyrtarët e pushtetit lokal të jenë sa më transparentë dhe të përgjegjshëm, në mënyrë që të rritet intensiteti i pjesëmarrjes së qytetarëve në punën e qeverisë lokale, dhe me këtë edhe të përmirësohet jeta e qytetarëve të komunës së Graçanicës.

Urbanizimi në komunë

Për shkak të pozitës së vet gjeografike, komuna e Graçanicës është shumë atraktive për investitorë ndërtimorë. Në vëndbanimet e komunës së Graçanicës, është evidentuar një zhvillim domethënës urbanistik. Është ripërtërirë infrastruktura rrugore, rregullimi i rrugëve kryesore, janë rindërtuar objektet fetare, janë ndërtuar komplekset sportive, janë restauruar objektet e shtëpive të kulturës, kopshtet dhe shkollat janë vetëm disa nga projektet e përealizuara kapitale, të cilat Komuna e Graçanicës i ka realizuar gjatë kohës së monitorimit tonë. Për investimet kapitale të Drejtorisë së Urbanizimit dhe planifikimit hapësinor për vitin 2013, është ndarë një buxhet prej mbi 2.000.000€ nga buxheti i Komunës së Graçanicës.

Komunikimi i pamjaftueshëm me banorë, gjegjësisht mungesa e konsultimit me bashkësinë lokale sjell deri te problemet në terren. Rasti më i ri është ndërprerja e punëve në ndërtimin e kopshtit zoologjik në Llaplasellë, për shkak të protestës së qytetarëve, të cilët janë të pakënaqur me realizimin e këtij projekti. Sipas mendimit të qytetarëve, në lokacionin e caktuar për ndërtimin e kopshtit zoologjik, duhet të ndërtohet terreni sportiv.

Gjatë monitorimit tonë, Kuvendi ka miratuar 18 vendime me propozim të Drejtorisë për Urbanizëm, në mesin e të cilëve më të shumta janë vendimet që kanë të bëjnë me ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore si dhe hartimi i planeve urbane-rregullative për personat fizikë. Gjithashtu janë miratuar taksa dhe tarifa për lëshimin e lejeve ndërtimore. Kuvendit Komunal i Graçanicës në korrik të vitit 2013, me kërkesë të drejtorit për Urbanizëm, Nada Brkljaq, ka marrë vendim për të vënë në shqyrtim publik Pplanin Zhvillimor të Komunës së Graçanicës, me të cilin pasqyrohet zhvillimi i Komunës së Graçanicës për periudhën 2013-2028, i cili ka zgjatuar deri më 30 shtator 2013.

Është mendimi ynë se komuna e Graçanicës, ekonomia e së cilës bazohet kryesisht në bujqësi, duhet të ketë vëmendje gjatë miratimit të vendimeve mbi ndërrimin e destinimit të

tokës, mbi intensitetin e ndërrimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore pasi që kjo mund të sjellë pasojë negative.

Financimi në komunë

Drejtoria për Buxhet dhe Financa i kryen punët nga lëmi i financave, të cilat kanë të bëjnë me balansimin e të hyrave dhe shpenzimeve publike, përgatitjen e buxhetit si dhe punë të tjera të parapara me ligj. Problemet e Komunës së Graçanicës në raport me financat kanë të bëjnë me uljen e buxhetit komunal në vitin 2014 në shumën prej 150000.00€, dhe përkundër kësaj uljeje, Kuvendi Komunal i Graçanicës ka miratuar buxhetin për vitin 2014. Buxheti i Komunës së Graçanicës për vitin 2013 është 5.708.467.00€, nga të cilat 1.150.000.00€ janë të hyra vetanake të Komunës, me çka Komuna e Graçanicës radhitet në komunat me të hyra më të mëdha vetanake. Buxheti i Komunës është i ndarë në 3 grante: granti i përgjithshëm, granti specifik për arsim dhe granti specifik për shëndetësinë primare. Gjithashtu Komuna e Graçanicës ka kompetenca të zgjeruara për shëndetësinë sekondare. Gjatë monitorimit të punës, nuk kemi vërejtur probleme në Drejtorinë për Financa. Drejtori i Drejtorisë për Financa, Slaviša Ničić ka raportuar rregullisht në Kuvend mbi financat e Komunës, dhe me raportet tremujore ia ka prezantuar Kuvendit akomunal të hyrat dhe shpenzimet e Komunës. Gjatë monitorimit të deritanishëm të punës së Kuvendit, është marrë vendimi mbi miratimin e raportit tremujor, gjashtëmujor dhe nëntëmujor financiar.

Mirëpo, transparenca në lidhje me raportimin nuk është në nivel të kënaqshëm. Raportet financiare për vitin aktual nuk mund të gjenden në ueb-faqen e Komunës së Graçanicës, as buxheti i vitit 2014. Mendimi ynë është se Komuna e Graçanicës do të duhej të ishte më transparente, gjegjësisht që me azhurnimin e ueb-faqes, e cila është mënyra e vetme multimediale e informimit, t'u mundësojë qytetarëve qasje në informata me rëndësi publike.

Konsiderojmë se investimet më të mëdha, Komuna e Graçanicës duhet t'i orientojë në lëmin e zhvillimit ekonomik, posaçërisht në bujqësi, si sektor parësor strategjik për investime kapitale.



Problemet e tjera në administratën e Komunës

Konsiderojmë se mosanaliza e problematikës së pikave të rendit të ditës nga ana e anëtarëve të Kuvendit Komunal dhe në komitete të përhershme, gjegjësisht mospërgatitja, është një prej problemeve në administratën e Komunës.

Edhe pse materiali dorëzohet përbrenda afatit ligjor, për shkak të mosazhuritit, disa këshilltarë janë hasur të papërgatitur për të mbajtur diskutimin në mbledhje. Nga kjo konstatohet se mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe të komiteteve janë shumë të shkurtrë, vendimet janë miratuar njëzëri, pa diskutim paraprak, gjë që ka sjellë deri te rritja e problemeve që janë grumbulluar.

Premtimet e Kryetarit të Ri

	Prioritetet	Projektet Kapital	Transparencë, Llogaridhënie
1	Zhvillimi i kapaciteteve ekonomike, krijimi i vendeve të punës	Ndërtimi i qendrës së shkollave të mesme	Komuna në dispozicion për qytetarët dhe mediat për të gjitha informatat e nevojshme
2	Avancimi i sistemit shëndetësor – sigurimi i aparateve mjekësore për institucionet shëndetësore	Aftësimi i sistemit për ujitje nga liqeni i Ujmirit në Liqenin e Graçanicës	Dita e dyerve të hapura – takimi një mujor ndërmjet kryetarit dhe qytetarëve
3	Avancimi i arsimit	Sistemi alternativ i ujitjes – Puset e Susisë	Vizitat të rregullta këshillave lokale për informim mbi punën e komunës
4	Zgjidhja e problemeve me komunalitë (furnizimi me ujë, mbeturinat, energjia elektrike)	Ndërtimi i një strehimoreje për kafshë	
5	Përmirësimi i programit social		

Rekomandimet për Komunë

Kryetarit të Komunës:

- Tërheqja e investitorëve të huaj, investime në ekonomi, subvencionimi i ekonomive të vogla, gjë që do të kishte si rezultat hapjen e vendeve të reja të punës dhe me këtë edhe uljen e shkallës së papunësisë,
- Sigurimi i aparateve mjekësore dhe i barnave për institucione mjekësore, në mënyrë që qytetarëve t'u sigurohet mbrojtja e duhur shëndetësore;
- Sigurimi i shërbimeve të transportit publik në nivelin lokal dhe regional, në veçanti në orët e pasdites,
- Përmirësimi i sektorit të komunalive (pastërtia publike), gjetja e zgjidhjes afatgjatë për mënjanimin e mbeturinave dhe mënjanimin e deponive të egra,
- Caktimi dhe mbajtja e debateve publike mbi punën e Komunës së Graçanicës, në mënyrë që qytetarët të konsultohen dhe të jenë të kyçur në punën e qeverisë lokale, me çka do të respektohej Ligji mbi vetëqeverisjen lokale,
- Monitorimi i rregullt i mbledhjeve të Kuvendit dhe i anëtarëve të Kuvendit në mënyrë që të përcillet puna e tyre (sa janë të kyçur në zgjidhje të problemeve, gatishmëria për diskutim...) dhe me këtë të nxitet puna e Kuvendit Komunal,
- Raportimi për qytetarë dhe shoqërinë civile lidhur me dokumentacionin me rëndësi publike, konsultimet me qytetarë në mënyrë që puna e pushtetit lokal të jetë më transparente,
- Të fillohet me mbledhjet e rregullta të Këshillit për Siguri në Bashkësi, ku do të merren vendime mbi rritjen e sigurisë në territorin e komunës së Graçanicës,
- Themelimi i komiteteve të tjera të parapara nga Kuvendi, me qëllim të shtjellimit më të hollësishëm të problemeve me të cilat ballafaqohet komuna,
- Qasja më serioze dhe përfshirja e mediave gjatë caktimit të diskutimeve publike dhe takimeve publike, me qëllim të pranisë sa më të madhe të qytetarëve.

Drejtoria për Urbanizëm:

- Kontrolli i zbatimit të planit urbanistik, në mënyrë realizimi i projekteve të jetë më i suksesshëm,
- Përgjegjësia më e madhe ndaj qytetarëve, konsultimi rreth projekteve kapitale si dhe marrja e mendimeve të qytetarëve gjatë realizimit të projekteve,
- Ndarja e barabartë e projekteve kapitale për të gjitha vendbanimet e komunës së Graçanicës.

Drejtoria për Financa:

- Investime më të mëdha në lëmin e zhvillimit ekonomik, posaçërisht në sektorët strategjikë të komunës së Graçanicës (bujqësia, turizmi veror),
- Azhurnimi i ueb-faqes me raporte të rregullta mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore, në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar,
- Të jenë më transparente ndaj qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile kur u kërkohet qasje në dokumentacion me rëndësi publike.

Kryesuesit të Kuvendit:

- Qasje më serioze, përgatitje për udhëheqjen e seancave si dhe njohuri e dispozitave ligjore,
- Trajtimi i barabartë i anëtarëve të opozitës me ata të pozitës,
- Nxitje nga ana e kryesuesit për të gjithë anëtarët e Kuvendit për zgjidhje më efikase të problemeve në rendin e ditës së Kuvendit,
- T'u mundësohet organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve që të marrin pjesë në mbledhjet e Kuvendit Komunal pa pengesa, si dhe në ato të komiteteve,
- Të mundësohet që mbledhjet e Kuvendit Komunal të jenë sa më transparente, dhe me këtë edhe më të përgjegjshme, me publikimin e transkripteve nga mbledhjet plenare dhe të komiteteve.

Anëtarëve të Kuvendit:

- Të njihen me problematikën e pikave të rendit të ditës, ta studiojnë materialin për punë para fillimit të mbledhjes,
- Të ofrojnë diskutime më cilësore, ashtu që të analizojnë thelbin e problemit,
- Pas konsultimit me qytetarë të komunës dhe me pushtetin lokal, mund t'i qasen parashtrimin të propozimeve,
- Qasje serioze të të gjitha pikave të rendit të ditës, respektimi i Kuvendit Komunal dhe vetëpërmbytje nga përdorimi i gjuhës joparlamentare,
- Përfaqësimi i qytetarëve, puna në të mirë të qytetarëve dhe komunikimi i rregullt me qytetarë dhe me shoqërinë civile.

Gracanica - Takimet e kuvendit dhe pjesëmarrja

Lloji i takimit	Numri	Pika në rendin e ditës	Gjithsej pjesëmarrja	Pjesëmarrja e grave
Seancat plenare (Gjithsej)	12	53	77.4%	35.5%¹
Janar	1	8	84%	37.5%
Shkurt	/	/	/	/
Mars	2	9	92%	34.3%
Prill	1	7	84%	37.5%
Maj	1	3	84%	37.5%
Qershor	3	7	75.4%	39.3%
Korrik	1	6	79%	40%
Gusht	1	2	57%	27.2%
Shtator	1	6	79%	33.3%
Tetor	1	5	63%	33.3%
Nëntor	/	/	/	/
Dhjetor	/	/	/	/
Komiteti për politikë dhe financa (Gjithsej)	12	50	88%	23%
Janar	1	8	100%	25%
Shkurt	/	/	/	/
Mars	2	9	93.7%	26.6%
Prill	1	7	100%	25%
Maj	1	3	100%	25%
Qershor	3	7	87.5%	28.5%
Korrik	1	4	87.5%	28.5%
Gusht	1	2	75%	16.6%
Shtator	1	5	75%	16.6%
Tetor	1	5	75%	16.6%
Nëntor	/	/	/	/
Dhjetor	/	/	/	/
	Gjithsej takime		Prania e shoqërisë civile	
Komiteti për siguri në bashkësi	2		Po	
	Gjithsej		Pjesëmarrja mesatare	
Diskutime publike	232		Persona	


¹ Përqindja e pjesëmarrjes së grave në raport me pjesëmarrjen e përgjithshme

- ²16 diskutime publike mbi buxhetin, dy diskutime publike mbi ndryshimin dhe plotësimin e statutit dhe propozimit të emërimit të rrugëve dhe vendbanimeve të komunës së Graçanicës, diskutimi publik mbi planin zhvillimor të komunës së Graçanicës, dy tubime mbi lokaiconin e varrezave ortodokse, një tubim mbi ndërtimin e largpërçuesit dhe vendosjes së shtyllave, një diskutim publik mbi eksproprijimin e tokës.

Rregulloret dhe vendimet


Dokumenti	Statusi	Votimi
Plani vjetor i punës së Komunës së Graçanicës	Aprovuar	Për: 16 Kundër: 0 Abst.: 0
Vendimi mbi rritjen e buxhetit për vitin 2012 nga të hyrat vetanake	Aprovuar	Për: 16 Kundër: 0 Abst.: 0
Plan ii veprimit për ndarje më të mire të buxhetit dhe menaxhimin më cilësor të Komunës së Graçanicës në vitin 2013	Aprovuar	Për: 17 Kundër: 0 Abst.: 0
Rregullorja e punës së Kuvendit komunal	Aprovuar	Për: 17 Kundër: 0 Abst.: 0
Ndryshimi dhe plotësimi i statutit	Aprovuar	Për: 18 Kundër: 0 Abst.: 0
Vendimi mbi ndërrimin e destinimit të tokës	Aprovuar	Për: 14 Kundër: 0 Abst.: 4
Rregullorja mbi ndarjen e subvencioneve	Aprovuar	Për: 18 Kundër: 0 Abst.: 0
Anulimi i vendimit të Kuvendit Komunal	Aprovuar	Për: 18 Kundër: 0 Abst.: 0
Vendimi i Kuvendit mbi ndërrimin e paluajtshmërisë me Agjencionin Kosovar për Privatizim	Aprovuar	Për: 18 Kundër: 0 Abst.: 0
Anulimi i Vendimit të Kuvendit mbi eksproprijimin e tokës	Aprovuar	Për: 13 Kundër: 3 Abst.: 2
Vendimi mbi shpalljen e interesit të përgjithshëm mbi pronën shoqërore të përfshirë në planin zhvillimor	Aprovuar	Për: 15 Kundër: 0 Abst.: 1
Vendimi mbi ribalansimin e buxhetit për vitin 2013	Aprovuar	Për: 16 Kundër: 0 Abst.: 0
Kërkesë për shfrytëzimin e hapësirave në pronësi të Komunës së Graçanicës	Aprovuar	Për: 15 Kundër: 0 Abst.: 1

Raporti Monitorimit 2013




Komuna Prizren

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



15. Komuna PRIZREN

Kuvendi i komunës së Prizrenit si organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale në të shumtën e Kuvendi i Komunës së Prizrenit si organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale, në të shumtën e rasteve gjatë mandatit 2010-2014, ka prodhuar situata të atilla që nuk kanë reflektuar në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të qytetarëve dhe ka qenë pjesë e shkeljeve ligjore.

Shkeljet ligjore

Fillimisht, Kuvendi i Komunës së Prizrenit kishte bërë shkelje me rastin e konstituimit të këtij organi, pas zgjedhjeve lokale 2009. Neni 42 i Ligjit për vetëqeverisje lokale rregullon çështjen e organizimit të seancës inauguruese dhe datën e certifikimit nga Komisioni Qendror Zgjedhor të rezultateve zgjedhore për anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit. Në bazë të kësaj, në muajin dhjetor 2009, është bërë certifikimi i rezultateve zgjedhore për Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe kjo e fundit ka qenë e obliguar që brenda një muaji të mbajë seancën konstituive. Meqenëse Kuvendi i Komunës së Prizrenit e ka mbajtur seancën konstituive më 15 shkurt 2009, arrijmë në konkludim se në këtë rast nuk është respektuar Ligji për vetëqeverisje lokale të Republikës së Kosovës.

Dy nënkryetarë nga komuniteti shumicë

Pos fillimit të punës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit me shkelje ligjore, edhe kryetari i Komunës së Prizrenit kishte filluar me shkelje të tilla. Kryetari i Komunës së Prizrenit kishte marrë vendim në shpërputhje me nenin 60 të Ligjit për vetëqeverisje lokale me rastin e emërimit të nënkryetarit të dytë nga radhët e komuniteti shumicë, ku rezultoi në shfuqizimin e këtij vendimi pas reagimeve të shumta të shoqërisë civile, por edhe MAPL-së si organ mbikëqyrës.

Seancat plenare

Kuvendin e Komunës së Prizrenit gjatë këtij mandati e ka përcjellë edhe mosrespektimi i procedurave ligjore që kanë të bëjnë me informimin e publikut mbi mbledhjet e këtij organi dhe numrin e mbajtjes së seancave gjatë një viti kalendarik duke shkelur nenin 43 dhe 43.2 të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Bojkoti i punimeve nga opozita dhe vetë pozita

Gjatë mandatit 2010-2013 të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, është vërejtur edhe bojkoti i punimeve të seancave nga subjektet politike të përfaqësuara në këtë kuvend. Fillimisht gjatë vitit 2010, opozita (subjektet opozitare) ishin pjesë e bojkotit të punimeve të seancave, mirëpo në fillim të vitit 2013, edhe vetë pozita u bë pjesë e bojkotit të punimeve të seancës së Kuvendit të Komunës së Prizrenit.

Bojkoti i mbledhjeve nga opozita, por edhe nga vetë pozita, ka qenë dëshmia më e madhe për mosefikasitetin e Kuvendit të Komunës në trajtimin e çdo shqetësimi të qytetarëve, të subjekteve politike dhe kontrollin e ekzekutivit komunal duke u bërë instrument pajtues për politikën “jo të mira” të ekzekutivit komunal.

Konflikt interesi dhe vendimi për dëfrim dhe qejfe

Në vendim tjetër i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, gjatë vitit 2013, ka qenë edhe vendimi për shkuarjen në ekskursion të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Me këtë vendim, pos që nuk

është pajtuar shoqëria civile, e ka quajtur skandaloz dhe me elemente të konfliktit të interesit.

Vendimi i tillë i Kuvendit të Komunës së Prizrenit ra ndesh me Ligjin për vetëqeverisje lokale; ku gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës ishin në konflikt interesi, ngase vendimi i tillë për shkuarjen në ekskursion ishte vendim i dëfrimit dhe qejfit të tyre pa u ndërlidhur me interesin qytetar.

Ky vendim ka tejkaluar mandatin e Kuvendit si institucion më i lartë i vetëqeverisjes lokale, vendim i cili fliste hapur që partia në pushtet kishte ngulfatur këtë institucion; në marrjen e vendimeve pa diskutime të mirëfillta dhe marrjen e vendimeve në interes personal të të gjithë anëtarëve duke vënë në rrezik përfaqësimin dinjitoz dhe interesin e qytetarit.

Komiteti për Politikë dhe Financa

Komiteti për Politikë dhe Financa nuk ishte pjesë e hartimit të buxhetit komunal. Mungesa e qasjes serioze në përfaqësim të interesave të qytetarëve ka rezultuar që buxheti i viti 2014 të votohej pa kontributin e 41 anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Prizrenit në hartimin e tij. Qarkorja Buxhetore 2014-01, e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave obligonte Komitetin për Politikë dhe Financa që të organizojë takime publike për të diskutuar prioritetet dhe strategjitë para aprovimit të këtij dokumenti. Mungesa e organizimit të dëgjimeve buxhetore nga Komiteti për Politikë dhe Financa reflektoj në kompetencë të vetme të Kuvendit në miratim të buxhetit, por jo edhe në pjesëmarrjen në hartimin e tij. Kuvendi dhe trupat e tij (komitetet obligative) duhet të jenë edhe pjesë e hartimit të buxhetit dhe jo vetëm të miratimit të kësaj politike publike.

Urbanizmi në Komunë

Prevalla dhe ndërtimet pa kriter - ogur zi për Kuvendin dhe ekzekutivin komunal. Shqetësimet e vazhdueshme të shoqërisë civile për çështjen e fshatit turistik Prevallë, këtë vit i parapriu një vendim i Ministrisë së Ambientit dhe i Planifikimit Hapësinor, ku ndaloi të gjitha ndërtimet dhe aktivitetet në këtë fshat.


Pas marrjes së vendimit nga e MAPH-së, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, i gjetur në një situatë të atillë, vendosi ta diskutojë çështjen e fshatit turistik Prevallë. Në seancën e korrikut, Kuvendi i Komunës së Prizrenit mori vendim ku obligoi ekzekutivin e Komunës gjegjësisht drejtoritë e caktuara të hartojnë një raport detal prej vitit 2006 e deri te vendimi i fundit i Ministrisë së Ambientit dhe të Planifikimit Hapësinor për ndërprerjen e të gjitha aktiviteteve në fshatin turistik Prevallë, dhe i njëjti raport të diskutohet deri në fund të muajit gusht.

Edhe përkundër këtij vendimi të Kuvendit të Komunës së Prizrenit për hartimin e një raporti detal nga ana e qeverisë lokale të Prizrenit, raporti i tillë asnjëherë nuk erdhi që të shqyrtohet në Kuvendin e Komunës. Kjo ishte edhe një dëshmi shtesë për mungesën e gatishmërisë së Kuvendit për të ruajtur rolin si organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale, por edhe la dyshime të vazhdueshme se përfaqësimi në këtë institucion mbetet në margjina të interesave të ngushta dhe sipërfaqësore duke mos pasur vullnetin politik dhe institucional që të trajtohen çështjet madhore siç ishte rasti i Prevallës, por edhe çështje të tjera të respektimit të planeve urbanistike dhe rregullative (ndërtimet pa kriter dhe mosrespektimi i këtyre planeve).

Betimi i anëtarëve mbeti vetëm betim i “thënë”


Me qasje joserioze, me vendime të dyshimta për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim dhe shkeljet sistematike ligjore e procedurale që nga konstituimi i këtij organi se “anëtarët e Kuvendit të Komunës së Prizrenit do t’i kryejnë me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit, detyrat dhe autorizimet si këshilltar i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë” , mbeti vetëm betim i thënë me rastin e konstituimit të këtij institucioni.

Raporti Monitorimit 2013




Komuna Suharekë

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



16. Komuna SUHAREKË

Kuvendi i Komunës së Suharekës si organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale në të shumtën e rasteve gjatë mandatit 2010-2014, ka prodhuar situata të atilla që nuk kanë reflektuar në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të qytetarëve dhe ka qenë pjesë e shkeljeve ligjore.

Transparenca në Komunë

Në Kuvendin e Komunës së Suharekës edhe më tej vazhdon trendi i hartimit të procesverbaleve prej vetëm 2-3 faqesh raport nga mbledhjet e këtij organi, gjë e cila u pamundëson qytetarëve informim të drejtë dhe të plotë mbi diskutimet e realizuara nga të zgjedhurit e tyre në organin më të lartë të vetëqeverisjes lokale.

Ajo çka vlen të potencohet se Kuvendi i Komunës së Suharekës ka proceduar me seancë të rregullt më 8 qershor, pa përfunduar seancën e datës 30 maj. KDI-ja konsideron se më këtë rast ka pasur shkelje procedurale ngase nuk mund të fillohet me mbajtjen e seancës së rregullt pa përfunduar ajo paraprake, andaj edhe duhet të evitohen këto shkelje nga ana e kryesuesit të Kuvendi të Komunës së Suharekës.

Nuk u raportua për menaxhimin financiar

Edhe Kuvendi i Komunës së Suharekës, gjatë mandatit katërvjeçar 2010-2013, nuk ka qenë pjesë e mbikëqyrjes së menaxhimit të parasë publike nga ana e ekzekutivit komunal. Në të shumtën e rasteve, kryetari i Komunës së Suharekës nuk ka raportuar për shpenzimet e rregullta tremujore financiare në Kuvendin e Komunës.

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave dhe përgjegjësitë, kryetari i Komunës duhet të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kuvendit Komunal raporte tremujore, të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit, i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen Kuvendit Komunal dhe një kopje duhet t'i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga kryetari i Komunës në faqen e internetit të Komunës. Çdo raport i këtillë duhet të paraqesë informatat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, së bashku me një përmbledhje të statusit të të gjitha projekteve kapitale të shpenzimit.

Shkeljet ligjore

Në njërën nga seancat e mbajtura gjatë mandatit katërvjeçar 2010-2013, kryetari i Komunës, bashkë me kryesuesin, kanë bërë shkelje të Ligjit për vetëqeverisje lokale duke mos i pajisur anëtarët e Kuvendit me materialin përcjellës për pikën e rendit të ditës, edhe përkundër obligimit ligjor që materialet për pika të rendit të ditës duhet të jenë në dispozicion për të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës, e jo vetëm për një grup parlamentar.

U fyen anëtarët e Kuvendit nga Sekretaria

Gjatë këtij mandati të Kuvendit të Komunës së Suharekës, në disa raste nuk është respektuar parimi i dhënies së përgjigjeve nga ana e ekzekutivit komunal të Suharekës, në pyetjet e bëra nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë nga kryetari informacione që janë të nevojshme për punën e tij si këshilltar. Nëse nuk është i kënaqur me përgjigjen, ai apo ajo mund ta ngrejë çështjen në Kuvendin e Komunës. Udhëzimi i Sekretarisë së Kuvendit që anëtarët të procedojnë me kërkesa për qasje në dokumente publike ka qenë fyerje për anëtarët dhe vetë institucionin dhe në kundërshtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale.

Urbanizmi në Komunë

Kuvendi i Komunës së Suharekës, gjatë këtij mandati, ka dhënë pronën komunale në shfrytëzim duke anashkaluar Udhëzimin Administrativ 2012/02 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale.

Duke u bazuar në neni 4.1 i këtij udhëzimi administrativ, i cili thotë: “ Prona e paluajtshme publike komunale jepet në shfrytëzim në procedurë të hapur, transparente dhe jodiskriminuese, përmes ankandit të hapur publik, duke u bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme për komunën dhe qytetarët e saj. Po ashtu, neni 6.1 i këtij udhëzimi administrativ thotë: “Pas zhvillimit të procedurave ligjore për dhënien e pronës komunale dhe pas vlerësimit final të ofertave përmes ankandit publik nga Komisioni i përbashkët i Kuvendit të Komunës dhe ekzekutivit të Komunës, i rekomandon Kuvendit të Komunës ofertën më të favorshme ekonomike, apo ofertat me kushte të njëjta, për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme publike të Komunës”.


Nga raporti i Komisionit janë specifikuar tre operatorë të përgjegjshëm, ku njëri prej tyre ka dhënë ofertën më të mirë, mirëpo anëtarët e Kuvendit kanë proceduar me votim të fshehtë, i cili ka rezultuar që ofertuesi me çmim më të mirë dhe ekonomikisht më i favorshëm për Komunën të mos votohet nga ana e anëtarëve. Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Suharekës me këtë rast nuk janë treguar parimorë në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të qytetarëve të Komunës së Suharekës, por për mbrojtjen e interesave të caktuara grupe duke e anashkaluar ofertuesin ekonomikisht më të favorshëm.

Vendimet e miratuara

Në bazë të Statutit të Komunës së Suharekës, thuhet se “për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të komiteteve të tij, mbahet procesverbali. Procesverbali përfshin emrat (evidencën) e anëtarëve të pranishëm dhe të anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret me emër secili anëtar, në procesverbal shënohet si ka votuar secili. Procesverbalin e mban një shërbyes civil, i caktuar nga shefi i shërbimit të kryetarit të Komunës. Kryesuesi e nënshkruan procesverbalin e miratuar nga Kuvendi”.


Lidhur me këtë, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Suharekës pothuajse në vazhdimësi ka bërë shkeljen e këtij neni të Statutit të Komunës së Suharekës duke mos potencuar numrin e votave pro, kundër apo abstenim në marrjen e vendimeve, duke lënë hapësirë që votimet të jenë uniforme, pa proceduar ashtu siç kërkohet me Statut të Kuvendit të Komunës së Suharekës.

Raporti Monitorimit 2013




Komuna Rahovec

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



17. Komuna RAHOVEC

Kuvendi i komunës së Rahovecit si organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale në të shumtën e rasteve gjatë mandatit 2010-2014 ka prodhuar situata të atilla që nuk kanë reflektu në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të qytetarëve dhe ka qenë pjesë e shkeljeve ligjore.

Seancat Plenare

Edhe Kuvendi i Komunës së Rahovecit pas zgjedhjeve lokale 2009 kishte filluar konstituimin dhe punën me shkelje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale përkatësisht Neni 50 i cili parasheh që “Kuvendi i Komunës duhet të shpallet jofunksionues nëse nuk e zgjedh kryesuesin tridhjetë (30) ditë pas themelimit”. Duke pas parasysh se Kuvendi i Komunës së Rahovecit seancën konstituive e ka mbajtur më 06.01.2010 ndërkohë që zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës e ka bërë në mbledhjen e datës 12.02.2010, pra gjashtë (6) ditë pas afatit ligjor, arrijmë në konkludim se në rastin e zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit nuk është respektuar Neni 50 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

Në kuadër të monitorimit të punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit, Instituti Demokratik i Kosovës ka vërjetë edhe mungesën e respektimit të nenit 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nën ky i cili i obligon kuvendet e komunave që të mbajnë dhjetë seanca brenda vitit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit. Kuvendi i Komunës së Rahovecit nuk ka vepruar në përputhje me Nenin 43.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale sipas së cilës Kuvendi i Komunës mban së paku dhjetë seanca në vit, pesë prej të cilave duhet të mbahen gjatë gjashtë muajve të parë të vitit.

Lëshimi i seancave nga ana e anëtarëve

Gjatë këtij mandati të punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit është parë një papërgjegjësi e anëtarëve në qëndrimin e tyre deri në fund gjatë punimeve të seancës. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, anëtarët e kuvendit të komunës detyrohen të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e kuvendit, të thirrura në mënyrë të duhur në komisionet ku ata janë anëtarë, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të justifikueshme për mungesën e tyre.

Ajo çka vlen të potencohet ka qenë mungesa e anëtarëve të pranishëm gjatë mbledhjeve përkatësisht lëshimi i seancës para përfundimit të saj. Për më tepër herë pas here ka munguar edhe kuorumi gjatë diskutimit ngase nuk ishin të pranishëm 16 anëtarë nga gjithsej 31 sa ka Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

Komiteti për Politik dhe Financa

Komiteti për Politik dhe Financa si trup punues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit gjatë mandatit katërvjeçar ka shkelur Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në ligj; Kuvendi i komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për: miratimin e buxhetit dhe planeve investuese; miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për kuvendin sipas statutit apo rregullores së punës. Ky organ i Kuvendit ka bërë shkelje të kësaj dispozite ligjore ngase ka miratuar rishikimin e buxhetit për periudhën e dytë të vitit fiskal 2012 pa kaluar në Kuvendin e Komunës së Rahovecit.

Transparenca në Komunë

Edhe Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë mandatit katër vjeçar 2010-2013 nuk ka qenë pjesë e mbikëqyrjes së menaxhimit të parasë publike nga ana e ekzekutivit komunal. Në të shumtën e rasteve Kryetari i Komunës së Rahovecit nuk ka raportuar për shpenzimet tremujore financiare në Kuvendin e Komunës.

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave dhe përgjegjësit, Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje duhet t'i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga kryetari i komunës në faqen e internetit të komunës. Çdo raport i këtillë duhet të paraqesë informatat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni së bashku me një përmbledhje të statusit të të gjitha projekteve kapitale të shpenzimit.

Miratohen rregullore pa ju nënshtruar dëgjimit publikë

Kuvendi i Komunës së Rahovecit gjatë mandatit katër vjeçar miratojë Rregullore komunale për përfshirjen e tyre në diskutimet publike. Duke u bazuar në Udhëzimin administrativ 2008/09 për transparencë në Komuna lidhur me konsultimin e publikut para miratimit të akteve komunale thotë “aktet normative të Kuvendit të Komunës dhe organeve tjera komunale përfshirë rregulloret dhe vendimet i nënshtrohen diskutimit publik para miratimit”.


KDI ka kritikuar Kuvendin e Komunës së Rahovecit për anashkalim të publikut në miratimin e akteve komunale siç janë rregulloret dhe ka kërkuar nga ekzekutivit komunal që rregulloret e draftuara të shqyrtohen në publik para se ato të procedohen në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi kërcohet nga ekzekutivi

Në seancën e datës 27.07.2012 nga ana e trupprojës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit janë kërcënuar anëtarët e Kuvendit gjatë punimeve të seancës. Tendencat e tilla për shantazhe dhe kërcënime dëmtojnë demokracisë institucionale dhe interesin e qytetarëve në raport me përfaqësuesit e tyre legjitim.


KDI pat kërkuar nga Kryetari i Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të krijojnë kushte më të mira për mbarëvajtjen e punimeve të seancave të kuvendit. Po ashtu kërkon që të ndërmerren masa adekuate ndaj personit i cili ka bërë presion tek anëtarët dhe ka vë në pikëpyetje mbarëvajtjen e punëve në institucionet e vetëqeverisjes lokale.

Raporti Monitorimit 2013




Komuna Dragash

Kuvendi Komunal



Dega Ekzekutive



18. Komuna DRAGASH

Kuvendi i komunës së Dragashit si organ më i lartë i vetëqeverisjes lokale, gjatë mandatit 2010-2014, në disa raste ka prodhuar situata të atilla që nuk kanë reflektuar në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm të qytetarëve dhe ka qenë pjesë e shkeljeve ligjore.

Transparenca në Komunë

Nuk raportohet për menaxhimin financiar. Edhe Kuvendi i Komunës së Dragashit gjatë mandatit katër vjeçar 2010-2013 nuk ka qenë pjesë e mbikëqyrjes së menaxhimit dhe shpenzimit të parasë publike nga ana e ekzekutivit komunal. Në të shumtën e rasteve Kryetari i Komunës së Dragashit nuk ka raportuar për shpenzimet e rregullta tre-mujore financiare në Kuvendin e Komunës.

Duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave dhe përgjegjësit, Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar. Këto raporte duhet t'i dorëzohen kuvendit komunal dhe një kopje duhet t'i dorëzohet ministrit brenda tridhjetë (30) ditëve pas përfundimit të çdo tremujori dhe më pas duhet të publikohen nga kryetari i komunës në faqen e internetit të komunës. Çdo raport i këtillë duhet të paraqesë informatat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni së bashku me një përmbledhje të statusit të të gjitha projekteve kapitale të shpenzimit.

U ndryshuan pikat e rendit të ditës në seancën e jashtëzakonshme

Gjatë mandatit katër vjeçar të punës së Kuvendit të Komunës së Dragashit, në një rën nga seancat e thirrura ky institucion ka bërë shkelje të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për shkak të të ndryshimit të pikave të rendit të ditës edhe përkundër asaj se kjo seancë është thirr si e jashtëzakonshme.

Duke ju referuar ligjit për vetëqeverisje lokale i cili fletë për thirrjet e seancave të jashtëzakonshme thotë “e drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshin të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar dhe pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes”.

Nuk u pajisen me material për pika të rendit të ditës

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim, ashtu siç kërkohet, shtatë (7) ditë pune para mbajtjes së mbledhjes. Në njoftimin e tillë shkruhet: data e mbajtjes së mbledhjes; koha e mbajtjes së mbledhjes; vendi i mbajtjes së mbledhjes; rendi i ditës për mbledhje; dhe materialet e mbledhjes”.

Kuvendin e Komunës së Dragashit në mandatin katër vjeçar e ka përcjellë edhe shkelja e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për mos dërgimin e materialeve në kohë tek anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe miratimi i vendimit pa qenë pjesë e rendit të ditës.

Shkeljet Ligjore

Një shkresë e institucioneve qendrore (MAPL) dërguar Kryetarit dhe Kuvendit të Komunës së Dragashit obligonte në shfuqizimin e vendimeve me nr. 06-137/1 i datës 27.08.2009 dhe vendimi nr. 06-47/1 i datës 25.05.2010; vendime këto të cilat kishin shfuqizuar aktvendimin e Këshillit Popullorë të Komunës së Dragashit të datës 20.05.1960 me nr 1536/60.

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Dragashit në njërën nga seancat e mbajtura në këtë mandat nuk gjetën gatishmërinë e shfuqizimit të këtyre vendimeve edhe përkundër obligimit nga organi i mbikëqyrjes së ligjshmërisë së vendimeve komunale (MAPL) që këto dy vendime të shfuqizohen.

Përfundimet

Mandati i ri është një mundësi e re për të lënë gjurmë të mira në qeverisje të mirë, sidomos nëse udhëheqja e qeverisë komunale merret për herë të parë. Andaj kryetarët, kryesuesit dhe anëtarët e kuvendit duhet të fillojnë punën me përgjegjësi dhe të mos përsërisin të metat e qeverisje lokale që janë paraqitur në këtë raport dhe të vazhdojnë dhe avancojnë të arriturat të ka bërë qeverisja lokale në Kosovë dhe komunën e tyre.

Si vëzhgues, kemi vërejtur që OJQ-të dhe zërat e qytetarëve shpesh merren si zëra përjashtues nga Kryetarët e Komunave pasi që ato nganjëherë duken tejet kritike. Mirëpo duhet pasur parasysh që shoqëria civile duhet të jetë kritike konstruktive që vihen në pah përshtypjet e tyre dhe të mund të fillohet një debat që përmirëson qeverisjen komunale apo politikën komunale.

Qeverisja e mirë është një proces që nganjëherë është i vështirë dhe merr kohë mirëpo kështu e ka demokracia që është dëshmuar si mënyra më e mirë e qeverisjes edhe pse ka të meta. Demokracia, përpos tjerash, nënkupton përfaqësim të qytetarëve, të gjithë qytetarëve, kurse qeverisja e mirë e vë në zbatim demokracinë.

Shoqëria civile mund të jetë partnere strategjike për të ndjekur një qeverisje të mirë. Shoqëria civile nuk përfshinë vetëm OJQ-të për demokratizim siç shpesh nënkuptohet nga disa zyrtar komunal, por edhe grupe qytetarësh të ndonjë lagje, përfaqësuesit e fshatrave, shoqatat profesioniste (si ajo e arkitektëve, artistëve, ekonomistëve). Gjitha këto janë shoqëri civile dhe mund të kenë rol konstruktiv në procese të caktuara të komunës. Aftësia e një kryetari për të përfshirë këto grupe në punën e qeverisë komunale është përcaktuese për qeverisje të mirë.

Dispozitat ligjore si obligimi vjetor për së paku dy takime me qytetarë, 10 seanca të kuvendit, si dhe dispozitat nën-ligjore si udhëzimi administrativë për themelimin e këshillave lokal dhe për themelimin e komiteti për këshillat për siguri janë norma në drejtim të duhur për të siguruar llogaridhënie dhe efikasitet të komunave mirëpo nuk duhet të shihen nga udhëheqësit e qeverive lokale si standarde ligjore që duhet përmbushur. Qeveritë lokale duhet të jenë më aktive në marrjen e nismave ligjore që rezultojnë nga konsultimet me qytetarë dhe përfaqësues të këshillave lokal, si dhe takime të rregullta me lagje dhe fshatra nga gjitha anët e komunës për çështje që i prekin më direkt këto lokalitete.

Përderisa takimet e kuvendeve komunale janë të hapura, duhet të sigurohen ulëse për qytetarë si dhe takimet e kuvendeve komunale dhe rendin e ditës të bëhen publike edhe për qytetarë.

Njëjtë si kryetarët e sapo zgjedhur edhe kryetarët në mandatin e kaluar kanë bërë premtime për afërsi me qytetarë, llogari për punën e tyre dhe transparencë komunale mirëpo shumë pak janë realizuar në praktikë. Andaj dhe kemi titulluar këtë punim si pyetje më shumë për kryetarët e ri se “A do të mbetën premtimet e tyre premtime zgjedhore që harrohen pasi të jenë zgjedhur apo do të përpjekën ti bëjnë realitet? Praktika tregon se një vend i emancipuar dhe i vetëdijetësuar me procesin demokratik duhet të vëjë në praktikë qeverisjen e mirë, edhe nëse merr më shumë kohë, dhe jo vetëm të flitet për të.